



KONFERENCË KOMBËTARE

"Roli aktiv i organizatave jofitimprurëse në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, përmes instrumenteve kushtetuese e ligjore"

(Organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë)

Tiranë, 28 Qershor 2011

PROCEEDINGS BOOK

Tiranë, 2011

**Ky botim u realizua me mbështetjen e:
AVOKATIT TË POPULLIT
dhe
PROGRAMIT TË GRANTEVE TË VOGLA TË KOMISIONIT
PËR DEMOKRACI,
të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.**

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© *E drejta e Autorit: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
& Avokati i Popullit*

**Radhitja në kompjuter: Autorët
Realizimi grafik: Enkelejda Misha**

Shtëpia Botuese

ISBN: 978-99943-706-6-5

PASQYRA E LËNDËS

Program i Konferencës	7
Gudar Beqiraj , Kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë Fjala e Përshëndetjes	11
Arta Mandro-Balili Avokati i Popullit dhe mbështetja e shoqërisë civile, në mbrojtje të të drejtave të njeriut ndaj cenimeve të administratës publike	13
Florina Nuni, Alma Vokopola Institucioni i Avokatit të Popullit, sfidat e tij në krijimin e një ure bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore.	31
Erind Mërkuri, Aurela Anastasi Mbrojtja e interesave të organizatave jofitimprurëse, përmes Gjykimit Kushtetues.	40
Elsa Dobjani Legjitimimi i organizatave jofitimprurëse në optikën e Gjykatës Kushtetuese	56
Eralda Methasani, Arta Vorpsi Roli i OJF-ve në forcimin e të drejtave dhe lirive themelore e interesave kolektive, përmes gjykimit të zakonshëm e atij kushtetues.	69
Denar Biba Ndihmesa e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, përmes gjykimit kushtetues në Shqipëri.	87

Arjana Fullani

Ndërhyrja kryesore e dytësore në procesin civil. Si duhet të kuptohet nga organizatat e shoqatat? 100

Suela Janina, Ledia Hysi

Roli i organizatave jofitimprurëse amicus curie pranë gjykatave ndërkombëtare në çështjet e të drejtave të Njeriut. 113

Klesta Hysi, Etilda Saliu (Gjonaj)

Aktivizimi i organizatave jofitimprurëse në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, pranë GJEDNJ. Përvoja e e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. 123

Orjona Mucollari, Mirela Bogdani, Jola Xhafo,

Organizatave jofitimprurëse si kategori e mbrojtësve të të drejtave të Njeriut 135

Monika Kocaqi

Parimet e efektivitetit të zhvillimit të shoqërisë civile si kusht i domosdoshëm për arritjen dhe respektimin e drejtësisë dhe të drejtave njerëzore. 142

Anila Nepravishta

Fëmijët në konflikt me ligjin dhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me shoqërinë civile në promovimin e garantimin e interesit më të mirë të tyre". 156

Iris Luarasi

Pasqyrimi në mediat e shkruara dhe elektronike i veprimtarisë së OJF-ve për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, përmes mjeteve ligjore. 173

Albana Shtylla

Organizatave e sindikale dhe roli i tyre në garantimin e të drejtave të punëmarrësve që burojnë nga marrëdhënia juridike e punës 181

Elisabeta Imeraj

Bashkëpunimi i Prokurorit me organizatat jofitimprurëse, për mbrojtjen e të drejtave të viktimeve të Trafikimit të qenieve njerëzore. Rastet e dëmshpërblimit. 192

Emira Shkurti

Çështje të kontraktimit të OJF-ve nga institucionet, për ofrimin e shërbimeve me natyrë publike.203

Aurela Bozo, Erviola Stoja

Konventa CEDAW dhe Protokolli Fakultativ i kësaj Konvente- si mjete ndërkombëtare për garantimin e të drejtave të grave.212

PROGRAMI I KONFERENCËS

QENDRA PËR NISMA LIGJORE DHE QYTETARE (QNL)
në bashkëpunim me
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

organizojnë:

KONFERENCËN SHKENCORE KOMBËTARE

**“ROLI AKTIV I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE NË
MBROJTJE TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT,
PËRMES INSTRUMENTEVE KUSHTETUESE E LIGJORE”**

Bordi i Shkencor i Konferencës:

1. Prof. Dr. Gudar Beqiraj, Akademik
2. Prof. Dr. Aurela ANASTASI, Akademike e Asociuar
3. Prof. Luan Omari, Akademik
4. Prof. Dr. Arta Mandro
5. Florina Nuni, Avokate e Popullit në Detyrë
6. Dr. Evis Alimehmeti, Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë
7. Prof. Dr. Xhezair Zaganjori

Tiranë, e premte, 24 Qershor 2011, pranë sallës “Aleks Buda”,
në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

me mbështetjen e Programit të Granteve të Vogla të Komisionit
për Demokraci, të Ambasadës së SH.B.A, Tiranë.

Paneli i Përbashkët. Salla "Aleks Buda"

09.00 - 09.30 Regjistrimi i pjesëmarrësve.

09.30 - 10.00- Hapja e Konferencës

Prof. Dr. Aurela Anastasi, Drejtore e QNL, pedagoge UT
Përhëndesin Konferencën:

Z. Gudar Beqiraj, Kryetar i Akademisë së Shkencave të RSH- së
Përfaqësues i Ambasadës së SHBA-së, në Tiranë

10.00-11.00- Referate shkencore

1. Avokati i Popullit dhe mbështetja e shoqërisë civile, në mbrojtje të të drejtave të njeriut ndaj cenimeve të administratës publike.

Prof. Dr. Arta Mandro-Balili, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë

2. Institucioni i Avokatit të Popullit, sfidat e tij në krijimin e një ure bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore.

Florina Nuni, Avokate e Popullit në Detyrë, Doktorante, UT

Alma Vokopola, Këshilltare ligjore pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, Doktorante, UT

3. Mbrojtja e interesave të organizatave jofitimprurëse, përmes Gjykimit Kushtetues.

Av. Erind Mërkuri, As-pedagog, Doktorant, UT

Prof. Dr. Aurela Anastasi

4. Legjitimimi i organizatave jofitimprurëse në optikën e Gjykatës Kushtetuese.

Elsa Dobjani, këshilltare pranë Gjykatës Kushtetuese të RSH-së,
Doktorante, UT

11.00-11.45 Sesion Pyetje-Përgjigje, Diskutime.

11.45-12.00 Pushim Kafe

Ora 12.00-14.00 - Paneli I. Salla "Aleks Buda"

moderator: Petraq Pojani

Organizatave jofitimprurëse si subjekte që vënë në lëvizje gjykatën Kushtetuese, gjykatat e zakonshme dhe gjykatat ndërkombëtare

1. Roli i OJF-ve në forcimin e të drejtave dhe lirive themelore e interesave kolektive, përmes gjykimit të zakonshëm e atij kushtetues.

Dr. Eralda Methasani (Fakulteti i Drejtësisë, UT), Dr. Arta Vorpsi, Gjykata Kushtetuese

2. Ndhimesa e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, përmes gjykimit kushtetues në Shqipëri.

Denar Biba, (Doktorant, UT)

3. Ndërhyrja kryesore e dytësore në procesin civil. Si duhet të kuptohet nga organizatat e shoqatave?

Arjana Fullani, anëtare e Gjykatës së Lartë (Doktorante, UT)

4. Roli i organizatave jofitimprurëse *amicus curie* pranë gjykatave ndërkombëtare në çështjet e të drejtave të Njeriut.

Suela Janina, Ledia Hysi, (Doktorante, Fakulteti i Drejtësisë, UT)

5. Aktivizimi i organizatave jofitimprurëse në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, pranë GJEDNJ. Përvoja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Klesta Hysi, Doktorante, UT, Av. Etilda Saliu (Gjonaj), Komiteti Shqiptar i Helsinkit

6. Organizatat jofitimprurëse si kategori e mbrojtësve të të drejtave të njeriut

Dr. Orjona Muçollari, Dr. Mirela Bogdani, Dr. Jola Xhafo, pedagoge, Fakulteti i Drejtësisë, UT

7. Parimet e efektivitetit të zhvillimit të shoqërisë civile si kusht i domosdoshëm për arritjen dhe respektimin e drejtësisë dhe të drejtave njerëzore.

Monika Kocaqi, Doktorante UT

Ora 12.00-14.00

Paneli II. Salla e "Bibliotekës së Akademisë së Shkencave",
moderatore: Arta Mandro

**Bashkëpunimi i shoqërisë civile me institucionet publike dhe
presioni ndaj tyre, mjet i rëndësishëm për mbrojtjen e të
drejtave të njeriut**

8. "Fëmijët në konflikt me ligjin dhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me shoqërinë civile në promovimin e garantimin e interesit më të mirë të tyre".

Anila Nepravishta, Komisionere, Zyra e Avokatit të Popullit, Doktorante, UT

9. Pasqyrimi në median e shkruar dhe elektronike i veprimtarisë së OJF-ve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes mjeteve ligjore. Iris Luarasi, Pedagoge UT, Drejtore e Linjës së këshillimit për gra dhe vajza, Tiranë

10. Organizatat sindikale dhe roli i tyre në garantimin e të drejtave të punëmarësve që burojnë nga marrëdhënia juridike e punës Albana Shtylla, (Doktorante UT)

11. Bashkëpunimi i Prokurorit me organizatat jofitimprurëse, për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Rastet e dëmshpërblimit.

Elisabeta Imeraj, Prokurore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë

12. Çështje të kontraktimit të OJF-ve nga institucionet, për ofrimin e shërbimeve me natyrë publike.

Emira Shkurti LLM, pedagoge, Fakulteti i Drejtësisë, UT

13. Konventa CEDAW dhe Protokolli Fakultativ i kësaj Konvensioni mjete ndërkombëtare për garantimin e të drejtave të grave.

Aurela Bozo, (Doktorante UT), Avokate pranë QNL-së

Erviola Stoja, Prokurore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda

**14.00-15.00 - Mbyllja e Konferencës dhe Drekë - koktej për
pjesëmarrësit**

Gudar BEQIRAJ

*Kryetar i Akademisë së Shkencave
të Republikës së Shqipërisë*

FJALA E PËRSHËNDETJES

Të nderuar të ftuar!

Të nderuar akademikë,

Të nderuar përfaqësues të organizatave dhe të shoqatave,

Të nderuar pedagogë të Universitetit të Tiranës,

Të nderuar studentë!

Kam kënaqësi të veçantë, që në emër të organizatorëve të kësaj Konference, t'ju përshëndes e t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj sot, në këtë ngjarje të përbashkët. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë vlerëson se, roli aktiv i organizatave jofitimprurëse, aftësimi dhe forcimi i tyre për të përdorur instrumentet e caktuara nga Kushtetuta e ligji, përbëjnë një garanci të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ne mendojmë se analiza dhe shqyrtimi i kësaj çështje është i lidhur ngushtë me vetë mbarëvajtjen e Shtetit të së drejtës, me rritjen e pjesëmarrjes së publikut në qeverisje, si dhe me fatin e demokracisë shqiptare. Një rol aktiv i organizatave jofitimprurëse dhe organizatave të tjera në mbështetje të të drejtave të njeriut, do t'i vendoste ato në një pozicion të pazëvendësueshëm, si përçuese të zërit të qytetarëve, me qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, nga institucionet publike. Gjithashtu, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat e tjera, në vijim të veprimtarisë së tyre në kuadrin e shërbimeve që ofrojnë për

qytetarët në nevojë, advokacisë dhe lobimit, kanë detyrë që të rrisin aftësitë e tyre në mënyrë të vazhdueshme, për të përdorur dobishëm mjetet që ofron për to, Kushtetuta dhe ligji. Në vitin 1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionoi shprehimisht, të drejtën e organizatave për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me anë të kërkesës, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Përpos kësaj, veçanërisht në këto 10 vitet e fundit, një sërë aktesh ligjore kanë sanksionuar detyrimin e organeve shtetërore për të bashkërenduar veprimtarinë e tyre me atë të organizatave jofitimprurëse të specializuara. Për më tepër, ligjet kanë afirmuar shprehimisht të drejtën e këtyre organizatave për të përfaqësuar përpara gjykatave dhe organeve të tjera, qytetarët në nevojë. Në këtë kuadër, zbatimi i ligjeve “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Për barazinë gjinore në Shoqëri”, kërkon një njohje të mirë nga të gjitha organizatat që operojnë në këto fusha, me qëllim që t’i përdorin ato me efikasitet e dobishmëri në të gjitha rastet që paraqitet nevoja. Gjithashtu, detyra të rëndësishme shtrohen për organizatat, edhe në kuadër të përdorimit të instrumenteve pranë gjykatave dhe organizatave ndërkombëtare. Ne mendojmë se organizatat kombëtare shqiptare duhet të aftësohen me qëllim që të përdorin ndërhyrjen si palë e tretë në gjykim, pranë Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ose për të paraqitur kërkesa pranë komiteteve të OKB-së, të krijuara për zbatimin e Konventave Ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të Njeriut.

Në gjithë këtë këndvështrim, shpresojmë dhe urojmë që kjo konferencë e përbashkët, të jetë një mjet i mirë për të analizuar punën e kryer deri tani në këtë drejtim, me qëllim që të nxjerrim konkluzionet e duhura për përmirësimin e saj në të ardhmen.

Ju faleminderit! I uroj suksese punimeve të Konferencës!

Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI¹

**AVOKATI I POPULLIT INSTRUMENT EFEKTIV DHE
MBËSHTETËS NË ROLIN E SHOQËRISË CIVILE PËR
MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NDAJ
CENIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

I. Hyrje

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, aksesit në të drejtë dhe në sistemin e drejtësisë si edhe në institucionet e tjera - janë elementët bazë dhe tregues cilësorë të shtetit të së drejtës. Ndërkohë që kuadri ligjor është gjithnjë e më pranë standardeve ndërkombëtare dhe ka tendencën që të harmonizohet në vazhdimësi me to, nuk mund të themi që kemi arritur gjithçka dëshirojmë. Përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe përdorimi i institucioneve nga shtetasit dhe operatorë të tjerë, ka ende vend për përmirësim dhe ende ka vështirësi.

Në skemën e institucioneve në mbrojtje të të drejtave të njeriut, një vend të veçantë ka Avokati i Popullit. Interaktiviteti ndërmjet OJF dhe këtij institucioni është shumë i rëndësishëm me qëllim që secili të realizojë me sukses dhe në mënyrë adekuate misionin e vet. Qartësia e detyrave dhe përgjegjësisë të një institucioni bën që kërkesat dhe pretendimet të drejtohen aty ku duhet dhe sigurojnë efektivitetin e çdo shërbimi. E kundërta është vetëm sorollatje, stres e humbje kohe si edhe cenim i së drejtës. Kështu, me qëllim që OJF-të të luajnë sa më

¹ Përgjegjëse e Trajnimit vazhdues të gjyqtarëve e prokurorëve, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë

mirë rolin dhe të përmbushin misionin e tyre, nevojitet të kenë një informacion sa më adekuat lidhur me institucionet të cilave mund t'i drejtohen e t'i mbështesin në zgjidhjen e një problemi.

Në rastin konkret, OJF-të duhet të njohin se çfarë kompetencash ligjore ka Avokati i Popullit dhe a mund e si mund t'i drejtohen këto këtij institucioni, me qëllim që të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat dhe instrumentet në dispozicion për mbrojtjen e një të drejte dhe të një interesi të ligjshëm. Në veprimtarinë e tyre në raport me këtë institucion OJF-të hasin disa vështirësi. Këto janë të lidhura me pasigurinë që vjen nga mos njohja e ligjit. Por duhet pranuar se mekanizmat institucionale jo gjithnjë janë treguar konsekuente dhe me nivel të lartë ose optimal profesional ndaj kërkesve, trajtimit të kërkesës, pretendimit, ankesës, njoftimit të bërë, etj. nga ana e OJF-ve. Kështu në vend të nxitjes në mbrojtje të së drejtës, këto qëndrime të institucioneve, kanë ndikuar në dekurajimin dhe janë bërë frenues ndaj aksesit në shërbimin që ofrojnë. Herë të tjera ka një ndrojtje dhe tërheqje për shkak të mos njohjes prej të interesuarve të mundësive ose pasigurisë e padijenisë lidhur me mënyrën dhe mjetin e kërimit të një të drejtë të cenuar apo që pretendohet si e tillë. Ndonjëherë ligji ka qenë një “zbukurim” i pa shoqëruar me strukturat adekuate qoftë në kuptimin e burimeve njerëzore ashtu edhe të institucioneve referuese.

Në përpjekjet për respektimin e të drejtave të njeriut, një vend të veçantë zë shoqëria civile dhe OJF. Në skemën e institucioneve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut një rol të veçantë ka Avokati i Popullit. Në vijim do të ndalemi në disa aspekte që duhen njohur lidhur me institucionin e Avokatit të Popullit dhe që janë në interes të shoqërisë civile për ta “përdorur” këtë mekanizëm për realizimin efektiv të misionit të vet.

II. Misioni dhe detyrat e Avokati i Popullit me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qasja me rolin e OJF.

Për këtë do të ndalemi në disa ligje që përbëjnë bazën kryesore si për veprimtarinë e OJF-ve ashtu edhe të Avokatit të Popullit, të

cilët siç duket, duhet të jenë bashkëpunëtorë në përpjekjet për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga diversiteti në një sërë drejtimesh, një analizë gjithëpërfshirëse na çon në konkluzionin, se nuk janë ta pakta kontaktet e misionit të Avokatit të Popullit me ato të OJF-ve.

Sipas Kushtetutës së RSH [përkatësisht nenet 60-63; 134]² dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”³, Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të *administratës publike*. Në këtë mënyrë edhe përmes këtij institucioni, synohet të monitorohet e të mbahet “nën kontroll” sikurse edhe ti jepet performancë e re vizionit dhe misionit të administratës publike, e cila ka tendencën që herë pas herë “të cedojë” ose të keqpërdorë diskrecionin e vet, duke cenuar kështu të drejtat dhe liritë e garantuara me ligj për qytetarin.

Nga ana tjetër, OJF ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut⁴. Sipas ligjit për OJF, me “veprimtari në të mirë dhe interes të publikut” kuptohet çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut. Ndër parimet mbi bazën e të cilave mbështetet veprimtaria e organizatave jofitimprurëse është parimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

² Shih Ligjin nr.8417/28.10.1998 “Kushtetuta e RSh” (ndryshuar).

³ Shih Ligji nr.8454/4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” (ndryshuar).

⁴ Shih neni 1, 2&6, 5, etj të Ligjit nr.8788/ 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (ndryshuar)

Pra, vëmë re se qëllimi dhe parimet thelbësore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, OJF-ve dhe administratës publike janë të njëjta. Secili, në varësi të misionit dhe veçorive, ka prioritet të drejtat e njeriut dhe realizmin e një veprimtarie në të mirë dhe interes publik.

Etiketimi e vlerësimi jo gjithnjë si pozitiv i “sjelljes” së administratës publike nuk është një paragjykim, por konkluzion i një sërë analizash dhe monitorimesh të veprimtarisë së saj. Kështu, psh, Indeksi i reformës gjyqësore⁵, ndonëse analizon veprimtarinë e sistemit të drejtësisë, nuk e sheh këtë të shkëputur nga hallka të tjera të sistemit të organeve të shtetit të së drejtës. Në këtë dokument nënvizohet se në çështje që kanë të bëjnë me doganat, pronësinë, prokurimet publike, etj. pjesëmarrja e “qeverisë” përshkruhet si e ngadaltë dhe penguese. Për më tepër këtu theksohet se ekzekutimi i vendimeve është një problem endemik i sistemit në tërësi por kryesisht i vendimeve me palë shtetin. Ka një sërë vendimesh të GJEDNj që i referohen pikërisht penalizimeve bërë shtetit shqiptar që vijnë si rezultat i mungesës së mjeteve efektive (në shkëlqje të nenit 13 KEDNJ) dhe mos veprimit të autoriteteve administrative dhe të përmbartimit⁶. Gjithashtu, Progres Raportet e Komisionit Evropian, në vijimësi, kanë qenë kritike ndaj standardeve të administratës publike dhe respektimit⁷. Në këto kushte, OJF-të kanë një mision të rëndësishëm. Të mbrojnë taksapaguesit shqiptarë nga veprimet burokratike të administratës publike, të cilat çojnë në mohimin e të drejtës dhe mandej në penaltete që ndikojnë mbi të gjithë!

Duke qenë se Avokati i Popullit, veç të tjerave të përcaktuar në kushtetutë e ligj, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ka mjaft mundësi që në mënyrë të pavarur dhe të paanshme të efektojë në mbrojtjen e interesave të qytetarëve

⁵ Shih Indeksi i Reformës Gjyqësore. Shqipëri Vol. IV. Fq 24.

⁶ Shih rastin Driza kundër Shqipërisë (33771/02); Qufaj Co Shpk kundër. Shqipërisë (54268/00 datë 18.11.2004); Marini kundër. Shqipërisë (3738/02, datë 8.12.2007).

⁷ Shih: http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2009_progress_report_en.pdf ; http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2010_en.pdf (aksesuar në gusht 2011)

kur këto interesa referohen si të cenuara nga OJF-të. Në këtë proces të veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit verifikon problemin e adresuar duke u ballafaquar me të gjithë dokumentacionin dhe informacionet të cilat i vihen në dispozicion nga organi administrativ. Kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa. Pikërisht këtu qëndron edhe forca e Avokatit të Popullit: pra, tek bërja e rekomandimeve⁸.

Gjithashtu, sipas nenit 134/1&dh dhe 134/2 të Kushtetutës, për çështje të interesit të vet, Avokati i Popullit mund t'i drejtohet edhe Gjykatës Kushtetuese. Dhe këto nuk kanë qenë raste të rralla. Në këtë mënyrë, është në diskrecion të plotë të Avokatit të Popullit që të zgjedhë mjetin më efektiv në mbrojtje të të drejtave të individit dhe ky mjet, në disa raste shumë të rëndësishme, ka qenë kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese⁹.

Raportet e paraqitura përpara Kuvendit bëjnë që shqetësimet dhe problemet e adresuara nga Avokati i Popullit edhe prej OJF-ve të përçohen në organin legjislativ, i cili mund të parashikojë eventualisht, rast pas rasti, nevojën e ndërhyrjeve ligjore¹⁰. Avokati i Popullit paraqet raportin vjetor përpara Kuvendit. Avokati i Popullit raporton përpara

⁸ Shih rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në vijimësi si dhe raportet e këtij institucioni me tri pushtetet dhe Gjykatën Kushtetuese: <http://www.avokatipopullit.gov.al/index.htm>

⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me Vendimin e saj nr.49 dt.31.07.2000 ka vendosur që Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara nga nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cenuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të tij.

¹⁰ Nga një analizë e statistikave lidhur me bashkëpunimin e OJF me Avokatin e Popullit, vëmë re se ka një numër të kufizuar rastesh ndër vite. Kështu, në vitin 2005 i janë drejtuar 26 shoqata, në vitin 2006 vetëm 14 shoqata, në vitin 2007 vetëm 13 shoqata, në vitin 2008 vetëm 14 shoqata, në vitin 2009 vetëm 23.

Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon si të rëndësishme dhe jep llogari vetëm para Kuvendit. Në këtë mënyrë, veç instrumenteve të tjera, shoqëria civile mund të "përdorë" efektivisht Avokatin e Popullit për të përçuar mesazhe të rëndësishme lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut ndaj të cilave duhet bërë ndërhyrje ligjore, administrative, etj.

Objekti i ankesës dhe kërkesës natyrisht lidhet me fushën e veprimtarisë së OJF duke e përputhur këtë kërkesë apo ankesë detyrueshmërisht me juridiksionin e Avokatit të Popullit. Pra, ankesat dhe kërkesat kanë pasur të bëjnë qoftë me shkelje të të drejtave të anëtarëve të shoqatës nga organet e administratës publike si edhe të tilla që kanë nxitur përmirësime të legjislacionit, i cili lidhet me fushën e veprimtarisë së tyre.

Interaktiviteti ndërmjet Avokatit të Popullit dhe OJF-ve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, është nënvizuar edhe në ligjin për Avokatin e Popullit, në nenin 31/3¹¹ të të cilit flitet për strukturën e këtij institucioni. Këtu gjendet seksioni lidhur me bashkëpunimin me OJF. Gjithashtu në nenin 30 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nënvizohet rëndësia e bashkëpunimit dhe format e bashkëpunimit të OJF me Avokatin e Popullit. Të tilla janë ato përmes:

- *Marrjes periodikisht të mendimit të OJF-ve lidhur me gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut sipas këndvështrimit të shoqërisë civile*¹²;

¹¹ Neni 31: Struktura - "Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në 3 seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët. Këto seksione janë:
1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve, që veprojnë për llogari të tyre.

2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor.

3. Seksioni i përgjithshëm për trajtimin e çështjeve jashtë fushave të mësipërme, për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe për studimet e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

¹² Ndër aktivitetet e tilla rendisim një takim të datës 20 Tetor 2006: Në takim ishin prezent 19 përfaqësues të OJF- që punojnë me/ për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri: Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, Amaro Drom, Amici dei Bambini, Qendra Bethany, CRCA, Cafod, Klinika Ligjore për të Miturit, ICMC, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, "Ndihmoni Jetën", Parlamenti Rinor, QTMPKF, Save the Children dhe World Vision.

- *Organizimi në bashkëpunim të paktën një herë në vit të veprimtarive kombëtare për gjendjen e te drejtave dhe te lirive te njeriut ne Republikën e Shqipërisë.*

Pra, jo vetëm OJF-të kanë nevojë për mbështetjen dhe bashkëpunimin me Avokatin e Popullit, por edhe anasjelltas duke i krijuar këtij mundësinë që të ketë një lidhje dhe angazhim konkret në mbrojtjen e interesave të OJF.

III. Dy fjalë për kuptimin dhe veprimtarinë e administratës publike

Administrata publike, Avokati i Popullit dhe OJF në veprimtarinë e tyre në mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, mbështeten në një bazë ligjore të përgjithshme, e cila ka në thelb të njëjtat parime. Përpos, këto kanë edhe legjislacionin e tyre specifik i cili është mbështetur në këto parime të përgjithshme.

Por çfarë përfaqëson administrata publike? Është një nocion shumë i gjerë dhe shumë i madh administrata publike. Për këtë është e rëndësishme të dimë se çfarë përfshihet në veprimtarinë administrative. Në ndihmë na vjen kryesisht Kodi i Procedurave Administrative¹³ por edhe projekt ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe gjykatat administrative”. Sipas nenit 2 të Kodit të Procedurave Administrative:

1. Veprimtaria e organeve administrative është tërësia e *akteve dhe veprimeve* nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i administratës publike, si dhe ekzekutimi i këtij vullneti.

2. Format e veprimtarisë administrative të rregulluara me këtë ligj janë:

- aktet administrative individuale dhe kolektive;
- kontratat administrative/publike; dhe
- aktet reale.

Janë organe administrative ose organe të administratës publike¹⁴:

¹³ Ligji nr.8485/12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”

¹⁴ Projekt ligji “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe gjykatat administrative” përdor këtë përkufizim lidhur me “Organin publik”: çdo organ i pushtetit qendror apo i njërive të qeverisjes vendore. Barazohet me organin publik çdo ent publik i krijuar me ligj, çdo person, juridik apo fizik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor, kontratë apo çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

- organet e pushtetit qendror të cilat kryejnë funksione administrative;
- organet e enteve publike në masën që ato kryejnë funksione administrative;
- organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative;
- organet e Forcave të Armatosura, si dhe çdo strukture tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.

Çdo akt dhe veprim administrativ, i çfarëdo niveli rregullues, del *si rregull* në bazë dhe për zbatim të ligjit. Në këto kushte është shumë e rëndësishme që të njihen parimet dhe procedurat që duhet të udhëheqin veprimtarinë e autoriteteve administrative në nxjerrjen e akteve administrative dhe në realizimin e veprimtarisë së tyre. Shtylla të tilla si Kodi i Procedurave Administrative (KPA), Kodi i Procedurës Civile¹⁵, ligji nr. 8480/27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, ligji nr. 10005/23.10.2008 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”; Ligji Nr. 10 279/20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Ligji nr. 8652/31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) etj., ligjet specifike janë të domosdoshme të shfletohen dhe të njihen në rastin kur administrata kryen një veprim i cili cenon të drejtat e shtetasve.

Konteksti ligjor që efektikon detyrueshmërisht aktivitetin e OJF-ve dhe të Avokatit të Popullit imponon njohjen e kujdeshme të gjerë dhe të thellë të veprimtarisë së administratës publike. Pra, kujt i shërben administrata publike? Pse është krijuar administrata publike? Çfarë detyrash dhe pushteti ka administrata publike dhe si i realizon këto? Administrata publike konsiston në një pafundësi detyrash dhe pushtetesh. Këto burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore. Detyrat dhe pushtetet e organeve administrative nuk

¹⁵Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohen nenet 324 deri 333 dhe shkronja “a”, e nenit 320. Pra, gjithë kreu i gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative.

janë një çështje statike. Ndryshimet sociale, politike, ekonomike, etj në vend, imponojnë edhe ndryshime në kornizën ligjore dhe këto efektojnë edhe administratën publike si të tillë. Disa herë detyrat dhe pushtetet shtohen dhe anasjelltas. Në disa drejtime edhe mund të *quasi* reduktohen. Ndërkohë është evidente një tendencë që këto të mos pakësohen në thelbin e tyre, por t'u kalojnë "si shërbime" privatëve. Edhe në këtë rast, përsëri raporti ynë qëndron si të ishte me administratën publike, sepse është përgjegjësia direkte/indirekte e saj në shpërndarjen e detyrave njërit apo tjetrit subjekt.

IV. Subjektet që i drejtohen Avokatit të Popullit.

Mënyra e drejtimit dhe mjetet

Na rezulton se nuk gjendet në Kushtetutë, një listë subjektësh që kanë të drejtë t'i drejtohen Avokatit të Popullit. Interpretimet jo vetëm të ngushta por edhe jo të sakta, herë pas here, kanë komentuar këtë duke marrë si pikënisje termin "individ" që përmendet në Kushtetutë në nenin 60 dhe duke e njohur këtë të drejtë vetëm për "individët". Ndonëse interpretimi i Kushtetutës është në kompetencë të GJK [neni 124 i Kushtetutës], na lejohet të pranojmë se edhe leximi i thjeshtë i nenit 60 nuk ka të bëjë me subjektet që kanë të drejtë t'i drejtohen AP, por me (a) subjektet "pasivë", pra ata që cenohen dhe që mbrohen nga AP, dhe këta janë individët dhe (b) subjektet "aktivë" të cilët me veprime apo mosveprime cenojnë të drejtat, liritë dhe interesat e të parëve. Ndërkohë, duke e parë Kushtetutën në tërësi si një dokument, e për t'i dhënë edhe një kuptim më të plotë subjekteve "pasivë", konstatojmë se ajo vet në nenin 16&2 ka garantuar se "Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetute vlejnë edhe për *personat juridikë*, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave".

Kuptohet që Kushtetuta është një dokument sintetik dhe telegrafik tepër cilësor dhe si e tillë nuk mund të ezaurojë të gjitha rregullimet. Për këtë qëllim i referohemi detajeve që gjenden në

Ligjin Nr.8454/ 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” (i ndryshuar)¹⁶. Sipas nenit 12, të drejtën për t’u ankuar tek Avokati i Popullit e ka:

- Çdo individ,
- grup individësh ose
- organizata joqeveritare.

Për çfarë mundet që OJF si subjekt t’i drejtohen AP?

OJF-të mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit në rastet kur këto pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshme (është fjala për interesin që ato mbrojnë për shkak të misionit të tyre) nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Për këtë është shumë e rëndësishme që çdo OJF të ketë kuptuar mirë që shqetësimi i paraqitur prej saj, është i lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit të Avokatit të Popullit. Vënia në lëvizje e Avokatit të Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave të njeriut nga veprimtaria e administratës publike. Pra, e rëndësishme është të theksohet se OJF-të legjitimohen për t’iu drejtuar Avokatit të Popullit kur individë, grupe individësh përfshirë edhe personat juridikë, pretendojnë se janë cenuar në të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të tyre nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Në ç’mënyrë OJF vënë në dijeni/lëvizje Avokatin e Popullit?

OJF-të kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur.

Avokati i Popullit duhet të ruajë fshehtësinë, nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën, apo njoftimin.

¹⁶ Ligji nr.8600/10.4.2000, Për një shtesë në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”; Ligji nr.9398/12.5.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8454/4.2.1999 “Për AP”, ndryshuar me Ligjin nr. 8600/10.4.2000.

Mënyra e vënies në lëvizje të Avokatit të Popullit nga OJF, përfshijnë:

- përmes një ankese;
- përmes një kërkesë;
- përmes një njoftimi.

Ligji për Avokatin e Popullit nuk kërkon një formë të veçantë apo të paracaktuar lidhur me ankimin apo njoftimet që i bëhen këtij institucioni. Përveçse, çdo OJF kur i drejtohet këtij institucioni duhet të bëjë kujdes në:

- Qartësinë e objektit të ankimit apo të kërkesës. Pra, OJF duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin e vet në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Avokati i Popullit¹⁷.

- Qartësinë e dhënies së informacionit lidhur me subjektin që e paraqet atë. Kjo sepse Avokati i Popullit nuk pranon ankesa ose kërkesa anonime.

V. Parimet e veprimtarisë dhe çështjet e kompetencës së Avokatit të Popullit

Sipas ligjit nr. 8454/4.2.1999 ndryshuar “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj [neni 2]. Në këtë veprimtari Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e:

- pavarësisë nga politika dhe tre pushtetet e tjera,

¹⁷ Për shembull: mungesa e qartësisë lidhur me përmbajtja e disa prej akteve ligjore e nënligjore që janë në fuqi dhe konkretisht të Ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Udhëzim nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Udhëzim nr.991/3, datë 2.3.2010 “Për një ndryshim në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

- paanësisë dhe integritetit,
- konfidencialitetit dhe besueshmëria,
- profesionalizmit dhe qartësia në qëllime dhe veprimtari,
- transparenca.

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur.

Avokati i Popullit duhet të ruajë fshehtësinë nëse e sheh të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën, apo njoftimin. Të gjitha shërbimet e Avokatit të Popullit lidhur me ankesat, njoftimet, kërkesat, janë pa pagesë.

Në rastin e paraqitjes së një ankesë, njoftimi apo kërkesë nga OJF, kur Avokati i Popullit vëren ose dyshon se kemi të bëjmë me një shkelje të së drejtës, fillon procedurën e shqyrtimit të ankesës.

VI. Gamë e gjerë bashkëpunimi me Avokatin e Popullit.

Për çfarë mund t'i drejtohen OJF-të Avokatit të Popullit?

• Çështjet e legjislacionit

Në veprimtarinë e tyre OJF-të konstatojnë aspekte të ndryshme të problemeve në legjislacion. Të tilla mund të jenë zbatimi jo korrekt i ligjit nga institucionet; pamundësia e zbatimit të një dispozite për shkak të mungesës së akteve nënligjore, ligji vjen në kundërshtim me interesin publik dhe me kushtetutën; mungesë koherence ndërmjet ligjeve të ndryshme; paplotësi në një ligj; mungesë harmonizimi me standardet ndërkombëtare, etj.

Në këtë mënyrë, OJF-të përmes njoftimeve apo kërkesë/ ankesave paraqitur pranë institucionit të Avokatit të Popullit bëjnë që të zbatohet efektivisht neni 24 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”¹⁸

¹⁸ Neni 24: E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative. “Kur Avokati i Popullit vëren se është vete përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak për krijon premisa për shkelje të te

(shih gjithashtu kreun IV të ligjit). Në morinë e ligjeve dhe të ndryshimeve të tyre të shpeshta, OJF, kanë privilegjin që duke u specializuar në një fushë të caktuar të monitorojnë edhe efektivitetin, dobishmërinë dhe standardet e legjislacionit. Nga ana tjetër, grupet me të cilat bashkëveprojnë OJF, kanë mundësinë e transmetimit të drejtpërdrejtë të çdo shqetësimi dhe boshllëku ligjor për shkak të konfidencës së krijuar.

• **Çështje të lidhura me pushtetin gjyqësor dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë.**

Sipas nenit 25 (paragrafi i fundit) të Ligjit nr. 9398/12.05.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454/4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”: *“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve”.*

Kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit, në këtë drejtim, janë tregues dhe kërkesë e një shoqërie dhe qeverisje demokratike të zhvilluar, për të rritur kontrollin e ndërsjelltë ndërmjet veprimtarisë së institucioneve që garantojnë të drejtat e njeriut.

Kështu, Avokati i Popullit mirëpret ankesa, kërkesa apo njoftime lidhur me Administratën Gjyqësore. Administrata e gjykatave si pjesë e sistemit të drejtësisë luan një rol të rëndësishëm në efektivitetin e aksesit në drejtësi dhe në gjykatë.

Ndryshimet e vitit 2005 që iu bënë ligjit për Avokatin e Popullit, përfshinë aksesin e këtij institucioni ndaj vendimeve të formës së prerë. Ky rol i Avokatit të Popullit ndaj vendimeve gjyqësore të

drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

- a) t’u rekomandoje organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;
- b) t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore;
- c) t’i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla.

formës së prerë, thjesht rrit garancitë për mbrojtjen e të drejtave të qytetareve, transparencën e gjyqësorit si dhe pjesëmarrjen e publikut në dhënien e drejtësisë nga ana e gjykatës dhe si i tillë, nuk cenon aspak pavarësinë e gjyqësorit, përkundrazi ndihmon punën e tij. Është fjala për një kompetence për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikim të këtyre vendimeve në Gjykatën e Lartë, si një nga mjetet e jashtëzakonshme që ligji u njeh subjekteve përkatëse në këto raste (shih plotësimet e neneve 438, 449 dhe 451 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile). Gjithmonë bëhet fjalë që Avokati i Popullit do të bëjë kërkesa për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në rastet kur sita e kontrollit gjyqësor ka lejuar të rrjedhin edhe gabime gjyqësore, për të cilat nuk ka mjet tjetër korregjimi. Është fjala që Avokati i Popullit të futet në subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë; kërkesa për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore nga ana e gjykatave, si dhe rishikimi i qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara në Gjykatën e Lartë lidhur me vendimet unifikuuese. Gjithmonë duke e lënë në çmimin e gjykatës mënyrën se si do ta bëjë këtë, përfshirë edhe refuzimin. Pra, kjo nënkupton se nuk ka prekje të pavarësisë së gjyqësorit.

Nga ana tjetër, ankesa, njoftime kërkesa mund të kenë të bëjnë edhe me procedurat gjyqësore. Ka disa aspekte të këtyre procedurave që janë strikte dhe të rregulluara ligjërisht, ka të tjera ku ka vend për më shumë diskrecion. Diskrecioni mund të shkojë edhe deri në cenim të standardeve, e këtu është rasti për të reaguar.

• Çështje lidhur me të drejtat e fëmijëve

Në vendin tonë ka shumë OJF që ia kanë dedikuar veprimtarinë e tyre mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Si të tilla, këto kanë mundësi që të njohin problematikën dhe të sugjerojnë alternativa zgjidhjeje të problemeve me të cilët ndeshen fëmijët dhe familjet sot.

Problemet që hasin fëmijët sot burojnë nga shumë faktorë si gjendja dhe niveli i ulët ekonomik e social i vendit, tronditja e bazamentit tradicional të familjes shqiptare, por mbi të gjitha

moszbatimi efikas i ligjit dhe mos bashkëpunimi i duhur nga agjencitë e caktuara si policia, prokuroria, gjykata, shërbimet inteligjente dhe struktura të tjera të shtetit si pushteti vendor, shkollat, institucionet e ndihmës dhe përkrahjes sociale, shtëpitë e fëmijës, etj. Jo në pak raste elemente të korruptuar dhe të përgjegjshëm profesionalisht të këtyre strukturave të shtetit kanë bërë pjesë apo kanë favorizuar këtë situatë. Shumë prej tyre vazhdojnë me të njëjtat qëndrime. Në një rast të tillë pritet që OJF-të të jenë zëri i fëmijëve.

- **Çështje që lidhen me institucionet e privimit të lirisë (paraburgim, burgje)**

Ka shumë rrezik që aty ku liria e personit është e kufizuar edhe të drejtat e njeriut të ndihen më shumë të kërcënuara. Avokati i Popullit Shqiptar gëzon para së gjithash avantazhin pasi ka një juridiksion të plotë për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe ka kompetenca të plota në këtë fushë. Brenda termit administratë publike janë të përfshira edhe institucionet shtetërore që mbulojnë sistemin penitenciar (burgjet dhe paraburgimet), organet e Policisë së Shtetit dhe ambientet ku mbahen persona të arrestuar, ndaluar apo shoqëruar, si dhe dhomat e izolimit disiplinor në Repartet e Ushtrisë Shqiptare.

Sipas nenit 19/1: “Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke venë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

- **Çështje të mirëqeverisjes**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka misionin e madh dhe shumë të nevojshëm: të ndihmojë drejtpërsëdrejti në forcimin e demokracisë

dhe mirëqeverisjes dhe të sjellë më shumë transparencë dhe përgjegjësi për administratën publike. Avokati i Popullit e ka për detyrë që të jetë i dedikuar maksimalisht në edukimin dhe zhvillimin e një qeverisjeje sa më të mirë. Avokati i Popullit duke qenë se mbron qytetarin nga veprimet apo mosveprimet e administratës që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore, rezulton të ketë në veprimtari të larmishme sikurse veprimtaria e administratës publike. Këtu mund të përfshihen çështje që ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e shoqërisë të tilla si:

- çështje të privatizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të ish pronarëve;
 - o respektimi i lirisë së informimit,
 - o çështje të rritjes së çmimeve si ato të energjisë elektrike dhe ujit,
 - o tarifave dhe taksave gjyqësore,
 - o tarifat e telefonisë fikse e celulare;
 - o mbrojtja e interesit të konsumatorëve,
 - o mbrojtja e të drejtave të pacientëve,
 - o mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara;
 - o probleme të të dënuarve dhe të persekutuarve politikë;
 - o çështje të mbrojtjes së mjedisit nga rreziqet e elektromagnetizmit, zhurmave e ndotjeve akustike;
 - o infrastruktura e ndriçimit të rrugëve,
 - o ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet shtetërore;
 - o mbrojtja e të drejtave të punonjësve (rastet e mosveprimit të strukturave shtetërore në mbrojtje të tyre siç ishte rasti i Gërdecit, etj.)
 - o të drejtat e ushtarakëve dhe të policisë;
 - o të drejtat e komunitetit rom, etj, etj.
- Gjithsesi lista nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese dhe zhvillimet ekonomike e sociale ndërkohë që i vendosin administratë publike detyrime të reja, e bëjnë Avokatin e Popullit një institucion aktiv dhe gjithnjë të gatshëm për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve.

VII. Konkluzione

Avokati i Popullit si institucion i pavarur dhe kushtetues ka në fokusin e veprimtarisë së vet përmirësimin dhe konsolidimin e qeverisjes sa më demokratike duke synuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut ndaj veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të administratës publike. Sado e mirë qoftë, çdo qeverisje ka nevojë për mekanizma kontrolli e monitorimi në vijimësi. Pikërisht, në këtë sistem, pranë sferës së qeverisjes dhe shoqërisë civile është vendosur Avokati i Popullit, në garanci të demokracisë dhe mirëqeverisjes”¹⁹.

Në mënyrë që OJF-të të luajnë në mënyrë sa më të plotë rolin e tyre, duhet të jenë kompetente në përdorimin e mekanizmave të shtetit të së drejtës përfshirë këtu edhe Avokatin e Popullit. Pikërisht, nisur nga ky interes, përmes këtij artikulli kemi synuar që të japim disa informacione lidhur me rolin e Avokatit të Popullit dhe të nxisim shoqërinë civile që t’i drejtohet pa hezitim këtij institucioni. Ndryshe nga mekanizma të tjerë në mbrojtje të të drejtave të njeriut [përfshirë këtu edhe sistemin gjyqësor apo rastin e Gjykatës Kushtetuese] duket se rruga drejt institucionit të Avokatit të Popullit është më e thjeshtë dhe më operative. Kjo i krijon lehtësi OJF-ve që t’i drejtohen këtij institucioni duke dhënë kështu një kontribut të shumëfishtë: të luajnë më mirë rolin e tyre, të vënë në efikasitet sa më të plotë Avokatin e Popullit, të përmirësojë veprimtarinë e administratës publike. Në këtë mënyrë përmirësohet cilësisht respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

¹⁹ Fjala e Presidentit të Republikës ShTZ. Bamir Topi me rastin e 10 vjetorit të institucionit të Avokatit të Popullit. Burimi <http://www.avokatipopullit.gov.al/Aktivitetet/Akt2%2010122009.htm> (aksesuar në Nëntor 2010).

BIBLIOGRAFIA

- Ligji nr. 8417/28.10.1998 “Kushtetuta e R. Sh” (i ndryshuar).
Ligji nr. 8454/4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” (i ndryshuar).
Ligji nr.8788/ 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar)
Ligji nr.8577/10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
Ligji nr. 8485/12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”
Ligji nr. 8116/ 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”
Indeksi i Reformës Gjyqësore. Shqipëri Vol IV. Fq 24.
Jurisprudencë
Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 49 dt.31.07.2000
Driza kundër Shqipërisë (33771/02);
Qufaj Co Shpk kundër. Shqipërisë (54268/00 datë 18.11.2004);
Marini kundër. Shqipërisë (3738/02, datë 8.12.2007).

Faqe web

- http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2009_progress_report_en.pdf ; http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2010_en.pdf
<http://www.avokatipopullit.gov.al/index.htm>

Florina NUNI²⁰
Alma FASKAJ (VOKOPOLA)²¹ Doktorante, UT

INSTITUCIONI I AVOKATIT TE POPULLIT, SFIDAT E TIJ NE KRIJIMIN E NJË URE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE.

1. Hyrje

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk do të mund të ishte e suksesshme pa një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë aktorët dhe faktorët, të cilët japin kontributin e tyre në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Padyshim që ky bashkëpunim, është vlerësuar si një marrëdhënie ligjore me të gjithë organet e administratës publike dhe të tretët që veprojnë për llogari të saj, në kuadër të oponencës për mënyrën se si ofrohet mirëqeverisja nga ana e këtyre organeve për qytetarët, por edhe si një bashkëveprim me të gjitha ato struktura të shoqërisë civile, të cilat kanë dhënë dhe japin realisht kontribut, për ngritjen dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike dhe shtetit të së drejtës në vend.

Marrëdhëniet e shtetit me organizatat jofitimprurëse në Shqipëri, në përgjithësi janë opozitare dhe ka pasur mosbesim të dyanshëm. Ne si Institucion vlerësojmë se zëri i këtyre organizatave ka shërbyer kohë pas kohe në të mirë të politikave qeverisëse,

²⁰ Avokate e Popullit në detyrë, Doktorante, UT

²¹ Këshilltare ligjore pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, Doktorante, UT

sikundër edhe ka plotësuar dhe plotëson kuadrin pluralist të mendimit dhe organizimit të lirë të individëve.

Ky punim synon të sjellë në rend kronologjik, por jo vetëm, se si Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërtuar bashkëpunimin me OJF-të dhe cilat kanë qenë efektet pozitive të këtij bashkëpunimi.

2. Hapësira ligjore e organizatave jofitimprurëse në drejtim të aksesit në Institucionin e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 60 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, Avokati i Popullit në Shqipëri mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse. Kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve. E drejta e tij për t'i ndjekur çështjet shkallë-shkallë, sipas hierarkisë së administratës, deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparenca, në punën e tij, bashkëpunimi i ngushtë me OJF-të dhe Median garantojnë suksesin në detyrën që i është caktuar atij.

Institucioni i Ombudsmanit nuk zëvendëson gjykatat, pra nuk është zëvendësues i një sistemi gjyqësor që duhet të jetë efektiv dhe i pavarur. Ai përbën një pjesë të mekanizmit për garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, me të cilën duhet të pajisen të gjitha shtetet demokratike, duke mos mbajtur as anën e administratës e as atë të individit, por duke punuar për kulturën e mirëqeverisjes dhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Kjo pavarësi shprehet në disa elemente si: Mospasja e lidhjeve të varësisë me Institucionet e tjera Kushtetuese të vendit si Presidenti,

Qeveria, Gjykatat etj; qenia jashtë politikës, jashtë partive dhe veprimtarive të tyre politike, disponimi i një buxheti të veçantë, përzgjedhja prej Avokatit të Popullit e Komisionerëve dhe ndihmësve të tyre brenda një strukture dhe organike të përcaktuar prej atij vetë, përcaktimi i Rregullores së Brendshme, Kodit Etik etj. Është e rëndësishme dhe vlen të përmendet se kjo pavarësi ka qenë dhe është reale, tipike, për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe pavarësisht nga kritikrat e shprehura apo të pashprehura publike, kjo pavarësi nuk do të lejohet të cenohet nga ndikimi i asnjë force politike apo Institucioni tjetër shtetëror.

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare që pretendojnë se të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme, u janë shkelur nga një akt, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës qendrore e vendore apo të ndonjë organi tjetër të veshur me autoritet publik, mund të paraqesin ankesa, kërkesa apo njoftime tek Avokati i Popullit për shqyrtimin e çështjes. Pra, ashtu si çdo subjekt i së drejtës dhe organizatat jofitimprurëse mund të fillojnë një procedurë para Institucionit të Avokatit të Popullit. Objekti i ankimit natyrisht është i njëjtë, pra kur veprimi ose mosveprimi i organeve të administratës publike ka shkelur të drejtat dhe liritë e individit. Megjithatë ligjvënësi, duke e konsideruar të rëndësishëm rolin e OJF-ve në mbrojtje të të drejtave të individit ka parashikuar ngritjen e një strukture pranë Institucionit, konkretisht Seksioni i Përgjithshëm, i cili trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Gjithashtu, sipas nenit 30 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", Institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Dihet që në Shqipëri janë krijuar një numër i konsiderueshëm organizatash joqeveritare, të cilat synojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve.

Seksioni i përmendur më sipër, nëpërmjet vendosjes së kontakteve me OJF-të merr informacionin e nevojshëm dhe monitoron që të drejtat e individëve që parashikohen nga ligji, të mbrohen. Nëpërmjet shkëmbimit të informacionit ne kryejmë hetime, japim opinione me qëllim që të inkurajojmë një vrojtim efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në të njëjtën kohë Institucioni i Avokatit të Popullit, për të bërë të mundur një bashkëpunim sa më të frytshëm, duke i dhënë aksesin e duhur këtyre subjekteve të së drejtës, ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi. Përmendim këtu marrëveshjen me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Grupin Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, Save the Children etj. Megjithëkëtë, nevojitet të theksojmë se *de jure* aksesin e OJF-ve në Institucionin e Avokatit të Popullit është i garantuar dhe për këtë arsye marrëveshjet e bashkëpunimit janë opsionale në varësi të specifikave dhe të krijimit të lehtësirave për vetë këto organizata në veprimtarinë e tyre.

3. Drejtimit e aksesit të OJF-ve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Disa refleksione rreth studimit.

Lidhur me objektin e kërkesave, ankesave apo njoftimeve, për të cilat OJF-të i janë drejtuar Avokatit të Popullit, vlen të theksohet se ato kanë qenë të ndryshme. Në studimin e realizuar nga Qendra Avokatore, janë përmendur ato thuajse në mënyrë ezauruese.

Këtu mund të përfshihen; çështje të privatizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të ish pronarëve; respektimi i lirisë së informimit, mbrojtje të së drejtës së konsumatorëve, mbrojtja e të drejtave të pacientëve, mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara; probleme të të dënuarve dhe të persekutuarve politikë; çështje të mbrojtjes së mjedisit nga rreziqet e elektromagnetizmit, zhurmave e ndotjeve akustike; infrastruktura e ndriçimit të rrugëve, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet shtetërore; mbrojtja e të drejtave të punonjësve (ku janë strukturat shtetërore në mbrojtje të tyre? Rasti i Gërdecit) të drejtat e ushtarakëve dhe të policisë, të drejtat e komunitetit rom etj. Pra është fakt se nuk ka

pasur kufizim të objektit për të cilin OJF-të i janë drejtuar Avokatit të Popullit.

Në referencë të vështirësive që OJF-të kanë, të cilat janë referuar me të drejtë në studim, vlen të përmendim se jemi plotësisht dakord me ekzistencën e tyre. Por në rast se do të tentojmë që të konstatojmë sa ato janë prezentë në Institucionin e Avokatit të Popullit, duke lënë mënjanë modestinë, me bindje mund të themi që, trajtimi që i është bërë rasteve të prezantuara nga OJF-të pranë Avokatit të Popullit kanë pasur nivel të lartë profesionalizmi duke i shkuar deri në fund vënies në vend të të drejtës së shkelur. Gjithashtu theksojmë se, Institucioni i Avokatit të Popullit ka një strukturim të tillë, që bën të mundur aksesin dhe trajtimin me prioritet të rasteve të prezantuara nga këto subjekte. Evidentojmë gjithashtu që cilësia e prezantimit të ankesave nga OJF-të, e argumenteve të dhëna në ankesë, pa dyshim janë për t'u vlerësuar, duke pasur parasysh eksperiencën e tyre në mbrojtje të të drejtave nga njëra anë, por nga ana tjetër nivelin të lartë profesional të tyre.

Në referencë të kuadrit ligjor që rregullon objektin e veprimtarisë së OJF-ve, jemi plotësisht dakord me konstatimin e bërë në studim, se *"...qëllimi dhe parimet thelbësore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, OJF-ve dhe administratës publike janë të njëjta. Secili, në varësi të misionit dhe veçorive ka prioritet të drejtat e njeriut dhe realizimin e një veprimtarie në të mirë dhe interes publik"*. Por, këtu mund të shtojmë që mjetet që Avokati i Popullit, ka për të bërë të mundur realizimin e këtij qëllimi, janë natyrisht më efektive. Kjo shprehet së pari me mjetin ligjor që ky Institucion ka, rekomandimin, pasojat e paraqitjes së tij, (paraqitja e rekomandimit sipas ndryshimeve që i janë bërë ligjit 'Për Avokatin e Popullit' neni 21 sjell pezullimin e aktit ose veprimet e paligjshme deri në shqyrtimin e tij dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit), detyrimin e organeve për t'ju përgjigjur ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit dhe për më shumë raportimi i tij në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në listimin e mjeteve që Avokati i Popullit ka në dispozicion, i etiketuar si një nga mjetet efikase që Avokati i Popullit ka në dispozicion, në

mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit, është inicimi i një procesi pranë Gjykatës Kushtetuese.

Problemi i legjitimitetit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është vlerësuar prej saj si element i rëndësishëm i inicimit të procesit kushtetues. Legjitimiteti i Institucionit të Avokatit të Popullit para Gjykatës (*locus standi*) dhe raportet e tij me këtë gjykatë, në këndvështrim të dispozitave kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ka ngjallur disa herë diskutime.

Sipas Kushtetutës, funksioni kryesor kushtetues i këtij institucioni është të mbrojtë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të parregullta të organeve të administratës publike. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të disa subjekteve, ndërmjet të cilave bën pjesë dhe Avokati i Popullit²². Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës të deputetëve dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Këtë të drejtë e kanë edhe Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat e tjera si dhe individët, vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me interesat e tyre²³.

Nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë këtyre viteve, është përdorur ky mjet për shumë arsye, të cilat, aq sa lidhen me interesin që ky institucion ka në mbrojtje të të drejtave të individit, duke e garantuar këtë mbrojtje jo vetëm në veprimet e mosveprimet e organeve të administratës publike, por duke kërkuar që garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të ekzistojë së pari në nivelin më të lartë të hierarkisë së akteve, ligjeve dhe akteve nënligjore normative.

Duke marrë shkas nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese,

²² Neni 134 i Kushtetutës;

²³ Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", neni 49;

Avokati i Popullit inicioi ndërhyrjen legislative në ligjin e tij, i cili bëhej pengesë në këndvështrim të legjitimitimit para Gjykatës Kushtetuese²⁴. Megjithatë, pavarësisht rregullimeve ligjore duhet thënë se ka qenë kjo Gjykatë, që ka evidentuar edhe kriteret e legjitimitimit, si:

1. Interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit (bëhet fjalë për *ligje* se për *akte normative nënligjore* nuk ka pasur ndonjëherë dyshime për legjitimitimin) **duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës.**

2. Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

3. Avokati i Popullit duhet të provojë se pasoja është e drejtpërdrejtë pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit.

Natyrisht në çështjet që Avokati i Popullit ka bërë objekt të Gjykatës Kushtetuese nuk kanë munguar rastet kur OJF-të kanë qenë subjekte që kanë paraqitur kërkesë pranë tij, në bazë të të cilave ka filluar hetimi i tyre.

Lidhur me subjektet për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit inicion fillimin e procedurës gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese,

²⁴Me ndryshimet e reja në Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", me anë të Ligjit nr.9398, datë 12.05.2005, Avokatit të Popullit i është njohur e drejta për t'iu drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese. Në nenin 24 të Ligjit përcaktohet se kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla. Po kështu është shfuqizuar paragrafi i dytë i nenit 25 të Ligjit ku ligji dhe aktet e tjera normative parashikoheshin jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Këto janë ndryshime ligjore që vijnë pas reflektimit mbi argumentimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese me vendimet e sipërcituara.

është hapur një debat në një rën nga seancat e raportimit të Avokatit të Popullit për Raportin e vitit 2009 në Komisionin e Përhershëm në Kuvend. Ashtu sikundër u përmend më sipër, Avokati i Popullit vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur është përmbajtja e ligjit apo aktit normativ dhe jo zbatimi i tyre shkakton shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuar nga Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Për këtë arsye tendenca që ka ekzistuar për të kufizuar rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Avokatin e Popullit bie në kundërshtim me vetë Kushtetutën tonë. Pra në këtë kuptim, termi "individ" i përdorur në nenin 60 të Kushtetutës nuk mund të jetë kurrsesi i njëjtë me personin fizik si subjekt i së drejtës. Ky nen ka për qëllim të përmend misionin e Avokatit të Popullit, që është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. E përforcon këtë argument dhe neni 16/2, i cili ka garantuar se: "Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejné edhe për *personat juridikë*, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave". Pra, nuk mund të flasim për të drejta dhe liri themelore vetëm të individit, por për të drejta dhe liri themelore, të cilat duhet t'i garantohen si individëve dhe personave juridikë, por natyrisht për aq sa këto të drejta përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave. Nëse personat juridikë që vënë në lëvizje Avokatin janë publikë apo privatë kjo nuk ka rëndësi, për ne është e rëndësishme që ata të parashtrijnë një rast që një veprim ose mosveprim i administratës publike, akt ligjor apo nënligjor normativ krijon premisa për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, të cilat këtyre të fundit ia garanton Kushtetuta.

Konkluzione

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur dhe do të ketë në vëmendje gjithmonë, ngritjen në një nivel më të lartë të bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse. Për këtë është e

rëndësishme që këto subjekte, aktive në mbrojtje të të drejtave të tyre t'i drejtohen Institucionit tonë pa asnjë hezitim, duke pasur parasysh se, mjetet juridike që kemi në dispozicion, janë padyshim më efektive në mbrojtje të të drejtave të individit.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare Nr. 28, datë 7.12.1998.
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese 2000-2009;
- Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
- Traja. K., “Drejtësia Kushtetuese”, Luarasi, Tiranë 2000
- Zaganjori. Xh. “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, Luarasi, Tiranë, 2002;
- Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet përkatëse;
- Raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit 2000-2010 paraqitur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

**Erind MERKURI²⁵ (Doktorant),
Prof. Dr. Aurela ANASTASI²⁶**

MBROJTJA E INTERESAVE TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, PËRMES GJYKIMIT KUSHTETUES

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, organizatat politike dhe organizatat e tjera gjejnë një rregullim të posaçëm. Pa mënjeluar rëndësinë që kanë dispozitat e Kushtetutës që i pozicionojnë ato si subjekte të të drejtave dhe lirive themelore me cilësinë e personave juridikë²⁷, duhet thënë se dispozitat më të rëndësishme kanë përcaktuar konkretisht, rregullime për organizimin, regjistrimin dhe funksionimin e tyre, në kuadrin e së drejtës për t'u organizuar, si dhe mjetet që Kushtetuta u njeh organizatave dhe shoqatave, për mbrojtjen e interesave të tyre.

Meqenëse organizatat gëzojnë të gjitha të drejtat sikurse çdo person juridik, kanë akses në gjykimin e zakonshëm, në të gjitha dimensionet që e sanksionon Kushtetuta. Por, veç kësaj, një mjet të rëndësishëm përfaqëson e drejta e tyre për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Këtij të fundit i kushtohet ky punim, qëllimshëm, për të evidentuar disa nga çështjet që

²⁵ Asistent pedagog i lëndës e Drejta Kushtetuese, pranë Departamentit të së Drejtës Publike të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

²⁶ Titullare e lëndës e Drejta Kushtetuese, pranë Departamentit të së Drejtës Publike të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

²⁷ Neni 16/21 Kushtetutës sanksionon: "Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve".

lidhen me gjykimin kushtetues të iniciuar nga organizata të ndryshme.

Duke përcaktuar subjektet që mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, Kushtetuta parashikon “*partitë politike dhe organizata të tjera*”, si subjekte që mund “*të bëjnë kërkesë, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*”²⁸. Megjithatë, Kushtetuta nuk ka bërë ndonjë sqarim mbi faktin se çfarë do të kuptojmë me termin “*organizata të tjera*” dhe “*interesat e tyre*”. Ajo vetë ka arritur të veçojë si kategori të dalluar qartë, vetëm shoqatat, të cilat duhet të kuptohen si një lloj organizate dhe aspak, si një kategori e ndryshme prej tyre. Megjithatë, legjislacioni shqiptar na ndihmon të rendisim të gjithë ata persona juridikë që përbëjnë një organizatë, siç mund të jenë organizatat jofitimprurëse (shoqatat, qendrat, fondacionet), sindikatat, si dhe organizime me karakter ekonomik të njohura nga ligji. Duhet theksuar fakti se, “*organizatat e tjera*” janë konceptuar nga hartuesit e Kushtetutës si një subjekt i posaçëm, i dallueshëm, nga individi, partitë politike, bashkësitë fetare, apo personat e tjerë juridikë. Sidoqoftë, ka qenë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, ajo që ka bërë të mundur përcaktimin e kritereve dhe kushteve që mundësojnë një organizatë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për një çështje, në bazë të nenit 134, pika 1/f e Kushtetutës.

Në mënyrë të veçantë duhet bërë krahasimi midis organizatave të tjera dhe individëve, përfshirë personat fizikë ose juridikë, të cilët mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1/g. Në këtë pikëpamje, individët, përfshirë personat fizikë ose juridikë që kanë të drejta të barabarta me ta, gjithashtu, mund të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Por, kjo mundësi e tij, është kufizuar vetëm në rastin kur ai pretendon shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe pasi ka shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike. Pra, individi, qoftë edhe si person juridik, nuk mund të kërkojë një kontroll abstrakt të normës, nëse pretendon se kjo e fundit vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për më tepër, deri më sot, kontrollin kushtetues për një proces të rregullt ligjor,

²⁸ Kushtetuta e RSh, neni 134, pika 1/f dhe pika 2.

Gjykata Kushtetuese e ka kufizuar në trajtimin e aspekteve procedurale të një procesi administrativ ose gjyqësor, duke mos e konsideruar si pjesë të juridiksionit kushtetues procesin e rregullt ligjor, substancial. Pra, në këtë rast, nuk kemi shanse për një kontroll të kushtetutshmërisë së normës që ka zbatuar Gjykata apo institucioni shtetëror, por vetëm për zbatimin në përputhje me Kushtetutën të normave procedurale.

Ky dallim përbën edhe një nga arsyet që dëshmon rritjen e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga organizata të ndryshme, jofitimprurëse. Nëse vërejmë me kujdes jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, do të shikojmë se organizatat po kthehen në subjekte mjaft aktive për mbrojtjen e interesave të grupeve që ato përfaqësojnë, duke u bërë avokate të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese për qytetarët.

Përballë kësaj situatë, shpeshherë, grupet e interesit synojnë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, nëse nuk kanë arritur t'i imponojnë zgjidhjet e veta organeve shtetërore. Megjithatë, duhet të theksojmë faktin se, kjo mundësi e ofruar nga Kushtetuta nuk është e pakufizuar. Sikurse e përmendëm më sipër, paragrafi i fundit i nenit 134/2 e bashkëngjit këtë mundësi me faktin nëse organizatat janë të afta të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Sa më sipër, si dhe tendenca gjithnjë në rritje nga organizatat jofitimprurëse, për t'iu drejtuar këtij institucioni dhe ndikimi që ka vendimmarrja kushtetuese në politikën e përgjithshme shtetërore, ka bërë që çështja e legjitimitit (*locus standi*) të këtyre organizatave, të jetë nga më të debatueshmet. Në çdo rast që Gjykata Kushtetuese, ka marrë në shqyrtim kërkesën nga një subjekt i tillë, ka analizuar këtë çështje me shumë kujdes dhe ka krijuar një jurisprudencë të pasur.

1. Përvojat e gjykimit kushtetues të kërkuara nga organizatat, në periudhën 1992-1998.

Fillimisht, e quajmë me vend të bëjmë një analizë të shkurtër me karakter historik, në 6 vitet e para të ekzistencës së Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që të shohim evolucionin e çështjes që po

trajtojmë. Në vitin 1992, në kuadrin e plotësimit të legjislacionit kushtetues pas rënies së komunizmit dhe vendosjes së një rendi demokratik, Kuvendi Popullor i kohës miratoi ligjin Nr. 7561, datë 29.04.1992, "*Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese*", i cili ishte një shtojcë e ligjit kushtetues "*Për dispozitat Kryesore Kushtetuese*". Ky ligj, për herë të parë në historinë e Shtetit Shqiptar, krijoi një Gjykatë Kushtetuese.

Midis të tjerave, ligji (neni 25) parashikonte subjektet që mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me këtë përmbajtje:

"Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj.

Për fillimin e procedurës kanë të drejtë të bëjnë kërkesë Presidenti i Republikës, një grup parlamentar, një e pesta e deputetëve, Këshilli i Ministrave, gjykatat, organet lokale të pushtetit, si dhe çdo person, lidhur me shkeljen e lirisë dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta".

Siç mund të vërehet në këtë rast, ligji nuk i referohet drejtpërdrejt organizatave, por *personit*. Megjithatë, gjatë viteve 1992-1998, Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje gjithsej 21 herë nga organizata të ndryshme, kryesisht të organizuara në formën e shoqatave. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të paraqitura, u bazua në interpretimin ligjor, që Gjykata Kushtetuese e kohës i bëri termit "person". Në bazë të Kodit Civil²⁹ të kohës, personat fizikë dhe juridikë ishin subjekte të së drejtës civile. Madje, në të shumtën e rasteve, çështja e legjitimitit të tyre, as nuk shtrohej për diskutim³⁰. Në vendimin e saj Nr. 2, datë 26.1.1995 Gjykata Kushtetuese trajtoi për herë të parë legjitimin e "organizatave" duke u bazuar pikërisht tek termi "person". Në këtë rast Gjykata

²⁹ Ligji Nr. 6340, datë 26.06.1981

³⁰ Gjykata Kushtetuese është vënë për herë të parë në lëvizje nga një organizatë në vitin 1993 kur ajo u shpreh me Vendimin Nr. 13, datë 22.11.1993. Në këtë vendim çështja e legjitimitit nuk u shtrua për diskutim. E njëjta situatë paraqitet edhe në dy vendimet e tjera vijuese Nr.4, datë 8.4.1994 dhe Nr. 7, datë 14.4.1994 të kësaj Gjykate, ku në arsyetimin e saj ajo nuk shprehet në lidhje me legjitimin e subjekteve që inician procesin kushtetues.

shprehet se ...Përsa i përket pretendimit tjetër se urdhërimi i organeve të pushtetit lokal shkel të drejtat kushtetuese të këtyre organeve, Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk legjitimohet ta ngrejë. Ajo si person juridik, në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", "ka të drejtë të bëjë kërkesë vetëm për të drejtat e saj kushtetuese...". Kështu, duket qartë natyra individuale e kërkesave të organizatave, drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, pyetja tjetër që lind është: cilat ishin të drejtat kushtetuese të këtyre organizatave, që mund të kërkoheshin përpara Gjykatës Kushtetuese?

Gjithashtu, pati disa raste kur Gjykata Kushtetuese përdori kërkesën e organizatave, për t'u vënë në lëvizje me iniciativën e vet. Kjo ndodhte kur kjo Gjykatë nuk e gjente me vend të legjitimonte organizatën si kërkuese, por gjente me vend të shqyrtonte në thelb çështjen e shtruar prej saj. Kështu në vitin 1997, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i është drejtuar disa herë Gjykatës Kushtetuese ku ka kërkuar shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të disa dispozitave ligjore. Në një nga vendimet e saj, Gjykata Kushtetuese, me vendim paraprak, është shprehur se, Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk legjitimohet të investojë këtë Gjykatë për mospajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën, për arsye se ky Komitet nuk përmendet ndër subjektet që kanë të drejtën t'i drejtohen kësaj Gjykate (neni 25, paragrafi i dytë i Ligjit nr. 7891, datë 29.04.1992).

Gjykata, duke marrë parasysh rëndësinë e problemit të ngritur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe sidomos karakterin e veçantë që merrte ky problem në kushtet e krijuara në vendin tonë, e pa të nevojshme ta marrë atë në shqyrtim me nismën e saj...³¹

I njëjti arsyetim shihet edhe në raste të tjera të ngjashme³². Siç mund të konstatohet, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk e ka konsideruar Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një "person", subjekt që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në arsyetimin e vendimit Gjykata përqendrohet në faktin se kjo organizatë nuk parashikohej nga neni 25 i ligjit kushtetues. Mendojmë se në këtë

çështje, arsyetimi ishte i pamjaftueshëm për të kuptuar se, për cilën arsye Gjykata nuk e legjitimoi Komitetin Shqiptar të Helsinkit si një person, por zgjodhi të vihet në lëvizje me nismën e vet, për të trajtuar çështjet e ngritura në kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Në vitin 1998 Gjykata Kushtetuese nëpërmjet një vendimi, përcaktoi se, në rast se një person juridik shuhet gjatë kohës që çështja është në shqyrtim përpara kësaj Gjykate, atëherë kërkesa duhet të rrëzohet për shkak se organizata *me shpërndarjen e saj e ka humbur cilësinë e personit juridik për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".³³ Ne mendojmë se, në një rast të tillë do të ishte më korrekte nga pikëpamja tekniko-juridike që, Gjykata të vendoste pushimin e gjykimit dhe jo rrëzimin e kërkesës. Si rregull, me shpërndarjen e personit juridik që e ka vënë në lëvizje Gjykatën, kërkesa, por edhe procesi i nisur para Gjykatës Kushtetuese, vetiu kthehen në *nul* dhe Gjykata në këtë rast, nuk mund që t'u japë përgjigje pretendimeve të ngritura nga subjekti përkatës.*

Në përfundim, konkludojmë se qysh në këtë periudhë, u krijua praktika e organizatave jofitimprurëse për të përdorur mjetin kushtetues të vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese me anë të kërkesës, me qëllim mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të target grupeve që ato përfaqësonin. Ato shtruan për herë të parë në jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese trajtimin e disa koncepteve të rëndësishme juridiko-kushtetuese si, legjitimitimin e organizatave për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë. Kjo periudhë shërbeu për të nxjerrë konkluzionet e duhura, me qëllim përpunimin e këtij instrumenti kushtetues për organizatat edhe në Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë.

³¹ Shih Vendimin Nr. 14. Datë 29.05.1997 të Gjykatës Kushtetuese

³² Shih Vendimin Nr. 13, datë 25.9.1997 të Gjykatës Kushtetuese

³³ Shih Vendimin Nr. 20, datë 10.06.1998

2. Inicimi i Gjykimit Kushtetues nga *organizatat e tjera sipas Kushtetutës së vitit 1998*

Hartuesit e Kushtetutës aktuale, u kujdesën që të përcaktonin më mirë rrethin e subjekteve që mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Madje, vërejmë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton një rreth më të gjerë subjektësh në raport me disa Kushtetuta të tjera. Kështu p.sh., nëse i referohemi Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, apo asaj të Republikës së Kosovës rezulton se, jo vetëm që rrethi i subjekteve lëvizëse të Gjykatave Kushtetuese në këto të fundit është më i ngushtë, por edhe nuk parashikohet shprehimisht vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nga organizata të tjera.

Sidoqoftë, duhet të theksojmë faktin se në Shqipëri, parashikimi i tyre në Kushtetutë si subjekte lëvizëse për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, nuk është pa kufij. Në zbatim të nenit 134/2 të Kushtetutës, ky subjekt, ka detyrimin të provojë interesin e tij, pra, një të drejtë konkrete kushtetuese që pretendon se i është cënuar.

Nga ana e tij, Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, është treguar i kursyer në lidhje me këtë çështje. Përveçse transpozon në mënyrë identike dispozitën kushtetuese, ai nuk shkon më tej për të ofruar kritere të detajuara në lidhje me legjitimitimin e organizatave. Megjithatë, duke analizuar në tërësi dispozitat kushtetuese dhe ligjore, së bashku me jurisprudencën kushtetuese, mund të nxjerrim kriteret e nevojshme, të cilat duhet të plotësojë një subjekt i tillë për të iniciuar në mënyrë të suksesshme një proces kushtetues. Po rendisim këto kritere, si më poshtë vijon:

a) Kërkesa duhet të paraqitet nga një “organizatë”.

Në lidhje me këtë pikë është e nevojshme që të specifikojmë se çdo të kuptojmë me termin *organizatë*. Nëse i referohemi punëve përgatitore të Komisionit parlamentar për hartimin e projektkushtetutës, vërejmë se kjo çështje nuk është trajtuar, nga ana e tyre. Komisioni në këtë pikë pranoi pa asnjë kundërshtim

propozimin e stafit teknik, duke mos u thelluar më tej.³⁴ Megjithatë, referuar në jurisprudencën përkatëse kushtetuese,³⁵ vërejmë se termi *organizatë* është përmendur në Kushtetutë në disa kuptime dhe në një sërë dispozitash.³⁶ Është e rëndësishme që “organizata” të ketë personalitet juridik. Në këtë drejtim, rëndësi të posaçme merr neni 46 i Kushtetutës, i cili shpall lirinë për t’u organizuar, si dhe përcakton Gjykatën si institucionin që duhet të regjistrojë këto organizata. Detyrimi për t’u regjistruar në Gjykatë dhe jo në ndonjë organ tjetër të administratës publike, tregon kujdesin e hartuesit të Kushtetutës, që krijimi dhe regjistrimi i organizatave të bëhet në mënyrë të pavarur nga vullneti i ekzekutivit, duke vendosur Gjykatën si organin më të përshtatshëm e të pavarur, e cila gjykon mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta i ka referuar ligjit rregullimin e të gjithë procedurës së regjistrimit të organizatave. Legjislacioni që rregullon këtë fushë është Kodi Civil dhe ligji “Për Organizatat jofitimprurëse”. Sipas këtyre akteve, organizatat si subjekte të së drejtës fitojnë personalitetin juridik që nga dita e regjistrimit të tyre në Gjykatë. Pra, në momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës që administrohet nga Gjykata, këto subjekte kanë fituar njëkohësisht zotësinë juridike dhe zotësinë juridike për të vepruar. Për rrjedhojë, ato janë të afta që të ndërmarrin të gjitha veprimet e njohura nga ligji. I parë në një këndvështrim të ngushtë formal, që nga ky moment, teorikisht, një organizatë mund të vërë në lëvizje edhe Gjykatën Kushtetuese. Jurisprudenca Kushtetuese në fakt, kur trajton legjitimin *ratione personae* të këtyre subjekteve i referohet pikërisht vendimit të Gjykatës me anë të të cilit është bërë regjistrimi i tyre. Pavarësisht se janë bashkime vullnetare njerëzish, sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”³⁷, qëllimi i tyre është realizimi i

³⁴ Shih Debati Kushtetues, Botim i OSBE, Tiranë 2006, fq.1-30.

³⁵ Shih Vendimet Nr. 16, datë 25.07.2008, Nr. 17, datë 25.07.2008, Nr. 31, datë 02.10.2009, Nr.4, datë 12.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³⁶ Neni 9/2, neni 20/2, 46 dhe 50 të Kushtetutës.

një interesi publik. Është kjo arsyeja themelore që këto subjekte kanë parimisht të drejtën për të iniciuar një proces kushtetues. Në këtë drejtim, sipas praktikës kushtetuese, nuk është e nevojshme që anëtarësia e tyre të përfshijë të gjithë personat që pretendohet se janë prekur nga një akt normativ i caktuar.

b) Kërkesa duhet të jetë bërë në përputhje me rregullat statutore.

Sipas Kodit Civil dhe ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, personat juridikë veprojnë nëpërmjet organeve të tyre drejtuese. Pra, në këto organe formohet vullneti i organizatës dhe po nëpërmjet tyre, ky vullnet shfaqet në botën e jashtme. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që organi i organizatës që paraqet kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese, të jetë i parashikuar nga statuti si organ përfaqësues, ose i autorizuar prej tyre. Për Gjykatën ka rëndësi thelbësore që kërkesa të jetë paraqitur nga organi kompetent, përndryshe subjekti nuk legjitimohet. Këtë moment të rëndësishëm procedural e shohim të pasqyruar në dy vendime të Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht, në vendimin Nr.40, datë 6.5.1999, Gjykata është shprehur se “...Në çështjen në shqyrtim nuk ka ndonjë vendim të organeve drejtuese të Shoqatës, Mbledhjes së Përgjithshme ose Këshillit Drejtues për të ngritur padi në Gjykatën Kushtetuese, me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 48 të Ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, siç kërkon neni 47 i Kodit Civil dhe as kërkesë të përbashkët të Kryetarit e Sekretarit të Përgjithshëm siç lejon neni 11/4 i Statutit të Shoqatës. Ka vetëm një kërkesë të nënshkruar nga Kryetari i Shoqatës dhe një prokurë me të cilën ka caktuar avokat të nënshkruar po prej tij.

...vetëm kryetari i shoqatës duke mos qenë përfaqësuesi i saj, sipas Kodit Civil e Statutit të Shoqatës, nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës....

Ndërsa në vendimin Nr. 25, datë 29.07.2008, Gjykata u shpreh se *...Kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve, e paraqitur nga*

³⁷ Ligj Nr. 8788, 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

kryetarja e saj, në kuptim të kompetencës që parashikohet në nenin 10 të Statutit, përmban si argument parësor, që Gjykata e konsideron të përfshirë në sferën e qëllimit të kësaj Shoqate, pretendimin për cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve e, në veçanti, të parimit të pavarësisë së gjyqësorit, që kanë të bëjnë me rolin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare si institucioni që zgjedh shumicën absolute të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë...

Pra, siç rezulton nga këto dy vendime nuk ka rëndësi se cili është organi i organizatës, në emër të të cilit paraqitet kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. E rëndësishme është që ky organ ta ketë këtë kompetencë të parashikuar në mënyrë të shprehur, në Statutin e organizatës, ose në aktet e organeve drejtuese të saj.

c) Organizata duhet të pretendojë shkeljen e një interesi vetjak.

Kjo pikë është një nga çështjet më të debatueshme në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, kohët e fundit është rihapur debati edhe për disa raste, të cilat mendohej se përbënin jurisprudencë të konsoliduar.³⁸ Ky debat shtrohet për shkak të natyrës së kontrollit që duhet të ushtrojë Gjykata Kushtetuese në këtë rast. Sipas jurisprudencës rezulton ...*se procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interesi publik qoftë dhe pa pasur një interes konkret subjektiv, vetëm autoritete të larta shtetërore, (subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të Kushtetutës). Pra, kushtetutë bërësi ka legjitimuar për të vënë në lëvizje Gjykatën në lidhje me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e parë të listuar në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet*

³⁸ Shih Vendimin Nr. 4, datë 23.02.2011, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin subjekti kërkues, Komitetit Shqiptar i Helsinkit, u legjitimua pjesërisht nga shumica e trupit gjykues. Ndërkohë, sipas mendimit paralel të gjyqtarës A.Xhoxhaji subjekti nuk duhet të ishte legjitimuar, ndërsa sipas mendimit në pakicë të gjyqtarit S. Sadushi, subjekti duhet të ishte legjitimuar plotësisht.

në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjithë subjektet e tjerë, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f”, dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike...³⁹

Pra, kontrolli që ushtron Gjykata në këtë rast është një kontroll konkret që do të thotë se subjektit i është cenuar një e drejtë konkrete kushtetuese, e drejtë e cila përfshihet brenda objektit të veprimtarisë së organizatës dhe për rrjedhojë përbën edhe interesin e vetë në këtë çështje. Në vazhdim të kësaj analize rezulton se për të përcaktuar interesin konkret subjektiv të organizatës, rëndësi themelore merr objekti i veprimtarisë i parashikuar në Statutin e Shoqërisë. Siç rezulton nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, moment i cili ndan legjitimitimin e një subjekti përpara Gjykatës është pikërisht mënyra se si është formuluar objekti i veprimtarisë së Shoqërisë në Statut.

Gjithashtu, sipas jurisprudencës kushtetuese rezulton se, nisur nga specifika e kontrollit konkret që realizon Gjykata në këto raste, këto subjekte nuk legjitimohen që të godasin në rrugën e kontrollit kushtetues aktet normative vetëm për shkak të veseve formale që këto akte normative mund të kenë. Kjo mund të ndodhë nëse fillimisht, kërkuesit justifikojnë interesin e tyre duke provuar dhe argumentuar përpara Gjykatës cenimin e një të drejtë apo të një lirie kushtetuese, pra shkelje materiale. Vetëm nëse kalohet ky moment, atëherë Gjykata mund të shqyrtojë edhe pretendimet për vese procedurale të akteve normative të goditura nga kërkuesit. Më konkretisht, Gjykata është shprehur se, *...Përsa i përket legjitimitit të subjekteve, të cilëve u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit... dhe më tej, në po të njëjtin vendim*

³⁹ Shih Vendimin Nr.17, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

shprehet se, ...Në analizë përfundimtare, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ndodhemi përpara cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Si pasojë, përderisa Gjykata nuk konstaton shkelje të këtij parimi kushtetues, nuk mund të vijojë më tej me analizën e kontrollit abstrakt të Vendimit të Këshillit të Ministrave në drejtim të respektimit të kriterëve të nenit 11/3 dhe 17 të Kushtetutës. Edhe në lidhje me pretendimin për cenim të nenit 118 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky pretendim do të merrej në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një *interes real* të cenuar nga norma e goditur. Nga analiza e mësipërme, rezultoi se e drejta e lirisë së veprimtarisë ekonomike nuk cenohet nga akti, objekt shqyrtimi, dhe për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar një proces kontrolli kushtetutshmërie, në lidhje me nenet 131/c dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë...⁴⁰.

Në një rast tjetër, Gjykata, pasi konkludoi se kishte shkelje të parimit të lirisë ekonomike, vazhdoi me tej me arsyetimin e saj dhe iu përgjigj pretendimeve për antikushtetutshmërinë e aktit edhe për vese procedurale. Kështu ajo shprehet se ...*Pretendimi se është shkelur neni 118/1,2 i Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar është marrë në tejkallim të kompetencave të deleguara nga neni 10, pika 5, e Ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" vlerësohet nga Gjykata si i drejtë, pasi vendimi objekt shqyrtimi, në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 nuk përmban dispozita mbi cilësinë e lëndëve djegëse. Këto dispozita lejojnë përdorimin e një produkti dhe përcaktojnë kushtet e tregtimit tij. Rrjedhimisht, këto pika të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave tejkalojnë delegimin legjislativ të bërë nga pika 5 e nenit 10 të Ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".⁴¹ Sidoqoftë, nga jurisprudenca kushtetuese, për shkak të objektit të veprimtarisë por edhe natyrës së çështjeve, këtë problem nuk rezulton ta kenë organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të gjyqtarëve dhe pavarësisë së gjyqësorit. Kështu, në një vendim tjetër Gjykata është shprehur se, "...Pavarësisht se në*

⁴⁰ Shih Vendimin Nr.17, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

⁴¹ Shih Vendimin Nr. Nr.24, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese

formë, neni 81, pika 2, shkronja "a" i Kushtetutës, është normë me natyrë procedurale, në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Kjo dispozitë kushtetuese është edhe në funksion të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe pretendimi për cenimin e kësaj prerogative procedurale, i ngritur pikërisht nga një subjekt, i cili në veprimtarinë ligjore ka një mision të tillë, e bën të pranishëm ekzistencën e interesit për çështjen në shqyrtim. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve legjitimohet racione materiale të kërkojë kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën⁴².

Shpeshherë, në jurisprudencën Kushtetuese është vëne re edhe legjitimimi i pjesshëm i subjekteve kërkuese. Kjo ndodh për faktin se, pavarësisht objektit të kërkesës të paraqitur nga organizata, ajo duhet të provojë dhe të argumentojë interesin e saj. Në rast se ajo e provon këtë interes vetëm për një pjesë të dispozitave dhe jo për pjesën tjetër, atëherë Gjykata do të shprehet vetëm në lidhje me dispozitat normative që mund të prekin interesat që mbron organizata dhe jo për dispozitat e tjera, pavarësisht problemeve kushtetuese që ato mund të kenë. Pra, kalimi në seancën gjyqësore përmes vendimit të kolegjit seleksionues, nuk e ezauron çështjen e legjitimitimit. Edhe përgjatë seancës mund të vihet në pikëpyetje legjitimimi i subjektit për pjesë të caktuara të kërtimeve të tij. Për ta konkretizuar këtë rast mund të marrim si shembull Vendimin Nr. 35/2007, ku Gjykata konkludoi se "...Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuarit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", nuk mbart në vetoete interesin për t'u konsideruar në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si subjekt iniciues i gjykimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike lidhur me çështje që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre. Kërkuari legjitimohet vetëm për atë pjesë të ligjit që ka të bëjë me cenimin e interesave të pronarit të ligjshëm privat.

Pretendimi i përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave lidhur me

⁴² Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 25, datë 29.07.2008

moslegjitimimin e kërkuetit për pjesën e dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me pronën publike, është i drejtë.

Bazuar në përfundimin që ka të bëjë me pozitën që ka kërkueti, sipas nenit 134, shkronja "g" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se duhet të nxjerrë në evidencë si objekt të kontrollit kushtetues, kryesisht nenet 15/1 e 2, 16/1, 17, 18, 19, 21, 25, 27, 28, 29, 30, 31 e 34 të ligjit të ankimuar..."⁴³.

Nga pikëpamja materiale, konstatojmë me kënaqësi se organizatat e tjera kanë treguar një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve. Kjo, duke parë edhe kufizimin e individit për të kapur gjykatën Kushtetuese vetëm për pretendimet që kanë të bëjnë me një proces të rregullt ligjor.

Vështruar jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese, konstatojmë se të drejtat kushtetuese që janë marrë në mbrojtje nga organizatat e shoqatat, përmes vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kanë qenë veçanërisht: e drejta e pronës, iniciativa e lirë ekonomike dhe të drejta të tjera me karakter ekonomik social e kulturor. Përveç tyre, një rëndësi të veçantë ka pasur mbrojtja e garancive procedurale në procesin penal, e drejta e ankimit, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për informim, e drejta për një jetë private të fshehtë, e drejta për barazi, madeje edhe e drejta për kompensim, zhdëmtim dhe rehabilitim, etj. Në mënyrë veçantë, gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga organizatat për kontrollin abstrakt të pajtueshmërisë së normës me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka sjellë një kontribut të rëndësishëm gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave. Kështu, ajo ka avancuar qëndrimin e saj në lidhje me parimet e rëndësishme kushtetuese, si ai parimi i autonomisë universitare, parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parimi i autonomisë vendore, parimi i sigurisë juridike, parimi i standardit të fituar, etj.

3. Konkluzione

Konkluzione të rëndësishme evidentojmë nga pikëpamja e zhvillimit të së drejtës procedurale kushtetuese. Kështu,

⁴³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 35, datë 10.10.2007

jurisprudenca ka konsoliduar interpretimin e inicimit të proceseve kushtetuese nga organizatat. Një proces i tillë mund të fillojë kur përmbushen disa kushte, të cilat çdo organizatë duhet t'i mbajë parasysh. P.sh., organizata duhet të jetë e regjistruar, pra të ketë fituar personalitet juridik.

Kërkesa duhet të paraqitet nga organi, të cilit statuti i ka dhënë një kompetencë të tillë.

Kërkesi duhet të justifikojë interesin e tij. Pra, organizata duhet të ketë objektin e veprimtarisë së saj, të lidhur ngushtë me fushën e rregulluar nga akti normativ që pretendohet të jetë antikushtetues. Në këtë moment, merr rëndësi mënyra e formulimit të objektit të veprimtarisë së saj, në statutin e organizatës.

Duke qenë se kontrolli kushtetues lidhet më një interes konkret, atëherë në këtë rast, si rregull, organizatat nuk legjitimohen të godasin për antikushtetutshmëri aktet normative për shkak të veseve të tyre formale. Megjithatë, ato mund ta realizojnë një kërkesë të tillë, vetëm nëse justifikojnë shkeljen e një të drejte kushtetuese nga ana materiale. Për këtë, si dhe për aspekte të përmbajtjes materiale të kërkesës, është e domosdoshme që organizatat të konsultohen me juristë e avokatë.

Nëse respektohen me kujdes këto kritere, mundësia e organizatave për të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, do të jetë me e suksesshme.

BIBLIOGRAFI

· Luan Omari, Aurela Anastasi - *"E Drejta Kushtetuese"* - Shtëpia Botuese ABC, Tiranë 2010

· Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda (Methasani) Cani - *"Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë"*, Shtëpia Botuese Adelprint, Tiranë 2011, financuar nga Fondacioni Konrad Adenauer

· *Debati Kushtetues*, Botim i OSBE, Vëllimi 2, Tiranë 2006.

- Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 6340, datë 26.06.1981- Kodi Civil
- Vendimi Nr. 13, datë 22.11.1993 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 4, datë 8.4.1994 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 7, datë 14.4.1994 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 14. Datë 29.05.1997 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 13, datë 25.9.1997 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimin Nr. 20, datë 10.06.1998 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 7, datë 25.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi Nr. 16, datë 25.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 17, datë 25.07.2008, i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 24, datë 24.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 31, datë 02.10.2009, i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 4, datë 12.02.2010 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr. 4, datë 23.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese

Elsa TOSKA (DOBJANI)⁴⁴

LEGJITIMIMI I ORGANIZATAVE NË OPTIKËN E GJYKATËS KUSHTETUESE

• Hyrje

Procedurat para gjykatave kushtetuese kanë një natyrë iniciuese fakultative (*juridiccion voluntaria*). Në parim gjykatat kushtetuese nuk mund të fillojnë procedime me iniciativë, (*ex officio*). Si rregull procedimet para kësaj gjykate iniciohen nga subjektet e cilësuar si të tilla nga dispozitat kushtetuese. Ka disa forma shqyrtimi kushtetues dhe legjitimimi të subjekteve për kontrollin kushtetues⁴⁵.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përcakton si subjekte për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (në vijim Gjykata) për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e para të listuar në nenin 134/1 të Kushtetutës, ndërsa të gjitha subjektet e tjera, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike⁴⁶. Dallimi

⁴⁴ “Këshilltare e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”, doktorante, UT. Komentet dhe konkluzionet e këtij punimi janë vetëm të autores dhe nuk përfaqësojnë qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese, institucionit ku ajo punon. .

⁴⁵ Mavcic Arne; Material “Judicial review of administrative decisions, the extent and limits of the judicial review, the efficiency of the judicial review” fq.4-5.

⁴⁶ Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike dhe organizatat e tjera.

mes kategorisë së parë të subjekteve, autoritetet shtetërore (përjashto Avokatin e Popullit dhe organet e qeverisjes vendore) dhe kategorisë së dytë, subjekteve private (organizatat e tjera, individë, parti politike,) është se të parave u prezumohet interesi, kurse të dytët duhet ta provojnë⁴⁷. Presidenti, Kryeministri, jo më pak se 1/5 e deputetëve dhe Kryetari i KLSH-së, u prezumohet interesi publik dhe funksional, mbrojtja e parimeve kushtetuese, shtetit të së drejtës dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret⁴⁸. Tipari dallues i një kërkesë për kontroll abstrakt të normës nga subjektet e pakushtëzuara është se ato vënë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të ligjit, pasi interesi që kërkohet të mbrohet nuk është thjesht individual, por është një interes që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre.⁴⁹

Gjykata kërkon paraprakisht që subjektet të provojnë cilësinë e tyre si subjekte që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës (*ratione personae*) dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre (*ratione materiae*). Termi “interes i tyre” është pengesa dhe barriera, sipas të cilës një kërkesë para Gjykatës Kushtetuese nuk konsiderohet si kërkesë popullore (*actio popularis*).

Ky punim do jetë i fokusuar në prezantimin e kriterëve kushtetuese jurisprudenciale të *locus standi* të organizatave të tjera (në vijim Organizata) dhe çështjeve të debatueshme mbi legjitimitimin e tyre, si mjaft të rëndësishme dhe me aktualitet, nisur

⁴⁷ Berberi Sokol “Protection of the constitutional values from civil society through the constitutional review”, Konferenca “Fundamental constitutional values and public practice”, Armeni 3-5 Tetor 2008; Proceedings ISSN 1829-0124 , fq.56; Marrë nga <http://www.concourt.am/english/events/conferences/2008/index.htm>

⁴⁸ Vendimi nr.9, datë 23.03.2010

⁴⁹Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008; vendimi nr.1, datë 07.01.2005

edhe nga numri i kërkesave në rritje të kësaj kategorie subjektsh para Gjykatës Kushtetuese⁵⁰.

* * *

Kuptimi kushtetues i termit “Organizata” dhe doktrina e koncepteve autonome

Do ndalem që në fillim të punimit lidhur më të ashtuquajturën doktrinë të “*koncepteve autonome*” huazuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁵¹. Sipas kësaj doktrine, termat e KEDNJ –së, nuk kanë domosdoshmërisht të njëjtin kuptim me termat e përdorur nga legjislationet vendase anëtare të KEDNJ-së. Edhe sipas Gjykatës Kushtetuese termat e përdorur në Kushtetutë janë koncepte autonome, dhe jo domosdoshmërisht interpretohen sipas kuptimit ligjor të tyre. Kjo gjykatë nuk e bën interpretimin e termave sipas kritereve formale të ligjeve të posaçme. Ajo shikon më në thellësi se për çfarë të drejte kushtetuese bëhet fjalë, cili ka qenë qëllimi i dispozitës, marrja parasysh e dispozitës në unitet me dispozita të tjera, ndërthurja e vlerave të ndryshme kushtetuese dhe hierarkia e vlerave dhe përfundimisht si mund ta kryejë ajo vetë funksionin kryesor të saj interpretimin e Kushtetutës jo vetëm në kontekstin e një gjykimi abstrakt të normës, por edhe në kontekstin e një gjykimi konkret ku interpretimi merr vlerën e duhur kontekstuale.

Zbatimi i kësaj doktrine, lejon që termat ligjore me termat kushtetues jo gjithmonë të jenë simetrike, madje nocioni “Organizatë” që ka përdorur dhe ka interpretuar Gjykata në jurisprudencën e saj e tregon asimetrinë e tij krahasuar me termin e përdorur nga ligjet për këtë koncept. Kjo do të thotë se Gjykata kur interpreton terma kushtetues si p.sh. termi “organizata të tjera” sipas nenit 134/f të Kushtetutës nuk i referohet domosdoshmërisht ligjit për OJQ-të⁵², Kodit Civil apo ligjeve të tjera të posaçme, por i jep

⁵¹ Chassagnou v.France prill 29, 1999; Artico v.Italy maj 13, 1980; Campbell and Fell v. UK, qershor 28, 1984. Shih për më tepër George Letsas “The truth in autonomous concepts; How to interpret the ECHR” , <http://ejil.oxfordjournals.org/content/15/2/279.full.pdf>

⁵² Ligji nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” me ndryshimet perkatese.

termit kuptimin kushtetues, duke marrë në konsideratë edhe burime të tjera autoritare të ndryshme nga ligji. Megjithatë Gjyqtarët nuk kërkojnë terminologji abstrakte filozofike që nuk ka baza ligjore gjatë këtij interpretimi, por ata përpiqen t'i japin dimension e duhur, dhe gjithsesi jo krejt të kundërt me terminologjinë ligjore.

1. Interesi i Organizatave dhe kontrolli kushtetues

Në funksion të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në "... organizata të tjera" të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, ka përfshirë organizatat politike (neni 131, shkronja "d"), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2)⁵³. Po kështu Gjykata ka përfshirë në rrethin e "organizatave të tjera" të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata ose organizime të tjera me karakter të ndryshëm, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore⁵⁴.

Tashmë me një praktikë të konsoliduar mund të veçojmë disa elemente të cilët nuk merren në konsideratë si argumente nga Gjykata Kushtetuese për moslegjitimitimin e Organizatave. Vendimmarrja e Gjykatës ka qenë konsistente në trajtimin e pretendimeve për mungesë legjitimimi dhe rrëzimin e tyre edhe pse parashtruar disa herë nga palët e interesuara (Kuvendi, Këshilli i Ministrave) për tre arsye të mëposhtme:

· *Me termin organizata nuk kuptohen vetëm shoqatat.* Gjykata është shprehur se ligjvënësi kushtetues, duke i vendosur organizatat e tjera krahas partive politike në nenin 134/f, nuk ka pasur për qëllim të pranojë si subjekte inicuese vetëm organizatat, por të përfshijë në rrethin e "organizatave të tjera" të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata apo organizime të tjera me karakter të ndryshëm, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore.⁵⁵

⁵³ Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010

⁵⁴ Vendimi nr. 33, datë 24.06.2010

⁵⁵ Vendimi nr. 16, datë 25.07. 2008

· *Organizatat nuk janë vetëm të karakterit politik.* Gjykata është shprehur se nuk mund të pranohet që organizatat e vendosura pranë partive politike në nenin 134/f të Kushtetutës janë vetëm të karakterit politik. Ligjvënësi kushtetues, duke i vendosur organizatat e tjera krahas partive politike në nenin 134/f, nuk ka pasur për qëllim të pranojë si subjekte inicuese vetëm organizatat me karakter politik. Termi “*organizatë*” në Kushtetutën është përmendur në disa konotacione, në analizë literale-gramatike të të cilave rezulton se kushtetutbërësi me *organizatë*, në kuptimin e përgjithshëm, ka kuptuar ato *politike* (neni 131, shkronja “d”), *etnike, kulturore, fetare, gjuhësore* (neni 20/2), *sindikale* (neni 50), *shoqërore, ekonomike, tregtare* (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2)⁵⁶.

· *Kërkuesit nuk duhet të provojnë se përfaqësojnë të gjithë kategorinë e tyre.* Gjykata është shprehur se për efekt të legjitimitetit nuk është e nevojshme që kërkuesit të provojnë se përfaqësojnë të gjithë kategorinë e tyre pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, i cili përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitetin. Kështu këtë qëndrim kjo gjykatë e ka mbajtur kur Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Shqipërisë dhe Shoqata Kombëtare e Debim -Internimeve i është drejtuar Gjykatës dhe kërkesa e tyre nuk është mbështetur edhe nga shoqatat e tjera të kategorisë së përndjekurve.⁵⁷ Gjithashtu po të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata kur i është drejtuar Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë e pa mbështetur në kërkesën e saj nga shoqata të tjera gjyqtarësh.⁵⁸

Në funksion të legjitimitetit *rationae materiae*, Gjykata ka theksuar, se vlerësimi, nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar ose veprimtarisë që kryen, dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat që

⁵⁶ vendimi nr.31, datë 02.12.2009; vendimi nr.17, datë 25.07.2008

⁵⁷ vendim nr.4, datë 12.02.2010

⁵⁸vendimi nr.11, datë 06.04.2010; vendim nr.31, datë 02.12.2009

kërkohet të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën.⁵⁹ Për pasojë, vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut⁶⁰.

Me anë të këtij detyrimi, për të provuar interesin konkret për çështjen kushtetuese të ngritur, synohet identifikimi i të drejtës së shkelur të subjektit, si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike të kundërshtuar. Pra, interesi konsiston te e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit⁶¹.

Gjykata ka theksuar se interesi duhet provuar dhe për këtë qëllim kërkuesi duhet së pari të saktësojë se në çfarë cilësie vepron kundër dispozitës së kundërshtuar dhe më pas të vërtetojë se në çfarë mënyre mund të preket në një aspekt të çfarëdoshëm të situatës së tij, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së tij dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.⁶²

Në funksion të dallimit mes pretendimeve që mund të ngrejë një subjekt i pakushtëzuar nga ai i kushtëzuar Gjykata ka argumentuar se subjektet e parashikuara në nenin 134/2 të Kushtetutës nuk legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike duke paraqitur si argument ekzistencën e veseve formale, në qoftë se vetë norma nuk ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës⁶³.

⁵⁹ vendimi nr.17, datë 25.07.2008; nr.9, datë 19.03.2008

⁶⁰ vendimi nr.31, datë 18.06.2010

⁶¹ vendimi nr.20, datë 09.07.2009

⁶² vendimi nr.9, datë 26.02.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.41, datë 16.11.2007; nr.9, datë 19.03.2008; nr.16, datë 25.07.2008; nr.12, datë 28.04.2009

⁶³ vendimi nr.17, datë 25.07.2008; vendimi nr. 24, datë 24.07.2009; vendimi nr.4, datë 23.02.2011

Gjykata e ka parë legjitimimin në raport edhe me proporcionalitetin, në kuptimin që subjekti është legjitimuar vetëm për atë pjesë të ligjit që ka lidhje me misionin apo veprimtarinë e tij.⁶⁴

2. Disa pikëpyetje/ debate mbi *locus standi* të Organizatave

2.1 A duhet të legjitimohen vetëm organizatat me anëtarësi dhe jo organizimet e tjera?

Termi “organizata të tjera” është interpretuar nga Gjykata në kuptimin kushtetues se i referohet shoqatave, fondacioneve, qendrave apo çdo organizimi tjetër me qëllim politik, ekonomik, social apo çdo qëllimi tjetër të ligjshëm⁶⁵. P.sh me vendimin nr. 9/2008 Gjykata shprehet se: “Qendra “Forumi i Mendimit të Lirë” është një organizatë jofitimprurëse, që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, i parashikuar në statut, është dhe nxitja e zhvillimit të legjislacionit në fushën e arsimit, mbrojtja e interesave të ndryshme të institucioneve arsimore të çdo niveli, respektimi i parimit të autonomisë universitare si dhe promovimi i edukimit shoqëror e individual, bazuar në vlerat e demokracisë liberale”. Sipas argumentimit të dhënë nga Gjykata, në rastin konkret për legjitimimin është marrë si referencë objekti i veprimtarisë dhe është lënë mënjanë mungesa e anëtarësisë. Në kushtet kur qendrat apo fondacionet krijohen pa anëtarësi sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse, dhe Gjykata është shprehur se me interes do kuptohen edhe interesat e anëtarësisë, natyrshëm mund të mendohet që “anëtarësia” duhet të jetë patjetër kriter legjitimimi apo jo? Për të shkuar më larg duhet që patjetër të jenë të cenuara interesat e anëtarësisë për efekt legjitimimi edhe nëse organizata është me anëtarësi? P.sh me vendimin nr. 4/2011, palët e interesuara ngritën pretendime lidhur me faktin se Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) si subjekt kërkues nuk provoi dot se

⁶⁴ vendimi nr.35, datë 10.10.2007

⁶⁵ vendimi nr.17/2008 dhe nr.16/2008

ligji anti mafia kishte cenuar interesat e anëtarësisë, por Gjykata e legjitimoi këtë subjekt sepse ligjin objekt kundërshtimi e pa të lidhur jo me interesat e anëtarësisë, por me interesat e misionit dhe objektit të veprimtarisë së KSHH-së. Mendoj se kriteri i “anëtarësisë” mbetet akoma një kriter për t’u elaboruar nga Gjykata Kushtetuese, se çfarë rëndësie do të duhej të kishte për legjitimimin, si kriter elastik apo statik, i paracaktuar si kusht legjitimimi.

2.2 A duhet të provojë organizata konkretisht dëmin e ardhur? Si mund ta provojë në një kontroll abstrakt?

Gjykata ka theksuar se kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normës mund të zbatohet ndaj akteve pavarësisht nga efekti që ato mund kenë në një konflikt aktual apo të pritshëm. Për Gjykatën është i njohur rregulli i pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencën kushtetuese, se gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme juridike nuk kërkohet ardhja e pasojës për të legjitimuar kërkuesin. Qëllimi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve është njëkohësisht edhe parandalimi i pasojave negative që mund të vijnë nga zbatimi i tyre.⁶⁶ Në fakt kontrolli i normës nga organizatat nuk është as kontroll abstrakt dhe as konkret sipas një ndarjeje të pastër doktrinale⁶⁷. Edhe vetë Gjykata në disa vendime ka pranuar se kontrolli i iniciuar nga Organizatat është kontroll konkret i normës⁶⁸. Duke mos i dhënë shumë rëndësi dhe vlerë ndarjes teorike se çfarë lloj kontrolli është kontrolli i iniciuar nga Organizatat, vlerën do ia shikoja në terrenin praktik, duke veçuar kriterin “dëmi i ardhur” ose “dëmi që duhet parandaluar”.

Në mendimin tim jo domosdoshmërisht duhet të kërkohet vërtetimi i dëmit të ardhur, mjafton që Organizata në cilësinë e kërkuesit të tregojë se dispozita e prezumuar antikushtetuese sipas tij e prek në mënyrë direkte dhe shqetësimi është real. Kategoria e Organizatave duhet të kenë një status të privilegjuar. Roli i

⁶⁶vendimi nr. 18, datë 29.07.2008; vendimi nr.1, datë 07.01.2005

⁶⁷ Sadushi Sokol; Kontrolli kushtetues, Botimpex, Mars 2004, fq.76-106.

⁶⁸ vendim nr.17/2008 dhe nr.4/2011

shoqërisë civile (aktorë jo shtetërore) në mbrojtjen e vlerave kushtetuese është shumë i rëndësishëm. Demokracia kushtetuese ka nevojë për një shoqëri civile aktive dhe të pavarur, veçanërisht në lidhje me arritjen e qëllimeve kushtetuese⁶⁹. Prandaj dhe për vlerat që Organizatat mbrojnë (kam parasysh këtu ato që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut të quajtura ndryshe *Watchdog organisations*), parandalimi i dëmit të ardhur do të ishte një shtysë më e fortë për legjitimimin e tyre se sa kërkimi me çdo kusht i vërtetimit të dëmit të ardhur.⁷⁰

2.3. Po veprimtaria, kohëzgjatja, a duhet të merret në konsideratë për legjitimimin?

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është legjitimuar për shkak veprimtarie faktike, por nëse do i drejtohej Gjykatës Kushtetuese një organizatë e krijuar pas daljes së ligjit objekt kundërshtimi në gjykatë, dhe që presupozohet se nuk ka kryer veprimtari faktike në përputhje me misionin e saj, a do duhej të legjitimohej? Do të shtroja në këtë situatë hipotetike tre pyetje: (i) Pa u angazhuar në veprimtari faktike në fushën përkatëse, a ka Organizata përqsajen e duhur kushtetuese për t'iu drejtuar Gjykatës? (ii) Po nëse Organizata të tjera që veprojnë në të njëjtën fushë prej vitesh nuk i drejtohen Gjykatës a është fakt që duhet marrë në konsideratë për efekt legjitimimi? (iii) A do duhej që kjo Organizatë të tentonte

⁶⁹ Berberi Sokol; "Protection of the constitutional values from civil society through the constitutional review", Konferenca "Foundamental constitutional values and public practice", Armeni 3-5 Tetor 2008; Proceedings ISSN 1829-0124 fq.56; Marrë nga <http://www.concourt.am/english/events/conferences/2008/index.htm>

⁷⁰ Ndoshta analogjia nuk është shumë e goditur me proceset e zhvilluara në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut, por kjo gjykatë shqyrton çështje në terma konkrete dhe nuk aplikon patjetër kriterin e dëmit të ardhur për të legjitimuar aplikantin, edhe pse neni 34 i KEDNJ përdor shprehimisht termin "Gjykatës mund t'i paraqiten kërkesa nga (...) që pretendojnë se janë të dëmtuar". Shih për më tepër Reid Karen; "A practitioner's guide to the European convention on human rights", 3rd edition, Thomson Sweet&Maxwell; 1-047 si dhe vendimin *Dudgeon vs. United Kingdom*, datë 22 tetor 198.

të bashkohej me Organizata të tjera *simotra* për të kaluar barrierën e legjitimitimit në Gjykatë?

2.4 A janë komulative kriteret e legjitimitimit apo janë përjashtuese?

Më lart kam parashtruar se elementet e legjitimitimit nuk janë shteruese, jo domosdoshmërisht duhet të jenë shteruese, por nuk janë as plotësisht të paracaktuara, komulative si dhe të elaboruara përfundimisht nga Gjykata⁷¹. Kjo do të thotë se Organizata para se të drejtohet Gjykatës jo domosdoshmërisht duhet të plotësojë të gjitha kriteret gjithëpërfshirëse të zërthyer nga vetë ajo. Për përcaktimin e disa prej kriterëve, është e nevojshme që nga Gjykata të mbahet qëndrim elastik, në varësi të rastit konkret dhe sigurisht nuk do konfondoja elasticitetin me mungesën e konsekuencës. Situatat duhen parë rast pas rasti; psh, KSHH nuk provoi dem tek ligji antimafia, por u legjitimua se provoi që dispozitat e atakuara kishin lidhje me misionin e Organizatës, po kështu KSHH nuk provoi se ligji cenonte anëtarësinë e tij⁷²; Unioni i Gjyqtarëve ngriti pretendime për cenim të pavarësisë së gjyqësorit për transferimet, por nuk provoi se kishte pasur ankesa të gjyqtarëve në rastet e transferimeve pa dëshirë⁷³ si element dëmi. Gjyqtari kushtetues në varësi të rastit

⁷¹ Kjo lloj politike nuk është tipike vetëm për Gjykatën Kushtetuese sa i përket legjitimitimit. Gjykata Europiane e Drejtësisë në linjën e legjitimitimit për aplikantët përpara saj sipas nenit 173 të Traktatit të Komunitetit Europian ka konsoliduar disa kritere dhe ka qenë liberale në disa kritere të tjera në varësi të çështje konkrete, në varësi të subjektit aplikues si dhe në varësi të aktit që është kundërshtuar para saj. Shih për më tepër Graig Paul; De Burca Grainne; "EC law Text, cases and materials"; Clarendon Press Oxford, 1998, fq.447-482.

⁷² vendimi nr.4, datë 23.02.2011

⁷³ Proceverbali i séancës gjyqësore, datë 15.06.2011, Cështja me kërkues Unioni i Gjyqtarëve dhe objekt "Shfuqizimi si i papajtuësëm me Kushtetutën i fjalisë "Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfutur pagën e gjyqtarit", të nenit 42/1 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe të shprehjes "ose më ulët" të nenit 42/1 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

konkret, duhet të pozicionohet duke vlerësuar elemente të tjerë legjitimimi siç mund të jetë shqetësimi se sa serioz dhe real është për shkeljen potenciale, rëndësia e shkeljes së pretenduar, mënyra e parashtrimit të pretendimeve, që mund t'i japë atij *insight* se çështja duhet të kalojë në seancë gjyqësore⁷⁴. Disa elemente të legjitimitit, nuk mund të jenë ezaurues në Kolegjin e Gjykatës (organi kompetent prej 3 anëtarësh që vendos legjitimitimin sipas nenit 31 të ligjit organik të Gjykatës), por duhet shqyrtuar çështja në seancë, psh ekzistenca e demit, shqetësimi tepër serioz për pasojat e dëmshme potencialisht, janë kritere që duan debat gjyqësor dhe për të mund të vendoset legjitimimi pas mbarimit të seancës gjyqësore.⁷⁵

KONKLUZIONE

Në përmbyllje mund të themi se (i) termi “organizatë” është nocion joshterues dhe kategori e hapur. Ai përfshin edhe grupime të organizimit të individëve (shtetas shqiptarë a të huaj), me kushtin që organizimi i tyre të përputhet me parimet demokratike, ndërsa programet dhe veprimtaria e tyre të mos mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtnë racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si dhe të mos jenë me karakter të fshehtë; (ii) Organizatat mund të jenë të karakterit politik, etnik, fetar, gjuhësor, shoqëror, ekonomik, tregtar dhe të tjera; (iii) Vlerësimi,

⁷⁴Gjykata Kushtetuese Belge tregohet më e butë sa i përket legjitimitit, për të shqyrtuar realitetin e efektit të pafavorshëm të pasojës kur kërkesa është paraqitur duke pasur parasysh respektimin e të drejtave themelore të individit. Ajo përmend, psh se e drejta për procesin e rregullt në fushën penale përbën një garanci gjer në atë pikë thelbësore saqë nuk kërkohet që personi që pretendon për shkeljen të provojë se dispozita që ai atakon do të ndikonte drejtpërdrejt në ecurinë e procedurave penale që lidhen me të (vendimi 86/2002 datë 8 maj 2002). Marre nga materiali i Drejtorisë së Studimeve pranë Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁵Ky qëndrim është mbajtur nga Gjykata p.sh. me vendimin nr.4/2011 ku pasi ka shqyrtuar pretendimet ka dalë në konkluzionin se kërkuesi nuk legjitimohet, për shkak se pretendimet nuk qëndronin. Shih dhe mendimin e Gjyqtarit në pakicë Sokol Sadushi.

nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë; (iv) Kërkuesi duhet të saktësojë se në çfarë cilësie (*qualitate qua*) vepron kundër dispozitës së kundërshtuar (legjitimim procedural); (v) Organizatat duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën; (vi) Interesi quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuesi se pasoja negative, është e drejtpërdrejt, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është reale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me funksionet e organizatës respektive; (vii) Interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi/rreziku real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit.

Për Organizatat do të ishte e rekomandueshme mbajtja parasysh e jurisprudencës së GJK-së, evidentimi i atyre kriterëve të përcaktuara në mënyrë të konsoliduar dhe komulative si përputhshmëria e veprimtarisë me fushën e veprimit të ligjit, përputhshmëria e misionit të tyre me normën e pretenduar si antikushtetuese, paraqitja e kërkesës nga organi kompetent sipas statutit, argumentimi i shqetësimit real për antikushtetutshmërinë e normës.

Po kështu Organizatat do të duhet të mbajnë parasysh ato kriterë fleksibël *si ardhja e dëmit* dhe të vazhdojnë të argumentojnë në gjykatë kur është e mundur ardhjen e tij, *kohëzgjatjen e veprimtarisë* si dhe në rast të një *kohëzgjatje* e shkurtër të konsiderojnë tentativën për bashkëpunim me organizata të tjera aktive në fushën përkatëse për t'iu drejtuar së bashku Gjykatës. Gjithashtu edhe *veprimtaria faktike* është një kriter që Organizatat duhet ta argumentojnë para Gjykatës. Nëse në misionin e tyre mund të kenë disa objektiva, ato duhet të veçojnë dhe parashirojnë atë pjesë të veprimtarisë së tyre që lidhet me normën e atakuar dhe me pjesën përkatëse të misionit të tyre.

Gjithsesi debati nuk duhet të konsistojë në faktin se pse ekzistojnë apo krijohen kriterë kufizuese/ngushtuese për legjitimimin, por nëse

këto kritere janë vënë për arsyt e duhura dhe në mënyrën e duhur. Kufijtë e legjimit të Organizatave do të duhej të shkonin deri tek mosrënia ndesh me administrimin e drejtësisë, me eficientë e vetë Gjykatës, me garantimin e respektimit të parimeve kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe elementëve të shtetit të së drejtës.

BIBLIOGRAFIA

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, e ndryshuar;
2. Jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese (1992-2011);
3. Jurisprudencë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
4. Kodi Civil;
5. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".
6. Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".
7. Sadushi Sokol, 'Kontrolli Kushtetues', Botimpex, Tiranë, Mars 2004.
8. Berberi Sokol, "Protection of the constitutional values from civil society through the constitutional review", Konferenca "Fundamental constitutional values and public practice", Armeni 3-5 Tetor 2008; Proceedings ISSN 1829-0124.
9. Pirdeni L. Material mbi legjitimitimin sipas Gjykatës Kushtetuese Belge, Shkurt 2005, Drejtoria e Studimeve, Gjykata Kushtetuese.
10. Graig Paul; De Burca Grainne; "EC law Text, cases and materials"; Clarendon Press Oxford, 1998.
11. Mavcic Arne; Material "Judicial review of administrative decisions, the extent and limits of the judicial review, the efficiency of the judicial review";
12. Reid Karen; "A practitioner's guide to the European Convention on Human Rights", 3rd edition, Thomson Sweet&Maxwell, 2004.
13. George Letsas "The truth in autonomous concepts; How to interpret the ECHR" Faqja e internetit <http://ejil.oxfordjournals.org/content/15/2/279.full.pdf>, 2004

Dr. Arta VORPSI⁷⁶

Dr. Eralda (METHASANI) ÇANI⁷⁷

ROLI I OJFVE NË FORCIMIN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE E INTERESAVE KOLEKTIVË PËRMES GJYKIMIT GJYQËSOR E ATIJ KUSHTETUES

- Hyrje

Kushtetuta e vendit parashikon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut i njihen dhe garantohen sa individëve aq edhe personave juridikë, pra edhe organizatave jo fitimprurëse (OJF).⁷⁸ Sipas Kushtetutës, e drejta për t'u organizuar kolektivisht i përket kujtdo (sigurisht ky organizim bëhet në përputhje me ligjin).⁷⁹ Kështu, OJF-të, krijuar në reflektim të të drejtave themelore të njeriut, gëzojnë të drejta themelore të njeriut. Një prej këtyre të drejtave është edhe ajo e mbrojtjes, parashikuar nga nenet 42, 43, apo 131/3, 143 të Kushtetutës. Në këto nene parashikohet sa e drejta për t'u drejtuar gjykatës, aq edhe e drejta për t'u drejtuar Gjykatës Kushtetuese (GjK), sigurisht sipas përcaktimeve të posaçme për secilin rast, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Gjuha e

⁷⁶ Është këshilltare ligjore e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe lektore e së drejtës kushtetuese dhe e së drejtës kushtetuese të krahasuar. Çdo mendim i shprehur prej saj është personal dhe nuk përfaqëson qëndrimin e institucionit ku ajo punon.

⁷⁷ Është titullare e të Drejtës Administrative, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

⁷⁸ Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta).

⁷⁹ Neni 46 i Kushtetutës.

Kushtetutës, duke qenë gjithëpërfshirëse në nenet 42 e 43, apo edhe 131, dhe madje edhe specifike si në rastin e nenit 143 ku i referohet edhe 'organizatave të tjera', përfshin parimisht edhe OJF-të në tërësinë e subjekteve që kanë akses në gjyqësor e Gjykatën Kushtetuese. Legjislatori më tej ka rregulluar me detaje mundësinë që padi në gjykatë apo kërkesa pranë GJK për adresimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut të ngrihen edhe nga OJF-të. Pavarësisht këtij parashikimi, kjo nuk do të thotë gjë tjetër veçse një mundësi *de lege lata*. Realizmi *de facto* është treguesi i përdorimit të kësaj mundësie. Aksesi në gjykatë apo Gj. K pa dyshim lidhet ngushtë me interesat e OJF-ve, dhe interesa të tilla janë të lidhura *a. sa* me interesat e vetë organizatave, pra çështje të tilla si regjistrimi, taksimi-tatimi, konflikte civile apo edhe penale në të cilat përfshihen vetë organizatat, aq edhe *b. me* adresimin e çështjeve të cilat kanë të bëjnë me objektin e veprimtarisë së tyre, pra me adresimin e interesit për të cilin ato janë krijuar. OJF-të krijohen si persona juridikë me anëtarësi apo jo,⁸⁰ duke u krijuar pra si subjekte që adresojnë interesat e një kolektivi të gjerë apo të ngushtë, por në çdo rast të një grupimi individësh që adresojnë një interes kolektiv, të përbashkët. Krijimi i mundësive të tilla ligjore si njohja e të drejtës për të ngritur padi apo paraqitur kërkesa pranë Gj. K, është reflektim i pozitës juridike të tyre që synon të adresojë sa vetë interesat e OJF-ve, aq interesat kolektive, pra qëndrimi në këtë këndvështrim i legjislatorit është ai utilitar. Mund të thuhet që sa më aktiv dhe cilësor të jetë roli i OJF-ve në angazhimin e tyre për mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut por edhe interesave legjitime apo të drejtave subjekteve, aq më shumë ato kontribuojnë drejtpërdrejtë në forcimin e respektimit të këtyre të drejtave e lirive në vend, pra aq më shumë kontribuojnë drejtpërdrejtë në forcimin e shtetit të së drejtës. Pa dyshim që aksesi në gjykatë apo mekanizma të tjerë të drejtësisë nuk është i vetmi mjet me të cilin OJF-të mund të kontribuojnë në avancimin e të drejtave të njeriut, është njëri prej tyre. Shpeshësia

⁸⁰ N. ...i ligjit për OJF-të.

e përdorimit të këtyre mekanizmave ligjorë nga OJF-të do të na orientonte të kuptonim nëse kemi pasur një kontribut aktiv të OJF-ve, por nga ana tjetër analiza e angazhimeve të tyre do të na tregonte nëse kemi të bëjmë me raste të abuzimit të përdorimit të të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës apo GJ. K së apo edhe me tërësinë e problematikave të shfaqura në realitetin vendas dhe për të cilat shoqëria civile ka reaguar në mbrojtje të interesit publik. Po ashtu, nëse nuk ka pasur ndonjë angazhim të madh të tyre, kjo mund të vijë ose si rrjedhojë e mospasjes së problematikave të caktuara në lidhje me të drejtat e njeriut, gjë që nuk mund të thuhet për Republikën e Shqipërisë konfirmuar kjo nga cilido raport i komunitetit ndërkombëtar por edhe vendas mbi garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut (në fund të fundit cilido vend ka problematikave të veta në lidhje me garantimin e të drejtave të njeriut), ose edhe se kapaciteti qoftë financiar, infrastrukturor, apo edhe ai profesional i OJF-ve nuk mundësojnë një adresim të kësaj problematike. Duke konsideruar tërësinë e problemeve me të cilët përballet shoqëria civile në vend, si dhe angazhimin e saj në këndvështrimin e paraqitur në këtë punim, mund të thuhet se ky angazhim jo i madh, por me një tendencë në rritje, ka qenë e vijnë të jetë i minuar nga një tërësi faktorësh, përfshirë madje këtu edhe barriera ligjore për aksesin në drejtësi të OJF-ve. Edhe pse barriera të shumta ekzistojnë, gjithsesi një tendencë në rritje e aksesit të OJF-ve në drejtësi mund të thuhet se është vënë re. Madje mund të thuhet edhe që kategoritë e çështjeve për të cilat janë investuar OJF-të në sistemin vendas janë tregues i dinamikave të zhvillimeve në vend. Nëpërmjet analizave të çështjeve të mësipërme, prezantimi synon të analizojë kështu aktivizimin e OJF-ve si dhe natyrën e këtij aktivizimi parë nga këndvështrimi i ndikimit të OJF-ve në forcimin e realizimit të të drejtave e lirive themelore e të drejtave e interesave legjitime e subjektive në vend.

- OJF-të dhe angazhimi në garantimin e të drejtave të njeriut
OJF-të janë organizma mjaft të rëndësishëm për realizimin e të

drejtave dhe lirive themelore. Të thuash vetëm kaq është e pamjaftueshme. Ato janë mekanizma të pakrahasueshme dhe integrale në procesin e garantimit të të drejtave të njeriut. Roli i tyre nuk është vetëm lokal e kombëtar por dhe ndërkombëtar.⁸¹ Kjo vlerë e tyre është njohur edhe nga Kombet e Bashkuara me deklaratën e 1998 “Për të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve, grupeve dhe organizmave të shoqërisë civile për të promovuar dhe mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të njohura universalisht”.⁸² Kjo deklaratë mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut është themelore, pasi përcakton një numër parimesh dhe rregullash të vendosura për të garantuar aktivizimin me qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe aksesin në drejtësi.⁸³

Mënyrat se si OJFtë realizojnë qëllimet e tyre janë të shumta. Kështu, një prej tyre është edhe ushtrimi i presionit ndaj organeve politikëbërëse ose lobimi, nëpërmjet të cilave ato arrijnë të kenë sukses duke u përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Praktika ka provuar që OJF-të shpesh mund të jenë më efikase se institucionet publike në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi ato operojnë më shpejt, pa burokraci dhe pa u kujdesur shumë për efektet politike të aksionit të tyre.⁸⁴ Nga ana tjetër, institucionet qeveritare janë burokratike dhe hallkat vendimmarrëse janë të shumta gjë që zgjat procesin në kohë por edhe ul ndjeshmërinë e publikut për vendimmarrjen për shkak

⁸¹ Shih për shembull mbi rolin e OJFve në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, William Korey, *NGOs and the Universal Declaration of Human Rights: a curious grapevine*, Palgrave, New York, 2001.

⁸² Shih tekstin e deklaratës në: <http://www.unhchr.ch/huridocda/huridoca.nsf/%28symbol%29/a.res.53.144.en>

⁸³ Kështu për shembull N. 9 i Deklaratës shprehimisht, i referohet këtij aspekti.

⁸⁴ Duke iu referuar shembujve të rajonit tonë, mund të përmendet shoqata ‘Vasa Prava’ [përkth: Të drejtat tuaja] e Bosnje-Hercegovinës, e cila e krijuar në vitin 199, që vetëm përgjatë vitit 2004 kishte ndërmarrë 77,338 veprime ligjore, përfshirë këtu këshilla ligjore, paraqitje ankimesh administrative, padish ligjore në gjykatë, kërkesash pranë organizmave për respektimin e të drejtave të njeriut, etj.. Shih Miroslav Misanovic, ‘Civil Society in Bosnia and Hercegovina: Lost in transition’, fq. 44, në Wolfgang Benedet, ed., *Civil Society and Good Governance in Societies in Transition*, Beograd, 2006.

të humbjes së aktualitetit.⁸⁵ Veprimtaria e OJF-ve nuk mbetet vetëm tek aspekti i iniciativave politike dhe sociale por lidhet edhe me ekzistencën dhe përdorimin e mekanizmave efektivë ligjorë. Është pranuar tashmë se individët, grupet dhe shoqatat kanë të drejtë dhe përgjegjësi të promovojnë respektimin e tyre në praktikë. OJF-të luajnë një rol të rëndësishëm në artikullimin konkret të nevojave apo detyrimit të plotësimit të mangësive në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut në rrafshin kombëtar dhe rajonal, duke asistuar ata, të cilët nuk mund të flasin vetë ose ata që nuk dëgjohen nga autoritetet përgjegjëse.⁸⁶

Detyrimi primar për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut i takon shtetit. Gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare, ligjvënësi dhe institucione të tjera publike janë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ato mundësojnë realizimin efektiv të të drejtave themelore nëpërmjet mekanizmave mbrojtës kundër shkelësve të të drejtave.⁸⁷ Pavarësisht se mjetet e përmendura më lart, janë më të efektshme dhe produktive, edhe shfrytëzimi i mjeteve ligjore efektive si ngritja e padisë në gjykatë apo edhe paraqitja e kërkesave në Gjykatë Kushtetuese janë të parashikuar në legjislacionin vendas si mekanizma që i përkasin edhe organizatave jo-fitimprurëse, sigurisht duke përcaktuar edhe rregullimet përkatëse, që do të thotë edhe kufizimet përkatëse të përdorimit.⁸⁸ Legjislatori ka krijuar kështu mundësinë që OJF-të të ngrenë padi në gjykatë apo të bëjnë kërkesa në Gj. K për adresimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut. Krijimi i mundësive të tilla ligjore si njohja e të drejtës për të ngritur padi, apo paraqitur kërkesa pranë Gj. K, është reflektim i pozitës juridike të tyre që synon të adresojë interesat kolektive.

⁸⁵ Allison Brysk, *Globalization and Human Rights* (2002) fq.14.

⁸⁶ Peter Willetts, *What is a Non-Governmental Organisation?* në: *UNESCO Encyclopedia Life Support Systems*, fq.17.

⁸⁷ Neni 15/2 i Kushtetutës shqiptare parashikon detyrimin e organeve të pushtetit publik që të respektojnë dhe kontribuojnë në realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

⁸⁸ Shih më lart referimet ligjore në Kushtetutë.

- Natyra e OJF-ve dhe angazhimi nëpërmjet aksesit në drejtësi për çështje të të drejtave të njeriut

OJF-të, si organizime të lira dhe vullnetare janë në vetvete shprehje e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ato që në momentin e themelimit reflektojnë lirinë e organizimit dhe të asociimit, e cila si një nga liritë themelore garantohet jo vetëm duke i siguruar kushtet e përshtatshme për t'u krijuar por edhe për të shpalosur qëllimet e organizimit të tyre gjatë gjithë aktivitetit.⁸⁹ Kushtetuta jonë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar sanksionojnë të drejtën e organizimit kolektiv të individëve për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, çka nënkupton se çdo person mund të bashkohet me të tjerët, me vullnet të lirë dhe pa ndërhyrjen e shtetit për të arritur një qëllim të përbashkët dhe të ligjshëm.⁹⁰ Edhe qëndrimi i GJEDNJ ka shkuar në drejtimin se qytetarët duhet të jenë të lirë të krijojnë një entitet ligjor për të vepruar kolektivisht në një fushë interesi të përbashkët, si pjesë e rëndësishme e lirisë së asociimit, pa të cilën ajo e drejtë nuk do të kishte kuptim.⁹¹

Megjithatë, jo të gjitha organizatat janë shoqata ose organizime në këtë kontekst. Organizatat paraqiten në forma të ndryshme të organizimit të brendshëm të tyre, e cila reflektohet natyrshëm edhe në aktivitetin që ato realizojnë. Kështu p.sh. nëse organizatat janë krijuar me baza dhe interesa profesionale, atëherë edhe sfera e të drejtave që ata mbrojnë ose promovojnë duhet të ketë të bëjë me liritë dhe të drejtat që lidhen me ushtrimin e profesionit. Në Shqipëri, i pari organizim që u krijua pas vitit 1991 ishte Forumi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në janar 1991, i shndërruar në Komitetin Shqiptar të Helsinkit, aktiviteti i të cilit në përdorimin e mjeteve të drejtësisë për adresimin në rrugë ligjore të të drejtave të njeriut ka qenë aktiv krahasuar me atë të OJF-ve të tjera në vend.⁹² Nëse organizatat kanë tjetër profil ose

⁸⁹ Omari/ Anastasi, *E drejta kushtetuese* (2008) fq.120.

⁹⁰ Neni 46 i Kushtututës shqiptare.

⁹¹ Çështja *Sidiropulor k. Greqisë*, 10 korrik 1998; *Sigurjonsson k. Islandës*, 30 qershor 1993; *Maestri k. Italisë*, 17 shkurt 2004.

⁹² Shih: www.ahc.org.al/

mbrojnë interesa të natyrave të ndryshme, atëherë duhet parë se çfarë kategorie të drejtash dhe lirish ato kanë në qendër të aktivitetit të tyre. Praktika dhe doktrina mbizotëruese (jo vetëm në Evropë por edhe në SHBA) pranon se personat juridikë, ku përfshihen edhe OJF-të, nuk mund të gëzojnë të drejta që lidhen direkt me natyrën e personit fizik dhe si të tilla nuk mund t'i kërkojnë gjyqësisht.⁹³ P.sh një person juridik nuk mund të pretendojë gjyqësisht se nga një akt i pushtetit publik i cenohet e drejta e jetës ose e drejta për të mos dëshmuar kundër vetes në një proces gjyqësor. Ky qëndrim bazohet tek argumenti se këto të drejta janë të natyrës individuale dhe duhen pretenduar individualisht edhe në rrugë gjyqësore dhe jo nga OJF-të.⁹⁴ Ka edhe të drejta që ushtrohen si individualisht ashtu edhe kolektivisht, si p.sh e drejta e informimit ose liria e shprehjes dhe e medias. Detyrimi i ankuesit në raste të tilla është të shpjegojë lidhjen midis personit juridik dhe të drejtës që atij si i tillë dhe jo si grup individësh i cenohet nga akti. Kështu p.sh një shoqatë që mbron median e lirë mund të pretendojë cenimin e lirisë së shprehjes dhe të të drejtës për të informuar të tjerët (publikun) nëse kërcënohet nga masa ekonomiko-financiare që ndërmerret qeveria në një moment të caktuar ndaj organeve të shtypit. Për inicimin e një gjykimi kushtetues nuk është mjaftueshme të pretendosh se cenohen interesa të përgjithshme të anëtarëve të grupimit konkret. Duhet të specifikohet interesi i posaçëm i anëtarëve të grupimit (kupto: OJF), i cili duhet të dallojë qartë nga interesi i përgjithshëm.

Pa dashur të ndalemi tek çështja e legjitimitetit të OJF-ve në gjykimin kushtetues, si një temë e trajtuar nga pjesëmarrësit në këtë aktivitet, vlen të theksohet se arsyeja përse duhet të fokusohemi tek aktiviteti i OJF-ve dhe promovimi i të drejtave kolektive dhe individuale përkatëse ka të bëjë *së pari* me kategorinë e të drejtave

⁹³ Winfried Brugger, *Grundrechte und Verfassungsgerichtsbarkeit in den Vereinigten Staaten von Amerika* (1987) fq.24.

⁹⁴ Shih çështjet *Couch k. Shteteve të Bashkuara*, 409 U.S 322, 328 (1973); *Shtetet e Bashkuara k. Martin Linien Supply Co*, 430 U.S 564 (1977).

që ato mund të promovojnë dhe *së dyti* me vlerësimin e shkallës së mbrojtjes së këtyre të drejtave prej tyre. P.sh një shoqatë që mbron interesat ekonomikë të anëtarëve të saj kundërshton një akt normativ si antikushtetues thjesht për faktin se vendos tarifa më të larta (taksa, tatime etj.) mbi artikujt që ata prodhojnë ose importojnë.

Gjithashtu, një tjetër çështje që ka lidhje me aksesin e OJF-ve në drejtësi është e lidhur ngushtë me realitetin në të cilin krijohen OJF-të, kapacitetet që ato kanë si dhe me infrastrukturën përfshirë këtu edhe ekzistencën ose jo të lehtësive për të aksesuar mekanizmat e drejtësisë. OJF-të shqiptare reflektojnë po atë problematikë që reflektojnë ato rajonale. Në një studim mbi kontributin e shoqërisë civile në Ballkanin në tranzicion përshkruhen realitete të ngjashme të cilat flasim për shoqëri civile të dobëta, jo të formuara, me probleme financiare dhe që orientohen shumë në veprimtarinë e tyre nga donatorët në këtë rajon. Kjo lloj situatë shfaqet e ngjashme edhe në Shqipëri. në një studim mbi zhvillimet e shoqërisë civile në vendin tonë, theksohen katër faza zhvillimi të OJF-ve:

- tranzicioni i hershëm (1991-1996)
- periudha e krizës (1997-2001)
- periudha post-krizë dhe maturimi i OJF-ve (2002-2005), dhe
- periudha e rrëzimit/shkarjes së OJF-ve (2005 - vijim).

Aktualisht në Shqipëri rezultojnë të regjistruara mbi 1500 OJF⁹⁵ edhe pse jo të gjitha janë operative. Këto OJF sipas të dhënave janë të angazhuara kryesisht me çështje të të drejtave të njeriut: 43% e OJF-ve janë të angazhuara me çështje të të drejtave të njeriut, 12% me promovimin e demokracisë, 12% me zhvillimin ekonomik, 10% çështje të mjedisit dhe trashëgimisë, 6% janë think-tank dhe 17% me të tjera çështje.⁹⁶ Ky tregues flet për faktin që OJF-të për nga vetë shpërndarja e veprimtarisë së tyre janë më shumë të

⁹⁵ E dhënë sipas listës së OJFve të regjistruar pranë strukturave tatimore. Shih: www.fint.gov.al/doc/Lista%20e%20OJF%20.xls

⁹⁶ Të dhëna të marra nga Studimi i Qendrës për Promovimin e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), *Third Sector Development in Albania: challenges and opportunities*, fq. 32. Shih në <http://www.euclidnetwork.eu/data/files/albania1.pdf>, aksesuar në qershor 2011.

orientuara drejt çështjeve të drejtave të njeriut në vend. Mendojmë që ky tregues flet edhe për nevojën për të adresuar çështjet me të cilat përballet realiteti në vend, qoftë ky në këndvështrim të vetë OJF-ve, apo edhe të donatorëve që mbështesin veprimtarinë e tyre. E themi këtë të fundit sepse të dhënat e studimet tregojnë se veprimtaria e OJF-ve në vend, ashtu si në të gjithë rajonin e Ballkanit, është e orientuar shumë nga donatorët kryesisht ndërkombëtarë.⁹⁷ UNDP me Indeks in mbi Qëndrueshmërinë e OJF-ve në vend na tregon se nga një shkallë 1/7 (ku 1 është performanca më e mirë dhe 7 më e dobëta), qëndrueshmëria e OJF-ve vendase nga viti në vit ka variuar në shifra mesatare, me një tendencë përmirësimi pas vitit 2005 në vijim edhe pse kjo tendencë ka parë stanjacion në këtë periudhë.⁹⁸ Ky përmirësim mund të ishte reflektuar edhe në përdorimin e mjeteve ligjore nga ana e OJF-ve për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, ndërkohë që çështjet e ngritura në gjykatë nga këto OJF nuk janë të shumta, pa mohuar këtu aspak që disa prej çështjeve që janë ngritur kanë qenë me rëndësi jo të vogël për zhvillimin e demokracisë në vend. Edhe pse shembujt mund të numërohen në disa në çdo vit, të paktën në Gjykatën Kushtetuese, gjithsesi ajo që mund të thuhet është që edhe njohuritë që kërkohen për të ngritur një çështje pranë Gjykatës Kushtetuese janë profesionale, po ashtu edhe në gjykatë. Kjo do të thotë që vetë OJF-të duhet të gëzojnë në radhët e tyre një farë shkalle të profesionalizmit në fushën e drejtësisë. Gjithashtu, edhe aspekti financiar, si për shembull kostot

⁹⁷ *Ibid.*

⁹⁸ Tabela e mëposhtme tregon Indeks in e Qëndrueshmërisë së OJFve në Shqipëri:

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi i qëndrueshmërisë së OJFve	4.2	4.8	4.6	4.6	4.3	4.1	3.9	3.9	3.9	3.8	3.8	3.9
Mjedisi Ligjore	4	4	4	4	3.6	3.5	3.4	3.6	3.6	3.6	3.7	3.8
Kapacitetet Organizative	4	5	5	5	4.5	4.2	4	3.9	3.9	3.9	3.9	3.9
Aftësia Financiare	5	5	5	5	4.8	4.6	4.5	4.5	4.6	4.5	4.5	4.6
Advocacia	4	4	4	3	3.9	3.6	3.4	3.3	3.3	3.3	3.4	3.4
Ofrimi i shërbimeve	5	5	5	5	3.9	4	3.9	3.9	3.9	3.9	3.7	3.7
Infrastruktura	5.5	5.5	5	5	4.6	4.4	4.2	4.1	3.9	3.9	3.9	4
Imazhi publik	4	5	4.5	5	4.6	4.5	4.2	4	3.9	3.8	3.8	3.8

Burimi: UNDP, http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/ Akseluar në qershor 2011.

e askesit të gjykatës apo të Gjykatës Kushtetuese mund të paraqitet si pengesë jo e përballeshme nga çdo OJF në vend. Megjithëse paraqitja e një ankimi kushtetues para Gjykatës Kushtetuese, ndryshe nga paraqitja e një padie/ankimi në gjykatat e zakonshme, nuk ka asnjë tarifë financiare, për OJF mund të paraqiten kosto të tilla si: kosto udhëtimi (kur qendra e OJF nuk është në Tiranë), pagesa e një eksperti/avokati të së drejtës kushtetuese etj. Duke konsideruar që raportet flasin për një stanjacion të aftësisë financiare dhe për mbështetje të OJF ve nga donatorët, pra edhe orientim të veprimtarisë së tyre nga interesat e këtyre të fundit, si dhe duke konsideruar që kostot e studimit të çështjet dhe përgatitjes për të, apo edhe të vlerës së padisë nuk janë të pakonsiderueshme, mund të thuhet që ky element ndikon deri diku si frenues në aksesin në drejtësi të OJF-ve.

- Aktivizimi i OJF-ve në vend

Siç u përmend, rastet e përdorimit të mjeteve ligjore nga OJF të nuk mungojnë edhe pse nuk janë të shumta. Mund të thuhet për shembull se vitet e fundit në praktikën e GJK është vënë re një rritje e numrit të kërkesave të ardhura nga OJF që kundërshtojnë akte të ndryshme normative (kryesisht ligje dhe akte nënligjore të KM), të cilat kanë pasur sukses në masë të konsiderueshme. Duke iu referuar vetëm 2 viteve të fundit 2009-2010, gjatë të cilëve GJK ka gjykuar 11 kërkesa të paraqitura nga OJF,⁹⁹ vërejmë se vetëm në 3 prej tyre janë elaboruar të drejta themelore të individit si liria e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike (shoqata e distributorëve farmaceutikë),¹⁰⁰ e drejta për të përfituar sigurime shoqërore (ushtarakët)¹⁰¹ dhe e drejta për punë dhe për t'u zgjedhur (lustracioni)¹⁰². Në rastet e tjera kanë qenë kryesisht pretendime

⁹⁹ Shih Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (2009), Shtypshkronja 'Grand Prind', Tiranë 2010; si dhe Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (2010), Shtëpia Botuese Ilar, Tiranë, 2011.

¹⁰⁰ Vendimi i GJK Nr. 28/2010.

¹⁰¹ Vendimi i GJK Nr. 33/2010.

¹⁰² Vendimi i GJK Nr. 9/2010.

që lidhen me parime kushtetuese të funksionimit të shtetit (ndarja e pushteteve, pavarësia e gjyqtarëve)¹⁰³ ose të elementëve të veçantë të organizimit të brendshëm të shoqatave (tarifa e provimit të avokatisë)¹⁰⁴ pa dyshim edhe këto po aq elementë të rëndësishëm edhe për vetë garantimin e të drejtave themelore të njeriut dhe mbarëvajtjen e një shteti të së drejtës.

Vlejnë për t'u përmendur edhe ankimet administrative apo paditë në gjykatë të paraqitura nga OJF të ndryshme. Duke mos pretenduar aspak që ky përshtkrim është shterues, mund të përmendim veprimtarinë e vazhdueshme të Komitetit Shqiptar i Helsinkit¹⁰⁵ sidomos pranë Gjykatës Kushtetuese për të drejtën e votës së personave të cilëve u është hequr liria, transparencën dhe privatësinë e disa kategorive të punësuar në administratën publike etj.¹⁰⁶ Gjithashtu, veprimtaria e Qendrës për Iniciativa Ligjore e Qytetare që vetëm përgjatë viteve 2008- 2009 ka ofruar shërbime ligjore për rreth 207 klientë përfshirë edhe përfaqësime në gjykatë, ka qenë konsistente në këtë ofrim shërbimesh ligjore sidomos grave e vajzave të dhunuara.¹⁰⁷ Më tej, mund të përmendim Qendrën Res Publica dhe Shoqatën e Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit¹⁰⁸ në lidhje me çështjen e Gërdecit apo të Romëve strehimet e të cilëve në periferi të Tiranës u dogjën në pranverën e këtij viti,¹⁰⁹ apo atë të Shoqatës së Gjyqtarëve për aspekte të lidhura me pavarësinë e

¹⁰³ Vendim i GJK Nr. 11/2010.

¹⁰⁴ Vendim i GJK Nr. 7/2010.

¹⁰⁵ Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka qenë ndër të parat organizata që kanë guxuar të sfidojnë edhe akte të rëndësishme para GJK, si p.sh dispozita të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurave Penale si dhe ligje të tjera të rëndësishme (ligji për lustracionin, ligji antimafia etj). Kjo organizatë, e njohur për aktivitetin e saj në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore, ka qenë mjaft aktive në drejtim të gjykimit kushtetues.

¹⁰⁶ Shih në <http://www.ahc.org.al/> dhe për vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese shih në [www.gjk.gov.al/si për shembull Vendimi i GjK Nr. 9/2010, apo Vendimi Nr. 20/2006, Vendimi Nr. 16/2004, etj.](http://www.gjk.gov.al/si_për_shembull_Vendimi_i_GjK_Nr._9/2010_apo_Vendimi_Nr._20/2006_Vendimi_Nr._16/2004_etj)

¹⁰⁷ Shih <http://www.qag-al.org/>

¹⁰⁸ Shih në <http://respublicalb.com/?catè3>

¹⁰⁹ Shih informacionin në <http://www.soros.al/2010/article.php?idè302>

paanësisë e gjyqësorit,¹¹⁰ ose kërkesat e Shoqatës 'Pronësi më Drejtësi' ajo e Shoqatës së Qiramarrësve të shtëpive shtetërore ish pronë private, në lidhje me të drejtën e pronësisë,¹¹¹ apo Shoqata e Ish të Burgosurve Politikë të Shqipërisë dhe Shoqata e Internim-Dëbimeve. Pra, përmbledhtazi mund të thuhet se OJF të kanë ngritur para gjykatave të të gjitha niveleve çështje me mjaft ndjeshmëri sociale gjë që tregon një rritje të angazhimit të tyre duke shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të njohura nga legjislacioni, pavarësisht rezultatit konkret të arritur.

- Sindikatat

Një tjetër çështje e debatuar sot në lidhje me aktivizimin e OJF në gjykimin kushtetues është nëse do të konsiderohen si OJF në kuptimin e promovimit të të drejtave të njeriut edhe sindikatat apo bashkimet profesionale (dhoma e avokatisë, noterisë, shoqatat e gjyqtarëve etj). Mbrojtja e interesave profesionalë dhe ekonomikë jo gjithmonë mund të lidhet direkt me garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kështu dallimi është i dukshëm midis kundërshtimit të një ligji për shkak të cenimit të së drejtës për të përfituar sigurime shoqërore (rasti i ushtarakëve)¹¹² dhe kundërshtimit të një ligji, i cili përcakton mënyrën se si do të organizohet apo kontrollohet ushtrimi i një veprimtarie të caktuar (ekspertët kontabël).¹¹³ Megjithëse interesi i anëtarëve të të dyja organizatave është i prekur direkt, ngritja e pretendimeve në nivelin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese në gjykimin kushtetues është e ndryshme. Në disa vende organizimet profesionale nuk konsiderohen si OJF, pasi ato janë të kufizuara në veprimtarinë e

¹¹⁰ Shih për shembull Vendimi i GjK Nr. 111/2011.

¹¹¹ Shih për shembull Vendimin e GjK Nr. 5/1997, Nr. 11/2011, etj. Përmendja e këtyre rasteve nuk lidhet drejtpërdrejt në këtë rast me rezultatin e gjykimin, për me faktin që një shqetësim kolektiv është paraqitur në hallkat e duhura të drejtësisë për të gjetur zgjidhje, një aspekt ky i rëndësishëm në vetë forcimin e shtetit të të së drejtës. Gjithsesi duhet pranuar që raste të tilla nuk janë të shumta.

¹¹² Vendimi i GjK Nr. 33/2010.

¹¹³ Vendimi i GjK shqiptare Nr. 3/2010.

tyre dhe mënyra se si ato garantojnë liritë e veta është e ndryshme nga ajo e OJF, aq më shumë kur bëhet fjalë për gjykimin kushtetues¹¹⁴. GJK shqiptare nuk ka pasur dilema të tilla, ajo ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga sindikatat duke i trajtuar ato si “organizata të tjera” në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.¹¹⁵

- Analizë e disa çështjeve konkrete në lidhje me aksesin në drejtësi të OJF-ve

Në angazhimin e OJF-ve për përdorimin e mjeteve ligjore një aspekt i rëndësishëm ka të bëjë me vetë qëndrimin që gjyqësori apo Gjykata Kushtetuese ka mbajtur ndaj legjitimitit të OJF-ve. *Actio popularis* në gjykatë edhe pse i njohur për shembull nga Konventa e Aarhusit (edhe e drejtë themelore sipas Kushtetutës për të marrë informacion për mjedisi), apo sipas Kodit të Procedurës Civile gjithsesi nuk është zbatuar shumë.¹¹⁶ Mund të përmendet ndonjë rast si për shembull ai i një grupimi qytetarësh të fshatit Rranzë, Shkodër të cilët në gjykatë kërkuan adresimin e një çështje që lidhej me gjendjen e mjedisit të tyre, por këto raste janë të pakta. Kështu që pak analizë mund të bëhet në lidhje me qëndrimet e gjykatës ndaj kërkesave të grupimeve apo të OJF-ve për adresimin e çështjeve të të drejtave të njeriut.

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese ka preferuar të mos analizojë gjerësisht veprimtarinë e organizatave për t’i legjitimuar në kërkimet

¹¹⁴ Kështu p.sh GJKF gjermane ka konsideruar se Kushtetuta mbron lirinë e organizimit vetëm në thelbin e saj, liria e organizimit nuk garanton një hapësirë veprimi të pakufizueshëm për nga përmbajtja, e personave dhe bashkimeve që hyjnë në sferën e mbrojtjes kushtetuese. Shih për më tepër vendimin BverfGE 50, 290 në: Vendime të përzgjedhura të GJKF gjermane (2010) fq. 318.

¹¹⁵ Ka debate sa i takon përkufizimit të termit “organizata të tjera”, ku qëndrimi mbizotërues është se me këtë term duhet të kuptohen organizata me karakter politik, përveç partive politike që janë të parashikuara shprehimisht.

¹¹⁶ Në lidhje me pjesëmarrjen e publikut për çështje të mjedisit REC Albania, një organizatë e cila adreson çështjet e mjedisit në vend, edhe pse ka botuar shumë dhe zhvilluar trajnime të shumta, pak ose më mirë të themi aspak nuk është angazhuar me adresimin e këtyre çështjeve në gjykatë. Shih <http://albania.rec.org/index.asp>

e tyre. GJK është mjaftuar vetëm me statutin e tyre, pra nëse në të është përfshirë e drejta që ata pretendojnë si të cenuar dhe nëse janë regjistruar sipas ligjit.¹¹⁷ Gjithashtu Gj. K i ka konsideruar njohur OJF-ve edhe të drejtën për t'iu drejtuar asaj jo vetëm si organizata të tjera sipas N. 134, germa e, por edhe sipas N. 131, germa f, pra për shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt.¹¹⁸ Arsyeja për këtë qëndrim të GJK mendojmë se duhet kërkuar tek prirja e kësaj të fundit për të zgjeruar mundësinë e kundërshtimit të akteve normative para saj, duke qenë se individit vetë i ka mundësitë mjaft të kufizuara për ta bërë një gjë të tillë. Kjo praktikë e GJK është për t'u përshëndetur, pasi efektet e saj kanë qenë pozitive sa i takon mbrojtjes së shtetit të së drejtës dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Megjithatë mendojmë se ka vend për debate doktrinare sa i takon subjekteve që i promovojnë këto të drejta dhe mënyra e realizimit të tyre në aspektin e legjitimitetit kushtetues.¹¹⁹

Një tjetër problem i vënë re në disa raste gjatë gjykimit kushtetues ka qenë edhe mbrojtja fragmentare e të drejtave dhe lirive të njeriut nga shoqatat. Në disa raste, kur rrethi i subjekteve interesat e të cilëve mbrojnë është mjaft specifik, ekzistojnë më shumë se një OJF krijuar si organizime të këtij rrethi subjektesh. Këto OJF nuk kanë pasur koordinim dhe një përfaqësim cilësor gjatë kontrollit kushtetues. Kështu, në një rast janë paraqitur dy shoqata për mbrojtjen e interesave të ish-ushtarakëve të liruar, një prej të cilave kundërshtonte ligjin për pensionet e ish-ushtarakëve si antikushtetues, ndërsa tjetra kërkonte mosmarrjen parasysh të kërkesës dhe fillimin e zbatimit të menjëhershëm të ligjit në fjalë pasi e kundërta do të shkelte interesat e tyre.¹²⁰ Ndërkohë një shoqatë e tretë kërkoi pjesëmarrjen në gjykim me cilësinë e kërkuarit me arsyetimin se edhe ajo mbronte interesat e ish-ushtarakëve. Natyrisht,

¹¹⁷ Shih vendime të GJK shqiptare Nr. 36/2007; Nr. 9/2008; Nr. 25/2008.

¹¹⁸ Shih edhe Vendimin e GjK Nr. 39/2003.

¹¹⁹ Në shumicën e çështjeve që iniciohen para GJK nga organizatat, subjektet e interesuara kontestojnë kërkesën e tyre duke u bazua fillimisht tek moslegjitimiteti i tyre për t'iu drejtuar GjK.

¹²⁰ Vendim i GjK Nr. 9/2007.

në një shtet demokratik nuk mund të kufizohet numri i shoqatave që mbrojnë të drejta të caktuara, por për të pasur një rezultat pozitiv në përpjekjet për të kundërshtuar akte normative potencialisht antikushtetuese nevojitet një koordinim më i mirë mes tyre.

Gjithashtu, ka pasur raste kur OJF-të që kanë vënë në lëvizje GJK kanë qenë regjistruar ose krijuar si të tilla me vendim gjykatë vetëm disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit që kanë ankimuar në GJK (p.sh forumi i mendimit të lirë, ligji për arsimin e lartë).¹²¹ Në pamje të parë kjo çështje duket e lidhur drejtpërdrejt me legjitimitimin e tyre para GJK, por pavarësisht se në aspektin e gjyqimit kushtetues është e tillë, për t'u theksuar është nëse qëllimi i krijimit të OJF është promovimi dhe mbrojtja e vazhdueshme e të drejtave të njeriut apo një synim sporadik dhe spontan? Pasja e një aktiviteti të shtrirë në kohë dhe hapësirë e OJF, si kusht për të iniciuar një gjykim kushtetues, nuk është e lidhur me legjitimitimin thjesht e vetëm për të kufizuar rastet e ankimit kushtetues. Ajo mbështetet tek fakti se natyra, qëllimi i krijimit dhe ekzistenca e OJF si e tillë duhet të jetë në të vërtetë promovimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut dhe për këtë të ketë tregues objektiv dhe të matshëm që e provojnë një gjë të tillë. OJF nuk krijohen për të realizuar një ose disa projekte të financuara me një qëllim të caktuar dhe pastaj të zhduken në harresë. Ato krijohen për të promovuar vazhdimisht të drejtat e njeriut pavarësisht pengesave apo interesave politike në një periudhë të caktuar kohore. E kundërta do të nënkuptonte ose instrumentalizimin e OJF për interesa politike, ose arritjen e perfeksionit në mbrojtje të të drejtave të njeriut në një shoqëri, ku aktiviteti i OJF nuk do të konsiderohej më i nevojshëm. Kjo e dyta ka pak gjasa të jetë e vërtetë edhe në shoqëritë më demokratike.

¹²¹ Vendimi i GJK Nr. 9/2008. Një nga kërkuesit ishte edhe Qendra "Forumi i mendimit të lirë" e krijuar vetëm disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit për arsimin e lartë, i cili ishte objekt shqyrtimi. Ky fakt nuk u mor në shqyrtim nga GJK, e cila e legjitimoi edhe këtë subjekt në kërkimet e tij.

- Përfundime/ Sugjerime

Duke përfunduar, vlen të theksohet se OJF që kanë në thelb të aktivitetit të tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të jenë më vigjilente dhe aktive edhe sa i takon shfrytëzimit të mjetit juridik që i ka njohur Kushtetuta, pra të adresimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut si në gjykatë ashtu edhe para Gjykatës Kushtetuese në përputhje me normat ligjore në fuqi. Duhet të pranojmë se ky rol, pavarësisht se ende i vogël, ka njohur rritje sasiore dhe cilësore nga viti në vit, të paktën para Gjykatës Kushtetuese. Natyrisht, këtë fakt duhet t'ia atribuojmë OJF-ve por edhe vetë GJK, e cila në vendimmarrjen e saj jo vetëm është treguar mjaft krijuese në interpretimin e dispozitave konkrete të kushtetutës dhe të ligjit organik të saj duke i hapur rrugën OJF (dhe jo vetëm atyre) për të kundërshtuar akte të pushtetit publik, por ka vendosur edhe standarde gjithmonë e më të larta kundrejt organeve shtetërore në garantimin e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, e shohim me mjaft optimizëm rritjen e rolit aktiv të OJF në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri edhe sa i takon kundërshtimit të akteve normative të pushtetit publik para GJK. Madje, bazuar në analizën e mësipërme sugjerojmë që roli i OJFve të jetë më aktiv pikërisht nisur nga fakti që ato kontribuues të rëndësishëm në forcimin e shtetit të së drejtës në vend.

Gjithashtu, mendojmë që duhet njohur shumë mirë situata për të kuptuar se cilat janë pengesat reale në përdorimin e mjeteve ligjore nga ana e OJF-ve. Analizat e zhvilluara na sugjerojnë që këto pengesa kanë të bëjnë së pari me të qenit të dobët të vetë OJF-ve dhe orientimit të punës së tyre nga interesat e donatorëve dhe jo domosdoshmërisht nga interesat e grupeve të çështjeve që përfaqësojnë këto OJF. Kjo do të thotë që vetë OJF-të duhet të kuptojnë që vijimi i rrugës së tyre do të jetë i pamundur nëse angazhimi do të jetë i kushtëzuar nga thirrje për aplikime të paraqitura vetëm nga donatorët. OJF-të duhet të kenë një strategji zhvillimi të tyre për të mundur konsistencë e qëndrueshmëri të punës.

Po ashtu, duhet të theksojmë se nevojitet bashkëpunim dhe

koordinimin i mi i punës dhe angazhimit të veprimtarisë së vetë OJF-ve. Raste e kundërshtive mes tyre pa dyshim janë të mirëpritura (kjo madje mund të shihet qartazi si tregues i demokracisë që ekziston në vetë shoqërinë civile), por gjithsesi përfaqësimi i interesit kolektiv duhet të jetë sa më i pjekur dhe menduar mirë dhe kjo pa dyshim kërkon mirë-koordinimin mes vetë OJF-ve.

Së fundi, sugjerojmë që edhe pengesat me karakter ligjor apo administrativ të analizohen nga këndvështrimi i të qenit të tyre pengesë në ushtrimin e veprimtarisë së OJF-ve edhe në aspektin e aksesit të drejtësi. Kështu, për shembull, vlerat e padive, në rastin kur OJF-të adresojnë një shkelje të të drejtave të njeriut mund të rishikohen me qëllim ofrimin e lehtësive për përdorimin e këtyre mjeteve nga vetë OJF-të.

BIBLIOGRAFIA

- Allison Brysk, *Globalization and Human Rights* (2002).
- Peter Willetts, *What is a Non-Governmental Organisation?* në: UNESCO Encyclopedia Life Support Systems.
- Qendra për Promovimin e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), *Third Sector Development in Albania: challenges and opportunities*
- Winfried Brugger, *Grundrechte und Verfassungsgerichtsbarkeit in den Vereingniten Staaten von Amerika* (1987).
- William Korey, *NGOs and the Universal Declaration of Human Rights: a curious grapevine*, Palgrave, New York, 2001.
- Wolfgangn Benedet, ed., *Civil Society adn Good Governance in Societies in Transition*, Beograd, 2006.
- Omari/Anastasi, *E drejta kushtetuese* (2008).
- Vendime të Gjykatës së Lartë të SHBA-së: Couch k. *Shteteve të Bashkuara*, 409 U.S 322, 328 (1973); *Shtetet e Bashkuara k. Martin Linien Supply Co*, 430 U. S 564 (1977).

- Vendime të GJEDNJ:

Sidiropulor k. Greqisë, 10 korrik 1998; *Sigurjonsson k. Islandës*, 30 qershor 1993; *Maestri k. Italisë*, 17 shkurt 2004.

- Vendimi i GJK Gjermane BverfGE 50, 290

- Vendime të GJK shqiptare:

V-39/2003; V-16/2004; V-20/2006; V-9/2007; V-36/2007; V-9/2008; V-25/2008; V-3/2010; V-4/2010; V-7/2010; V-9/2010; V-11/2010; V-28/2010; V-33/2010; V- 111/2011.

Faqe Interneti

www.ahc.org.al/

www.fint.gov.al/doc/Lista%20e%20OJF%20.xls

<http://www.euclidnetwork.eu/data/files/albania1.pdf>

http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/

<http://respublicalb.com/?catë3>

<http://www.soros.al/2010/article.php?idë302>

www.gjk.gov.al/

<http://albania.rec.org/index.asp>

<http://www.unhchr.ch/huridocda/huridoca.nsf/%28symbol%29/a.res.53.144.en>

Denar BIBA (MA)¹²²

NDIHMESA E SHOQËRISË CIVILE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE KUSHTETUESE PËRMES GJYKIMIT KUSHTETUES NË SHQIPËRI

Hyrje

Ndonëse nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar të asaj se çfarë duhet kuptuar me *shoqëri civile*, përgjithësisht termi i referohet fushës së aksionit kolektiv në lidhje me interesa, qëllime dhe vlera të përbashkëta. Teorikisht, format institucionale të *shoqërisë civile* janë të dallueshme nga ato të *shtetit* dhe *tregut*, megjithëse në praktikë kufijtë mes tyre janë të ndërlikuar dhe të paqartë. *Shoqëria civile* është shpesh e populluar nga organizata jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, bashkime profesionale, sindikata, lëvizje shoqërore, shoqata biznesi, koalicionet dhe grupe në përkrahje të interesave të ndryshme, etj.¹²³

Nga entitetet e sipërpërmendura, do të dallojmë dhe ndalemi te organizatat jo-fitimprurëse (OJF) që ushtrojnë veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, do të konsiderohet si OJF për të drejtat e njeriut çdo entitet i shoqërisë civile përsa kohë që karakteri i tij privat nuk do të komprometohet dhe veprimtaria e tij do të udhëhiqet nga ideja e të drejtave të njeriut, sikundër janë

¹²² Këshilltar, pranë Gjykatës së Lartë të RSh, doktorant, UT.

¹²³ Përkufizim i dhënë nga London School of Economics Centre for Civil Society. Cituar nga Saif Al-Islam Alqadhafi, "The Role Of Civil Society In The Democratisation Of Global Governance Institutions", London School of Economics, London, September 2007.

parashtruar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe instrumentet e tjerë të së drejtës ndërkombëtare. Akoma më tej, një organizatë do të kualifikohet si “OJF për të drejtat e njeriut” kur ajo ka për qëllim të saj të parë mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave dhe punon për të mirën e të gjithë shoqërisë dhe jo thjesht për përmirësimin e jetës së anëtarëve të saj.¹²⁴

Duhet të kuptohet se demokracia nuk është një model që mund të kopjohet nga shtete të caktuara, por një qëllim për tu ndjekur nga të gjithë popujt. Organizatat jo qeveritare luajnë një rol thelbësor në këtë fushë. Ato mund të ndihmojnë në zhvillimin e mënyrave efektive të përhapjes së ideve për paqen dhe demokracinë. Ato mund të marrin pjesë në lindjen dhe zhvillimin e institucioneve demokratike të një vendi. Ato, gjithashtu, shërbejnë si vëzhgues vigjilentë, duke ndihmuar garantimin e respektit të demokracisë në mbarë botën.¹²⁵

Këto fjalë të ish Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, z. Boutros-Ghali, na ndihmojnë të deduktojmë veprimtaritë primare që një organizatë e shoqërisë civile duhet të ushtrojë në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut:

- Të kujdeset që të drejtat e njeriut, sikundër janë shpalosur nga e drejta ndërkombëtare, të jenë formalizuar edhe nga e drejta pozitive vendase, përmes akteve me fuqinë më të lartë;

- Të kujdeset që të ekzistojnë procedura ligjore efektive për zbatimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe që këto procedura të jenë të hapura për të gjithë;

- Të bëjë publike shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut;

- Të sigurojë ndihmë të kualifikuar ndaj viktimeve të këtyre dhunimeve.¹²⁶

¹²⁴ Martin Olz, “Non-Governmental Organisations in Regional Human Rights Systems”, (1997) 28 *Columbia Human Rights Law Review* 308.

¹²⁵ Willets (ed.), *The Conscience of the World: The Influence of Non-Governmental Organisations in the U.N. System*, London: Hurst & Company, 1996.

¹²⁶ Netherlands Organisation for International Development Co-operation (NOVIB), “Human Rights and Development”, Hague, 1991/1992.

Me të drejta të njeriut, në këtë punim do të kuptojmë kryesisht liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, sipas Kushtetutës së R. Sh (1998), të parashikuara në Krerët I-IV të saj, ato që rrjedhin nga *fryma* e Parimeve Themelore kushtetuese, dispozitave të Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut (KEDNj) e KE si dhe akteve të tjera ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.

Qëllimi i këtij punimi është identifikimi dhe marrja në analizë e ndihmesës së shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përmes gjykimit kushtetues në Shqipëri, si pjesë e veprimtarisë së tyre funksionale.

OJF në gjykimin kushtetues shqiptar

Si rregull, investimi i Gjykatës Kushtetuese është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga kërkesat apo ankimet e sjella pranë saj vetëm nga një numër i mirëpërcaktuar subjektesh (të ashtuquajturit *subjekte të legjitimuar*).

Një ndër këto subjekte është edhe “organizata”. Praktikisht, neni 134 i Kushtetutës, duke listuar subjektet që legjitimohen të investojnë Gjykatën Kushtetuese, në nënparagrafin “f” thotë shprehimisht: “partit[të] politike dhe organizatat e tjera”. Togfjalëshi është bërë mëse njëherë pjesë e debatit kushtetues dhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se “organizatat e tjera” ..., sipas nenit 134, pika 1, germa “f”, të Kushtetutës janë subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.¹²⁷ Organizatat që mund ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese mund të jenë me karakter *politik* (neni 131, shkronja “d”), *etnik, kulturor, fetar, gjuhësor* (neni 20/2), *sindikal* (neni

¹²⁷ Vendimi nr.16/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

50), *shoqëror, ekonomik, tregtar* (neni 61/4) dhe *të tjera* (neni 9/2), mjaft që organizimi i tyre të përputhet me parimet demokratike, ndërsa programet dhe veprimtaria e tyre të mos mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si dhe të mos jenë me karakter të fshehtë (neni 9/2 i Kushtetutës).¹²⁸

Kushtetuta, në nenin 131 të saj parashikon kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Ndërthurjen më të qartë mes kompetencave të Gjykatës dhe subjekteve që mund ta vënë në lëvizje atë (pasi Gjykata Kushtetuese nuk mund të vërë në lëvizje vetveten *ex officio, proprio motu*) e bën Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese të R. Sh”, përkatësisht në nenet 49, 52 dhe 71 të tij. Nga analiza e këtyre neneve, del qartë se personat juridikë privatë legjitimohen të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

a) *për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare;*

b) *për shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit dhe*

c) *për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës,*

në të tre rastet, absolutisht vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me “interesat e tyre”, kusht ky i shprehur në mënyrë eksplicite si në Kushtetutë ashtu edhe në Ligjin Organik të Gjykatës Kushtetuese.¹²⁹

Kushtetuta, ndërkohë që shprehet qartë dhe kuptueshëm në lidhje me subjekte si Presidenti i Republikës e në vijim për pikat b,

¹²⁸ Vendimi nr.17/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

¹²⁹ Gjithashtu, në bazë të nenit 16/2 të Kushtetutës, një OJF mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese edhe në lidhje me *grykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor*, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave (neni 131/f i Kushtetutës), por për qëllime të këtij punimi kjo e drejtë nuk do të detajohet më tej. Për më shumë shiko: Denar Biba, “Ankimi Kushtetues nga Persona Juridikë të së Drejtës Civile, sipas Legjislacionit Shqiptar”, E Drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore Nr.21, 2004.

c, dhe ç të nenit 134 të saj¹³⁰, duke i legjitimuar ata për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese në rastet “a”, “b” dhe “c” të përshkruara më lart, është mjaft e kursyer në shpjegim përsa u përket subjekteve si Avokati i Popullit, organizatat, etj., pasi le vend për interpretim në lidhje me nocionin “interesat e tyre”. Gjykata Kushtetuese është përpjekur që t'i japë kuptim këtij nocioni *rast pas rasti*.

Kështu, në lidhje me pikën “a” - *shqyrtimin pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare*, Gjykata në vijimësi ka legjitimuar organizatat jofitimprurëse.

Nga një hulumtim personal, më rezultoi se pas miratimit të Kushtetutës 1998, Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje në lidhje me sa më sipër në 40 raste, nga një larmi organizatash. Ndër to ka pasur entitete të shoqërisë civile me karakter thelbësisht *politik* (si p.sh. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë), *profesional* (si p.sh. Unioni i Gjuetarëve të Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë), *biznesi* (si p.sh. Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Konfederata e Industrive të Shqipërisë, etj), *organizime sindikaliste* (si p.sh. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë, etj), *grupime mbrojtëse* (si p.sh. Shoqata Kombëtare e Ushtrakeve në Rezervë, Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”, Shoqata Kombëtare Antikomuniste e Ish-të Përndjekurve Politikë, etj.), apo *entitete me funksion të spikatur mbrojtjen e të drejtave të njeriut* (si p.sh. Komiteti Shqiptar i Helsinkit).

Është momenti të theksoj se pjesa më e madhe e këtyre organizimeve të shoqërisë civile dështojnë të bien plotësisht në përkufizimin e sipërcituar të “OJF-ve për të drejtat e njeriut”, pasi nuk kanë qëllim të tyre të parë e permanent mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individëve përtej atyre që janë anëtarë të grupimit

¹³⁰ E qartë është gjithashtu edhe pika “d” e nenit 134, që referon tek neni 145: “Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese...”.

shoqëror që përfaqësojnë. Sidoqoftë, siç është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese në çështjen me kërkuues Dhoma Amerikane e Tregtisë etj, *“Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, kërkuësit janë organizata që mbrojnë interesat ekonomike të anëtarëve të tyre... . Në këtë kuptim, dispozita e atakuar ... ka të bëjë drejtpërsëdrejti me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të shoqatave kërkuëse”*¹³¹. Në mënyrë analoge mund të arsyetohet edhe për rastet kur gjykata është vënë në lëvizje për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve apo akteve të tjera normative nga shoqata të tjera në mbrojtje të biznesit apo ato me karakter profesional. Natyrisht, duke mos u konsideruar si *“OJF në mbrojtje të të drejtave të njeriut”*, nuk mund të mohohet se edhe këto grupime, përmes iniciativave të tyre kanë dhënë *a priori* ndihmë në lidhje me liri dhe të drejta individuale të listuara nga kushtetuta. Them *a priori*, pasi në realitet, shumica e këtyre iniciativave kanë rezultuar të pasuksesshme, sepse kërkesat respektive nuk janë pranuar nga Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, teorikisht gjykoj se lëvizje të tilla kanë pasur impakt në tonifikimin e muskulaturës së shoqërisë civile dhe në kualifikimin e të drejtave gjatë gjykimit kushtetues dhe të vetë këtyre strukturave të shoqërisë me këtë lloj të posaçëm gjykimi.

Vlejnë të dallohen, për specifikën e tyre grupimet që mbrojnë interesa të caktuara, si psh. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (V.31/2010), Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë (V. 9/2007 e V. 33/2010), Shoqata e Qiramarrësve në Shtëpitë Shtetërore ish-Pronë Private (V. 26/2005 e V. 11/2007), Shoqata Kombëtare Antikomuniste e Ish të Përndjekurve Politikë (V. 34/2005) e ndonjë tjetër. Këto organizime, ndonëse i janë drejtuar sporadikisht Gjykatës Kushtetuese kanë rezultuar *“fituese”*, duke vendosur relativisht gurë kilometrikë domethënës në rrugëtimin e tyre në mbrojtje të të drejtave si *siguria juridike, e drejta e pronës, e drejta e punës, barazia përpara ligjit, parimi i drejtësisë njerëzore dhe dëmshpërblimit, kompensimit dhe rehabilitimit të ish të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, etj.*

¹³¹ Vendimi nr.16/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshe nga sa më lart, në lidhje me Shoqatën Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”, ndonëse meriton të vlerësohet për përpjekjet e saj në mbrojtje të interesave të grupimit shoqëror që përfaqëson – shoqata i është drejtuar 5 herë Gjykatës Kushtetuese (V. 43/2001, V. 185/2001, V. 206/2001, V. 30/2005 dhe V. 35/2007), duhet thënë me keqardhje se ajo ka një rekord të vetin, pasi për të gjitha kërkesat është vendosur “mospranim”. Sikundër është shprehur edhe literalisht Gjykata, por edhe nga analiza personale, ky rezultat ka ardhur përtej arsyeve të tjera edhe si pasojë e nivelit të ulët të argumentimit, adresimit të problemeve jashtë afateve ligjore apo nga identifikimi i gabuar i aktit të goditur.

Një rast që duhet veçuar ka qenë marrëdhënia speciale e Gjykatës Kushtetuese me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (K.Sh.H). E përkufizoj *speciale* për një sërë arsyesh, formale dhe informale, duke qenë se kjo marrëdhënie nuk është kufizuar vetëm në rolin trupë gjyqësore-subjekt kërkuar, por ka shkuar më tej, pasi KShH në mënyrë të vazhdueshme ka qenë një lexues i vëmendshëm, promovues dhe mbështetës i pakushtëzuar i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. KShH ka qenë promotor i kontrollit kushtetues të ligjeve e akteve të tjera normative në 6 raste (V. 15/2003, V. 25/2003, V. 16/2004, V. 20/2006, V. 9/2010 dhe V. 4/2011), me një mesatare statistikore: 3 kërkesa të pranuar dhe 3 të rrëzuara.

Ndërsa ka pranuar kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit me objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale të R. Sh”, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se *“Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë e njohur për veprimtarinë e saj në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili, sipas statutit, ka si objekt dhe qëllim vëzhgimin e gjendjes lidhur me këto të drejta. Duke pasur një qëllim të tillë, ai ka statusin e një kërkuar legjitim, sipas nenit 134 të Kushtetutës”*¹³².

¹³² Vendimi nr.15/2003 i Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa në vendimin nr.16/2004, për po të njëjtin subjekt, Gjykata shprehet: *“Komiteti Shqiptar i Helsinkit është legjitimuar në paraqitjen e çështjeve analoge pranë Gjykatës Kushtetuese “për çështje që lidhen me interesat e tij”, kur konstatohet, se pretendimet e parashtruara lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, gjë që sipas Statutit të kësaj Organizate përbën edhe objektin kryesor të veprimtarisë së saj”*.

Ky është një argumentim i cili nuk ndeshet te asnjë prej vendimeve të tjera të Gjykatës me kërkues të tjerë, për legjitimitimin e të cilëve është kërkuar që interesi të jetë *i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak*. Me të drejtë krijohet përshtypja (e bazuar) se Gjykata Kushtetuese i ka dhënë KShH një status të posaçëm ndër entitetet e tjera të shoqërisë civile, duke e veçuar atë përsa i përket legjitimitimit në lidhje me (pothuajse) dhunimin e çdo të drejte a lirie themelore. Gjykoj se ky qendrim është i drejtë dhe duhet mbështetur.¹³³

Në lidhje me qëllimin e këtij punimi, në gjykimin tim vlerësoj se përsa i përket ngushtësisht kërkesave të regjistruara nga KShH në Gjykatën Kushtetuese, ndikimi i tyre në lidhje me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut është përgjithësisht pozitiv. E cilësoj në mënyrë relative, pasi çdo kërkesë ka pasur specifikat e saj, ndonjëra edhe me ndikim të dyshimtë. Nuk mund të mos rezultojë e tillë në analizë të fundit kërkesa e parë e KShH në Gjykatën Kushtetuese, me objekt shfuqizimi si antikushtetues i nenit 410/2 të KPP (me ndryshimet e kohës), i cili, sipas KShH, duke parashikuar se “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar nga *i pandehuri* në format e parashikuara nga ligji”, cenonte të drejtën për t’u mbrojtur dhe të drejtën për gjykim të çështjes në të gjitha shkallët. Kërkesa rezultoi e suksesshme për momentin pasi Gjykata Kushtetuese e pranoi atë dhe vendosi “Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në nenin 410 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Penale, të fjalëve “nga i pandehuri””¹³⁴. Vendimi shkaktoi në përplasje të fortë mes

¹³³ Së fundi ka pasur përpjekje sfiduese ndaj kësaj praktike, me argumentin që “Dispozitat e këtij ligji nuk janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj këtij subjekti dhe nuk shtrijnë efekte mbi të ose mbi anëtarët e tij, por ato as nuk e prekin atë në mënyrë të pafavorshme dhe as nuk rrezikojnë t’i shkaktojnë një dëm çfarëdo. Zbatimi i këtyre dispozitave nuk sjell asnjë pasojë mbi veprimtarinë e subjektit, sipas parashikimeve të bëra në statut”. I analizuar *ad absurdum*, ky qendrim (sipas meje i gabuar) çon në konkluzionin se p.sh. liritë dhe të drejtat njerëzore të një terroristi të arrestuar të *Al Qaeda-s*, të dhunuara gjatë procesit gjyqësor, mund të mbrohen vetëm nga ... *Al Qaeda* dhe askush tjetër!

¹³⁴ Vendimi 15/2003 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë e cila refuzoi *de facto* zbatimin e tij. Problemi është se 7 vjet më pas, me Vendimin 30/2010, Gjykata Kushtetuese, në një çështje të nisur me referim nga Gjykata e Lartë vendosi të shfuqizojë përmbajtjen që ajo vetë kishte imponuar të po të njëjtit nen (410/2 të KPP), duke pranuar se "...është e pranueshme që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar rritjen e standardeve kushtetuese. [...]. [Gj]ykata vlerëson se duhet të riinterpretojë praktikën e saj në lidhje me gjykimin në mungesë dhe sidomos në lidhje me të drejtën e të gjykuarit në mungesë, për t'u rivendosur në afat për të ankimuar vendimin e dhënë...". E thënë ndryshe: Gjykata Kushtetuese pranoi se kishte gabuar. E thënë ndryshe: ndikimi i këtij aksioni të KShH ishte në analizë të fundit në cenim të lirive dhe të drejtave individuale!

Ndër kërkesat me impakt të plotë dhe të prekshëm pozitiv të KShH në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me të drejta individuale kanë qenë ajo për shfuqizimin e tre VKM "Për shmangien e nepotizmit..." në sektorët e administratës publike¹³⁵ dhe ajo për shfuqizimin e ligjit (të ashtuquajtur) për lustracionin¹³⁶. Kërkesat rezultuan të suksesshme; Gjykata Kushtetuese në të dy rastet vendosi pranimin e tyre dhe shfuqizimin e akteve të goditur. Përmes vendimeve përkatëse të nxitura ndër të tjera¹³⁷ edhe nga KShH, Gjykata Kushtetuese siguroi garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të barazisë përpara ligjit, të drejtës për punë, të drejtës për tu zgjedhur, parimit të shtetit të së drejtës dhe ndarjes dhe balancimit të pushteteve, garancive kushtetuese të mandateve të disa funksionarëve të organeve kushtetuese dhe të gjyqësorit, etj.

Nuk duhet harruar pa përmendur edhe iniciativa e fundit e KShH me objekt shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit të ashtuquajtur "antimafia", ndonëse fatkeqësisht (sipas meje) Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën.

¹³⁵ Vendimi 20/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

¹³⁶ Vendim 9/2010 i Gjykatës Kushtetuese

¹³⁷ Në të dy rastet KShH nuk ishte subjekti i vetëm që vinte në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Në lidhje me pikën “b” - *shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit*, ndonëse si Kushtetuta, ashtu edhe Ligji Organik i Gjykatës Kushtetuese ua njuh *de jure* subjekteve “persona juridikë private” të drejtën për t’u legjitimuar në këtë kërkesë, *de facto*, për vetë natyrën e çështjeve që i nënshtrohen kontrollit paraprak, rrethi i subjekteve që praktikisht mund të iniciojnë një kontroll të tillë në Gjykatë është mjaft i kufizuar.¹³⁸ Rasti i kërkesës së Partisë Socialiste (një organizatë politike, por që gjithsesi pjesë e bashkësisë së *shoqërisë civile*), e cila me kërkesën e saj me objekt “Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën e Shqipërisë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare” është një rast unik, i jashtëzakonshëm si përsa i përket vendimmarrjes formale të Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe ndikimit të një kërkesë në historinë e një vendi. Kjo kërkesë, vetë vendimi i Gjykatës dhe pasojat e tij meritojnë të studiohen në një punim të posaçëm, ndaj edhe po e mbyll këtu, me një provokim në lidhje me legjitimitimin e subjektit, i cili, sipas meje, në atë qasje që zgjodhi për t’u afruar gjykimit kushtetuese, linte shumë për të dëshiruar porsa i përket legjitimitit *ratione materiae*.

Përsa i përket kërkesave për *interpretimin përfundimtar të Kushtetutës* (pika “c” më lart), jurisprudenca kushtetuese shqiptare nuk ka ende një rast të tillë me kërkuar një organizatë jo-fitimprurëse, ndonëse në analogji me subjektin e ngjashëm Avokati i Popullit mund të them se, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës dhe atij 71 të Ligjit “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese”, edhe një OJF mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese

¹³⁸ Kjo sepse sipas nenit 121 të Kushtetutës dhe ligjit nr.8371, datë 09.07.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, ekziston një procedurë shumë konkrete që parashikon mënyrën e lidhjes deri në ratifikimin përfundimtar të një marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë aspekt dihet se kush janë organet që merren me një veprimtari të tillë, duke filluar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave, Presidenti dhe Kuvendi.

me kërkesë për interpretimin e Kushtetutës, gjithmonë vetëm për ato çështje që lidhen me funksionin dhe qëllimin e ekzistencës së saj.

Konkluzione¹³⁹

Demokracia mund të ekzistojë vetëm nëse pushtetet shtetërore kundërpeshohen dhe kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme. Organizatat jo fitimprurëse (OJF) luajnë një rol thelbësor në lidhje me këtë. Një formë demokratike e shoqërisë mund të jetë e qëndrueshme vetëm nëse institucione si parlamenti, partitë politike dhe gjyqësori mbështesin dhe ndihmojnë në forcimin e kulturës qytetare demokratike përmes mbrojtjes dhe forcimit të lirive dhe të drejtave themelore, drejtësisë shoqërore, përgjegjësisë së ekzekutivit dhe kufizimit të tejkalimeve të mundshme të pushteteve nga ky i fundit. Po aq e rëndësishme në këtë ndërmarre historike është sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në funksionimin e demokracisë. Edhe njëherë këtu, roli i strukturave të shoqërisë civile është i pazëvendësueshëm.

Në këtë mision të saj, shoqëria civile, me entitet e saj si *partitë politike, sindikatat, grupet e biznesit, grupeve avokatore* dhe posaçërisht *OJF për të drejtat e njeriut*, kanë një instrument jashtëzakonshëm: gjykimin kushtetuese. Përmes këtij instrumenti të konsideruar si zbulimi më i madh në fushën e drejtësisë për Shek. XX, shoqëria civile mund të vendosë veten në pozita të barabarta me ekzekutivin dhe legjislativin duke i sfiduar ato në lidhje me aktet vendimmarrëse që kanë nxjerrë, e potencialisht duke siguruar shfuqizimin e këtyre akteve kur ato vijnë ndesh me parimet dhe të drejtat e parashikuara në Kushtetutë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH.

Gjatë periudhës së studiuar, organizatat/shoqatat e qytetarëve shqiptarë i janë drejtuar në një numër të konsiderueshëm rastesh Gjykatës Kushtetuese. Jo gjithmonë iniciativat e tyre kanë rezultuar të suksesshme. Mungesa e profesionalizmit lidhur me njohjen e të

¹³⁹ Konkluzionet e këtij punimi i referohen praktikës kushtetuese 1999-2011 (qershor), duke marrë si pikë fillimi në kohë hyrjen në fuqi të Kushtetutës (nëntor 1998).

drejtës kushtetuese dhe jurisprudencës së saj si dhe të Gjykatës së Strasburgut kanë qenë, ndër të tjera, shkaqe të dukshme të këtij mossuksesi. Kërkesat nganjëherë kanë qenë të cekëta dhe me pretendime gati gati naive.

Sidoqoftë, sa më shumë kohë kalon, aq më serioze dhe të argumentuara bëhen kërkesat, sikundër edhe shtohet numri i tyre. Veçoj ndër to kërkesat e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si për gjuhën e formën profesionale, ashtu edhe për objektet e spikatura në favor të garantimit dhe forcimit të të drejtave kushtetuese.

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese, në respektim të Kushtetutës dhe ligjit nuk ua ka mbyllur derën kërkesave apo ankesave të këtyre subjekteve.

Përkundrazi, është për t'u theksuar se, duke legjitimuar në vijimësi organizatat (bashkime vullnetare) në lidhje me *shqyrtimin pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare*, apo në një të ardhme (kur të paraqitet rasti) në lidhje me *interpretimin përfundimtar të Kushtetutës*, Gjykata Kushtetuese ka plotësuar edhe një "mangësi" të Kushtetutës sonë, e cila nuk i'a njeh individit këtë të drejtë.

Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, i ka shndërruar këto organizata në avokatë të të drejtave dhe lirive themelore të individit shqiptar.

BIBLIOGRAFIA

1. Saif Al-Islam Alqadhafi, "The Role Of Civil Society In The Democratisation Of Global Governance Institutions", London School of Economics, London, September 2007.

2. Martin Olz, "Non-Governmental Organisations in Regional Human Rights Systems", (1997) 28 *Columbia Human Rights Law Review* 308.

3. Willets (ed.), *The Conscience of the World: The Influence of Non-*

Governmental Organisations in the U.N. System, London: Hurst & Company, 1996.

4. Netherlands Organisation for International Development Co-operation (NOVIB), "Human Rights and Development", Hague, 1991/1992.

5. Vendimi 20/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

6. Vendimi nr. 16/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

7. Vendimi nr. 17/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

8. Vendim 9/2010 i Gjykatës Kushtetuese.

Ariana FULLANI¹⁴⁰

NDËRHYRJA NË PROCESIN CIVIL. NEVOJA PËR NJË KUPTIM TË DREJTË TË SAJ NGA ORGANIZATAT DHE SHOQATAT.

1. Hyrje.

Organizatrat jofitimprurëse (OJF) përfaqësojnë interesin publik përballë vendimmarrësve, duke kanalizuar shqetësimet, pikëpamjet dhe vlerat e publikut në përgjithësi ose të grupeve të interesit në procesin politik. Ato sigurojnë zhvillimin dhe zbatimin e politikave evropiane dhe ndërkombëtare, duke u ofruar ekspertizën e tyre politikëbërësve dhe duke identifikuar çështje të reja të cilat duhen trajtuar, si dhe propozojnë masat për zgjidhjen e tyre. Duke qenë se qytetarët kanë pak ndikim mbi strukturat që rregullojnë jetën e tyre, janë OJF-të ato, të cilat ngushtojnë hendekun midis të qeverisurve dhe qeverisësve përmes ndërgjegjësimit publik mbi qëllimet, politikat dhe veprimet në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, OJF-të inkurajojnë dhe mundësojnë qytetarët të fuqizohen e të përfshihen në proceset politike dhe vendimmarrëse, të cilat ndikojnë në jetën e tyre. OJF-të janë krijuar dhe përbëhen nga anëtarë aktivë të shoqërisë dhe, për rrjedhojë, ato kontribuojnë në ndërtimin e solidaritetit social, krijimit të komunitetit dhe forcimit të ndërgjegjësimit social. Në këtë kuptim, OJF-të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhjen midis publikut dhe

¹⁴⁰ Anëtare e Gjykatës së Lartë, Doktorante, UT

procesit politik dhe janë aktorë kyç në ndërtimin e një dialogu civil të strukturuar midis qytetarëve dhe qeveritarëve. Për më tepër, OJF-të janë shpesh ofruesit kyç të shërbimeve, si në aspektin e mbështetjes praktike, informacionit, këshillave, shërbimeve shëndetësore dhe sociale ose këshillimeve ligjore. Madje, janë OJF-të ato, të cilat ndikojnë të krijojnë praktikën më të mira në fushat përkatëse, duke zhvilluar tregues standardesh dhe target grupe. Së fundi, OJF-të janë roje të interesit publik, pavarësisht natyrës ambjentaliste, sociale, zhvilluese ose humanitare.¹⁴¹

Qëllimi i këtij prezantimi lidhet me përpjekjen për të gjetur mundësitë ligjore dhe praktike për ndërhyrjen (pjesëmarrjen) e OJF-ve në procese gjyqësore, kryesisht në mbrojtje të drejtave të njeriut dhe në reformat gjyqësore për këtë qëllim, si dhe hapjen e një debati mbi këtë çështje, ku qëndrimet e ndryshme, eksperiencat dhe praktikën më të mira mbeten të mirëpritura.

Roli im në këtë prezantim është ai i një aktivisteje të drejtave të njeriut, që aktualisht ushtron funksionin e saj si gjyqtare në Gjykatën e Lartë dhe qëndrimet janë tërësisht personale.

Pavarësisht pengesave ligjore të dukshme, që në kuptim të këtij debati do të donim të shiheshin si të diskutueshme, kuptimeve të ndryshme të normave procedurale, mungesës së iniciativës për interpretimin *senso lato* të ligjit procedural mbi ndërhyrjen e personave të tretë në procesin civil, nga tërësia e vlerave që përfaqësojnë OJF-të dhe e kontributit të tyre të spikatur në shoqërinë shqiptare, do të ishte me interes që roli i tyre aktiv të shtrihej edhe më gjerë, përfshi këtu edhe proceset gjyqësore.

Në një shoqëri civile, qytetarët presin që gjykatat dhe sistemi i drejtësisë të funksionojë me një shkallë të gjerë qëndrueshmërie, parashikueshmërie dhe integriteti. *Qëndrueshmëria* mund të shprehet përmes praktikave të përditshme të zbatimit të ligjit, përmes hartimit të kodeve ose rregulloreve të paanshme dhe të drejta dhe përmes gjyqtarëve të paanshëm, që vendosin mbi çështjet individuale në përputhje me ligjin. *Parashikueshmëria* dhe *integriteti*

¹⁴¹ http://ec.europa.eu/governance/social-ngos_en.pdf

i sistemit të drejtësisë (pavarësisht nëse ky i përket të drejtës romano-gjermanike, common law, familjes islamike apo të tjera) shprehet gjithashtu përmes kodeve, praktikave, precedentëve të cilët evoluojnë nga koha në kohë, si dhe nga sjellja e policëve, prokurorëve, gjyqtarëve dhe gjykatave në çështjet individuale.¹⁴²

Në një shoqëri civile, qytetarët presin që të respektohen të drejtat dhe liritë e tyre themelore, të cilat në të vërtetë duhet thënë se jo në pak raste shkelen. Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve vetëm nëpërmjet parashikimeve Kushtetuese dhe ligjore, nuk është i mjaftueshëm, prandaj zbatimi i garancive kushtetuese dhe ligjore në praktikë mbetet prioritet si për aktorët politikë ashtu dhe për aktivistët e të drejtave të njeriut. Këta të fundit, të organizuar në organizata ose shoqata të ndryshme, përmes zbatimit të projekteve, strategjive, lobimeve në nivele të ndryshme, bëjnë të mundur një mbrojtje më të madhe të të drejtave dhe lirive themelore. Pengesat që hasin OJF-të nuk janë të pakta, ku për qëllime të këtij shkrimi do të përmendim pamundësinë për të marrë pjesë si palë e tretë të procese gjyqësore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Tradicionalisht, janë identifikuar tri pengesa kryesore për përdorimin e ndërhyrjes së OJF-ve si persona të tretë në procese gjyqësore: së pari, organizatat mund të mos kenë dijeni për procese gjyqësore të cilat ngrenë çështje që paraqesin interes për to; së dyti, për shkak se praktika nuk është zhvilluar mirë në këtë drejtim, OJF-të nuk dinë cilat janë procedurat për ndërhyrjen; dhe së fundi, ato kanë frikë se mos u duhet t'u paguajnë palëve në proces ndonjë kosto financiare si rezultat i ndërhyrjes së tyre.¹⁴³

1. Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor.

Kodi i Procedurës Civile (KPC) në kreun III, të titullit të dytë, të pjesës së dytë të tij "Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin civil" parashikon institutin e ndërhyrjes në procesin gjyqësor të personave të tretë duke përcaktuar shprehimisht kërkesat që ky

¹⁴² <http://siteresources.worldbank.org/INTLAWJUSTINST/Resources/>

¹⁴³ <http://www.publiclawproject.org.uk/documents/3rdPartyInterventionsGuide.pdf>

subjekt procedural duhet të plotësojë për t'u legjitimuar si palë në procesin gjyqësor. Konkretisht, KPC-ja e kategorizon pjesëmarrjen e personit të tretë në procesin gjyqësor si *ndërhyrje kryesore*¹⁴⁴ dhe *ndërhyrje dytësore*¹⁴⁵. Normat procedurale sanksionojnë se *kushdo* mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor, duke parashikuar edhe kriteret dalluese të këtyre ndërhyrjeve, që në rastin e ndërhyrjes kryesore është interesi vetjak dhe i drejtpërdrejtë i personit të tretë dhe, në rastin e ndërhyrjes dytësore është interesi i tërthortë, ose ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për njërën prej palëve në gjykim.

KPC-ja madje, detajon edhe procedurat që duhet të respektojnë personi i tretë, i cili duhet të paraqitet në seancë përgatitore ose gjyqësore, duke i paraqitur gjykatës kërkesën e tij me shkrim ose duke e depozituar atë në sekretari dhe kur është rasti edhe prokurën e dokumentet provuese në aq kopje sa janë ndërgjyqësit. Gjykata urdhëron që ato t'u njoftohen palëve mundësisht pa shtyrë séancën gjyqësore.¹⁴⁶

Përveç ndërhyrjes së personit të tretë me iniciativën e tij (*ndërhyrje vullnetare*), KPC-ja parashikon edhe një mënyrë të dytë përmes të cilës personi i tretë merr pjesë në procesin gjyqësor, ndërhyrje e cila realizohet përmes ushtrimit të thirrjes së personit të tretë nga palët ndërgjyqëse, ku secila prej tyre mund të thërresë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes (*ndërhyrje e detyruar*). Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që paraqitet në seancën përgatitore ose në sekretarinë gjyqësore kur ka filluar shqyrtimi i padisë. Kërkesa i njoftohet menjëherë gjyqtarit i cili urdhëron që

¹⁴⁴ Neni 189 "Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur pretendon për vete tërësisht ose pjesërisht sendin ose një të drejtë që është objekt i padisë në shqyrtim, ose që lidhet me përfundimin e gjykimit, duke ngritur padi kundër të dy palëve ose njëres prej tyre.

¹⁴⁵ Neni 191 "Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njërën ose tjetrën palë, me të cilin bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë".

¹⁴⁶ Neni 190 i KPC-së

t'i njoftohet personit të tretë, mundësisht pa shtyrë seancën gjyqësore të caktuar. Thirrja e personit të tretë lejohet kur ai ka banim të ditur brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe derisa nuk ka përfunduar gjykimi i çështjes në shkallë të parë.

Personi i tretë, me të cilin pala që e thërret mendon se e ka të përbashkët çështjen, mund dhe duhet të thirret si bashkëndërgjyqës me të kur plotësohen kriteret e bashkëndërgjyqësisë të parashikuara në nenin 161 të KPC-së, të cila janë: a) ekzistenca e të drejtave ose detyrimeve të përbashkëta mbi objektin e padisë; b) situata juridike sipas të cilës të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë.

Personi i tretë mund të thirret edhe nga pala që mendon se prej tij mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes (rastet e denoncimit të padisë personit të tretë). Personi i tretë thirret nga pala përkatëse për t'u bashkuar me të në të njëjtën pozitë procedurale, nisur nga një marrëdhënie juridike e përbashkët me të dhe me palën tjetër në konflikt.¹⁴⁷

Por, pjesëmarrja e personit të tretë në procesin civil bëhet e mundur edhe përmes një mënyre të tretë, e cila ka të bëjë me iniciativën e vetë gjykatës, e cila, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore. Sekretaria e njofton atë me letërthirrje. KPC-ja parashikon se gjykata pranon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykimin civil me vendim të ndërmjetëm. Kundër vendimit që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë mund të bëhet ankim i veçantë.¹⁴⁸

Për sa i përket të drejtave procedurale të personit të tretë, KPC-ja parashikon se personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejojnë palëve përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë. Me pëlqimin e të dy palëve personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit

¹⁴⁷ Vendim nr.901, datë 14.07.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

¹⁴⁸ Nenet 192-194 të KPC-së

të dalë jashtë gjykimit. Vendimi që jepet pas ndërhyrjes dytësore ose thirrjes së personit të tretë ka efekt kundrejt tij si për sa u përket marrëdhënieve të tij me personin që e ka thirrur ose për të cilin ka ndërhyrë për ta ndihmuar, ashtu dhe për sa u përket marrëdhënieve të tij me anën kundërshtare.¹⁴⁹ Tërësia e të drejtave procedurale të personave të tretë apo formimi i ndërgjygjësisë nga gjykatat e shkallëve më të ulëta ka qenë në mënyrë të vazhdueshme në fokusin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, praktika e së cilës mbetet një burim interpretimi për këto norma procedurale dhe që pasurohet në mënyrë të vazhdueshme.¹⁵⁰

2. Kuadri ligjor vendas mbi legjitimitimin e organizatave jofitimprurëse si palë ndërgjygjëse në gjykatat kombëtare.

Formulimi i normave procedurale mbi pjesëmarrjen e personit të tretë në procesin gjyqësor, *prima facie* respekton neutralitetin e subjektit, pra nuk përcakton nëse subjekti që ka një interes kryesor apo dytësor në një proces gjyqësor duhet të jetë person fizik apo person juridik. Mjafton që i treti të posedojë një lloj të veçantë legjitimitimi, i cili megjithëse nuk i lejon që të veprojë në mënyrë autonome mbi marrëdhënien e paraqitur në gjyq nga paditësi, është megjithatë i mjaftueshëm për të justifikuar ndërhyrjen dhe kërkesën e tij.¹⁵¹ Parë në këtë vështrim, natyrshëm lind pyetja nëse munden OJF-të ta përdorin mjetin procedural të ndërhyrjes dytësore apo thirrjen nga palët apo gjykata kryesisht me cilësinë e personit të tretë në një proces gjyqësor, kur shprehimisht normat procedurale ia njohin këtë mundësi “*kujtdo*” që ka një interes në procesin gjyqësor.

Kuadri ligjor vendas duket sikur i jep përgjigje pyetjes së mësipërme. Konkretisht, ligje të veçanta si ligji nr. 9970, datë

¹⁴⁹ Nenet 195-196 të KPC-së.

¹⁵⁰ Shih vendimin nr. 387, datë 03.04.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁵¹ Për një trajtim më të zgjeruar teorik të rregullimit ligjor aktual të ndërhyrjes së personit të tretë në procesin gjyqësor civil, shih: “Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil”, nga Prof. asoc. Dr. Ardian Nuni & Asim Vokshi (Ma), botuar në revistën juridike shkencore “Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, Viti i shtatë i botimit, nr.1, mars 2010, fq.5-23.

24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" parashikojnë një rol aktiv të organizatave jofitimprurëse nëpërmjet përfaqësimit ligjor, vënies në lëvizje dhe mbështetjes së rasteve në gjykatë.

Kështu, neni 30 i ligjit "Për Barazinë Gjinore në shoqëri" parashikon procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke sanksionuar se organizatat jofitimprurëse, *të licensuara për ofrim shërbimi social*, mund të përfaqësojnë ose të mbështesin në procese ligjore, në emër të ankuesit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Kjo normë ligjore ofron mundësinë e një roli shumë aktiv të organizatave jo vetëm nëpërmjet përfaqësimit, por edhe mbështetjes në procese ligjore, për çështje që lidhen me garantimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Vërehet një kufizim në llojin e OJF-ve që mund të ushtrojnë këtë të drejtë, pasi ndërhyrja e OJF-ve (përfaqësim ose mbështetje) varet nga natyra e shërbimit që ofron organizata si dhe nga fakti i pasjes së një licence për këtë qëllim. Ky kufizim mendoj se është i arsyeshëm pasi ka për qëllim angazhimin e organizatave dhe eksperteve të kualifikuar në fusha të caktuara dhe merr rëndësi po të kemi parasysh praktikat jo të mira në këtë fushë, ku në varësi të ardhjes dhe ikjes së donatoreve të interesuar në fusha të ndryshme shfaqen dhe zhduken organizata që jo gjithmonë ofrojnë atë që duhet. Gjithsesi duhet theksuar se termi "mbështetje", nuk plotëson tërësisht nevojën për qartësimin e mundësisë së ndërhyrjes në procesin gjyqësor civil të OJF-ve, me cilësinë e personit të tretë, ndaj në këtë pikë ligji mund të përmirësohet.

Neni 34 i ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" që parashikon subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, sanksionon se: "Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi." Edhe në këtë rast, ligji përcakton shprehimisht kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për

legjitimimin e OJF-ve në procese gjyqësore më objekt mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si subjekte që legjitimohen për paraqitjen e kërkesës për Urdhër Mbrojtje për të mitur dhe Urdhër të menjëhershëm mbrojtje për persona madhorë dhe të mitur.¹⁵² Në këtë rast pozita e tyre paraqitet ajo e kërkuarit dhe jo si persona të tretë.

Në dy ligjet e mësipërme duket se ligjvënësi, në hartimin e normave ligjore përkatëse, ka pasur si qëllim dhënien e një roli primar OJF-ve, pra atë të iniciuesit të procesit gjyqësor dhe jo atë të ndërhyrësit dytësor (mbështetësit) në këtë proces gjyqësor. Në këtë kuptim, mungesa e njëtrajtësisë në formulimet ligjore shkakton paqartësi në zbatimin korrekt të normës, duke çuar në krijimin e pengesave dhe interpretime të ndryshme. Për rrjedhojë, nuk rezulton një praktikë gjyqësore e mirëfilltë në vendin tonë, ku OJF-të që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të luajnë këtë rol që u njeh ligji, duke vënë në lëvizje ose duke ndërhyjnë si palë të treta në proceset gjyqësore që zhvillohen në gjykatat e zakonshme.

Përballë kësaj mungese legjitimimi të OJF-ve si persona të tretë në proceset gjyqësore, jurisprudenca kushtetuese shqiptare evidenton një realitet tjetër, konkretisht raste të shpeshta të legjitimitit të OJF-ve dhe rolit të tyre ndërhyrës (*si pjesëmarrës në gjykim*) dhe mjaft aktiv në mbrojtje të standardeve kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka përpunuar hollësisht kriteret për legjitimimin e këtyre subjekteve duke u shprehur se subjektet që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike. Në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, për të legjitimuar subjektet iniciues,

¹⁵² Ligji nr. 9669, datë 18.12.2010, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, neni. 13.

Gjykata Kushtetuese kërkon paraprakisht që ato të provojnë nëse janë subjekte që parashikohen në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre. Në plotësim të këtyre kërkesave, Gjykata i konsideron organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për te iniciuar një gjykim kushtetues, duke pasur legjitimitet vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Për sa i përket legjitimitet të subjekteve, të cilave u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Pra, interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit.¹⁵³

3. Praktikat më të mira ndërkombëtare.

Çdo organizatë jofitimprurëse që punon në fushën e të drejtave të njeriut që përfshihen në çdo traktat mund të ndërveprojë me mekanizmat e traktateve, përfshi këtu Komitetet e ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesë. Kështu, OJF-të mund të paraqesin ankesa para Komitetit të të Drejtave të Njeriut, Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Komitetit kundër Torturës dhe Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Racial.

Garancitë ndërkombëtare përfshijnë, gjithashtu, edhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), jurisprudenca e së cilës ka nënvizuar natyrën thelbësore të rolit të OJF-ve në mënyrë të vazhdueshme.¹⁵⁴ Prej viti 1981¹⁵⁵ kur GJEDNJ-ja u njohu mundësinë

¹⁵³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 23.02.2011

¹⁵⁴ Shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "*Gorzelik and Others v Poland*", 17 shkurt 2004 [DHM], para 92

¹⁵⁵ Shih çështjen "*Young, James and Webster v. UK*", në të cilën u autorizua një përfaqësues i Kongresit të Sindikatave të bënte një prezantim me gojë bazuar në nenin 38 (1) të rregullave të Gjykatës. Në këtë kohë përmbajtja e dispozitës ishte si vijon: "Dhoma mundet me kërkesë të një Pale, ose të Delegatëve të Komisionit, ose proprio motu, të vendosë të dëgjojë ... në çdo kapacitet tjetër çdo person, provat apo deklaratimet e të cilat duket se e asistojnë atë në kryerjen e detyrave të saj".

organizatave jofitimprurëse të marrin pjesë në procedurat para kësaj gjykate, praktika e saj ka pasuruar në mënyrë të vazhdueshme rregullin e parashikuar nga neni 34 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) se Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, *organizatë joqeveritare* ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktime të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Organizata mund të luajë një rol aktiv nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të aplikantit/es duke ndërhyrë edhe si palë e tretë në GJEDNJ përmes komenteve me shkrim (*amicus curiae*) ose duke marrë pjesë në raste të caktuara në procese.

Neni 36/2 i KEDNJ-së parashikon në lidhje me ndërhyrjen e palës së tretë se: “Kryetari i Gjykatës, në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, mund të ftojë çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose një person të interesuar që nuk është kërkues të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seance”. Menjëherë pas njoftimit të palës së paditur kontraktuese për aplikimin, Presidenti i Dhomës mund, që në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, të ftojë ose t’i japë leje një pale kontraktuese, e cila nuk është palë në proces, ose çdo personi të interesuar që nuk është kërkuesi të paraqesë komentet me shkrim, ose në raste të veçanta, të marrë pjesë në proces. Kërkesa për leje për këtë qëllim duhet të jetë e mirë arsyetuar dhe të paraqitet me shkrim në një nga gjuhët zyrtare jo më vonë se 12 javë pasi njoftimi i aplikimit ti jetë dhënë palës së paditur kontraktuese. Një tjetër kufi kohor mund të fiksohet nga Presidenti i Dhomës për shkaqe të veçanta. Mospërmbushja e kushteve të tilla bën që Presidenti i Dhomës mund të vendosë të mos përfshijë komentet në dosjen e çështjes ose të kufizojë pjesëmarrjen në seance, në atë masë që ai e konsideron të nevojshme.¹⁵⁶

Organizata jofitimprurëse mund të paraqesë një letër zyrtare, nëpërmjet së cilës të kërkojë leje për të ndërhyrë. Në këtë kërkesë

¹⁵⁶ Rregullorja e GJEDNJ-së, neni 44, ndryshuar 7 korrik 2003, 13 nëntor 2006, hyrë në fuqi në 1 prill 2011.

përcaktohen detaje mbi organizatën ndërhyrëse, profilin e saj dhe ravijëzohen çështjet e propozuara për tu adresuar në paraqitjen me shkrim. Komentet me shkrim ju dërgohen palëve të çështjes, të cilët kanë të drejtën të paraqesin observimet e tyre me shkrim. Këto observime në përgjigjen e palëve i dërgohen organizatës ndërhyrëse për komente të mëtejshme. Ndërhyrja e palës së tretë mund të asistojë gjykatën në qartësimin e kontekstit në të cilin një politikë ose praktikë e veçantë është miratuar ose zbatohet nga një shtet palë i Konventës. Kërkesat për leje për të ndërhyrë si palë e tretë zakonisht lidhen me çështje të meritave por është e mundur të paraqiten edhe në lidhje me vendimin për pranueshmërinë e çështjes. Komentet me shkrim të paraqitura sipas këtij rregulli përgatiten në një nga gjuhët zyrtare, anglisht ose frëngjisht.

Praktika e mësipërme ka rezultuar mjaft e suksesshme dhe mund të merret si shembulli i praktikës më të mirë në këtë drejtim, e cila mund të gjejë zbatim edhe në realitetin shqiptar.

4. Konkluzione dhe rekomandime.

Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor përbën një mjet procedural të përshtatshëm dhe efektiv, i cili në rast se do të zbatohet edhe për legjitimimin e OJF-ve në proceset me objekt mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore do t'i shërbente miradministrimit të drejtësisë, ekonomisë gjyqësore të vendimeve dhe minimizimit të konflikteve. Realizimi i një reforme ligjore në këtë drejtim, nëpërmjet përmirësimit të formulimit të dispozitave të KPC-së, në lidhje me pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil (*edhe në formën e amicus curiae*), do të ishte një hap i rëndësishëm dhe dobiprurës në këtë drejtim. Më tej edhe qenia më aktive e gjykatave në thirrjen me iniciativën e tyre të OJF-ve të interesuara në procese gjyqësore konkrete, mbetet një kontribut mjaft i rëndësishëm në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. Nga ana tjetër, duke patur parasysh edhe natyrën komplekse të proceseve gjyqësore me disa palë, u takon OJF-ve të hartojnë një plan veprimi dhe strategji konkrete si dhe të llobojnë

për të bërë realitet mundësinë për t'u legjitimuar si persona të tretë në proceset gjyqësore.

Ndërkohë në situatën e tanishme ligjore, kontribut i vyer i këtyre organizatave (OJF-ve), sidomos i atyre të specializuara në fushën e ligjeve, do të vazhdonte të mbetej dhënia e ndihmës juridike në formën e konsulencave juridike, hartimit të akteve e deri tek përfaqësimi në gjyq për çështje të ndryshme gjyqësore në të cilat krijohen precedentë të rëndësishëm dhe vendosen standarde të larta në mbrojtje të të drejtave të njeriut në përgjithësi apo të grupeve vulnerabël edhe sikur të mos jetë rasti ose të mos ekzistojë mundësia për të realizuar ndërhyrjen si persona të tretë në proces.

Krijimi i precedentëve në këtë drejtim do të ishte ndihma më e madhe që mund t'i jepej këtyre grupeve të interesit dhe mbrojtjes së interesave të tyre.

Po kështu, ofrimi i ndihmës në formën e opinionëve të ekspertëve të fushave të caktuara që punojnë, janë trajnuar dhe angazhohen në OJF dhe që janë ndër më të mirët e fushave përkatëse, si punonjës socialë, psikologë, mjekë, etj, në ato procese ku ka nevojë për këtë mendim të specializuar, do të ishte një ndihmë e madhe për drejtësinë në përpjekjet e saj për të qenë një shërbim cilësor që i ofrohet shoqërisë.

Vetëm më pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në këtë proces drejtësi e vonuar për individët e dhunuar, të diskriminuar, me aftësi të kufizuara, të miturit etj nuk do të kthehet në drejtësi të mohuar.

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi i Procedurës Civile
2. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2010, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
3. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri",
4. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

5. Prof. asoc. Dr. Ardian Nuni & Asim Vokshi (Ma) "Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil", botuar në revistën juridike shkencore "Jeta Juridike", botim i Shkollës së Magjistraturës, Viti i shtatë i botimit, nr. 1, mars 2010, fq. 5-23.

6. <http://www.gjk.gov.al>

7. <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

8. <http://www.echr.coe.int/echr/en/hudoc/description/>

9. <http://www.ligjet.org>

10. http://ec.europa.eu/governance/social-ngos_en.pdf

11. <http://siteresources.worldbank.org/INTLAWJUSTINST/Resources/>

12. <http://www.publiclawproject.org.uk/documents/3rdPartyInterventionsGuide.pdf>

Suela JANINA (MA)¹⁵⁷

Ledia HYSI (MA)¹⁵⁸

**“ROLI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE SI
AMICUS CURIAE PRANË GJYKATAVE
NDËRKOMBËTARE NË ÇËSHTJET E TË DREJTAVE TË
NJERIUT”**

Në vitet e fundit është vërejtur një aktivitet i paprecedentë i organizatave jo fitimprurëse në nivelin ndërkombëtar¹⁵⁹. Ato kanë një rol jetësor në përpunimin e axhendave ndërkombëtare, në influencimin e politikëbërjes dhe zbatimin e normave ndërkombëtare. Këto organizata kanë provuar se kanë arritur të jenë një forcë udhëheqëse në inovacionet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare dhe një partner vital i zbatimit të përditshëm të standardeve ndërkombëtare¹⁶⁰.

E drejta ndërkombëtare moderne i ka rezervuar aktorëve jo shtetërore një rol të rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Deri para pak dekadash drejtësia

¹⁵⁷ Doktorante, Fakulteti i Drejtësisë, UT

¹⁵⁸ Doktorante, Fakulteti i Drejtësisë, UT

¹⁵⁹ Nocioni i OJF nuk është unik në praktikën ndërkombëtare dhe debatin akademik. Termit organizatë jofitimprurëse dhe organizatë joqeveritare përdoren me të njëjtën frekuencë. Në këtë punim ky term i referohet organizatave të ngritura me iniciativë private, formalisht të lira nga influencat qeveritare dhe pa një qëllim fitimi.

¹⁶⁰ Emanuele Rebasti & Luisa Vierucci, A legal status for NGO in contemporary International Law..www.esil-sedi.eu/fichiers/en/VierucciRebasti-971.pdf

ndërkombëtare ka qenë një prerogativë e shteteve, me përjashtime të vogla. Në dy dekadat e fundit, forcimi dhe krijimi i gjykatave ndërkombëtare me kompetenca mbi individët, ka sjellë edhe pjesëmarrje të rritur të OJF në proceset përpara këtyre gjykatave.

Ky punim do të ketë në focus të tij rolin e OJF-ve të drejtave të njeriut në proceset gjyqësore për çështjet e drejtave të njeriut në gjykatat ndërkombëtare. OJF mund të përfshihen si kërkues individualë kur vetë ajo është viktimë e shkeljes së drejtave të njeriut lidhur me të, ose kur plotëson ankime individuale në emër të individëve të cilëve u janë shkelur të drejtat si dhe kur ofron asistencë ligjore dhe ekspertizë për ankuesit individualë. Në këtë aspekt OJF trajtohen si një individ. Ky këndvështrim nuk trajtohet në këtë punim, i cili ka qëllim të hulumtojë përjashtjen e OJF në proceset gjyqësore të iniciuara nga individët për shkelje të drejtave dhe lirive të tyre. Aftësia e OJF për të iniciuar një çështje ndërkombëtare apo për të ndërhyrë si palë ka qenë e kufizuar për shkak të parimit tradicional të së drejtës ndërkombëtare se në gjykatat ndërkombëtare vetëm shtetet janë palë në proces.¹⁶¹

Me evoluimin e së drejtës ndërkombëtare ky koncept tashmë ka ndryshuar. OJF janë veçanërisht aktive dhe mbrojtëse të interesit publik përpara organeve gjyqësore ndërkombëtare, sidomos në sistemet rajonale sic janë Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut, Gjykata Ndër-Amerikane e Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë nëpërmjet mekanizmit të njohur si *amicus curiae*.

Koncepti i *Amicus Curiae*

Termi latin *amicus curiae*, që do të thotë “mik i gjykatës”, i referohet një personi që nuk është palë në një çështje, i cili ofrohet vullnetarisht për të dhënë informacion dhe për të ndihmuar gjykatën për zgjidhjen e kësaj çështje. Informacioni që jepet zakonisht është një opinion ligjor në formën e një përmbledhje e

¹⁶¹ Jan Wouters & Ingrid Rossi, Human Rights NGO-s: Role, structure and legal status. Institute for International Law, Working paper n.14, November 2001, www.law.kulven.be

njohur si *amicus brief*. Koncepti i *amicus curiae* rrjedh nga e drejta romake dhe duke filluar nga shekulli 9 u përfshi gjerësisht në sistemin anglo-sakson¹⁶². Zbatimi i mekanizmit të *amicus curiae* në historikun e tij është karakterizuar nga fleksibiliteti. Dikur vlerësohej se roli i *amicus* ishte krejt neutral, ndërsa sot pranohet që edhe *amicus* mund të ketë një interes të lidhur me çështjen.

Roli i *amicus* është të ndihmojë gjykatën duke paraqitur ligjin në mënyrë të paanshme ose nëse ndonjë nga palët nuk përfaqësohet, duke paraqitur instrumentat ligjore në emër të tij. Kur çështja ka më shumë ndikime se ajo që ngrenë palët në proces, *amicus briefs* janë një mënyrë për të prezantuar këto shqetësime, kështu që efekti ligjor më i gjërë i vendimeve të gjykatës nuk do të varet vetëm tek palët e përfshira drejtpërdrejt në këtë çështje.

Amicus curiae ndryshon nga një palë e interesuar e cila është një palë që është identifikuar si e ndikuar drejtpërsëdrejti nga çështja ndërmjet paditësit dhe të paditurit. *Amicus* ka qenë tradicionalisht një figurë neutrale e ftuar për të asistuar gjykatën nga pikëpamja ligjore, p. sh mbi interpretimin e një ligji të huaj. Me kalimin e kohës *amicus* morën një rol më aktiv , sa sot në vendet që zbatojnë common law termi *amicus curiae* dhe palë e tretë përdoren në të njëjtin kontekst.

Çfarë funksionesh ka *amicus* në fushën e të drejtave të njeriut.

Së pari *amicus curiae* mund të ofrojë argumente ligjore ose fakte mbi çështjen, të cilat palët kanë dështuar t'ia paraqesin gjykatës.

Së dyti *amicus* mund të ofrojë analiza të detajuara nga pikëpamja ligjore që nuk janë përfshirë nga palët për arsye politike ose taktike.

Së treti *amicus* mund të asistojë gjykatën në çështje të reja dhe komplekse. *Amicus* sjell ekspertizën që nuk është e mundur për palët dhe ndihmon në shpjegimin e çështjeve të vështira që do ta ndihmonin gjykatën të marrë një vendim për çështjen.

Pra *amicus* asiston gjykatën në paraqitjen e argumenteve alternative ose shtesë duke luajtur një rol të rëndësishëm në analizën gjyqësore.

Si rregull procedural, gjykatat duhet të japin lejen për t'u

¹⁶² Amicus curiae- Wikipedia, the free encyclopedia, <http://en.wikipedia.org/wiki>

paraqitur si *amicus*. OJF paraqesin arsytet pse argumentat që do të paraqiten prej tyre nuk paraqiten dot nga palët ose se si ndërhyrja do të ndihmojë në zgjidhjen e çështjes. Disa herë gjykata ka vendosur pranimin e ndërhyrjeve *amicus* kur justifikohet nga rrethanat, ne disa raste të tjera ka kërkuar edhe miratimin e palëve në proces. Zakonisht *amici* paraqesin argumentime të shkruara por në disa raste mund të lejohen të marrin pjesë në procedimin gojor ku mund të jenë subjekt i pyetjeve nga gjykata dhe nga palët.

Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të *amicus curiae*.

- Një element pozitiv është se pjesëmarrja në këtë formë në procese gjyqësore është me kosto të ulët dhe efektive në lidhje me kohën në krahasim me përgatitjen e të gjithë çështjes si një palë.¹⁶³

- Duke qenë se *amicus* nuk janë të lidhur me vendimin ata mund ta ngrenë çështjen edhe një herë tjetër nëse përfundimi i çështjes është i pafavorshëm, pra nuk janë të lidhur nga parimi *res judicata*.

- *Amicus* nuk kufizohen vetëm tek çështja por ata marrin pjesë në gjykim mbi bazën e një interesi të përgjithshëm, përfshirë prezantimin e personave të nënpërfaqësuar ose interesin publik.

- Disavantazhi kryesor i takon mungesës së kontrollit mbi drejtimin apo menaxhimin e procesit ligjor. OJF nuk i vihen në dispozicion dokumentat e çështjes dhe ata nuk mund të dëgjohen pa leje të gjykatës. Atyre nuk u jepet dëmshpërblim ose nuk i njihet rimbursimi i kostove siç u njihet palëve ne proces.

Megjithëse disa autorë i njohin rol më të rëndësishëm avantazheve dhe disa prej tyre disavantazheve, të gjithë bashkohen me konkluzionin se në ditët e sotme kjo është e vetmja rrugë për OJF për marrjen pjesë në çështje perpara gjykatave ndërkombëtare.

Paraqitja si *amicus curiae* në gjykatat ndërkombëtare

Amicus curiae përdoret shpesh si një mekanizëm për pjesëmarrje në çështjet përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

¹⁶³ Shelton Dinah, The participation of Non-Governmental Organizations in International Judicial Proceedings, American Journal of International Law, 1994

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dy dispozita shumë të rëndësishme për OJF. Neni 34 parashikon aplikimin individual duke i lejuar organizatave jo qeveritare krahas çdo personi ose grupi individësh, të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës në raste të shkeljeve të të drejtave të parashikuara në këtë konventë. Përpara hyrjes në fuqi të Protokollit të 11 në vitin 1994 nuk ka pasur referencë eksplicite të ndërhyrjes së një pale të tretë në proceset para kësaj Gjykate. Kjo mundësi ishte një çështje që vendosej nga Gjykata ose Komisioni sipas disa rregullave procedurale. Pas hyrjes në fuqi të Protokollit të 11, neni 36 i jep diskrecionin kryetarit të Gjykatës që të lejojë ndërhyrjen e palës së tretë. Pra vetëm kryetari ka të drejtë që të lejojë ose të refuzojë pjesëmarrjen në gjykim. Thelbësore është të kuptohet se ndërhyrja duhet të jetë në interes të drejtësisë, në kuptimin që ta ndihmojë gjykatën në plotësimin e detyrës së saj. Më tej janë rregullat e Gjykatës që përcaktojnë procedurat për ndërhyrjen e palës së tretë. Sipas Rregullit 44, mund të bëhet kërkesë për të ndërhyrë në gjykim brenda 12 javësh nga data e komunikimit. Nuk ka formë të posaçme apo tarifë aplikimi. Kërkesa e vetme është që të jenë "të arsyetuara në mënyrën e duhur" dhe të bëhen në një nga gjuhët e punës së Gjykatës: frëngjisht ose anglisht. Forma më e zakonshme është ajo e faksimit të një kërkesë për t'u lejuar në gjykim drejtuar Sekretarisë së Gjykatës, duke treguar çështjen konkrete, interesin e OJF dhe një përmbledhje të shkurtër të ndërhyrjes së propozuar. Nëse prezumojmë një aplikim të arsyetuar brenda afateve kohore, leja për të ndërhyrë me shkrim jepet pothuajse gjithmonë, me kushtin standart që ndërhyrja nuk duhet t'i kalojë 10 faqe dhe ndërhyrësi nuk do të kërkojë të adresojë faktet ose përmbajtjen e çështjes. Aplikimet e bëra jashtë afatit kohor nuk janë asnjëherë të suksesshme dhe lejet për të bërë paraqitje te fakteve në seancat gojore janë shumë të rralla.

Një nga rastet e para ku një organizatë e të drejtave të njeriut kërkoi leje për të paraqitur një memorandum të shkruar, ishte çështja Tyrer¹⁶⁴. Kërkesa e Këshillit Kombëtar për Liritë Civile

¹⁶⁴ Tyrer v. United Kingdom (1978) çështja lidhet me dënimet trupore nëse ato përbëjnë shkelje të ndalimit për trajtim cnjerëzor e degradues. Gjykata në këtë çështje gjeti shkelje të nenit 3 të Konventës.

(tashmë e njohur si LIBERTY) për t'u përfshirë në proces, u refuzua pa diskutime. Çështja ka qenë një nga më të vështirat, pasi organizata kërkonte që të përfaqësohej në gjykatë qoftë si palë, si përfaqësues i Tyrer ose familjes së tij, si *amicus curiae* apo në çdo formë tjetër.

Çështja e dytë është Malone¹⁶⁵ ku kërkesës së Bashkimit të Zyrave të Postës për të paraqitur qëndrime të shkruara për 5 pika, Gjykata i dha leje për ato çështje që janë të lidhura veçanërisht me shkeljet e pretenduara të Konventës. Ndërhyrja pati një efekt të rëndësishëm në vendimin e Gjykatës.

Një çështje e rëndësishme është çështja Lingens¹⁶⁶. Kryetari i Gjykatës i lejoi Institutit Ndërkombëtar të Shtypit (IPI) nëpërmjet INTERIGHTS të paraqesë vërejte të shkruara, me disa kushte me qëllim që komentet të ishin sa më të shkurtra dhe të limituara vetëm në çështjen specifike.

Në çështjen Monnell and Morris mbi burgosjen e të dënuarve në Britaninë e Madhe, JUSTICE iu dha leja për të ndërhyrë por opinionet e saj nuk u morën parasysh nga gjykata. Ndërkohë qeveria britanike korrigjoi deklaratimet e bëra në memorandumin e saj pas përmbledhjes *amicus* që nxorri në pah gabimet e bëra nga qeveria.

Në çështjen Soering që ka të bëjë me ekstradimin e një të akuzuari drejt SHBA-së, pjesë nga ndërhyrja e Amnesty International u cituan dhe u adoptuan në vendimin e Gjykatës.

Në çështjen Brannigan and MC Bride v. United Kingdom 1994, ishte hera e parë ku gjykata përdori termin *amicus curiae* në referencë me ndërhyrjet e një pale të tretë.

Po kështu mund të përmendim çështjen Zontul kundër Greqisë (korrik 2010) dhe çështje të tjera në shqyrtim ku roli i OJF është mjaft aktiv.

Në disa raste Gjykata ka refuzuar kërkesat për përmbledhje *amicus* mbi disa arsye kur kërkesa nuk ka lidhje me çështjen

¹⁶⁵ Malone v. United Kingdom (1985) ku gjykata gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës.

¹⁶⁶ Lingens v. Austria (1986) Gjykata gjeti shkelje të nenit 10 të Konventës.

konkrete, kur është përmbushur me vonesë, kur ka precedentë të qartë për çështjen, ose është paraqitur një material i ngjashëm.

Nga një analizë e punës së Gjykatës vërejmë se *amicus* ndërhyjnë më shumë në rastet që kanë të bëjnë me lirinë e informimit, privatësinë, procesin e rregullt ligjor dhe burgosjen arbitrare. Shikojmë gjithashtu se ka disa aktorë që përsëriten INTERRIGHTS, ARTICLE 19, JUSTICE, LIBERTY dhe AMNESTY INTERNATIONAL paraqesin shpesh *amicus curiae*. Një studim i bërë nga Shelton tregon se në 75% të rasteve ku ka ndërhyrë një OJF, Gjykata ka gjetur shkelje të Konventës, ndërkohë që raporti për rastet kur nuk ka ndërhyrje *amicus* është 50%¹⁶⁷.

Ndërkohë që në një gjykatë tjetër të ngjashme, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut praktika e *amicus curiae* është përdorur më gjërësisht, madje që në çështjen e parë. Është karakteristike se kjo gjykatë nuk ka refuzuar asnjë ndërhyrje, tashmë janë mbi 100 ndërhyrje të evidentuara në çështjet e të drejtave të njeriut.¹⁶⁸

Ndërhyrjet *amicus* janë më të rralla përpara Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg. Kjo për arsye të angazhimit më të pakët të OJF me legjislacionin e BE por më tepër për qëndrimin kufizues që ka marrë vetë kjo gjykatë në drejtim të kërkesave të tilla.

Interesante është dhe shqyrtimi i praktikës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Kjo gjykatë e re, në Rregullin 103 të Procedurës dhe Evidencave i jep të drejtën Dhomës Paragjyqësore që të vendosë për pranimin e *amicus curiae* që mund të bëhet nga një individ, organizatë apo shtet.

Në vendimin e fundit të datës 13 qershor 2011, ku u refuzua kërkesa e “No Peace Without Justice” për ndërhyrje *amicus* për situatën në Kenia, citohet se “kjo gjykatë ka theksuar edhe herë të tjera se ajo do të lejojë *amicus curiae* vetëm mbi raste përjashtimore kur ajo është e mendimit se këto pikëpamje ofrojnë ekspertizë specifike”.

¹⁶⁷ Ana Wilkowska-Landowska, Friends of the Court, The role of Human Rights Non Governmental Organizations in the litigation proceedings.

¹⁶⁸ Michael K. Lowman, When does the party begin after the friend leave? The American University Law Review, Vol 41, 1244

Ky qëndrim është i kuptueshëm si shqetësim i gjykatës për të mos lejuar një fluks të madh ndërhyrjesh të cilat në një farë mase do të vononin dhënien e vendimeve. Megjithatë edhe në praktiken e kësaj gjykate vërehet se argumenti në favor të një roli më aktiv të organizatave të të drejtave të njeriut mbështetet në aftësinë e tyre për të ngritur zërin e interesit publik.

Deri në vitin 2004 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ishte e vetmja gjykatë që nuk ishte hapur ndaj aktorëve joshitetorë. Neni 66 i Statusit të Gjykatës flet për organizatat ndërkombëtare dhe jo për OJF. Me Direktivën nr. XII të datës 30 korrik 2004, Gjykata përcaktoi se OJF mund të paraqesin një pohim të shkruar lidhur me një çështje në gjykim, që nuk mund të konsiderohet si pjesë e dosjes, por publikohet në mjediset publike të Pallatit të Paqes.¹⁶⁹ Kjo praktike është larg nga përfshirja e OJF në proces, dhe megjithëse është një formë afrimi me gjykatën nuk mund të konsiderohet si *amicus curiae*.

Konkluzione

Si konkluzion mund të themi se influenca e shoqërisë civile në gjykimet ndërkombëtare është sot një realitet. Studimet e ndërmarra nga një numër organizatash tregojnë se çështja nuk është me nëse por si duhet ta menaxhojnë OJF këtë pjesëmarrje.

Në rastet kur gjykata ka lejuar OJF të marrin pjesë në gjykim si *amicus curiae*, ato kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në proceset e të drejtave të njeriut. Ndërhyrjet *amicus* paraqesin analiza krahasuese ligjore të cilat Gjykata ose palët nuk mund t'i paraqesin duke lehtësuar kështu procesin e vendim-marrjes.

Sot ky mekanizëm përdoret nga e drejta ndërkombëtare veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo formë pjesëmarrje në gjykim zbatohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian dhe së fundmi edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.

¹⁶⁹ Nicolas Leroux, NGO at the World Court, *International Community Law Review* 8, 2006.

Është për t'u vlerësuar se paraqitjet e organizatave të të drejtave të njeriut janë pranuar gjerësisht, pasi gjykata ka njohur ekspertizën që këto kanë dhe i ka gjetur observacionet të vlefshme sidomos në çështje komplekse dhe me ndjeshmëri të lartë.

Praktika e këtyre gjykatave tregon dobishmërinë e hapjes së proceseve gjyqësore ndaj aktorëve jo qeveritarë. Gjykatat kanë përfituar nga pjesëmarrja e OJF. Ndërkohë OJF duhet ta shfrytëzojnë sa më mirë këtë mekanizëm me qëllim që të arrijnë të përcjellin përpara gjykatave ndërkombëtare zërin e interesit publik dhe të realizojnë misionin e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

OJF në vendin tonë kanë shumë për të mësuar nga kjo përvojë. Ndonëse në sistemin tonë juridik nuk është traditë përdorimi i *amicus curiae*, praktika e OJF edhe në vendet që kanë kushte historike e juridike të ngjashme me vendin tonë, është një shembull i mirë i përfshirjes aktive në çështje të të drejtave të njeriut në gjykatat ndërkombëtare. Angazhimi në këtë dimension të rëndësishëm do të jetë pozitiv jo vetëm për OJF por edhe për vetë shoqërinë shqiptare.

BIBLIOGRAFIA

1. Emanuele Rebasti& Luisa Vierucci, A legal status for NGO in contemporary international law.www.esil-sedi.eu/fichiers/en/VierucciRebasti-971.pdf
2. Jan Wouters&Ingrid Rossi, Human rights NGO-s: Role, structure and legal status. Institute for international law, Working paper n.14, november 2001, www.law.kuluvn.be
3. Shelton Dinah, The participation of non-governmental organizations in international judicial proceedings, American Journal of International Law, 1994
4. Ana Wilkowska-Landowska, Friends of the court, The role of human rights non governmental organization in the litigation

proceedings.www.nottingham.ac.uk/hrlc/document/publications.

5. Michael K. Lowman, When does the party begin after the friend leave? *The American University Law Review*, Vol 41, 1244

6. Nicolas Leroux, NGO at the World Court, *International Community Law Review* 8, 2006.

Klesta HYSI¹⁷⁰
Av. Etilda SALIU GJONAJ¹⁷¹

AKTIVIZIMI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE PRANË GJEDNJ. PËRVOJA E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT.

Hyrje.

Organizatave jo fitimprurës (OJF) luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, jo vetëm për promovimin, por edhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut brenda dhe jashtë vendit duke vënë në lëvizje dhe përdorur mekanizma ndërkombëtarë. Në këtë artikull trajtohet roli i OJF-ve në vënien në lëvizje të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) në dy pozicione: si përfaqësuese e shtetasve që pretendojnë se e drejta e tyre e sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa) është shkelur dhe në rolin e ndërhyrjes si palë së tretë. Nëpërmjet analizës së Konventës dhe jurisprudencës së GjEDNJ, trajtohen mundësitë dhe sfidat e OJF-ve shqiptare për të vënë në lëvizje këtë gjykatë, procedurat e parashikuara sipas Protokollit 14 dhe bashkëpunimin me institucione të ngritura pranë Këshillit të Evropës si Komisioneri për të Drejtat e Njeriut.

¹⁷⁰ Klesta Hysi (Doktorante) është pedagoge në Departamentin e së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, UT.

¹⁷¹ Etilda Saliu Gjonaj është juriste dhe punon pranë Komitetit Shqiptar i Helsinkit. Ajo është pedagoge e jashtme pranë Departamentit Penal, Fakulteti i Drejtësisë, UT

Praktika e organizatave jo fitimprurëse shqiptare në raport me GjEDNJ është një tjetër çështje që trajtohet në këtë artikull, duke u përpjekur të analizohen mundësitë e bashkëpunimit midis OJF-ve dhe vështirësitë që hasen në praktikë për dërgimin e çështjeve në GjEDNJ. Artikulli përmbillet me disa përfundime dhe rekomandime për forcimin e rolit të OJF -ve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut pranë GjEDNJ.

2. Vendi i OJF-ve në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)

Sipas KEDNJ (neni 34) çdo person, organizatë jofitimprurëse ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese, mund të paraqesin një kërkesë para GjEDNJ-së duke pretenduar shkelje të të drejtave të parashikuara në Konventë ose në protokollet e saj¹⁷². Nga formulimi i nenit 34 të Konventës del se palët që bëjnë kërkesa individuale para GjEDNJ duhet të pretendojnë të jenë direkt viktimat të shkeljes së Konventës. Megjithatë, një person ligjor, si për shembull një shoqatë e regjistruar mund të bëjë aplikim në emër të anëtarëve të saj në rrethana të përshtatshme (shih për shembull çështjet *Cha'are Shalon Ve Tsedek kundër Francës (2000)* si dhe *Kisha Metropolitane e Besarabisë kundës Moldavisë (2001)*¹⁷³. Në çdo rast, Konventa nuk parashikon një *actio popularis* dhe nuk lejon paraqitjen e kërkesave kundër një ligji *in abstracto* thjesht sepse mund të jetë në kundërshtim me KEDNJ¹⁷⁴.

Konventa zbatohet si për personat fizik edhe për personat juridikë, pra organizatat mund të bëjnë kërkesë për shkelje të të drejtave pranë GjEDNJ. Por pavarësisht se parashikimet Konventës zbatohen si për individë (grup individësh) dhe për organizatat, jo

¹⁷² Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut, botim i Këshillit të Europës, Neni 34

¹⁷³ Gomein. D., *Udhëzues i Shkurtër i Konventës Europine për të Drejtat e Njeriut*, Botim i Këshillit të Evropës, 2005, f. 168.

¹⁷⁴ Hodson. L., "NGOs and the Struggle for Human Rights in Europe", HART Publishing, 2011, fq.20

të gjitha të drejtat e parashikuara në Konventë mund të bëhen objekt kërkese nga OJF-të¹⁷⁵, pasi duke qenë persona juridikë, ato nuk mund të gëzojnë disa të drejta si p.sh. e drejta për jetën, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës, e drejta për tu martuar etj. Por, organizatat mund të pretendojnë të jenë drejtpërdrejtë viktimat të shkeljes së të drejtës së shprehjes, lirisë të tubimit dhe organizimit, të drejtës për një proces të rregullt ligjor etj.

Gjithashtu, sipas nenit 36 të KEDNJ-së¹⁷⁶, një OJF mund të ndërhyjë si palë e tretë në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë duke paraqitur komente me shkrim ose duke marrë pjesë në seanca gjyqësore. Pas hyrjes në fuqi të Protokollit 14¹⁷⁷ dhe me forcimin e rolit të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës¹⁷⁸, OJF-të mund të bashkëpunojnë me Komisionerin për respektimin e të drejtave të njeriut, roli i të cilit është promovimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut në 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Komisioneri ndërhyt si palë e tretë përpara GJEDNJ-së për këtë arsye e konsiderojmë një mjet të domosdoshëm për të ndërhyrë pranë këtij mekanizmi.

3. Roli aktiv i OJF-ve në përfaqësimin e çështjeve në GJEDNJ

Po të hedhim një vështrim praktikës shumë vjeçare të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat janë palë kontraktuese të KEDNJ-së, vihet re se roli i OJF-ve si përfaqësuese ose si pale të treta ndërhyrëse pranë GjeDNJ ka qenë i hershëm. Në bazë të

¹⁷⁵ Erik Denters dhe Wino J.M. van Veen, "Voluntary Organizations in Europe: The European Convention on Human Rights", *International Journal Not - for - Profit Law*, Volumi 1, Dhjetor 1998 (http://www.icnl.org/knowledge/ijnl/vol1iss2/art_3.htm)

¹⁷⁶ Shih *Konventa Europiane e të drejtave të njeriut*, botim I Këshillit të Europës, neni 36.

¹⁷⁷ Protokollit 14 ka hyrë në fuqi në Qershor 2010.

¹⁷⁸ Aktiviteti i Komisionerit fokusohet në tre drejtime kryesore: vizita në shtete të ndryshme dhe dialogu me autoritetet dhe shoqërinë civile, puna tematike dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, bashkëpunimi me institucione të tjera të Këshillit të Evropës dhe struktura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

KEDNJ-së¹⁷⁹, organizatat mund të përfaqësojnë aplikantët e tyre në GJEDNJ. Disa organizata si Interights¹⁸⁰, AIRE center¹⁸¹ dhe Liberty¹⁸² kanë eksperiencë të gjatë si përfaqësuese të aplikantëve në GJEDNJ. Si modele pozitive në këtë fushë janë Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve (European Roma Rights Center), Memorial European Human Rights Advocacy Centre, etj.

3.1 OJF si palë e tretë ndërhyrëse në GJEDNJ

Konventa parashikon mundësinë e ndërhyrjes si palë e tretë për çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose për një person të interesuar që nuk është kërkues, të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seanca¹⁸³. Ndërhyrja mund të bëhet në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Madhe së GjEDNj.¹⁸⁴

OJF-të me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të aplikantit ose me iniciativën e tyre përfshihen si palë e tretë ndërhyrës nëpërmjet një diskutimi kur një çështje ka rëndësi për sarsia i përket politikave të ndërmarra dhe zakonisht përfshin më shumë persona sesa vetëm aplikantin. Sipas nenit 36 të KEDNJ-së, një organizatë mund të ndërhyjë si palë e tretë nëpërmjet komenteve të shkruara ose të marrë pjesë në seancat dëgjimore. Megjithatë, individët, organizatat dhe grupet e individëve nëse dëshirojnë të ndërhyjnë, duhet të kenë një interes të dukshëm në rezultatin e çështjes¹⁸⁵ dhe se forma e ndërhyrjes bëhet sipas rregullave të përcaktuara¹⁸⁶ Një numër i

¹⁷⁹ Neni 35 I Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

¹⁸⁰ <http://www.interights.org/home/index.html>

¹⁸¹ <http://www.airecentre.org/>

¹⁸² <http://www.liberty-human-rights.org.uk/index.php>

¹⁸³ Neni 36 I Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

¹⁸⁴ Neni 36 (1) I Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

¹⁸⁵ Pieter van Dijk, Fried van Hoof, Arjen van Rijn, Leo Zwaak "Theory and Practice of The European Convention on Human Rights", Intersentia, Antwerpen-Oxford, 2006, fq. 205.

¹⁸⁶ Sipas Rregullave të Gjykatës dhe KEDNJ-së, çdo palë që do të ndërhyjë si palë e tretë ndërhyrëse duhet t'i shkruajë Presidentit të dhomës për të marrë lejen për të bërë një gjë të tillë brenda 12 javëve me një koment të shkruar jo më shumë se 10 faqe. Për gjykatën, ndërhyrja e palës së tretë duhet të shërbejë për

madh organizatash¹⁸⁷ ndërhyjnë në procesin gjyqësor pranë GjEDNJ si palë të treta për çështje të ndryshme.

3.2 Organizatat e të drejtave të njeriut në Shqipëri - mbrojtje e të drejtave të individëve

Pavarësisht se Shqipëria ka rreth 15 vjet që ka ratifikuar KEDNJ-në¹⁸⁸, numri i aplikimeve në GjEDNJ me palë shtetit shqiptar mbetet i vogël. Numri i pakët i aplikimeve është rrjedhojë e sensibilizimit të pakët të qytetarëve lidhur me rolin e Gjykatës dhe të Konventës, pavarësisht kontributit disavjeçar të organizatat jofitimprurëse në këtë drejtim. Nga ana tjetër, organizatat e të drejtave të njeriut në Shqipëri kanë një përvojë të shkurtër të aplikimit të KEDNJ-së dhe tashmë ato i shohin hapësirat e përfaqësimit të çështjeve në GjEDNJ si një instrument i gjallë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

Megjithatë, rritja e numrit të aplikimeve në GjEDNJ nuk është domosdoshmërisht tregues suksesi përsa i përket sensibilizimit dhe informimit të qytetarëve. Shumë aplikimeve në GjEDNJ nuk pranohen pasi nuk respektojnë procedurën e kërkuar nga Konventa¹⁸⁹. Ky fakt është vënë në dukje edhe nga Z. Jean Paul

të qartësuar kontekstin në të cilën një politikë apo praktikë e caktuar është adoptuar nga shtetet palë kontraktuese të KEDNJ-së. Zakonisht kjo ndërhyrje bëhet në fazën e shqyrtimit të themelit të çështjes. Lidhur me rregullat e GjEDNJ mund të lexoni më shumë Rules of Court në <http://www.echr.coe.int/rdonlyres/6AC1A02E93C4E06894EF>

¹⁸⁷ Organizata aktive në GjEDNJ janë AIRE Center, ERRC, Amnesty International, Human Rights Watch, Komitetet e Helsinkit në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, Intersight në Bullgari, International Commission of Jurists, Prezenca e OSBE-se, JUSTICE¹⁸⁹, etj. Për shembull AIRE Centre është përfshirë si palë e tretë ndërhyrëse në disa çështje si: *çështja C-411/10 R (NS) v SSHD*; *çështja C-186/10 Oguz v SSHD*, *Patmalniece v SSWP*, *çështja C-83/11 Secretary of State for the Home Department v Rahman, Pellegrini, etj.*; Amnesty International ka ndërhyrë në çështjet *Soering, McCann, Akdiov, Chahal etj.*; JUSTICE ka ndërhyrë në çështjen T. kundër Mbretërisë së Bashkuar etj.

¹⁸⁸ Shqipëria e ka nënshkruar KEDNJ-në në 13.7.1995 dhe e ka ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi në 2 Tetor 1996

¹⁸⁹ Lidhur me kushtet e pranueshmërisë, shih nenin 35 të Konventës.

Costa, Presidenti i GJEDNJ-së,¹⁹⁰ sipas të cilit qytetarët nuk e njohin mirë Gjykatën dhe Konventën, rregullat e Gjykatës dhe kërkesat bazë për dërgimin e çështjes në GJEDNJ. Për të kapërcyer këtë pengesë, Costa vlerëson nevojën për të ndihmuar jo vetëm përfaqësuesit ligjor të aplikantëve, por dhe aktorët e shoqërisë civile të cilët duhet të informojnë qytetarët për kërkesat bazë të aplikimeve që prezantohen para GJEDNJ-së.

Veprimtaria informuese lidhur me GJEDNJ zhvillohet nga disa organizma dhe organizata vendase dhe te huaja mes të cilave janë Zyra e Këshillit të Evropës me seli në Tiranë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ), Shoqata për Personat me Aftësi të Kufizuar, Shërbimi Ligjor Falas, etj. Këta aktorë ofrojnë shërbime si: sensibilizimi dhe informimi i shtetasve lidhur me të drejtat për të cilat mund të dërgohet çështja në GJEDNJ; rritja e kapaciteteve të vetë sektorit si të OJF-ve kombëtare dhe lokale me qëllim identifikimin e rasteve për në GJEDNJ ashtu si dhe përfaqësimin e tyre, plotësimi i aplikimit fillestar ose të ndonjë procedure paraprake; përfaqësimi i çështjeve që nga plotësimi i aplikimit fillestar deri në dhënien e vendimit; monitorimi i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së nga vetë shteti shqiptar si përsa i përket masave individuale ashtu dhe për ato të përgjithshme; dërgimi i informacioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e vendimit drejtuar Komitetit të Ministrave të GJEDNJ-së, etj.

3.3 Përvoja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit pranë GJEDNJ-së¹⁹¹

¹⁹⁰ Seminar “*The Convention is yours*” – *Dialogue between Judges*, 2010, botim i GJEDNJ, 2011, për më shumë shih; <http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/Reports+and+Statistics/Seminar+documents/Dialogue+between+Judges/>

¹⁹¹ Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është një organizatë që ka si mision mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo është themeluar në dhjetor 1990 dhe ka 20 vjet që kryen aktivitetin e saj në mbrojtje, promovim dhe respektim të të drejtave të njeriut. Në Prill 2007, KSHH hapi Klinikën Ligjore në të cilën ofrohen një sërë shërbimesh ligjore falas, ku një prej fushave është dhe asistencë ligjore dhe përfaqësimi para Gjykatave shqiptare, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut. Më shumë informacion mund të gjeni në faqen zyrtare të KSHH: www.ahc.org.al;

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka përfaqësuar në GJEDNJ çështjen *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*¹⁹². Edhe pas përfaqësimit të kësaj çështje, KSHH vazhdon të asistojë aplikantët Lika dhe Laska në procesin e rivendosjes në vend të të drejtave të tyre. Fillimisht aplikuesit kanë aplikuar vetë në GJEDNJ (vitin 2004) më pas u asistuan nga një avokat¹⁹³ dhe KSHH.

Aplikantët janë dënuar, *inter alia*, për vjedhje me dhunë dhe pasi janë kapur nga policia, ata i janë nënshtruar një procedure jo të rregullt të “njohjes së personave”¹⁹⁴ duke u detyruar të veshin maska blu dhe të bardha njësoj si ato që u përdorën në vjedhje, ndërkohë që dy të tjerët ishin me maska të zeza. Gjithashtu, gjatë pyetjes së tyre dhe paraqitjes për njohje, avokati mbrojtës nuk ka qenë prezent. U vu re se aplikantët ishin konsideruar fajtorë dhe dënuar vetëm me provën “njohjen e personave” që ju bënë nga dëshmitarët, provë e cila është kryer në mënyrë jo të rregullt proceduralisht.

Bazuar në nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, Gjykata në mënyrë unanime i konsideroi veprimet e kryera si shkelje serioze dhe duke e konsideruar procesin e parregullt ligjor.

Vendimi u dha nga GJEDNJ në 20 prill 2010¹⁹⁵, duke konsideruar shkelje të nenit 6/1 përsa i përket procesit të padrejtë ligjor në aspektin e hetimit duke vazhduar dhe më tej i cili nuk është rregulluar gjatë procedimit gjyqësor. Në aplikim të nenit 46 të KEDNJ-së, Gjykata vërejtë në vendimin e saj, se sistemi ligjor penal i shtetit të paditur (shqiptar - shënimi i autoreve) nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedimeve të brendshme, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Gjykata nuk është e detyruar të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme

¹⁹² Për më shume informacion, shih vendimin në anglisht *Laska and Lika v. Albania* - 12315/04 and 17605/04 Judgment 20.4.2010 [Section IV]

¹⁹³ Av. Andi Dobrush, sot Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni I shoqërisë së Hapur - Soros

¹⁹⁴ Sipas Nenin 171 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, të RSH-së, miratuar me ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995 dhe ndryshimet përkatëse

¹⁹⁵ Vendimi mori formë të prerë, 20 korrik 2010

duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur¹⁹⁶.

Gjykata konsideroi se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, përfaqëson në parim mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në Rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedimeve gjyqësore në nivelin e brendshëm, duke zbuluar që masa të tilla përfaqësonin “mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit *in integrum*”. Gjithashtu kjo reflekton parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm është i detyruar të jap dëmshpërblimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte para se të kryhej akti i paligjshëm¹⁹⁷. Në aplikim të nenit 41 të KEDNJ-së, GJEDNJ dha si dëmshpërblim nga 4,800 Euro për secilin aplikant.

KSHH është duke ndjekur dhe ndërmarrë hapa për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së. Mbas marrjes fuqi të vendimit (3 muaj) pas dhënies se tij në 20 Korrik 2010 qeveria shqiptare kishte tre muaj kohë për të ekzekutuar vendimin (sipas nenit 41 dhënien e shpërblimit në të holla të dy aplikantëve. Ndërkohë që vendimi i GJEDNJ në këtë aspekt u realizua nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, datë 13 Tetor 2011¹⁹⁸.

¹⁹⁶ Shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih *Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*)

¹⁹⁷ Neni 35 i projekt neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësitë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare - shih paragrafin 35 më lart, dhe, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [GC], nr. 32772/02, §§ 85-86, GJEDNJ 2009-....

¹⁹⁸ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Për Ekzekutimin e vendimit të gjykatës

Vështirësia në rastin konkret gjendet në aplikimin e nenit 46 të KEDNJ-së, nëpërmjet të cilit kërkohet që nëpërmjet kërkuesve ose vetë shteti të rihapë ose të rigjykojë çështjen gjyqësore. Mbas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së për çështjen në fjalë, KSHH ka depozituar në Gjykatën e Lartë, kërkesën për rishikim të çështjes duke e konsideruar vendimin GJEDNJ-së si një provë të re. Kjo procedurë u pa e arsyeshme duke qenë se shteti shqiptar nuk po ekzekutonte vendimin lidhur me nenin 46 të KEDNJ-së, edhe për shkak se në K. Pr. P nuk ka hapësirë ligjore për të rihapur gjykimin në rastet kur vendoset nga GJEDNJ pasi është gjetur shkelje e procesit të rregullt ligjor.

Duke qenë se është hera e parë që GJEDNJ jep një vendim në aplikim të nenit 46, që kërkon marrjen e masave nga ana e shtetit shqiptar për të rihapur çështjen ose rigjykimin e saj, në një kohë kur mungon baza ligjore dhe nuk ka praktikë gjyqësore (vendim të Gjykatës së Lartë), KSHH në bashkëpunim me Fondacionin Soros ka ndërmarrë një iniciativë për ndërhyrje në legjislacion. Ndërhyrja në legjislacion po bëhet nëpërmjet hartimit të një projektligji të ri për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, e cila më pas do të kërkojë ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Civil.

4. Sfidat dhe përparësitë

Pavarësisht se KSHH ka paraqitur vetëm një rast pranë GJEDNJ-së, kjo organizatë është duke punuar me disa çështje të shkeljes flagrante të drejtave të njeriut të cilat janë në fazën e shterimit të mjeteve juridike në vend. Duke marrë në konsideratë eksperiencën e parë të KSHH pranë GJEDNJ-së, vihet re se shoqëria civile në Shqipëri has vështirësi në ofrimin e këtyre shërbimeve, si: vështirësi financiare dhe mungesë të burimeve njerëzore të specializuara, kohëzgjatja e madhe e procedimeve për shterimin e çështjes në

europiane për të drejtat e njeriut, datë 20.4.2010, për çështjet nr. 12315/04 dhe nr. 17605/04, "Laska dhe Lika kundër Shqipërisë", në web siten e Këshillit të Ministrave <http://www.keshilliministrave.al/?fq=brenda&m=news&lid=13854>

gjykatat vendase dhe koha e gjatë e gjykimit në GJEDNJ, qëndrueshmëria e një donatori në financimin e shërbimeve ligjore; vështirësia në identifikimin e impaktit për shkak të kohës së gjatë të shqyrtimit ose në rast të mospranimit apo mosdhënja e të drejtës nga sistemi gjyqësor; mungesa e informimit të qytetarëve për KEDNJ-në dhe GJEDNJ-në; ngritja e kapaciteteve të stafit të OJF-ve që deri tani ka kontribuar vetë sektori nëpërmjet fondeve të donatorëve, duke mos patur mbështetjen e shtetit. Krahas mangësive në burimet njerëzore dhe financiare, një pjesë e organizatave shqiptare duhet të bëjnë ndryshimet në statutin e tyre për përfaqësimin e çështjeve në gjykatë;

Duke vlerësuar rolin e organizatave të të drejtave të njeriut, një nga përparësitë për OJF shqiptare është se ato njihen nga GJEDNJ si përfaqësuese ligjore në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësisht se kanë formën e një personi juridik (në një kohë që gjykatat shqiptare nuk i njohin organizatat si persona juridikë të marrin një prokurë në emër të vetë organizatës); hapja e praktikave të reja përsa i përket jurisprudencës por dhe legjislacionit; zëri i OJF-ve dëgjohet dhe si pale e tretë ndërhyrëse duke luajtur një rol tepër të rëndësishëm në procesin e rivendosjes në vend të të drejtave të njeriut; shpenzimet paraprake që duhen bërë për dërgimin e një aplikimi pranë GJEDNJ-së janë shumë modeste; OJF-të mund të rimbursohen nga GJEDNJ përsa i përket shpenzimeve që kryejnë për përfaqësimin e çështjes si dhe për shërbimin që ato i kanë ofruar klientit nëpërmjet kërkesës së aplikantit për ndihmë ligjore; ndihma ligjore nuk jepet për kërkesat të cilat sapo kanë filluar procedurat në GJEDNJ, por ju jepet pasi çështja i është komunikuar qeverisë shqiptare; jepet një tarifë për shërbimet e mbrojtjes sipas fazave¹⁹⁹ dhe jepet për shpenzime fax, fotokopje, postë si dhe në rast se do të ketë ndonjë seancë dëgjimore shpenzimet për këtë proces.

¹⁹⁹ Në një vlerë të përafert rimbursimi është 1200 euro për të gjitha fazat

5. Konkluzione dhe rekomandime

Roli i organizatave Shqiptare është shumë i rëndësishëm në dhënien e informacionit dhe sensibilizimit të qytetarëve dhe të vetë organizatave lidhur me mekanizmat mbrojtës si Konventa dhe në procedurat që ndiqen pranë GJEDNJ-së. Për këtë arsye do të ishte e nevojshme një mbështetje më e madhe nga strukturat e shtetit shqiptar ashtu dhe nga donatorë të huaj. Njëkohësisht është e nevojshme rritja profesionale dhe trajnimi i stafeve të organizatave të cilët do të asistojnë aplikantët të drejtohen pranë GJEDNJ-së.

Për shkak të një numri të pakët të çështjeve pranë GJEDNJ-së nga aplikantët shqiptarë, i lind për detyrë organizatave jo vetëm të dërgojnë sa më shumë çështje pranë këtij institucioni, por njëkohësisht duhet të tregohen të kujdesshme në plotësimin e kërkesave të pranueshmërisë në bazë të nenit 35 të KEDNJ-së.

Organizatave shqiptare duhet të rrisin bashkëpunimin midis tyre për dërgimin e çështjeve në GjEDNj dhe të shkëmbejnë eksperiencë me organizatat në vende të tjera që kanë eksperiencë në ndërhyrjet si palë e tretë dhe në përfaqësimin e çështjeve pranë GjEDNj.

Me qëllim që të drejtat e shkelura të rivendosohen, organizatat shqiptare duhet të monitorojnë qeverinë shqiptare në ekzekutimin e vendimeve të GjEDNj-së, jo vetëm të masave individuale me karakter financiar, por edhe ekzekutimin e masave të përgjithshme duke pasur bashkëpunim me organet mbikëqyrëse të vendimeve të GjEDNj-së pranë Këshillit të Evropës.

BIBLIOGRAFIA

Konventa Europiane e të drejtave të njeriut, botim i Këshillit të Evropës, dhe protokollet e saj Nr.11 dhe 14.

Erik Denters dhe Wino J.M. van Veen, "Voluntary Organizations in Europe: The European Convention on Human Rights", International Journal Not - for - Profit Law, Volumi 1, Dhjetor 1998.

Donna Gomein, Udhëzues i Shkurtër i Konventës Europiane për

të Drejtat e Njeriut, Botim i Këshillit të Evropës, 2005, fq. 168

Pieter van Dijk, Fried van Hoof, Arjen van Rijn, Leo Zwaak "Theory and Practice of The European Convention on Human Rights", Intersentia, Antwerpen-Oxford, 2006

Loveday Hodson, "NGOs and the Struggle for Human Rights in Europe", HART Publishing, 2011

Seminar "The Convention is yours" - Dialogue between Judges, 2010, botim I GJEDNJ-sw, 2011, botuar në <http://www.echr.coe.int>

Kodi i Procedurës Penale, të RSH-së, miratuar me ligjin Nr. 7905, datw 21.03.1995 dhe ndryshimet përkatëse

Vendimi i Këshillit të Ministrave Për Ekzekutimin e vendimit të gjykatës europiane për të drejtat e njeriut, datë 20.4.2010, për çështjet nr. 12315/04 dhe nr. 17605/04, "laska dhe lika kundër shqipërisë"

Faqe interneti

Web site i Intersight Center; www.interights.org

Web site i Aire Center: www.airecentre.org

Web site i Liberty; www.liberty-human-rights.org.uk.

Faqja e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut : www.echr.coe.int

Web site i Komitetit Shqiptar të Helsinkit: www.ahc.org.al
Strategjia e KSHH-së 2011 - 2013.

Dr. Oriona MUÇOLLARI
Dr. Mirela BOGDANI
Dr. Jola XHAFO²⁰⁰

ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE SI KATEGORI E MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Përpunimi i Deklaratës për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut filloi në vitin 1984 dhe përfundoi me miratimin e tekstit nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1998, me rastin e 50 vjetorit të përvjetorit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Një mbështetje kolektive nga një numër organizatash jo qeveritare të të drejtave të njeriut dhe disa delegacione shtetesh ndihmuan duke u siguruar që rezultati final të ishte një tekst i fuqishëm, shumë i përdorshëm dhe konkret. Ndoshta pjesa më e rëndësishme e këtij dokumenti është fakti që ai nuk i drejtohet jo vetëm shteteve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut por çdo njeriu²⁰¹. Ky dokument na tregon se secili prej nesh ka një rol për të përmbushur si mbrojtës i të drejtave të njeriut dhe nënvizon që ekziston një lëvizje globale për të drejtat e njeriut që na përfshin të tërëve²⁰². Emri i plotë i Deklaratës është: “Deklarata mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë Individë, Grupeve dhe Organeve të Shoqërisë për të promovuar/ rritur njohjen e mbrojtjes universale të të drejtave dhe lirive themelore

²⁰⁰ Autoret janë pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë, UT

²⁰¹ Sekaggya M., Report of the Special Rapporteur on the situation of human rights defenders, General Assembly, United Nations, 30 December, 2009.

²⁰² <http://www2.ohchr.org/english/issues/defenders/declaration.htm>

të njeriut” i cili më pas shkurtimisht përdoret me këtë emër të shkurtuar: “Deklarata mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut”.

Karakter i ligjor i Deklaratës²⁰³. Deklarata në vetvete nuk është ligjërisht e detyrueshme. Megjithatë ajo përmban një numër parimesh dhe të drejtash që bazohen në standardet ndërkombëtare të njohura nga instrumente të tjerë ndërkombëtarë që janë ligjërisht të detyrueshëm – si Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat Civile dhe Politike. Për më tepër Deklarata u miratua me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme dhe kjo nënkupton përkushtim nga shtetet pjesëmarrëse për zbatimin e saj. Së fundmi, shtetet janë duke konsideruar idenë e Deklaratës si pjesë e detyrueshme e sistemit të tyre ligjor kombëtar. Deklarata nuk krijon të drejta të reja por thekson dhe sqaron më në detaje të drejtat ekzistuese duke qenë kështu një mbështetje për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në praktikë. Deklarata parashikon detyra jo vetëm për shtetet por edhe për secilin individ në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

“Mbrojtësit e të drejtave të njeriut” është një term i përdorur për të përkufizuar njerëz, që individualisht ose me të tjerë, veprojnë për të reklamuar dhe nxitur mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut identifikohen mbi të gjitha nga veprimet e tyre dhe nëpërmjet përshkrimit të disa prej veprimeve të tyre si dhe përmbajtja e asaj që ata bëjnë.

Shembujt që mund të japim duke u përpjekur të përkufizojmë aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut nuk mund të përbëjnë një listë me aktivitete ose detyra të përcaktuara.

Kjo listë është gjithmonë në ndryshim.

Në këtë kategori përfshihen:

- Gazetarët që paraqesin dhunimet e të drejtave të njeriut;
- Punonjësit social dhe mësuesit e të drejtave të njeriut;
- Sindikatat që mbrojnë të drejtat e punëmarrësve;

²⁰³ Brenda BE nuk ka një mekanizëm mbrojtës në mbrojtje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

- Gratë që punojnë në fushën e shëndetit riprodhues;
- Ambientalistët që nënvizojnë ndikimin e projekteve të zhvillimit tek njerëzit dhe toka.

Në këtë punim do të përpiqemi të trajtojmë pikërisht disa nga grupimet e mësipërme, pasi jemi të ndërgjegjshëm që aktiviteti i mbrojtësve të të drejtave të njeriut është dhe po bëhet gjithnjë e më shumë i rrezikshëm, dhe vetëm kur ata organizohen në organizata janë më të pavarur dhe të mbrojtur për të treguar realitetin, larg presioneve të subjekteve të ndryshme shtetërore ose private²⁰⁴.

Të flasësh për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është një përpjekje e gjatë dhe e pafund. Ka një mori aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe standarde në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Por vitet e fundit në përpjekjet për të vënë në vend të drejtat e shkelura, ka dalë në pah një kategori subjektsh/individësh të cilët gjatë rrugës së tyre në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si pjesë e punës së tyre ose si aktivitet i lirë kanë vënë jetën e tyre dhe të familjarëve në rrezik.

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë individë, grupe apo organizata që nxisin mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpërmjet rrugëve paqësore dhe jo nëpërmjet dhunës. Ata:

- zbulojnë dhunimet/cenimet/shkeljet;
- fuqizojnë individët dhe komunitetin të kërkojnë të drejtat bazike si qenie njerëzore;
- raportojnë dhunimet/cenimet/shkeljet në kërkimet apo studimet që bëhen të njohura për publikun;
- nxisin/shtyjnë përgjegjësit për të qenë mbështetës.

Pengesat²⁰⁵. Për shkak të punës që kryejnë, mbrojtësit e të drejtave të njeriut përballen me shumë sfida. Në shumë vende ata janë:

- subjekte ndaj vrasjeve apo torturave;
- të persekutuar nga përdorimi i sistemit gjyqësor;

²⁰⁴ Deri në atë masë që është e mundur.

²⁰⁵ <http://www.amnesty.org/en/human-rights-defenders/resources/financial-resources>

- të injoruar nga ligje shtrënguese;
- të zhdukur apo të humbur.

Cili është aktiviteti i mbrojtësve të të drejtave të njeriut:

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut kanë për qëllim të nxisin mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike dhe realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Mbrojtësi i të drejtave të njeriut merret me çështje të ndryshme si tortura, arrestime dhe burgime arbitrare, çështje gjentiale të gjinisë femërore, diskriminim, çështje punësimi, çështje të kujdesit shëndetësor, si dhe toksikime si rezultat i ndotjes së ambientit. Gjithashtu mbrojtësit janë aktiv në mbështetjen e të drejtave të njeriut si e drejta e jetës, e drejta për ushqim dhe ujë në nivelet më të larta të standardeve shëndetësore, e drejta për strehim të përshtatshëm, e drejta për emër dhe kombësi, e drejta për edukim, për lirinë e lëvizjes, etj. Ata shpesh herë i adresojnë këto të drejta sipas kategorive, për shembull, të drejtat e grave, të fëmijëve, të pakicave kombëtare, të refugjatëve.

Për rastin e Shqipërisë, një nga subjektet më të rëndësishëm në mbrojtje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut është Avokati i Popullit. Veprimtaria e këtij institucioni ka ndihmuar në vënien në vend të të drejtave të shkelura të individëve.

Në mënyrë që kjo Deklaratë të merret në konsideratë seriozisht nga shtetet për t'u zbatuar, ashtu si edhe instrumentat e tjerë ndërkombëtarë të këtij formati, zbatueshmëria e Deklaratës shoqërohet nga raportimet periodike para Asamblesë së Përgjithshme, në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut nga shtetet pjesëmarrëse.

Në raportimin e vitit 2010, përqendrimi kishte qënë më i madh rreth sigurisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe masave të ndryshme mbrojtëse që ishin marrë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të siguruar sigurinë e tyre fizike. Duhet pranuar që pas gati 11 vjetësh, që kjo Deklaratë është vënë në zbatim, ka pasur ndryshime dhe përmirësime në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por nga ana tjetër duhet pranuar që pasiguria mbetet dhe mbrojtësit janë akoma në rrezik²⁰⁶. Për fat të keq, akoma sot,

mbrojtësit kërcënohen, arrestohen, ngacmohen për shkak të punës së tyre nga subjektet që përmendëm më sipër. Raportimi i mësipërm shërben pikërisht për të dhënë rastet e mira dhe ato negative në lidhje me sigurinë dhe trajtimin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Ajo çka rezulton si përfundim është përgjegjësia e shteteve edhe kur shkeljet, kërcënimet, ngacmimet ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut janë kryer nga subjekte të tjera private, jo shtetërore. Shtetet duhet të organizojnë programe të ndryshme që marrin përsipër mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ekzistenca e ndihmës së shteteve ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut, do të stimulojë dhe sigurojë më shumë mbrojtësit për të çuar përpara punën e tyre. Ky detyrim i shteteve është i përcaktuar në vetë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës mbrojtja e të drejtave të njeriut ka efektin e saj horizontal dhe vertikal.

Megjithatë, edhe pse nuk ka një mbrojtje specifike nga BE për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, siç përmendëm edhe më sipër, ekziston një Strategji²⁰⁷ e BE në lidhje me ndihmesën që mund t'i jepen mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Në këtë ndihmesë mund të përfshijmë:

- Takime të ambasadorëve me organizatat jo fitimprurëse si mbrojtëse të të drejtave të njeriut;
- Mirënjohje konkrete dhe të dukshme për punën e organizatave të ndryshme;
- Marrja pjesë në gjykime kundër organizatave jo fitimprurëse;
- Vizita në burg për mbrojtësit e të drejtave të njeriut;
- Dhënia e vizave emergjente;
- Ndihmesa në krijimin e strategjive lokale;
- Promovimi i mekanizmave mbrojtës.

Mbështetja financiare. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut si kur punojnë individualisht, edhe kur punojnë në emër të një organizate që mbron të drejtat e njeriut, aktivitetet e tyre në mbështetje dhe nxitje të të drejtave të njeriut kërkojnë pa diskutim

²⁰⁶ Report of the Special Rapporteur on the situation of humanrights defenders, Margaret Sekaggya, Distr.: General, 4 August 2010

²⁰⁷ EU Guidelines on Human Rights Defenders

mbështetje të vazhdueshme financiare. Në këto aktivitete mund të përfshijmë:

- Organizim protestash;
- Publikime materialesh;
- Udhëtime për mbledhje informacioni mbi dhunimet/cenimet e të drejtave të njeriut;
- Pritje dhe/ose takime me viktimat apo përfaqësues shtetesh;
- Paisja me materiale komunikimi;
- Ndihma me ndihmesë ligjore ndaj viktimave të abuzuar.
- Etj..

Mbështetjet nga mund të vijnë këto burime përfshijnë:

- Individët;
- Organizatat kombëtare ose jo ndërkombëtare jo qeveritare;
- Organizatat ndërkombëtare qeveritare (BE);
- Organizatat ndërkontinentale për fonde zhvillimi²⁰⁸.

Fondet mund të jenë afat shkurtër, p.sh. për të ndihmuar një mbrojtës të të drejtave të njeriut në rrezik; ose afat gjatë p.sh. për të ndihmuar një organizatë jo qeveritare për të mbajtur, zhvilluar ose gjeruar aktivitetin e saj.

KONKLUZIONE

Kategoria për të cilën folëm në këtë punim, ajo e Mbrojtësve të të drejtave të njeriut, më konkretisht Organizatat jo fitimprurëse, është një kategori e re në mbrojtje, por jo e re në aktivitetet e saj. Organizatat jo fitimprurëse prej kohësh janë nismëtare në shumë aktivitete në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por shumë më vonë u ndie e nevojshme puna dhe aktiviteti i tyre dhe akoma më vonë, u vu re nevoja për marrjen në mbrojtje gjatë realizimit të aktivitetit të tyre.

Kuptohet që detyra kryesore i mbetet shteteve. Është shteti ai që duhet të marrë masa për të ngritur infrastrukturën e nevojshme në mbrojtje të aktiviteteve të ndryshme të organizatave jofitimprurëse e sidomos kur jeta e tyre vihet në rrezik për shkak të

²⁰⁸ <http://www.amnesty.org/en/human-rights-defenders/resources/financial-resources>

këtij aktiviteti si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga subjektet private.

Edhe nga Raportimet e përmendura në këtë punim, rezulton se puna dhe aktiviteti i organizatave jo fitimprurëse akoma është e pambrojtur dhe nuk merret seriozisht në konsideratë. Mbetet detyrë e shteteve të krijojnë strategji kombëtare në mbrojtje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe një zë i veçantë në krijimin e këtyre strategjive duhet të jenë edhe organizatat jofitimprurëse.

BIBLIOGRAFIA

· Sekaggya M., Report of the Special Rapporteur on the situation of human rights defenders, General Assembly, United Nations, 30 December, 2009.

· Sekaggya M., Report of the Special Rapporteur on the situation of human rights defenders, General Assembly, United Nations, 4 August 2010.

· EU Guidelines on Human Rights Defenders.

· <http://www.amnesty.org/en/human-rights-defenders/resources/financial-resources>

· <http://www2.ohchr.org/english/issues/defenders/declaration.htm>

Monika Kocaqi (Ma)²⁰⁹

**PARIMET E EFEKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT TË
SHOQËRISË CIVILE, SI KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR
ARRITJEN DHE RESPEKTIMIN E DREJTËSISË DHE TË
TË DREJTAVE NJERËZORE**

Diskutimi mbi “efiçencën” apo “efektivitetin” e Organizatave të Shoqërisë Civile, rolin që luajnë, mund apo duhet të luajnë këto organizata, si edhe përmirësimet që kanë sjellë sidomos në drejtim të arritjes dhe respektimit të drejtësisë dhe të të drejtave njerëzore, mund të konsiderohet aq i lashtë sa edhe vetë themelimi i këtij sektori. Ndër vite (dhe jo vetëm në Shqipëri) janë ngritur dhe debatuar herë pas here çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me mënyrën e funksionimit të Organizatave të Shoqërisë Civile, mënyrën e përthithjes dhe menaxhimit të burimeve nga këto organizata, e mbi të gjitha mënyrën e përdorimit të këtyre burimeve krahasuar me produktet e realizuara dhe ndikimin e drejtpërdrejtë, të menjëhershëm e afatgjatë, në komunitetet apo grupet e synuara prej tyre. Jo në pak raste, mënyra se si është ndërtuar ky lloj debati ka tingëlluar më tepër si lakim i fjalëve “Efektivitet”, “Zhvillim produktiv”, “Rezultate të matshme”, e të tjera, shoqëruar kjo më pas me qëndrime tepër kritike, hera herës edhe abuzuese, në drejtim të punës së këtyre organizatave, por duket se procesi shkëputet pikërisht këtu. Ndonëse logjikisht analiza e punës së Organizatave të Shoqërisë Civile duhet të ndiqet nga një tërësi hapash të tjerë argumentues dhe përmirësues të rolit

²⁰⁹ Drejtoreshë Ekzekutive, Shoqata “Refleksione”, Tiranë.

që luajnë dhe duhet të luajnë këto organizata, në Shqipëri ka vite tashmë që nuk ndërmerren veprime konkrete, përveç reagimeve sporadike, deri diku vetëmbrojtëse, si edhe fillesave të ndonjë “plani pune të përbashkët” i cili zbehet me kalimin e kohës. Pjesa më e madhe e diskutimit përqendrohet rreth mjedisit lehtësues/favorizues në të cilin duhet të punojnë Organizatat e Shoqërisë Civile dhe mungesës së këtij mjedisi në Shqipëri për një tërësi arsyesh, por ky diskutim merr trajtën e një fenomeni “thjesht shqiptar” dhe shkëputet nga procesi mbarë botëror që po ndiqet nga Organizatat e Shoqërisë Civile në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, puna e shkëlqyer e Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri në drejtim të mbrojtjes së të drejtave apo ofrimit të një tërësie shërbimesh konkrete grupeve të ndryshme në nevojë, është një fakt i pamohueshëm dhe i pranuar edhe nga shteti. Organizimi i tryezave të përbashkëta e të herëpashershme, si edhe shkëmbimi i ekspertizës në këtë drejtim, e provon më së miri këtë fakt.

Megjithatë, sa aktive, të vendosura e të bashkuara i shohim organizatat kur bëhet fjalë për lobimin dhe përmirësimin e statusit të grupeve të caktuara në shoqëri, aq edhe të ndara apo deri diku indiferente bëhen këto organizata, për të diskutuar dhe lobuar për përmirësimin e mjedisit në të cilin duhet të funksionojnë. Për më tepër, duket se procesi i ndërmarrë nga Organizatat e Shoqërisë Civile globalisht në këtë drejtim, tingëllon tepër i largët për Shqipërinë. Ndonëse edhe vetëm pak muaj na ndajnë nga organizimi i Forumit të Katërt të Nivelit të Lartë (HLF4) i cili do të mbahet në Busan, Kore, në fund të këtij viti, dialogimi mes organizatave dhe përfaqësuesve të shtetit shqiptar në këtë forum, duket se nuk ka ndërmend të fillojë...

Dialogimi për parimet dhe standardet e funksionimit të Organizatave të Shoqërisë Civile, përfshirë këtu edhe veprimtarinë financiare të tyre, është domosdoshmëri. Diskutimi dhe negociimi për krijimin e kushteve favorizuese në funksion të organizatave, është parakusht për vendosjen e standardeve të nevojshme dhe

matjen e efektivitetit të shërbimeve të ofruara. Ndërkohë që krijimi i barrierave në komunikim përta i takon qartësisht të këtyre kushteve, si dhe vendosja e kërkesave shpesh tërësisht të pabazuara e në kundërshtim me legjislacionin bazë të funksionimit të organizatave, çojnë në përkeqësim të marrëdhënieve, si dhe në mospërdorimin me kapacitet të plotë të burimeve në dispozicion. E gjithë kjo marrëdhënie duhet bazuar tashmë edhe në veprimet globale të ndërmarra për këtë qëllim.

Shqetësimi për mjedisin në të cilin funksionojnë Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe për krijimin e mundësive që ato të realizojnë potencialin e tyre të plotë, është një shqetësim global. Ka vite tashmë që dialogu në këtë drejtim ka kaluar nga parimet e ofrimit të ndihmës efektive, drejt parimeve të nxitjes së zhvillimit efektiv. Globalisht Organizatat e Shoqërisë Civile i kanë pranuar përgjegjësitë e tyre për të marrë masa dhe drejtuar një proces, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të tyre si aktorë zhvillimi. Roli i rëndësishëm që luajnë Organizatat e Shoqërisë Civile në bashkëpunimet ndërkombëtare, ndihmën dhe zhvillimin, ka kohë tashmë që është njohur, por ende nuk është formuluar dhe pranuar qartë, në të gjitha diskutimet dhe proceset ndërkombëtare. Për këtë arsye, organizatat në mbarë botën janë bashkuar në veprime të përbashkëta me qëllim që të arrijnë të ndërtojnë një konsensus mbi parimet e pranuar bashkërisht, për përmirësimin e zhvillimit të tyre me efikasitet, si dhe mbi një minimum standardesh për një mjedis të përshtatshëm/aftësues/mundësues, në të cilin ato të mund të aplikojnë tërësisht dhe fuqizojnë rolet e tyre specifike për zhvillim.

Dekadën e kaluar²¹⁰, nën një seri samitesh ndërkombëtare, Forumesh të Nivelit të Lartë dhe mbledhjesh të shumta, donatorët, qeveritë dhe aktorët e tjerë të zhvillimit, përfshirë këtu edhe Organizatat e Shoqërisë Civile, kanë diskutuar për ri-modelimin e arkitekturës globale për ndihmën ndërkombëtare, për reformimin

²¹⁰ Open Forum for Effectiveness Development of Civil Society Organizations, "Toolkit for CSO Effectiveness Development", www.cso-effectiveness.org, vizituar për herë të fundit në Qershor 2011.

e praktikave të ndihmës, si dhe për t'i dhënë fokus bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim. Arkitektura e ndihmës përbëhet nga aktorë kyçë, duke përfshirë këtu qeveritë (Veriore dhe Jugore), donatorët bilateralë dhe multilateralë, Komisionin Evropian, Institucionet Ndërkombëtare për Financim (të tilla si Banka Botërore dhe Fondi Ndërkombëtar Monetar), organizatat ndërkombëtare (të tilla si DAC dhe OECD), fonde të specializuara (p.sh Fondi Global kundër AIDS, Tuberkulozit dhe Malariae), fondacione private, si dhe organizata të shoqërisë civile mbarëbotërore. Termi "Arkitekturë" i referohet gjithashtu kanaleve, procedurave dhe mekanizmit të shpërndarjes së ndihmës, që nënkupton, termat dhe mënyrat në të cilat burimet e ndihmës transferohen nga donatorët tek marrësit. Organizatat e Shoqërisë Civile luajnë një rol shumë të rëndësishëm në arkitekturën e ndihmës ndërkombëtare, si aktorë në zhvillimin ndërkombëtar, si marrës të ndihmës për aktivitete për zhvillim, por edhe në disa rrethana si donatorë.

Ndihma efektive mund të përcaktohet si hapësira në të cilën burimet e ndihmës kanë sukses në arritjen e rezultateve të qëndrueshme të zhvillimit për njerëzit e varfër. Ndonëse theksi i donatorëve dhe qeverive ka qenë kryesisht në çështje të shpërndarjes dhe menaxhimit të ndihmës, organizatat e shoqërisë civile argumentojnë se duhet adoptuar një qëndrim më holistik në përcaktimin e ndihmës efektive. Ky drejtim mund të theksojë më tepër ndikimin dhe impaktin për të drejtat e të varfërve dhe grupeve të marginalizuara. Organizatat e shoqërisë civile synojnë të thellojnë dhe zgjerojnë reformat për ndihmën efektive si dhe priren ta orientojnë debatin drejt zhvillimit efektiv.

Në mars të vitit 2005, në Forumin e Dytë të Nivelit të Lartë të organizuar në Paris, u hartua edhe një dokument i quajtur Deklarata e Parisit mbi Ndihmën Efektive, e cila shërbeu si një pikë referimi për të arritur një marrëveshje mes donatorëve dhe qeverive marrëse, përsa iu takon pesë parimeve dhe angazhimeve përbashkëta për të përmirësuar ndihmën efektive. Deklarata e Parisit i vendosi këto parime si për donatorët edhe për veprimet e

shteteve marrëse, për një periudhë pesë vjeçare (2005 - 2010). Qëllimi kryesor është reformimi i shpërndarjes dhe menaxhimit të ndihmës, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të saj. Reformat synojnë “të rrisin impaktin e ndihmës [...] në reduktimin e varfërisë dhe pabarazive, nxitjen e zhvillimit, ndërtimin e kapaciteteve dhe përshpejtimin e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit”²¹¹. Nënshkruesit e Deklaratës së Parisit janë qeveritë e 141 vendeve të zhvilluara e në zhvillim, Komisioni Evropian dhe 27 organizata ndërkombëtare. Ndonëse shumë organizata të shoqërisë civile pranojnë rëndësinë e parimeve si dhe nevojën për reformim të praktikave zyrtare për ndihmën e donatorëve dhe qeverive marrëse, vetë organizatat nuk janë pjesë e nënshkrimit të kësaj Deklarate dhe nuk ishin zyrtarisht pjesë e procesit që çoi në formulimin e saj. Prandaj edhe parimet dhe reformat e cituara nuk mund të gjejnë zbatim mbi Organizatat e Shoqërisë Civile. Jo vetëm kaq, por Deklarata e Parisit, e kuadron ndihmën efektive nga perspektiva e donatorëve, marrësve dhe kanaleve të burimeve ndërkombëtare të ndihmës. Ndërkohë, Organizatat e Shoqërisë Civile argumentojnë se vendi i tyre në arkitekturën e ndihmës nuk vjen aq shumë nga roli i tyre si donatorë apo marrës të ndihmës, por nga një tërësi rolesh socio-ekonomike në zhvillim, të gjitha të bazuara në përcaktimin e atributit të solidaritetit social. Këto radhiten që nga mobilizimi i komuniteteve në nevojë për monitorimin e praktikave dhe politikave të qeverisë; nga shpërndarja e shërbimeve dhe programeve për edukimin e publikut; si dhe nga ndihma në përcaktimin e vlerave sociale të solidaritetit dhe drejtësisë sociale. Përveç mos reflektimit të këtyre roleve, Deklarata e Parisit fokusohet në shpërndarjen dhe menaxhimin e ndihmës, për të cilën Organizatat e Shoqërisë Civile besojnë se nuk është matja e efektivitetit të tyre. Në krahasim me donatorët zyrtarë dhe qeveritë, fokusi i të cilëve në Deklaratën e Parisit ishte gjerësisht në shpërndarjen efiçente të ndihmës (ndihma efektive), organizatat

²¹¹ Deklarata e Parisit, e vlefshme on-line në adresën www.oecd.org/dac/effectiveness, vizituar për herë të fundit në Qershor 2011.

e shoqërisë civile kërkojnë ta vlerësojnë efektivitetin e tyre nëpërmjet marrëdhënieve të tyre, si dhe impakteve në të drejtat dhe mënyrën e jetesës së grupeve të varfra e marginalizuara (zhvillimi efektiv). Parimet për zhvillimin efektiv të organizatave përfshijnë por nuk janë të limituara në: standardet dhe detyrimet për të drejtat e njeriut; përgjegjshmëria ndaj njerëzve dhe përgjegjshmëri e përbashkët kur punohet në partneritet; drejtësi, besim dhe vizion i përbashkët në partneritet; drejtësi gjimore; transparencë; drejtësi sociale dhe solidaritet; fuqizim; diversitet dhe pavarësi; administrim; si dhe të mësuarit e ndarja e eksperiencave.

Roli dhe rëndësia e këtyre organizatave si aktorë zhvillimi është njohur dhe pranuar si i drejtë nga donatorët dhe qeveritë vetëm në vitin 2008 në Forumin e Nivelit të Lartë të Accra²¹². Këtu Organizatat e Shoqërisë Civile përcaktohen si donatorë të rëndësishëm, kanale dhe marrës të ndihmës. Axhenda për Veprim e Accra-s (AAA)²¹³ është dokumenti që rezultoi nga ky Forum, i cili u mbajt në Accra, Ganë në shtator 2008. Qëllimi kryesor i këtij Forumi ishte të vlerësohej progresi mbi angazhimet dhe synimet e ndërmarra në Deklaratën e Parisit. Gjithsesi, AAA shkoi përtej Deklaratës së Parisit përmes prezantimit të çështjeve të reja në debatin për ndihmën efektive, të tilla si hapësira demokratike, ndarja e punës, Jugu/bashkëpunimi me Jugun, apo Organizatat e Shoqërisë Civile si aktorë zhvillimi dhe kushtëzimi. AAA²¹⁴ u negociua mes donatorëve, organizatave

²¹² Axhenda për Veprim e Accra (AAA), paragrafi 20, në të cilin donatorët dhe qeveritë iu referohen organizatave të shoqërisë civile si “aktorë zhvillimi me të drejtë, përpjekjet e të cilëve në këtë drejtim plotësojnë ato të qeverisë dhe sektorit privat”

²¹³ Axhenda për Veprim e Accra (AAA), e vlefshme on-line në adresën www.accahlf.net, vizituar për herë të fundit në Qershor 2011.

²¹⁴ Neni 20 i AAA është piketa kryesore e arritjes për njohjen e rolit dhe zërit të OSHC-ve si aktorë zhvillimi: “Ne [donatorët dhe qeveritë zyrtare] do të thellojmë bashkëpunimin tonë me OSHC-të si aktorë të pavarur të zhvillimit, duke respektuar të drejtën e tyre të plotë që përpjekjet e tyre të plotësojnë ato të qeverive dhe sektorit privat. Ne ndajmë interes të përbashkët për të siguruar që kontributi i OSHC-ve për zhvillim të përfshijë potencialin e plotë të tyre. Për këtë qëllim:

a. Ne ftojmë OSHC-të të reflektojnë se si mundet që t’i zbatojnë ato parimet e DP mbi efektivitetin e ndihmës, nga perspektiva e OSHC-ve;

multilaterale dhe qeverive marrëse. Në ndryshim nga Forumi i Dytë i Nivelit të Lartë në Paris, në këtë Forum të Tretë, Organizatat e Shoqërisë Civile luajtën një rol të rëndësishëm në avokimin për të thelluar programin mbi ndihmën efektive, si dhe u lejua pjesëmarrja e plotë në këtë Forum e 80 organizatave. Këto organizata të deleguara në Forum u udhëhoqën nga një "Forum i Organizatave të Shoqërisë Civile" që u zhvillua paralelisht, me pjesëmarrjen e më shumë se 600 organizatave.

Në vijim të Forumit të Tretë të Nivelit të Lartë, fokusi për dialogun ndërkombëtar për efektivitetin ka filluar të zhvendoset nga ndihma efektive në zhvillimin efektiv. Organizatat e shoqërisë civile argumentojnë se zhvillimi efektiv kërkon shumë më tepër sesa "vetëm" ndihmë institucionale efektive. Bazuar në kornizën e të drejtave të njeriut, këto organizata argumentojnë se zhvillimi efektiv ka të bëjë me impaktin e veprimeve të aktorëve të zhvillimit, duke përfshirë donatorët dhe qeveritë, në përmirësimin e jetës së të varfërve dhe të margjinalizuarve. Ai nxit zhvillimin pozitiv dhe të qëndrueshëm që adreson, nën një kornizë demokratike, rrënjët dhe simptomat e varfërisë, pabarazisë dhe margjinalizimit.

Koncepti i zhvillimit efektiv thekson nevojën për diversitet dhe instrumente, politika apo aktorë që plotësojnë njëri-tjetrin, për të arritur impaktin e zhvillimit në të mirë të të varfërve dhe të margjinalizuarve. Qëllimet e zhvillimit efektiv qëndrëzohen në realizimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Vëmendje e veçantë iu jepet të drejtave të grave, të drejtave të popullsisë indigjene, si dhe të drejtës për zhvillim për vendet në zhvillim. Arritja e zhvillimit efektiv dhe impakteve të qëndrueshme duhet të jenë shqetësimi kryesor i të gjithë

b. Ne mirëpresim propozimet e OSHC-ve për t'u angazhuar me to në një proces shumë-aktorësh të drejtuar nga OSHC-të, për të nxitur efektivitetin e zhvillimit të OSHC-ve. Si pjesë e këtij procesi ne do të kërkojmë: i) të përmirësohet koordinimi i përpjekjeve të OSHC-ve me programet e qeverive; ii) të zgjerohet përgjegjshmëria e OSHC-ve për rezultatet; iii) të përmirësohet informacioni mbi aktivitetet e OSHC-ve.

c. Ne do të punojmë me OSHC-të për të arritur një mjedis lehtësues/mundësues që do të maksimizojë kontributin e tyre për zhvillim."

aktorëve të zhvillimit – donatorëve, qeverive, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe komuniteteve.

Zhvillimi efektiv është një kornizë holistike që duhet të ndikojë në të gjitha aspektet e marrëdhënieve për zhvillim të Organizatave të Shoqërisë Civile, si dhe mënyrave për të punuar me partnerët dhe përfituesit e tyre, duke u nisur nga identiteti i tyre si organizata, nga etika, vizioni dhe mandati i tyre, që nga mënyra e përcaktimit të punës dhe veprimit në terren e deri tek mënyra se si janë të lidhura e sa të përgjegjshme janë përkundrejt zgjedhësve të tyre (apo grupeve ku fokusohen). Zhvillimi efektiv nuk ndikohet vetëm nga çështje të brendshme të organizatave por gjithashtu edhe nga politikat apo praktikat e aktorëve të tjerë të zhvillimit, për shembull nga termat dhe kushtet e mbështetjes së donatorëve, si edhe nga kuadri ligjor nën të cilin këto organizata duhet të veprojnë, i përcaktuar ky nga donatorët dhe qeveritë e vendeve marrëse (mjedisi lehtësues/mundësues). Një numër organizatash apo rrjetesh të këtyre organizatave të sektorit për zhvillimin njerëzor, kanë hartuar dhe po zbatojnë mekanizma dhe parime specifike të lidhura me aspekte të ndryshme të zhvillimit efektiv, të tilla si përgjegjshmëria dhe partneriteti i barabartë.

Në vitin 2009, organizatat e shoqërisë civile mundësuan pjesëmarrjen e plotë në anëtarësinë e Grupit të Punës për Zhvillimin Efektiv, i cili do të përcaktojë çështjet dhe axhendën e Forumit të Nivelit të Lartë të Busan-it. Forumi i Hapur për Zhvillimin Efektiv të Organizatave të Shoqërisë Civile, është një proces që ka mbledhur së bashku organizata si dhe aktorë të tjerë të zhvillimit, duke përfshirë edhe qeveri dhe donatorë, në konsultime dhe dialogë mes shumë përfituesish, të gjitha këto në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, për një periudhë kohore nga mesi i vitit 2009 deri në mes të vitit 2011. Përmes këtij Forumi Organizatat e Shoqërisë Civile arritën të bien në konsensus mbi një kuadër të pranuar bashkërisht për përmirësimin e zhvillimit efektiv të tyre. Ky kuadër bazohet në vetë vizionet, drejtimet, marrëdhëniet, realitetin institucional dhe impaktin e veprimeve të organizatave. Ai reflekton

siç duhet rolet dhe përgjegjësitë e Organizatave të Shoqërisë Civile si aktorë zhvillimi. Forumi i Hapur mundësoi gjithashtu një hapësirë për organizatat me qëllim që të nxjerrin mësim nga shkëmbimi i praktikave të mira mbi përpjekjet ekzistuese për zgjerimin e impaktit të veprimeve të tyre. Forumi i Hapur lehtësoi dialogun mes donatorëve dhe qeverive zyrtare, për të ndërtuar të kuptuarit dhe mbështetjen për kushtet e nevojshme për të pasur një mjedis lehtësues/mundshëm për Organizatat e Shoqërisë Civile. Organizatat janë të panumërta dhe diverse përsa i përket qasjes, misionit, vizionit dhe ekspertizës për të qenë subjekt i qasjes së “të njëjtit etalon”. Forumi i Hapur nuk pati për qëllim të imponojë një kod sjelljeje global apo ndonjë mekanizëm tjetër mbi Organizatat e Shoqërisë Civile. Në vend të kësaj, ai synoi të lehtësojë integrimin e kuadrit të propozuar për zhvillimin efektiv në shumë mekanizma ekzistues për përgjegjshmërinë, apo në vendosjen e këtyre mekanizmave në nivele të përshtatshme (platforma, rrjetëzime, koalicione të pëlqyera nga organizatat).

Duke njohur dhe pranuar jo vetëm kontributet, por edhe dobësitë apo sfidat si aktorë zhvillimi, Organizatat e Shoqërisë Civile kanë afirmuar angazhimin e tyre në ndërmarrjen e veprimeve pro-aktive për të përmirësuar dhe qenë tërësisht të përgjegjshme, për praktikën e tyre të zhvillimit. Forumi i Hapur mbi Zhvillimin Efektiv të Organizatave të Shoqërisë Civile, ishte një proces tërësisht gjithëpërfshirës udhëhequr nga vetë këto organizata globalisht, i cili përcaktoi vizionin dhe parimet thelbësore që përkufizojnë dhe udhëheqin ndryshimin për praktika efektive të zhvillimit të tyre. Në shtator të vitit 2010, më shumë se 170 përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile nga 82 shtete u mblodhën së bashku në një asamble globale në Stamboll, Turqi për të marrë në konsideratë dhe adoptuar në mënyrë unanime “*Parimet për Efektivitetin e Zhvillimit të Organizatave të Shoqërisë Civile*” – një dokument ky i ndërtuar në

²¹⁵Anëtare e Grupit Global të Punës për Europën në Forumin e Hapur të Shoqërisë Civile.

bazë të konsultimeve me qindra organizata në më shumë se 70 shtete dhe sektorë të ndryshëm. Në këtë proces nuk mungoi të ishte e përfshirë edhe Shqipëria, ndonëse interesimi i organizatave shqiptare ishte tepër i vakët. Në 30 Qershor 2010 u zhvillua në Tiranë nga Shoqata “Refleksione” me mbështetjen e CONCORD²¹⁵, një tryezë konsultative kombëtare pikërisht për të diskutuar mbi mjedisin në të cilin funksionojnë organizatat në Shqipëri, si dhe mbi parimet bazë përmes të cilave mund të përcaktohet zhvillimi efektiv përkundrejt ndihmës efektive. Ndonëse diskutimi në këtë tryezë u zhvendos nga parimet globale në problemet e përditshme që ndeshin organizatat shqiptare gjatë zbatimit të aktiviteteve të tyre, të 15 organizatat pjesëmarrëse në këtë takim, ranë dakord që, ka ardhur momenti i rifillimit të një procesi dialogimi efektiv mes shtetit dhe shoqërisë civile.

Tetë Parimet e Stambollit marrin në konsideratë diversitetin e vizionit, qëndrimeve, marrëdhënieve apo edhe impaktit të Organizatave të Shoqërisë Civile në veprimet e tyre për zhvillim. Nisur nga diversiteti dhe shpërndarja gjeografike, Forumi i Hapur synoi zbatimin e këtyre parimeve në atë mënyrë që ato të janë të përshtatshme për çdo organizatë bazuar në sektorin dhe kontekstin në të cilin ato veprojnë. Me fjalë të tjera, Parimet e Stambollit mund të konsiderohen si baza e Kuadrit Ndërkombëtar për zhvillimin efektiv të shoqërisë civile.

Për këtë arsye, Organizatat e Shoqërisë Civile u mbledhën në një asamble të dytë globale, për të miratuar tashmë versionin më të fundit të përpunuar të këtyre parimeve, version ky që më pas do të paraqitet zyrtarisht në Forumin e Katërt të Nivelit të Lartë. Të gjithë këto hapa të përmendur deri tani janë ndërmarrë bazuar në Forumin e Tretë të Nivelit të Lartë, ku qeveritë dhe donatorët pranuan angazhimin e tyre “për të punuar me Organizatat e Shoqërisë Civile me qëllim që të mundësojnë një mjedis lehtësues i cili maksimizon kontributet e këtyre organizatave drejt zhvillimit”. Që nga ky moment, Organizatat e Shoqërisë Civile në mbarë botën bazuar në eksperiencat e vendeve që iu përkasin apo aty ku

veprojnë, po përpiqen të përcaktojnë nocionin/kushtet e këtij mjedisi lehtësues për punën e tyre.

Organizatat e Shoqërisë Civile janë efektive si aktorë zhvillimi kur ato, ndër të tjera, bashkëpunojnë për arritjen e rezultateve dhe impaktit të qëndrueshëm të veprimeve të tyre për zhvillim, duke u fokusuar tek rezultatet dhe kushtet për ndryshime afatgjata tek njerëzit, me fokus të veçantë tek popullsitë e varfra e të marginalizuara, me qëllim që të mund të sigurojnë vazhdimësinë e këtij ndryshimi edhe për brezat e ardhshëm. Organizatat e Shoqërisë Civile nuk mund të arrijnë rezultate të qëndrueshme të zhvillimit nëse operojnë të vetme, ato duhet të angazhohen në terma afatgjatë për partneritetet mes tyre dhe grupeve për të cilat punojnë. Ndryshimi pozitiv duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të fokusohet në rrënjët dhe shkaqet e varfërisë dhe pabarazisë. Organizatat e Shoqërisë Civile ofrojnë kontribut thelbësor dhe mbushin boshllëqe shumë të mëdha veçanërisht në situata konflikti apo post-konflikti - ku edhe roli apo arritjet nga ana e shtetit janë më të pakta, por ato nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojnë rolin e shtetit, kapaciteti i të cilit duhet forcuar në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike në shëndetësi, arsim, apo edhe në të gjitha fushat e tjera të jetës. Vetë Organizatat e Shoqërisë Civile e pranojnë rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të tyre për të vlerësuar dhe demonstruar me fakte impaktin dhe qëndrueshmërinë e punës së tyre, e cila është shpesh komplekse dhe e shtrirë në kohë. Por gjithashtu duhen marrë në konsideratë gjerësisht edhe proceset socio-ekonomike apo politike të cilat mundësojnë ose ndikojnë negativisht në arritjen e këtyre zhvillimeve të qëndrueshme nga ana e Organizatat e Shoqërisë Civile.

Respektimi dhe promovimi i të drejtave njerëzore dhe drejtësisë sociale është parimi i parë i renditur në dokumentin e Parimeve të Stambollit, si udhërrëfyes për nxitjen e zhvillimit. Organizatat e Shoqërisë Civile janë efektive si aktorë zhvillimi kur ndër të tjera, zhvillojnë dhe zbatojnë strategji, aktivitetet dhe praktika që promovojnë të drejtat njerëzore individuale dhe kolektive, duke përfshirë këtu të drejtën për tu zhvilluar me dinjitet, punë të

përshtatshme, drejtësi sociale dhe mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit. Shumë organizata i kanë integruar të drejtat e njeriut në qëllimet dhe aktivitetet e tyre, por gjithashtu edhe kërkojnë zbatimin e qasjes së bazuar në këto të drejta njerëzore, në punën e tyre. Fuqizimi i kapaciteteve të njerëzve përsa iu takon të drejtave të tyre, kërkon qasje holistike për programet dhe praktikatat e Organizatave të Shoqërisë Civile, duke përfshirë këtu edhe vetë angazhimin dhe përgjegjshmërinë e qeverive për të marrë në konsideratë dhe zbatuar detyrimin e tyre për mbrojtjen, respektimin dhe nxitjen e të drejtave të njeriut. Qëndrime të tilla adresojnë vazhdimisht çështjet e pabarazisë, vulnerabilitetit, diskriminimit dhe padrejtësisë ekonomike që ndikon mbi varfërinë dhe pabarazinë.

Mishërimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore përmes promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave, është një tjetër parim shumë i rëndësishëm që ndjek parimin e parë të cituar më sipër. Organizatat e Shoqërisë Civile konsiderohen efektive si aktorë zhvillimi kur nxisin dhe praktikojnë mishërimin e drejtësisë gjinore, përmes reflektimit të shqetësimeve dhe eksperiencave të grave dhe vajzave, ndërkohë që mbështesin përpjekjet e tyre për të realizuar të drejtat individuale dhe kolektive, si edhe për të marrë pjesë si aktorë plotësisht të fuqizuar në procesin e zhvillimit. Arritja e barazisë gjinore përmes adresimit dhe përmbushjes së të drejtave të grave dhe vajzave – në të gjitha dimensionet e tyre – është thelbësore për realizimin e rezultateve dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes drejtësisë gjinore nxit edhe arritjen e barazisë gjinore - aksesit të barabartë të grave dhe vajzave kundrejt burimeve, mundësive dhe vendim-marrjes në të gjitha nivelet. Duke theksuar faktin që gratë nuk janë një kategori homogjene, Organizatat e Shoqërisë Civile theksojnë nevojën për diversifikimin e drejtimit të ndërhyrjes së tyre, të cilat përfshijnë edhe punën me grupe të ndryshme grash dhe vajzash në nevojë, me qëllim nxitjen e fuqizimit dhe sigurisë dhe mirëqenies së tyre. Organizatat e Shoqërisë Civile gjithashtu pranojnë se burrat dhe gratë janë partnerët thelbësorë që duhen angazhuar në këtë proces. Por edhe

vetë Organizatat e Shoqërisë Civile nuk është se janë të imunizuara nga pabarazitë gjinore. Avancimi i drejtësisë gjinore shkon përtej kushteve praktike për gratë dhe vajzat, pikërisht në minimizimin e pabarazive strategjike të fuqisë dhe pushtetit mes burrave dhe grave, përmes nxitjes së hartimit të ligjeve dhe praktikave antidiskriminuese. Por vetëm pjesëmarrja e grave nuk është e mjaftueshme për të garantuar që nevojat dhe të drejtat e tyre do të respektohen dhe merren në konsideratë, prandaj dhe kultura e organizatave duhet të transformohet pikërisht për të arritur në thelb barazinë gjinore.

Parimet e Zhvillimit Efektiv të Shoqërisë Civile janë përkufizime të vlerave dhe cilësive mbi të cilat duhen bazuar marrëdhëniet socio-ekonomike, politike, dhe organizative të Organizatave të Shoqërisë Civile. Ato janë pika reference universal për aktivitetin për zhvillim, duke theksuar të drejtën e njerëzve që jetojnë në varfëri, si edhe të grupeve të marginalizuara. Në diversitetin e tyre, zhvillimi efektiv i organizatave është tërësisht i varur nga konteksti në të cilin ato veprojnë, në lidhjen e tyre me qeveritë, sektorët dhe grupet me të cilat punojnë²¹⁶.

Parimet e Stambollit²¹⁷:

1. Respektimi dhe promovimi i të drejtave njerëzore dhe drejtësisë sociale.
2. Mishërimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore përmes promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave.
3. Fokusimi në fuqizimin e njerëzve, përmes një qeverisjeje demokratike dhe pjesëmarrëse.
4. Promovimi i qëndrueshmërisë mjedisore.
5. Praktikimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë.

²¹⁶ "The Siem Reap Consensus CSO Consensus on the International Framework for CSO Development Effectiveness", agreed by the Second Global Assembly, Open Forum for CSO Development Effectiveness, Siem Reap, Cambodia June 28 - 30, 2011.

²¹⁷ Po aty.

6. Veprimi përmes partneriteteve të barabarta dhe solidaritetit.
7. Shkëmbimi i njohurive dhe angazhimi për të mësuarit e përbashkët.
8. Angazhimi për realizimin e ndryshimeve pozitive dhe të qëndrueshme.

Si udhërrëfyese për ecurinë e punës dhe zhvillimin e mëtejshëm të Organizatave të Shoqërisë Civile në mbarë botën, këto parime qëndrojnë të renditura si më lart, në pritje të mbështetjes dhe miratimit përfundimtar në këtë fundviti. Në të gjithë këtë kontekst, organizatat shqiptare mund të konsiderohen të pozicionuara sa afër, aq edhe larg. Afër, pasi puna dhe kontributi i tyre i përditshëm vënë theksin në arritjen e drejtësisë dhe respektimin e të drejtave njerëzore, si edhe shkon në linjë me këto parime të zhvillimit efektiv që pritet të përqafohen dhe aplikohen globalisht. Por larg, pasi siç e përmenda edhe më sipër, nëse bëhet fjalë për të diskutuar për mjedisin në të cilin funksionojnë këto organizata në Shqipëri, ende nuk është bërë e mundur gjetja e një gjuhe dialoguese dhe partneriteti mes tyre dhe shtetit, e duket se negociimi në këtë pikë lë ende shumë për të dëshiruar.

Rruga drejt Buzanit ndonëse e gjatë, është tashmë drejt fundit dhe së shpejti organizatat në mbarë botën do të bazojnë aktivitetin e tyre në vendimet që do ndërmerren në këtë Forum. Por reflektimi me ndjeshmëri dhe prioritet ndaj gjithë këtij procesi nga organizatat në Shqipëri, është domosdoshmëri dhe nuk duhet të mbetet më sporadik e në heshtje. Kontributi dhe puna e jashtëzakonshme e organizatave shqiptare duhet të kompletohet edhe me fokusimin e një pjese të energjive dhe burimeve pikërisht në kuptimin dhe zbatimin e këtyre parimeve të zhvillimit efektiv, përmes mundësisë të një mjedisi lehtësues të funksionimit të tyre, si kusht i domosdoshëm për arritjen dhe respektimin e drejtësisë dhe të të drejtave njerëzore.

Anila NEPRAVISHTA²¹⁸

**FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN DHE ROLI I
AVOKATIT TË POPULLIT DHE I SHOQËRISË CIVILE
NË PROMOVIMIN E GARANTIMIN E INTERESIT MË
TË MIRË TË TYRE**

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të të miturve e adoleshentëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të sistemit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm për ndërgjegjësimin e opinionit publik lidhur me faktin që fëmijët e dhunuar sot përbëjnë shoqërinë e nesërme pa të ardhme e shpresë. Avokati i Popullit si institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, e ka pasur që në krijimet e tij në një fokus të veçantë punën për mbrojtjen, promovimin e garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve. Realizimi e plotësimi i rekomandimeve për harmonizimin e politikave dhe të legjislacionit kombëtar me atë evropian, në zhvillimin e forcimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përbëjnë pjesë të vullnetit të shprehur të të gjithë klasës politike të vendit tonë. Në këtë aspekt respektimi i të drejtave të fëmijëve është parë e konsideruar si pjesë e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Nocioni i interesit më të lartë të fëmijës

Interesi më i lartë i fëmijës është parim i prodhuar dhe përhapur në kohët moderne. Dhe puna për arritjen në këtë rezultante, si

²¹⁸ Komisionere pranë Avokatit të Popullit

dhe për njohjen e fëmijës subjekt të drejtash ka zgjatur për rreth 60 vitet e fundit. Ky parim përbën shtyllën bazë dhe të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijës” dhe konkretisht neni 3 i saj. Pra në këtë dokument për herë të parë është sanksionuar detyrimi që të gjitha shtetet duhet të garantojnë që interesat më të mira të fëmijëve të jenë në qendër të të gjitha vendimeve apo masave qeveritare e organizmave shtetërore, të cilat ndikojnë tek fëmijët. Ky parim bazë i Konventës në përmbajtje të këtij neni ndërthuret dhe në nene të tjera të kësaj Konvente-si një konsideratë parësore²¹⁹. Në interes të këtij punimi është për tu përmendur neni 37/c²²⁰ dhe 40/2 i Konventës²²¹. Synimi i këtij parimi është që jo duke garantuar interesin më të lartë të fëmijëve, të shkelen interesat e grupeve të tjera shoqërore, por të lehtësohet mbrojtja e interesave të këtij grupi vulnerabël. Interesi më i lartë i fëmijës përbën një koncept juridik që duhet të gjejë shprehjen e plotë e të saktë në praktikë. Kryetari i Komitetit të Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijëve është përpjekur të

²¹⁹ P.sh neni 9.1, neni 9.3, neni 20.1, neni 37.c dhe neni 40.2 i Konventës

²²⁰ Neni 37 (c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.

²²¹ Neni 40/2/b (iii). Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

- (b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:
- (i) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;
- (iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

japë këtë përkufizim të interesit më të lartë të fëmijës: “Përbën një instrument juridik për sigurimin e mirëqenies së fëmijës në aspektin fizik, psikik e social. Ai përbën një detyrim për të gjitha instancat dhe organizatat publike apo private që të shqyrtojnë se sa ky kriter është përmbushur në momentin kur një vendim është marrë lidhur me një fëmijë dhe ai përbën një garanci për fëmijën, që interesi i tij të merret parasysh në një plan afatgjatë”²²².

Avokati i Popullit-institucion kombëtar në mbrojtje të të drejtave njerëzore të fëmijëve

Shqipëria ende nuk e ka një Ombudsman për fëmijët. Një rol të tillë është përpjekur dhe e ka kryer Zyra e Avokatit të Popullit. Ky institucion trajton raste ankesash apo kërkesash objekti i të cilave është shkelja e të drejtave njerëzore të fëmijëve, duke i cilësuar si parësore. Shpesh nga ankesat ka rezultuar që interesi më i lartë i fëmijës nuk ka qenë në epiqendër të një procesi administrativ nga organet e ndryshme të administratës publike. Numri më i madh i ankesave me objekt shkelje të të drejtave të fëmijëve të paraqitura pranë kësaj Zyre, ka qenë nga prindërit dhe familjarët e tyre. Të pakta kanë qenë ankesat nga vetë fëmijët. Kjo tregon ndër të tjera dhe vulnerabilitetin e tyre, si pjesa më e brishtë e shoqërisë sonë.

Konkretisht fokusi që ka ky institucion lidhur me të drejtat e fëmijëve është:

i-trajtimi i ankesave individuale për mosrespektim apo dhunim të të drejtave të tyre;

ii-identifikimi dhe nxjerrja në pah e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme e të parregullta nga ana e organeve shtetërore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti tek fëmijët. Kjo sidomos në kontekstin e shkollave, spitaleve, burgjeve, institucioneve.

iii-Promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe fushatë sensibilizimi mbi këtë temë.

iv-Analizë legjislacioni me synim përmirësime të mëtejshme,

²²² Jean Zermatten “Interesi më i mirë i fëmijës”

lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Organizatat jofitimprurëse vendase dhe të huaja, luajnë një rol të rëndësishëm duke u siguruar shërbime të ndryshme fëmijëve, si asistencë ligjore falas, bëjnë punë hulumtuuese, publikojnë raporte mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe organizojnë trajnime të ndryshme për edukimin e zyrtarëve publike duke rritur ndërgjegjësimin e tyre. Për këtë arsye, është i rëndësishëm krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit me to, dhe në këtë kuadër ka bashkëpunuar Avokati i Popullit me organizatën Save the Children, për krijimin e fuqizimin e Nënseksionit për të drejtat e fëmijëve.

Po e ilustruam me dy shembuj konkretë. Në Nëntor 2008, Institucioni i Avokatit të Popullit kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të vendimeve penale në Vaqar, Tiranë.

Ndër problemet e konstatuara ishte dhe fakti që në godinën e vetme të Burgut Vaqar strehoheshin 166 të dënuar, nga të cilët 13 të mitur. Në ambientet ku ishin strehuar të miturit nuk kishte mbipopullim. Por dhomat ishin të ftohta, me sistem elektrik të dëmtuar si dhe me lagështirë. Madje edhe biblioteka ku këta të fundit kalonin një pjesë të mirë të kohës kishte të njëjtat kushte. Një tjetër problem që u konstatua nga ankesat e të dënuarve ishte dhe mungesa e ofrimit të një larmie asortimentesh ushqimore, sipas normativave ditorë dietikë.

Në përfundim të këtyre konstatimeve, Avokati i Popullit parashtrori mendimin se hapja e qendrës penitenciare për të miturit në Kavajë do të zgjidhë përfundimisht problemin e mbipopullimit në Burgun e Vaqarit. Veçse ky zhvillim duhet të shoqërohet edhe me një sërë investimesh në këtë burg për të arritur një nivel optimal standardesh. Ndaj iu rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të dënuarve të Burgut Vaqar, Tiranë si dhe mundësimi sa më parë i hapjes së qendrës penitenciare për të miturit në Kavajë, si një veprim që do të ulë menjëherë mbipopullimin në Burgun e Vaqarit²²³.

²²³ www.avokatipopullit.gov.al/rekomandime

-Po kështu në vitin 2008 kjo Zyrë konstatoi se gjykatat, ndonëse ekzistonin kushtet ligjore të aplikimit të masës edukuese të vendosjes së të miturve në një institucion edukimi, ato hezitojnë në dhënien e vendimeve të tilla për shkak të mungesës së institucionit të edukimit.

Ndaj i rekomandoi Ministrit të Drejtësisë të propozojë në Qeveri marrjen e të gjitha masave të nevojshme organizative, teknike, materiale dhe financiare për krijimin e institucionit të edukimit për vendosjen e të miturve që kanë kryer vepra penale, por nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç.

-Së dyti, nisur nga Inspektimet e kryera nga kjo Zyrë në shumë nga Komisaritet e Policisë, në Dhomat e Shoqërimit dhe të Sigurimit të Shtetasve ka rekomanduar marrjen e masave urgjente për rikonstruksionin e ambienteve të dhomave të shoqërimit, si dhe ndarjen e tyre për persona të mitur dhe femra në Komisariate, sipas konceptimit të bërë në Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

Në kuadrin e punës klasike të një zyre Ombudsmani, i drejtoi në vitin 2009 Ministrit të Drejtësisë disa Rekomandime për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, në favor të fëmijëve, edhe në kuadrin e Reformës në drejtësi.

Në mënyrë të përmbledhur lidhur me rekomandimin konkret, në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë, ndër të tjera konkludohej se: "mungesa e një ligji të veçantë penal dhe procedural penal për të miturit, nuk cenon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij, të njohura nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Ndaj krijimi i një kuadri të veçantë ligjor për të miturit në konflikt me drejtësinë konsiderohet i panevojshëm, përse kohë i mituri është subjekt i një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Nga ana e Ministrit të Drejtësisë vlerësohen përpjekjet e Institucionit të Avokatit të Popullit për përmirësimin e legjislacionit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave e lirive themelore të njeriut. Për çështje që mbuloohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit, çdo projektligj për ndryshimin e kodeve të lartpërmendura, do të paraqitet për mendim".

Domosdoshmëria e krijimit të një sistemi të drejtësisë për të mitur sa më efektive, në Shqipëri, i cili të përmbushë standardet ndërkombëtare, është mjaft e lidhur me procesin e fuqizimit e të konsolidimit të një sistemi demokratik dhe me krijimin e shtetit të së drejtës. Pa u vendosur drejtësia për të miturit, fëmijët në konflikt me ligjin do të vijojnë të trajtohen si të rriturit, nga të gjitha institucionet zbatuese të ligjit.

Është e rëndësishme të vëmë në dukje bashkëpunimin dhe përpjekjet për krijimin e urave ndërlidhëse të këtij institucioni kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut me shoqërinë civile. Punë e cila duhet të vijojë e faktikisht të ngrihet në një stad më të lartë, me fokusin kryesor interesin më të mirë të qytetarëve të së ardhmes së shoqërisë sonë.

Tashmë është elaboruar një mori aktesh ndërkombëtare lidhur me rregullimin e të drejtave të fëmijëve, por po aq e ditur është që në botë ka një numër të tejkajshëm, fëmijësh të dhunuar, apo të cilëve vijojnë t'i shkelen të drejtat e tyre njerëzore. Pra ka mjaft hapësira që duhen mbushur për sa i përket të drejtave që mbrohen ligjërisht dhe të drejtave që i mohohen praktikisht fëmijëve. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB e 29 Nëntorit 1985, që tashmë njihet si Rregullat e Pekinit Mbi Drejtësinë për të miturit, ka përcaktuar që mbrojtja juridike e të miturve duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit kombëtar, në të gjitha Shtetet anëtare.

Natyra komplekse e problemeve që i shpiten fëmijët që të jenë në konflikt me ligjin, apo që i përfshijnë ata e i vënë në kontakt me mekanizmat e ndryshëm të sistemit të drejtësisë, e bën të detyrueshme që të veprohet kryesisht në dy drejtime:

Së pari, për të përmirësuar problemet lidhur me ndalimet e paligjshme apo në paraburgimin e të miturve, zvarritjet e vonesat në gjykime dhe parregullsi të tjera të rënda - kur situata të tilla ndodhin - ose e thënë ndryshe duke bërë të mundur riaktivizimin e sistemit të administratës të Drejtësisë në vend.

Së dyti, puna në vijimësi për të promovuar e mbrojtur të drejtat e fëmijëve në komunitet, për krijimin e një sistemi të menaxhimit

të Drejtësisë për të Miturit, duket si një masë jo e plotë, pa një veprim paralel për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në nivel Komuniteti, sidomos në theksimin e rolit të familjes, si dhe promovimin e parandalimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Komiteti i të Drejtave të Fëmijës në Gjenevë ka miratuar një sërë rekomandimesh lidhur me drejtësinë për të miturit. Në shumë nga vendet evropiane ka rezultuar si një fushë me interes përsa i përket drejtësisë për të miturit, studimi i parandalimit të hershëm të kriminalitetit të të miturve. Kjo është arritur duke hartuar programe për mbështetjen e familjeve në nevojë, programet për të luftuar braktisjen e shkollës nga fëmijët, etj.

Po kështu një masë tjetër mjaft e rëndësishme për të parandaluar kriminalitetin e të miturve është dhe zhvillimi i drejtësisë restauruese. Kjo frymë e re po rezulton çdo ditë e më efikase në mjaft vende të Evropës, si një nga format më të thjeshta të kontrollit të kriminalitetit të fëmijëve dhe shmangies së recidivizmit. Baza e sistemit të drejtësisë, e pa dyshim dhe të asaj për të miturit në vendet e Bashkimit Evropian, ku dhe ne aspirojmë anëtarësimin, janë të orientuara në togfjalëshin “drejtësi, siguri, liri”. Debati evropian²²⁴ mbi programet e drejtësisë për të miturit zhvillohet tashmë në dy linja kryesore: së pari në mirë përcaktimin në planin teorik të bazave për ndëshkimin e të miturve dhe të rinjve autorë të veprave penale dhe së dyti në krijimin e modeleve të reja në fushën e drejtësisë për të miturit.

Rritja e kriminalitetit të të miturve të shpie në disa përfundime.

Së pari jemi të vetëdijshëm që vendosja dhe bërja drejtësi për të miturit që shkelin apo thyejnë ligjin, duke filluar nga ndalimi, gjykimi dhe më pas dënimi na shpie në një kontroll mjaft të kufizuar të kriminalitetit të të miturve. Padyshim që faktor ndikues në zhvillimin e kriminalitetit të të miturve përbën dhe kontrolli nëpërmjet mjeteve ndëshkuese.

Në Evropë politikatat e drejtësisë për të miturit mbështeten në

²²⁴ “Programme de l’Union Européenne en matiere de droits de l’enfant”, Komisioni Evropian, 15 Shkurt 2011.

parimet e proporcionalitetit dhe të subsidiaritetit të ndërhyrjeve të shtetit ndaj të miturve-autorë të veprave penale. Këto parime janë mirëpërcaktuar në Rregullat bazë Standarde të OKB mbi Drejtësinë për të Miturit të 1985 si dhe në Konventën e OKB “Mbi të Drejtat e fëmijës” të 1989.

Në SHBA gjykata e parë për të rinjtë është krijuar në vitin 1889, dhe që nga kjo kohë një numër i madh shtetesh kanë vendosur mënyra të trajtimit të posaçëm për të rinjtë në konflikt me ligjin. Kjo konsiston në dënime shumë herë më të lehta apo të një tjetër natyre për të miturit, krahasuar nga trajtimi që i bëhet delinkuentëve të moshës madhore²²⁵. Megjithëse legjislativi është përparimtar në këtë aspekt në mjaft vende, praktika lë shumë për të dëshiruar, nisur nga fakti që të miturit vendosen në të njëjtat qendra dënimi me madhorët. Është e qartë që nisur nga rregullat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të të miturve të cilat parashikojnë që masat e privimit të lirisë për të miturit duhet të jenë si ndërhyrjet e nivelit të fundit dhe me një kohëzgjatje sa më të shkurtër të mundshme, si në shumë vende të kontinentit dhe në vendin tonë, një gjë e tillë shpesh nuk ndodh.

Cilat janë efektet e heqjes së lirisë tek të miturit?

Heqja e lirisë ndikon në gjendjen psikologjike të të miturit, shëndetin dhe mbi të gjitha me stigmatizimin dhe izolimin e tij nga shoqëria. Pra në plan afatgjatë, heqja e lirisë mund të sjellë probleme psikologjike të pariparueshme, shpesh shpie në raste vetëvrasjesh e aq më tepër sjell egërsimin e delinkuentit të mitur që të vijojë rrugën dhe sjelljet e tij kriminale në të ardhmen.

Ekspertët e psikologjisë e konsiderojnë mbylljen në institucionet e vuajtjes së dënimit të të miturve si një masë që ndikon shumë në zhvillimin jo të duhur të fëmijës. Megjithë debatet rreth kësaj çështjeje, duhet gjithmonë që organet e dhënies drejtësi të udhëhiqen nga parimi që privimi i lirisë për të miturit duhet parë

²²⁵ Shih Studimin e Sekretarit të Pergjithshëm të OKB mbi dhunen ndaj femijeve në konflikt me ligjin; <http://www.violencestudy.org/r180>.

si një masë e karakterit përjashtimor dhe duhen kërkuar gjithmonë rrugë e mjete të tjera më të mira sesa privimi i lirisë, për t'ju përgjigjur kriminalitetit të të miturve.

Cilat janë masat alternative të kufizimit të lirisë dhe pse është e rëndësishme promovimi i drejtësisë restauruese?

Masat alternative synojnë që të miturit të ri integrohen në shoqëri, duke bërë të mundur që të miturit të vijojnë lidhjet me komunitetin. Një Studim i OKB mbi dhunën ndaj fëmijëve i 2005 ka treguar që rreziku i recidivizmit është më i lartë tek të miturit në institucionet e vuajtjes së dënimit, sesa tek ata që i janë nënshkruar masave alternative²²⁶. Drejtësia restauruese synon që nëpërmjet riparimit të dëmeve të shkaktuara nga shkelja e kryer, të "riparohet" jo vetëm viktimi, por dhe të ndërjegjësohet vetë i mituri, që të ri integrohet në shoqëri në një mënyrë paqësore²²⁷.

Megjithatë Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve në Gjenevë ka vlerësuar që trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin, nuk është i duhuri dhe që mjaft Shtete kanë shumë për të bërë për respektimin e përmbajtjes së Konventës, sidomos lidhur me të drejtat procedurale, përcaktimin dhe përdorimin e masave lidhur me trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, pa ju nënshtruar procedurave ligjore, si dhe përsa i përket kufizimit të lirisë në raste të veçanta dhe vetëm si një masë e fundit²²⁸.

Janë katër tekste bazë të Kombeve të Bashkuara që kërkojnë

²²⁶ Raporti i OKB mbi dhunën ndaj fëmijëve, 2005, fq.227.

²²⁷ Rezoluta e ECOSOC 200/14 "Parimet bazë të aplikimit të programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale" (E/2000/30), 27 korrik 2000. Meqënëse nuk është arritur njëzëri në një përkufizimi të modelit të drejtësisë restauruese, Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB ka dhënë këtë përkufizim: praktika restauruese janë i gjithë procesi ku përfshihen viktimi dhe delinkuenti, dhe kur ka vend të gjithë personat e tjerë, pjestarë të komunitetit mbi të cilët ndjehen pasojat e një shkeljeje, të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive për t'i dhënë një zgjidhje problemeve që ka sjellë kjo shkelje, përgjithësisht me ndihmën e një ndërmyetesuesi.

²²⁸ Komenti i Përgjithshëm nr.10 i Komitetit të OKB në Gjenevë, "Të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të miturit", 25 Prill 2007.

përdorimin ndaj kësaj kategorie të të miturve të masave alternative të kufizimit të lirisë:

- Rregullat bazë të OKB mbi administrimin e drejtësisë për të miturit, ose Rregullat e Pekinit.

- Parimet e OKB për parandalimin e delinkuencës së të rinjve, ose parimet e Riadit.

- Konventa e OKB "Mbi të drejtat e fëmijës"²²⁹.

- Observacioni i Përgjithshëm nr. 10 i Komitetit të të Drejtave të Fëmijës.

Kjo lloj drejtësie paraqet një mori përparësish, pasi synon së pari të rregullojë marrëdhëniet e acaruara ndërmjet viktimës, autorit-delinkuent dhe komunitetit, pra synon të rregullojë dëmet, të bashkojë palët dhe të vendosë harmoninë e mirëkuptimin në komunitet. Është e vërtetë që kjo lloj drejtësie ka si objektiv kryesor krijimin e hapësirave ndaj nevojave dhe kërkesave të viktimave të akteve kriminale, por ka dhe aspektin edukativ ndaj autorit të veprës. Në mjaft vende evropiane është sanksionuar me ligj përdorimi i drejtësisë restauruese si model ndërhyrjeje në rastet e kriminalitetit të të miturve. Dhe ndërmjetësimi përbën njërin nga teknikat më efikase të kësaj drejtësie.

Kjo lloj drejtësie parashihet si thellësisht e rëndësishme për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, pasi ndikon pozitivisht në zhvillimin e tyre emocional e moral, duke i nxjerrë përfundimisht këta fëmijë nga rruga e krimit, edhe në të ardhmen, dhe në të njëjtën kohë rivlerëson dhe nxjerr në dritë dhe figurën e viktimës. Megjithatë në opinionin publik mbizotëron ideja që vetëm heqja e lirisë është përgjigja e duhur për aktet kriminale të të miturve.

Kur flasim për parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve mund ta konsiderojmë si thelbin e synimin e drejtësisë për të mitur. Ndaj për ta arritur këtë qëllim i gjithë interesimi i shoqërisë duhet fokusuar kryesisht në socializmin dhe integrimin e fëmijëve në të gjitha

²²⁹ Rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB e 20 nëntorit 1989. Por në këtë Rezolutë, Asambleja (neni 40 i Konventës) vetëm e parashikoi këtë parim, por pa specifikuar mënyrën e aplikimit në praktikë.

aspektet e nivelet: shkollë, familje, komunitet. Ajo që vlen dhe për vendin tonë është krijimi i hapësirave dhe burimeve brenda komunitetit për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Dhe këto duhet të jenë shumëplanëshe, si në familje, me programe të mbështetjes së familjeve në nevojë, punësimi i prindërve të papunë, brenda institucioneve-si në shkolla, nëpërmjet edukimit me vlerat më të mira të edukatës qytetare, si dhe nga vetë organizatat jofitimprurëse.

Roli i OJF në sensibilizimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Vetëm një fakt mund të përmendim lidhur me rolin shoqërisë civile. Deri në vitin 2007 policia e shtetit fenomenin e dhunës në familje e ka vlerësuar si çdo aktivitet tjetër kriminal, në përputhje me legjislacionin penal, pasi mungonte një ligj i veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ishte nisma e shoqërisë civile plotësimi i legjislacionit në këtë aspekt, duke krijuar premisat për hartimin dhe miratimin e Ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"²³⁰, që ndër të tjera ka përcaktuar ngritjen e funksionimit e strukturave të posaçme për parandalimin dhe luftën ndaj këtij fenomeni. Roli i tyre është thelbësor dhe në ndihmën dhe asistencën ligjore e psikologjike që i japin të miturve në konflikt me ligjin.

Puna e tyre është e vlerësueshme gjithashtu dhe për studimet e herëpashershme që ata kryejnë. Përmend këtu Studimin e iniciuar nga UNICEF dhe CRCA mbi drejtësinë për të miturit në 2007, që ndër të tjera konkludonte që numri i fëmijëve në konflikt me ligjin në Shqipëri është rritur dhe që sistemi i drejtësisë nuk i përgjigjej kësaj rritjeje. Po ky studim tregonte që kriminaliteti tek fëmijët nën 14 vjeç është shtuar, dhe kjo nuk gjente zgjidhje nga Kodi i Procedurës Penale.

Po kështu bashkëpunimi me Qendrën Shqiptare për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara konkludoi me botimin e një studimi të mirëfilltë në vitin 2009 të të gjithë legjislacionit shqiptar dhe përqasjes së tij me Konventën Mbi të drejtat e fëmijëve. Ndër OJF me të cilat ky Institucion ka bashkëpunuar ndër vite janë

²³⁰ Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006, i ndryshuar.

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve-CRCA, Qendra Fëmijët Sot, Every Child, TLAS-Albania, Qendra Avokatore për Gratë dhe Vajzat, Instituti Evropian i Tiranës, Komiteti i Helsinkit, etj. Një ndër rekomandimet e raportit të Monitorimit 2010 mbi zbatimin e masterplanit për sistemin shqiptar të paraburgimit, nga Instituti Evropian i Tiranës në partneritet me Institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë dhe: "Autoritetet kompetente duhet të krijojnë një seksion të veçantë për të miturit në Spitalin e Burgut, duke përfshirë një hapësirë të veçantë për periudhën e ajrimit dhe ambiente të veçanta argëtuese". Një bashkëpunim i tillë me këtë Institut ka vijuar duke kryer në mënyrë të veçantë monitorime të situatës në paraburgime në të gjithë vendin, gjë që ka pasur impakt, pasi është gjetur mbështetja e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë për t'ju përgjigjur me rezultat rekomandimeve të kryera. Punës promovuese lidhur me të drejtat e fëmijëve i ka shërbyer dhe bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e Zyrës së Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme që OJF kanë organizuar ndër vite lidhur me tema të ndryshme. Ky bashkëpunim ka qenë i ndërsjellët dhe është konkluduar se si Avokati i Popullit ashtu dhe OJF kanë qëllime të të njëjtit sens: atë të promovimit e garantimit sa më të mirë të të drejtave të njeriut.

Konkluzione dhe rekomandime

-Krijimi i seksioneve për të miturit në disa gjykata dhe prokurori është një arritje pozitive dhe e harmonizuar me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Rëndësi të veçantë ka në administrimin e drejtësisë për të mitur dhe ndarja e specializimi i gjyqtarëve për të miturit, nga pjesa tjetër e trupës gjyquese. Kjo pasi përderisa fëmijët nuk e kanë përgjegjësinë e duhur, nevojitet një gjykim që t'i japë më tepër përgjigje edukimit, sesa dënimit të tij. Kjo pasi siç rëndom është thënë që kemi të bëjmë me një "të rritur" të së ardhmes. Po kështu ka një dallim të qartë jo vetëm në trupën gjyquese, por dhe në objektivat, metodat dhe në dënimet që do të përdoren. Synimi i të drejtës penale për të miturit nuk

përmban nocione të vuajtjes, shtrëngimit e të zhdëmtimit, por përqendrohet në një perspektivë të edukimit, parandalimit, kujdesit, shoqërore dhe mbrojtëse²³¹.

-Pjesëmarrja e organizatave jofitimprurëse dhe kontributi që ato japin është i pazëvendësueshëm sidomos për dhënien e shërbimeve që ende mungojnë në vendin tonë apo për thellimin e mëtejshëm të reformave që tashmë kanë nisur.

-Nevojitet një koordinim ende më i madh i të gjitha veprimtarive ndërinstytucionale, sidomos përsa i përket politikave për parandalimin e kriminalitetit të të miturve.

-Sistemi i drejtësisë për të miturit në vendin tonë është reformuar me zbatimin e dënimeve alternative ndaj heqjes së lirisë për shkelësit e mitur, si dhe tashmë është ngritur dhe një qendër e re paraburgimi për të miturit në Kavajë. Megjithatë kohëzgjatja e proceseve gjyqësore mbetet e lartë, duke çuar në shmangie të parimit që paraburgimi duhet të jetë masa e fundit për fëmijët në gjykim.

-Ngritja e institucionit të edukimit për të miturit që kryejnë vepra penale, por nuk kanë arritur moshë për përgjegjësi penale, është mjaft e rëndësishme. Neni 46/2 i Kodit Penal përcakton se: "...masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale". Detyrimi i shtetit shqiptar për administrimin e drejtësisë për të miturit rrjedh dhe nga neni 40, pika 5 e Konventës së të Drejtave të Fëmijës që përcakton se: "Shtetet palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal".

Në Shqipëri nga fundi i vitit 2007, mund të thuhet se ka filluar aplikimi i dënimeve alternative kryesisht për të miturit. Përmendim për këtë Gjykatën e Tiranës e cila në bashkëpunim mjaft të mirë me UNICEF-in ka filluar t'i aplikojë këto masa. Po kështu Ministria e Drejtësisë e ka në prioritet dhe në fokus zhvillimin e masave

²³¹ J.Zermatten, "Les objectifs du droit penal des mineurs", Revue valaisanne de jurisprudence, Nr.4,1995

alternative të dënimit për të miturit, duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe administrimin e drejtësisë për të miturit. Vetëkuptohet që tradita e zbatimit të masave alternative të dënimit në Shqipëri është mjaft e vogël, pasi legjislacioni shqiptar është i orientuar kryesisht drejt ndëshkimit me burgim. Me aplikimin e këtyre dënimeve alternative e fituar është si shoqëria, në kuptimin e integritetit të individit, por dhe vetë individi, për shkak të destruktivizmit që shkakton në karakterin e tij një dënim me heqje lirie. Gjithsesi themelore në këtë lloj alternative mbetet fakti që i mituri përveç punës së lehtë që do të kryejë, të mos përjashtohet nga procesi i arsimimit.

Përmirësime të vazhdueshme i janë bërë Kodit Penal²³², i cili ka mjaft amendamente në mbrojtje të të miturve, nga fenomene e situata rast pas rasti. Kjo pasi mjaft vepra penale përbëjnë shkëlqje të rënda të së drejtës së fëmijëve për një rritje, edukim dhe zhvillim normal e shoqëror.

Edhe ndryshimet e fundit që i janë bërë Kodit të Procedurës Penale²³³ kanë pasur si synim që të miturit të gëzojnë ndihmë të posaçme juridike dhe psikologjike në të gjitha shkallët e procedimit, në praninë e prindit apo personave të kërkuar nga vetë i mituri, mbrojtjen e detyrueshme kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç, si dhe mjaft garanci të tjera si:

-Pyetja e të miturve në seanca me dyer të mbyllura,

-E drejta e përfaqësuesit ligjor të të miturit në cilësinë e të dëmtuarit akuzues,

-Ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale, etj.

Prioritete për vendin tonë mbetet miratimi i paketës ligjore “Mbi drejtësinë për të miturit”, funksionimi i Institucionit të Riedukimit të të Miturve si dhe specializimi i mëtejshëm i gjyqtarëve. Reforma në drejtësi është sfidë e përbashkët e të gjitha forcave politike dhe

²³² Ligji nr.10023 datë 27.11.2008 «Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë».

institucioneve shtetërore të vendit tonë. Por sot për sot duket se mungon konsensusi politik.

Konstatimi se në disa drejtori Policie mungon funksioni i psikologut-gjatë shoqërimit apo marrjes në pyetje të shtetasve të mitur, për mungesë organike, e ka nxitur Zyrën e Avokatit të Popullit për të rekomanduar plotësimin organik të këtij shërbimi me personel në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit, ashtu siç përcaktohet në nenin 35 të K. P. Penale²³⁴.

Ligji “Për Ndihmën Juridike”²³⁵, ka mundësuar që këtë ndihmë ta përfitojnë edhe të miturit për të cilët mbrojtja është e detyrueshme me ligj, dhe ajo mund të kërkohet para, gjatë ose pas procesit gjyqësor. Por gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë vërehet se ka probleme sidomos përsa i përket cilësisë së mbrojtjes nga avokatët.

-Monitorimi i respektimit të të drejtave të miturve në kontakt me sistemin e drejtësisë penale është një element i rëndësishëm. Krahas rolit të mekanizmave të brendshëm kontrollues sidomos të prokurorisë dhe të gjykatës, rëndësi kanë dhe institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, ndër të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizatat monitoruese të të drejtave të njeriut. Roli i tyre jo vetëm monitorues, por edhe rekomandues mundëson evidentimin e shkeljeve, sinjalizimin e organeve kompetente.

-Fëmijët duhen trajtuar me të gjitha normat e dinjitetit njerëzor. Heqja apo privimi i lirisë duhet parë si masa e fundit dhe për një kohëzgjatje sa më të shkurtër për fëmijët në konflikt me ligjin.

-Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet strukturave të ndryshme që do trajtojnë këtë kategori të miturish duhet të jetë sa më i madh, duke shmangur sa më shumë pengesat burokratike, e kjo duke trajnuar në mënyrë multidispline të gjithë këtë armatë të madhe punonjësish si prokurorët, forcat e policisë, gjyqtarët, avokatët, punonjësit socialë e psikologët, punonjësit e burgjeve,

²³³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, www.qpz.al

²³⁴ www.avokatipopullit.gov.al/rekomandime.

²³⁵ Ligji nr. 10039 date 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

apo dhe të shërbimit të provës. Në këtë kuadër dhe bashkëpunimi i ndërsjellët ndërmjet Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile duhet të vijojë në funksion jo vetëm të promovimit të të drejtave të fëmijëve, por dhe të mbrojtjes sa më të mirë të interesit të tyre.

BIBLIOGRAFIA

-Rekomandimi i Këshillit të Evropës “Mënyrat e reja të trajtimit të delinkuencës së të miturve dhe roli i drejtësisë për të mitur” Rek. 2003 (20)

-Rregullat Evropiane për të miturit autorë të veprave penale që i janë nënshtruar dënimeve dhe masave” 2008 Rek. 2008 (11)

-Studimi i UNICEF dhe CRCA Mbi drejtësinë për të Miturit, Tiranë 2007.

-Revue valaisanne de jurisprudence, Nr. 4, 1995

-Këshilli i Evropës, 17 Nëntor 2010 “Linjat drejtuese të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë për Fëmijët”.

- Programme de l’Union Europeenne en matiere de droits de l’enfant”, Komisioni Evropian, 15 Shkurt 2011.

-Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB mbi dhunën ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin; <http://www.violencestudy.org/r180>.

-Faqja zyrtare e Avokatit të Popullit në Shqipëri www.avokatipopullit.gov.al

-Ligji nr. 10039 date 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

-Ligji nr. 10023 datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” .

-Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, www.qpz.al

- Komenti i Përgjithshëm nr. 10 i Komitetit të OKB në Gjenevë, “Të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të miturit”, 25 Prill 2007.

- Rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB e 20 nëntorit 1989.
- Raporti i OKB mbi dhunën ndaj fëmijëve, 2005.

Iris LUARASI, docente²³⁶

**PASQYRIMI NË MEDIA E SHKRUARA
DHE ELEKTRONIKE I VEPRIMTARISË SË OJF-VE
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT,
PËRMES MJETEVE LIGJORE.**

Të drejtat e njeriut apo liritë civile janë të drejtat dhe liritë që i japin një individ të drejta specifike si ajo për të jetuar, e drejta për të punuar, për liri dhe siguri, për një gjyq të ndershëm, për privaticitetin, lirinë e shprehjes, e shumë liri e të drejta të tjera. E pa dyshim mes këtyre lirive civile dhe llojeve të lirisë duhen dalluar qartë ndryshimet mes të drejtave pozitive dhe atyre negative²³⁷. Koncepti formal i lirive civile daton me Magna Kartës, një dokument i rëndësishëm gjithashtu në të gjitha manualët e gazetarisë ku flitet për historinë e shtypit, liritë dhe të drejtat e tij.

Çdokush ka të drejtën të shprehë lirshëm opinionin e tij; kjo e drejtë përfshin lirinë për të ruajtur opinionet pa ndërhyrje si dhe për të kërkuar dhe marrë informacione dhe ide përmes medias pa asnjë dallim dhe kufi²³⁸, thuhet në Artikullin 19.

Fakti është se edhe pse shumë vende e kanë nënshkruar Artikullin 19 (për lirinë e shprehjes, opinionit dhe informacionit), ai në vetvete nuk është bërë realitet. Një media e lirë dhe e pavarur

²³⁶ Departamenti Gazetarisë, Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti Tiranës.

²³⁷ Wikipedia http://en.wikipedia.org/wiki/Civil_liberties

²³⁸ Artikulli 19, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara

është kolona kyçe e një demokracie funksionale që ndihmon në shpërndarjen e informacionit dhe mendimit të lirë. Por edhe vende të zhvilluara e në zhvillim siç është edhe rasti i Shqipërisë kanë probleme të formave të ndryshme me median. Mbulimet ndërkombëtare të lajmeve po bien në mënyrë shqetësuese në kohën kur bota po përpiqet të globalizohet. Në shumë vende, gazetarët përballohen me kërcënime të censurës, rrahje, arrestime e madje edhe vrasje për raportimin e çështjeve që mund të jenë kontraversiale ose nuk janë në interes të pushtetarëve.

A janë të drejtat e njeriut çështje më të rëndësishme sesa format e tjera të informacionit që duhet të raportojnë gazetarët? Sigurisht që jo, e në fakt kjo pyetje duhej ngritur në një aspekt tjetër: kur media trajton çështje të të drejtave të njeriut a i raporton ato saktë e ashtu siç duhet përse i përket standardeve tradicionale të raportimit? Shumica e gazetarëve po t'i pyesësh për këtë nuk do të gjejnë shumë thjeshtë një konsensus për t'iu përgjigjur kësaj pyetje. Por gjithsesi është i vërtet fakti se edhe në Shqipëri media ka filluar t'i japë më shumë vëmendje (edhe pse e pamjaftueshme) çështjeve të të drejtave të njeriut, dhe arsyet pas kësaj mund të jenë komplekse. Mbulimi shtohet edhe për shkak të faktit se udhëheqësit politikë edhe jashtë fushatave edhe gjatë fushatave i referohen çështjeve të të drejtave të njeriut më shumë sesa i referoheshin dhjetë vjet më parë si në fjalimet e tyre formale ashtu edhe në retorikën politike. Edhe opinioni publik gjithashtu ka ndryshuar e ndoshta këto mund të jenë arsye të tjera shtesë pse është shtuar numri i raporteve që mbulojnë çështje të të drejtave të njeriut e si rrjedhim edhe profile dhe aktivitete të Organizatave Jofitimprurëse (OJF)

Gazetaria nuk është një profesion i lehtë në shumicën e rasteve e madje ka ngjarje okazionale kur gazetarët dhe media konfrontohen nga ngjarje aq të mëdha sa arrihet të testohet nocioni i profesionalizmit deri në limitet e tij (11 Shtatori 2001 në Shtetet e Bashkuara apo Gërdeci në Shqipëri). Raportimet e informuara që pasuan ngjarjet, talk show dhe debatet televizive plot me ekspertë e analistë me debate të tensionuara e apasionante ishin një provë

se media e pavarur e forcuar me gazetarinë profesioniste mund të jetë një forcë e përdorur për të bërë mirë.

Raportimet nga vendi i ngjarjes, perspektiva e transmetimit dhe publikimit të ngjarjeve me interes njerëzor ilustroi se si media kontribuoi në ndërtimin e konfidencës së publikut duke promovuar debatin publik, duke dhënë informacione që ekspozonin korrupsionin dhe shpjegonin impaktin që kishte kjo mbi jetët e njerëzve. E ndërsa gazetarët mund të bëjnë mirë, ky nuk është qëllimi i tyre. Edhe pse shumë gazetarë mund të nënshkruajnë petitionin për një pluralizëm demokratik dhe respekt për të drejtat e njeriut, pak prej tyre duan që t'u thuhet që të ndjekin një politikë apo strategji të caktuar.

Gjatë viteve të fundit është e dukshme se gazetarë të medias së shkruar dhe asaj elektronike vërejnë se çështja e të drejtave të njeriut ka më shumë vlera lajmi për ta sesa kishte vite më parë. Media është bërë e interesuar jo vetëm në dhunimet që i bëhen të drejtave të njeriut por edhe në aparatin institucional që është dizenuar të promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut. Paralelisht me këtë, një numër i madh organizatash jo fitimprurëse janë krijuar e formuar si pjesë e shoqërisë civile në fusha të caktuara. Veçanërisht organizatat e të drejtave të njeriut monitorojnë dhunën kundër këtyre të drejtave, llobojnë për reforma në këtë fushë dhe e ushqejnë shtypin e median e lirë me informacione nga ky subjekt.

Por edhe pse pranojmë se gazetarët e kanë zgjeruar raportimin e tyre për çështje të të drejtave të njeriut në fusha të reja, sërish mbetet fakti se shumë çështje të kësaj fushe mbeten pothuajse të pa raportuara. Të drejtat e njeriut gjerësisht duket sikur trajtohen nga pikëpamja politike dhe e të drejtave civile, ndërsa rëndësia e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore përfshirë edhe varfërinë, pabarazinë dhe diskriminimin social dhe ekonomik injorohet²³⁹.

Me çfarë cilësie ndodhin raportimet mediatike që kanë të bëjnë

²³⁹ Journalism, Media and the Challenge of Human Rights Reporting, 2002, International Council on Human Rights Policy, ATAR Roto Press SA, 1214, Vernier, Switzerland

me të drejtat e njeriut, ky është një diskutim tjetër. E ndërsa të dhënat për raste dhune ndaj këtyre të drejtave nuk mungojnë, impakti i këtij informacioni tek publiku nuk është aq i madh saç pritet. Kjo ishte edhe arsyeja se pse shumë organizata të të drejtave të njeriut e ri panë qëndrimin e tyre ndaj informacionit publik dhe advokacisë.

Në Shqipëri, mass media është burimi më i rëndësishëm i informacionit për dhunimet që i bëhen të drejtave të njeriut. As eksperiencat personale as OJF-të e kësaj fushe nuk janë kaq domethënëse. Për shumicën e njerëzve, televizioni, radio dhe gazetat janë burimi i tyre i vetëm i informimit. Këta të fundit zgjedhin se cilat janë ngjarjet dhe vendet për të cilat ne duhet të mësojmë diçka, ata vendosin se kush ngjarje merr vlera lajmi, ata kontekstualizojnë problemin, ata përcaktojnë axhendën politike si dhe krijojnë një ndërgjegjësim për çështjet e të drejtave të njeriut. Media e bën këtë përmes dy rrugëve të dukshme.

Së pari, mediat janë gjeneratorët dhe burimet e informacionit. Nën suazën e rubrikave të tilla si “lajme nga bota” për shembull reporterët mbledhin, procesojnë dhe prezantojnë shumicën e informacioneve që ne marrim për dhunimet që ju bëhen të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Pra janë ata agjentët politikë dhe moralë që vendosin se ta nënvizojnë një ngjarje të veçantë, të mbajnë qëndrime të qarta editoriale, të bëjnë thirrje se “duhet bërë diçka”.

Së dyti, pavarësisht rolit të tyre të pavarur si prodhues të informacionit, mediat janë bartësit e informacionit që vjen nga organizatat e të drejtave të njeriut. Pra me pak fjalë media është moderator mes këtyre organizatave dhe publikut të gjerë.

Roli i një gazetari është të raportojë ngjarje dhe fakte. Shumica e gazetarëve nuk besojnë se ata e kanë për detyrë të privilegjojnë raportimin për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Edhe media është target i lobimit nga ana e qeverisë, nga kompanitë private, OJQ-të që llobojnë. Media më shumë reflekton sesa krijon influencën politike, por sigurisht kjo nuk ju heq përgjegjësinë gazetarëve.

Edhe shumica e konsumatorëve nuk mendon se të drejtat e

njeriut duhet të privilegjojen. Konsumatorët lexojnë, shikojnë ose dëgjojnë lajmet për shumë arsye, duke përfshirë këtu edhe arsyen e zbavitjes. Është e drejta e tyre që ta bëjnë këtë. Për këtë arsye, marrin ato lajme që duan. Por si mund të raportohen në mënyrë të saktë të drejtat e njeriut? Dhe si të komunikohen në një mënyrë që të jetë interesante për audiencën?

Nga ana tjetër, organizatat e të drejtave të njeriut përballohen me të njëjtat dilema. A duhet ato të jenë të pavarura në tregun e informacionit apo duhet të përpiqen të influencojnë axhendën e lajmeve? Vetë OJQ-të janë një burim alternative lajmesh. Ato prodhojnë publikimet e tyre dhe kanë deri diku një lloj influence në mbulimin e lajmeve për të drejtat e njeriut. Por kjo sa vjen e bëhet më e vështirë. Një çështje e të drejtave të njeriut bëhet legjitime kur mbështetet nga opinioni publik dhe media²⁴⁰. Megjithatë shumë mundësi të reja ofrohen nga ato që quhen mediat e reja. Shumë gazetarë dhe organizata mediatike i përdorin organizatat e të drejtave të njeriut si burimin e tyre të parë të informacionit. Problemi për OJQ-të është që t'i mbajnë televizionet e mëdha si Top Channel apo Klan të interesuara por pa i kthyer në sensacion çështjet që ato duan të hedhin në transmetim. Kjo e bën imperativ koordinimin më të mirë mes stafeve mediatike dhe organizatave të të drejtave të njeriut. Organizata të mëdha si Amnesty International, Artikulli 19, Human Rights Watch, etj kanë krijuar zyrat e tyre të mëdha ndërkombëtare të shtypit për të artikulluar shqetësimet e tyre në New York apo Bruksel²⁴¹.

Për të parë më nga afër gjithë sa thamë më sipër, kemi marrë në shqyrtim se si u raportua nga media rasti i djegies së disa banesave rome në një vend ku pretendohet të ngrihet një pallat.

Më datë 16 mars 2011, VOA (Zëri i Amerikës) pati këtë kokë

²⁴⁰ Ninan Thomas Pradip, "Safeguarding Human Rights: Opportunities and Challenges for NGOs involved in the Democratisation of Communication", in Asian Media Information and Communication Centre, Media and Human Rights in Asia, Singapore: AMIC, 2002, p. 14.

²⁴¹ James Curran and Myung-Jin Park, *De-Westernizing Media Studies*, London: Routledge, 2000.

lajmi në mbulimin e kësaj ngjarje: “OSBE, SHBA dhe BE kërkojnë mbrojtje dhe kujdes për romët e dhunuar”. Një ditë më pas, në datë 17 mars gazeta “Telegraf” raportonte “Drejtësia të hetojë Gërdecin dhe shpërnguljen e romëve” **Tre vjet pas shpërthimit në Gërdec, Komisioni Evropian bën apel për hetim të akteve që çuan në këtë tragjedi dhe që personat e përfshirë të dënohen”.**

Më datë 18 mars, në edicionin qendror të lajmeve Top Channel raportoi **“Romët në mëshirë të fatit”**

“Organizata që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut kanë përfituar financime për projekte të ndryshme për të mbështetur integrimin e këtij komuniteti. Romët tregojnë se të vetmet përfitime që kanë marrë ka qenë regjistrimi në gjendjen civile dhe një pako modeste ushqimesh.

Gjatë vitit 2008 deri në 2010, organizatat joqeveritare kanë përfituar rreth 5 milionë euro nga donatorë të huaj vetëm për romët.

Këto para duhet të shfrytëzoheshin për ri integrimin e tyre në shoqëri. Në Elbasan numërohen të paktën 600 familje ku 400 prej tyre janë përqendruar në lagjen “5 maji” në vendin e quajtur Rrapishtë.

Të premtën, në Ministrinë e Punës, është zhvilluar një takim me të gjitha organizatat që kanë përfituar donacione për të ndihmuar komunitetin rom, ku është vendosur që ditën e hënë të diskutohet për godinat ku do të qëndrojnë përfundimisht 45 familjet rome.

Zyra e shtypit në Ministrinë e Punës ka sqaruar se organizatat kanë marrë përsipër shpërndarjen e të gjitha materialeve që u duhen familjeve në këto ditë.

Ndihma të cilat, mesa duket nuk kanë mbërritur ende në duart e këtyre familjeve.”

Po në këtë datë, televizioni ABC News raportonte “Romët e shpërngulur, banorët: S’kemi ushtruar dhunë raciste ndaj tyre. Policia arrestoi 2 persona për konfliktin që shkaktoi shpërnguljen e 20 familjeve rome”.

Një ditë më pas, me datë 19 mars Gazeta Shqip botoi artikullin, “Arsyeja e shpërnguljes, banorët dyshojnë për afera ndërtimesh”

“Ndërsa një tjetër, i cili i përket komunitetit rom, shpreh bindjen

se në lojë mund të jenë edhe shoqatat, që kërkojnë të marrin ndonjë fond për mbrojtjen e romëve e që më pas i përdorin vetëm për fitime vetjake. Të gjitha veprimet e kryera së fundmi, sipas tyre, kanë një prapavijë të menduar mirë për fitime të mëdha.”

Mjafton kjo ngjarje e mbulimet me tonalitete të ndryshme për të bërë pyetjet që ka edhe audienca me të drejtë; kush ka të drejtë, kush e shkaktoi këtë gjendje realisht e kush po vjedh paratë????

Kjo ngjarje që nga raportimet e para dukej sikur do zgjidhte çështje të mëdha korruptive me të drejtat e romëve në Shqipëri, mbeti pa përgjigje si dhe shumë çështje të tjera korruptive që përbëjnë lajm, vetëm nëse aty është i përfshirë ndonjë politikan apo kjo ngjarje ka kontekst politik. Në një cep të vogël të gazetës, Gazeta Shekulli shkruante më 28 mars “Romet e dëbuar refuzojnë çadrat ne periferi”. Askush nuk foli më për këtë ngjarje, askush nuk zbuloi korrupsion nga qeveria apo OJQ-të që merren me të drejtat e popullsisë romë në Shqipëri. Njerëzit e harruan këtë ngjarje si dhe shumë ngjarje të tjera ku të drejtat e njeriut merren nëpër këmbë në mënyra çnjerëzore e kjo ngjarje vetëm do të shërbejë si një background kur një ngjarje tjetër që përfshin komunitetin rom të dalë sërish në skenë.

BIBLIOGRAFIA

1. John Keane, “Democracy and the Media”, International Social Science Journal 129, August 1991,
2. James Curran and Myung-Jin Park, De-Westernizing Media Studies, London: Routledge, 2000.
3. Michael Ignatieff, “Is Nothing Sacred? The Ethics of Television”, in Michael Ignatieff, The Warrior’s Honor - Ethnic War and the Modern Conscience, London: Chatto and Windus, 1998
4. Ninan Thomas Pradip, “Safeguarding Human Rights: Opportunities and Challenges for NGOs involved in the Democratisation of Communication”, in Asian Media Information and Communication Centre, Media and Human Rights in Asia,

Singapore: AMIC, 2002

5. Journalism, Media and the Challenge of Human Rights Reporting, 2002, International Council on Human Rights Policy, ATAR Roto Press SA, 1214, Vernier, Switzerland

6. Artikulli 19, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara

7. John Naughton, "With the Rusty Sword of Truth – Television's Influence and the Systemic Crisis in Serious Journalism", Times Literary Supplement, July 24, 1998

8. David Morgan, "Mass Media and the Policy Process", in Emirates Centre for Strategic Studies and Research, The Information Revolution and the Arab World – Its Impact on State and Society, London: I.B. Tauris, 2008

Albana SHTYLLA (Ma)²⁴²

ORGANIZATAT E SINDIKALE DHE ROLI I TYRE NE GARANTIMIN E TE DREJTAVE TE PUNEMARESVE, QË BUROJNË NGA MARRËDHËNIA JURIDIKE E PUNËS

E drejta e organizimit të punëmarrësve në organizatat e tyre sindikale, është një e drejtë e përcaktuar në nenin 50 të Kushtetutës, sipas të cilit “të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës”.

Gjithashtu në Kushtetutën e RSH, në tërësinë e të drejtave që përshkruhen dhe rregullohen nga akti themelor, përcaktohet dhe e drejta për punësim. Sipas nenit 49 të Kushtetutës “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme...”. Pra neni 49 i Kushtetutës së RSH përshkohet nga parimi i lirisë përsa i përket të drejtave për punësim. Shteti në këtë dispozitë përvijëzohet si një shtet i cili merr përsipër rolin e garantit, duke e njohur me ligj të drejtën personit që të sigurojë mirëqenien e tij me punë të ligjshme.

Pra sipas përcaktimeve të sipërcituara të Kushtetutës, çdo punëmarrës/person, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe individual, ka të drejtë të anëtarësohet në një organizatë sindikale në mënyrë që të garantojë fitimin e mjeteve të jetesës së tij me një punë të denjë dhe të ligjshme. Ligjvënësi në këtë përcaktim kushtetues ka theksuar së kjo e drejtë e organizimit e punëmarrësve duhet të ushtrohet vetëm për mbrojtjen e interesave të punës, dhe për asnjë qëllim apo objekt tjetër. Mbështetur në nenet e

²⁴² Drejtore e Drejtorisë Juridike, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Doktorante, UT

sipërpërmendura të Kushtetutës, të parimeve dhe të drejtave të njohura në to, ligjoënësi ka miratuar Kodin e Punës së R. Sh, në brendinë e të cilit ka dispozita të cilat sanksionojnë me tej këto të drejta. Legjislacioni shqiptar i punës ka për qëllim jo vetëm njohjen në aspektin formal të këtyre të drejtave, por edhe njohjen e tyre në aspektin thelbësor, me qëllim garantimin e tyre si dhe marrjen e masave për zbatim.

Kodi i Punës ka të shprehur në përmbajtjen e tij parimet dhe normat e vendosura nga Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për “Të drejtën e organizimit”, apo “Për liritë sindikale”, të ratifikuara nga RSH, si dhe ato të sanksionuara në Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar, të cilat janë parime dhe norma mbizotëruese ndaj rregullimeve apo përcaktimeve të legjislacionit shqiptar të punës. Ndërkohë, Shqipëria vazhdon me intensitet procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar të punës me *acquis communautaire* të BE në fushën e marrëdhënieve juridike të punës. Duhet theksuar se gjatë këtij procesi spikat orientimi dhe adresimi i dy momenteve thelbësore në trajtimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e punëmarrësve. Këto aspekte kanë të bëjnë, së pari me karakterin garantues të lirive dhe të drejtave të shtetasve, pra me konsolidimin e një shoqërie të qeverisur nga shteti ligjor, me objektiv mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në të cilat një vend të rëndësishëm zënë edhe të drejtat e punëmarrësve, dhe së dyti me karakterin social, duke parashtruar mënyrat e ndërhyrjes së shtetit në favor të grupeve me vulnerabël të shoqërisë.

Sipas dispozitave të Kreut XVI të Kodit të Punës, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata sindikale, të cilat në kuptimin formal juridik, funksionojnë si organizata shoqërore, të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të anëtarëve të tyre.

Organizatat e punëmarrësve kanë një rol të rëndësishëm në efektivitetin e zbatimit të marrëdhënieve juridike të punës, nëpërmjet ndërjegjësisimit të punëmarrësve për rëndësinë e

organizimit dhe veprimtimit sindikal jo vetëm në drejtim të garantimit të të drejtave individuale të punës, por edhe në mbrojtjen e tyre profesionalisht, juridikisht dhe ekonomikisht.

Gjithashtu në dispozita të posaçme të Kodit të Punës parashikohen, mjetet dhe format ligjore të ndërhyrjes së organizatave të punëmarrësve, për garantimin e të drejtave që burojnë nga marrëdhëniet juridike kolektive të punës.

Në këtë punim do të përpiqem të trajtojë disa nga instrumentet ligjore që Kodi i Punës ju ka njohur organizatave të punëmarrësve, natyrisht duke u përqendruar jo në të gjithë tematikën e rregullimit ligjor nga Kodi i Punës, por në ato më kryesoret, që i bëjnë ato një aktor kryesor në zhvillimin e dialogut social për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.

Kodi i Punës trajton juridikisht statusin dhe veprimtarinë e sindikatës në nenet 160 deri në 203, dhe konkretisht rolin e tyre në çështjet e: kontraktimit kolektiv, të drejtës së grevës dhe zgjidhjes së konflikteve të punës.

Kontraktimi kolektiv

Kontrata kolektive është një nga burimet më të rëndësishme profesionale të marrëdhënieve të punës, ajo ka përparësi ndaj rregullimeve juridike individuale të punës, si dhe mund të parashikojë dispozita për trajtime më të favorshme ndaj punëmarrësve nga sa parashikon vetë legjislacioni i punës në fuqi.

Në nenet 160 deri në 165 të Kodit të Punës trajtohen subjektet të cilat legjitimohen si palë në fillimin e negociatave, bisedimeve për lidhjen e një kontratë kolektive, por edhe procedura që ato duhet të ndjekin që të njihen si të tilla nga pala punëdhënëse. Kodi ka shprehur në mënyrë eksplicite së nga pala punëmarrëse, legjitimon si palë që ka të drejtë të marrë përsipër detyrime por edhe të ketë të drejta në kuadër të marrëdhënies juridike kolektive, organizatën e punëmarrësve, ndërkohë që për palën tjetër përcaktohet si palë e mundshme si vetë punëdhënësi ashtu edhe organizata e punëdhënësve ku ai aderon.

Pra sipas këtij përcaktimi të Kodit të Punës, punëmarrësit duhet të jenë të organizuar detyrimisht në një organizatë, me qëllim që të kenë të drejtë të sigurojnë një rregullim kolektiv të marrëdhënies së tyre të punës. Ky përcaktim ligjor nuk ka për qëllim që të pengojë apo kufizojë punëmarrësit në garantimin e të drejtave të tyre, por synon që të nxisë organizimin dhe reagimin kolektiv si një mjet më i ndjeshëm, efektiv dhe i fuqishëm ndaj punëdhënësit.

Sipas nenit 163 të Kodit të Punës, vetëm organizata/at e punëmarrësve e cila/të cilat është/janë me të përfaqësuar/përfaqësuarat në ndërmarrje ka/kanë të drejtën që t'i kërkojë/kërkojnë punëdhënësit/organizatës së punëdhënësit për fillimin e bisedimeve për negociimin e një kontrate kolektive.

Ky përcaktim ligjor nuk ka për qëllim përjashtimin e një apo disa organizatave të tjera të punëmarrësve, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto ndërmarrje. Qëllimi i ligjvënësimit në këtë dispozitë ligjore është që të rrisë forcën e përfaqësimit dhe të reagimit të punëmarrësve në këtë fazë të rëndësishme të lindjes së marrëdhënies juridike kolektive. Sa më e përfaqësuar të jetë një organizatë punëmarrësish aq më i fortë është pushteti i saj në fazën e negociimit të kontratës kolektive dhe në garantimin në të, të të drejtave që burojnë për punëmarrësit nga legjislacioni i punës. Kur flasim për shfaqje të forcës apo të pushtetit të organizatës së punëmarrësve gjatë negociimit të kontratës kolektive, duhet të kemi në konsideratë forcën apo pushtetin e saj brenda përcaktimeve ligjore të Kodit të Punës, formave dhe procedurave të parashikuara në të.

Megjithatë shpeshherë gjatë zbatimit në praktikë të këtyre neneve të Kodit të Punës, është vënë re se organizatat e punëmarrësve, nuk kanë shfrytëzuar maksimalisht lirinë e njohur nga dispozitat e këtij Kodi, për të garantuar të drejta më të favorshme për punëmarrësit që ato përfaqësojnë. Në praktikë vërehen kontrata kolektive standarde dhe gati identike me kontratat individuale të punës, pa përcaktime impenjative për punëdhënësit lidhur me detyrimet që ai duhet të përmbushë për të përmirësuar të drejtat e punëmarrësve, gjatë periudhës së

vlefshmërisë së kontratës kolektive. Në një analizë të fundit që mund t'i bëj shkaqeve që sjellin një nivel të ulët mbrojtje në kontratat kolektive të negociuara nga organizatat e punëmarrësve, mund të theksoj se ky nivel i përmbajtjes së kontraktimit kolektiv, është reflektim i drejtpërdrejtë gjithashtu edhe i nivelit të ulët të zhvillimit të marrëdhënieve industriale, i mungesës së një tradite dhe kulture të rrënjosur të kontraktimit dhe dialogut social, si dhe së fundi produkt i ekzistencës së organizatave të dobëta të punëmarrësve. Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikim në këtë nivel të kontraktimit është edhe ekzistenca e punës informale dhe presionit që ushtrohet nga punëdhënësit mbi punëmarrësit për vazhdimin e një marrëdhënie juridike punë informale.

Kodi i Punës në nenin 169 të tij, përcakton detyrimin që mbartin organizatat e punëmarrësve, nënshkruese të kontratës kolektive, për zbatimin e dispozitave të kontratës nga anëtarët e tyre, apo për detyrimin e paqes gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj. Pra në një kuptim të caktuar sipas ligjvënësit, organizatat e punëmarrësve jo vetëm kanë një rol të rëndësishëm në parashikimin në kontratat kolektive të të drejtave të punëmarrësve, por edhe në drejtim të garantimit dhe zbatimit, nga anëtarët e saj, të detyrimeve që ato marrin përsipër në këtë marrëdhënie kolektive të punës.

E drejta e grevës

E drejta e grevës buron nga Kushtetuta e R. Sh, e cila në nenin 51, pika 1 përcakton së "e drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës është e garantuar". Pra në këtë dispozitë të aktit themelor është përcaktuar roli garant i shtetit për ushtrimin e kësaj të drejtë nga çdo punëmarrës, me kusht që kjo grevë të ndërmerret vetëm për çështje që lidhen me marrëdhëniet e punës. Për më tepër në pikën 2 të këtij neni të Kushtetutës, është përcaktuar së kjo e drejtë mund të kufizohet me ligj për kategori të veçanta punëmarrësish, me qëllim që shoqërisë t'i sigurohen shërbimet e domosdoshme. Pra në këtë pjesë të dispozitës, është vendosur një klauzolë ligjore e cila përcakton së nga ushtrimi i kësaj

të drejtë mund të privohen vetëm kategori të caktuara punonjësish, por edhe këta përjashtohen vetëm për një qëllim të caktuar, që është garantimi i shërbimeve të domosdoshme për shoqërinë.

Për një zberthim të plotë ligjor të ushtrimit të së drejtës së grevës, në nenet 197-198 të Kodit të Punës, përcaktohen rregulla të detajuara lidhur me, kushtet e përgjithshme, subjektet që mund të ushtrojnë këtë të drejtë, pjesëmarrjen në grevë, ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në të, llojet e grevave që mund të ndërmerren, gjendjet e veçanta apo shërbimet e rëndësishme jetike etj.

Sipas nenit 197, pika 2 dhe nenit 197, pika 1 të Kodit të Punës, organizatat e punëmarrësve të cilat kanë personalitet juridik, kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e grevës për zgjidhjen e kërkesave të tyre ekonomike dhe shoqërore. Pra sipas kësaj pike, së pari subjekti i cili legjitimohet për të ushtruar këtë të drejtë në emër të punëmarrësit është vetëm organizata e punëmarrësve, me personalitet juridik që ushtron aktivitetin e saj pranë një punëdhënësi të caktuar, dhe së dyti kjo e drejtë duhet të ushtrohet prej saj për zgjidhjen e kërkesave ekonomike dhe shoqërore të punëmarrësve. Në mënyrën së si është formuluar kjo dispozitë e Kodit të Punës, duket sikur ajo tejkalon përcaktimin e Kushtetutës, që e lidh ushtrimin e të drejtës së grevës vetëm me marrëdhëniet e punës. Në fakt marrëdhënia juridike e punës ka në përmbajtjen e saj si elementë ekonomik ashtu dhe shoqëror, pra në përmbajtjen e saj trajtohet shpërblimi i punës, pjesëmarrja në fitim, rritja e mirëqenies sociale të punëmarrësit (mbulimin me sigurime shoqërore), mbrojtja shoqërore e punës. Pra, parë në këtë kontekst, theksoj së përcaktimi i bërë në Kodin e Punës nuk tejkalon dispozitën e Kushtetutës, por e trajton atë në përmbajtjen dhe thelbin e marrëdhënies së punës. Pra në analizë të fundit, ushtrimi i të drejtës së grevës nga organizata e punëmarrësve bëhet me qëllim garantimin dhe respektimin e të drejtave të punëmarrësve në marrëdhënien juridike të punës.

Pjesëmarrja në grevë e punëmarrësve sipas Kodit të Punës është vullnetare, dhe askush nuk mund të detyrohet të marrë pjesë në

një grevë kundër dëshirës së tij. Pra pjesëmarrja në grevë e punëmarrësve, në asnjë rast, nuk duhet të jetë e detyruar as nga drejtuesit e organizatës së punëmarrësve në të cilën ai është anëtar.

Sipas nenit 197/3, pika 2, ushtrimi i të drejtës së grevës do të konsiderohet i ligjshëm, nëse organizata e punëmarrësve ndërmerr një grevë për nënshkrimin e një kontrate kolektive punë ose nëse ka një të tillë, për plotësimin e kërkesave që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe që nuk rregullohet nga kjo kontratë, me përjashtim të rasteve kur kontrata parashikon detyrimin absolut të paqes, si dhe pasi palët (organizata/ t e punëmarrësve dhe punëdhënësi/ organizata e punëdhënësve) kanë konsumuar paraprakisht procedurën e ndërmjetësimit dhe të pajtimit.

Në përcaktimet e mësipërme të Kodit të Punës, theksi vihet në faktin që organizata e punëmarrësve, në çdo rast ushtrimin e të drejtës së grevës duhet ta ketë të ndërlidhur me marrëdhënien e punës, pavarësisht nëse ende ajo nuk është formalizuar nga pikëpamja juridike. Nëse ka një marrëdhënie të formalizuar në këndvështrimin juridik, dispozita i ka krijuar mundësinë organizatës së punëmarrësve që për çështje që nuk janë rregulluar në brendinë e saj, ajo të ketë të drejtën që të organizojë lëvizjen dhe veprimtarinë e saj, me qëllim maksimizimin e përpjekjeve për të garantuar të drejtat e punëmarrësve. Gjithsesi, ligjvënësi është shprehur që për përdorimin e kësaj të drejte, palët duhet që paraprakisht të jenë përpjekur për zgjidhjen e saj me procedurat e ndërmjetësimit.

Lidhur me garantimin e të drejtës për grevë, Kodi i Punës në nenin 197/2, ka përcaktuar të njëjtin nivel mbrojtje të së drejtës për punë të atyre punonjësve që në situatë greve dëshirojnë të punojnë, por njëkohësisht mbron nga përdorimi i forcës dhe nga arbitrariteti i punëdhënësve ata që duan të bëjnë grevë të ligjshme.

Në përputhje me parashikimin Kushtetues për garantimin e shërbimeve të domosdoshme për shoqërinë, gjatë kohës së ushtrimit të grevës, në nenin 197/5 të Kodit të Punës, përcaktohet ndalimi i grevës në ato aktivitete që klasifikohen si shërbime jetike, ndërkohë që në nenin 197/6 nuk lejohet ushtrimi i të drejtës së grevës në

sektorin e shërbimeve për plotësimin e nevojave të rëndësisë themelore të popullsisë, në rast se nuk sigurohen shërbimet minimale. Në mënyrën së si janë hartuar këto dispozita, dhe duke pasur parasysh edhe terminologjinë e përdorur në to, duket sikur ka një përplasje ndërmjet tyre, pra në nenin 197/5 kemi një ndalim të grevës në shërbimet jetike, ku përfshihen edhe ato të rëndësisë themelore të popullsisë, ndërkohë që në nenin 197/6 përcaktohet së në këta sektorë të fundit mund të ushtrohet kjo e drejtë por me kusht që të sigurohen shërbimet minimale. Pra brenda dispozitave të Kodit të Punës ka një standard dhe përcaktim të dyfishtë për të njëjtat shërbime, duke krijuar në këtë mënyre situata të paqarta ligjore, të cilat në analizë të fundit mund të sjellin, së pari mohim të së drejtës për ushtrimin e grevës, dhe së dyti një mbrojtje jo të mirë dhe të plotë të të drejtave të punëmarrësve në këto shërbime. Sipas pikës 2 të nenit 51 të Kushtetutës, nuk mund të kemi mohim të së drejtës për grevë, nga organizata e punëmarrësve në këto sektorë shërbimesh në bllok, por vetëm kushtëzim të kësaj të drejte duke garantuar shërbimet e domosdoshme për shoqërinë. Në këtë kontekst vlerësoj se duhet të ketë një reformulim të nenit 197/5 dhe nenit 197/6 në mënyrë që përcaktimet në to të jenë të përputhura me kushtëzimin e Kushtetutës.

Neni 197/7 i Kodit të Punës përkufizon si të ligjshme grevën e solidaritetit nëse ajo mbështet një grevë të ligjshme që ndërmerret ndaj një punëdhënësi, në ndihmë të të cilit punëdhënësi i grevistëve solidarë jep mbështetje aktive për të ndaluar ose përfunduar grevën. E përkufizuar në këtë mënyrë, greva e solidaritetit kufizon lirinë sindikale të organizatave të punëmarrësve, karakterin solidar të kësaj lëvizje. Pa solidaritetin e punëmarrësve për të garantuar të drejtat e tyre në marrëdhënien e punës, nuk mund të ketë sindikalizëm. Mbi sa më sipër, vlerësoj se duhet të ketë një reformulim të konceptit të grevës solidarë, me qëllim që të mos kemi kufizim të lirisë sindikale, për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.

Zgjidhja e konflikteve kolektive të punës

Konfliktet kolektive të punës janë pjesë përbërëse e zbatimit të

marrëdhënieve juridike kolektive të punës, dhe pikërisht lidhur me to Kodi i Punës institucionalizon zgjidhjen e tyre me pajtim, ndërmjetësim, arbitrim apo në rrugë gjyqësore.

Në kreun XVII të Kodit të Punës, përcaktohen përkufizimi i konfliktit kolektiv²⁴³, nivelet e shqyrtimit dhe negocimit të konfliktit, procedurat e trajtimit të konflikteve kolektive nga palët etj.

Edhe në rastin e konflikteve kolektive, Kodi i Punës njeh si palë të procesit të zgjidhjes së këtij konflikti organizatën/at e punëmarrësve dhe punëdhënësin ose organizatën e punëdhënësve, pra përfaqësues të punëmarrësve në këtë proces për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, janë organizatat e tyre.

Neni 189 të Kodit të Punës, përcakton së zyrat e pajtimit kanë në përbërjen e tyre organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve dhe të punëdhënësve. Pra sipas këtij përcaktimi ligjor në zyrat e pajtimit marrin pjesë organizatat e punëmarrësve/punëdhënësve më të përfaqësuara në territorin gjeografik ku e shtrin aktivitetin zyra e pajtimit, e cila jo domosdoshmërisht është organizata e punëmarrësve që ka nënshkruar kontratën kolektive për të cilën ka lindur konflikti. Organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve kanë një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit të palëve, vetëm në rastet e konflikteve për kontratat kolektive, kur kjo e fundit nuk ka të parashikuar në përmbajtjen e saj një procedurë pajtimi të mjaftueshme. Pra palët, në kontratën kolektive të punës mund të kenë rënë dakord edhe për një procedurë pajtimi tjetër ndërmjet tyre, duke angazhuar në të organizatën e punëmarrësve nënshkruese të kontratës kolektive.

Gjatë procesit të pajtimit në zyrën e pajtimit palët thirren për t'u paraqitur në seancën e shqyrtimit dhe marrin pjesë në debate duke paraqitur argumentet, dokumentet dhe të dhënat që kërkon zyra. Në përfundim të procesit zyra e pajtimit paraqet një propozim

²⁴³ Neni 188 i Kodit të Punës "Me konflikt kolektiv kuptohet çdo konflikt ndërmjet disa punëmarrësish, një ose disa organizata punëmarrësish, nga njëra anë, dhe një ose disa punëdhënësish ose një ose disa organizata punëdhënësish, nga ana tjetër"

për palët për zgjidhjen e konfliktit kolektiv, ndërkohë që janë përsëri palët ato (pra organizata e punëmarrësve dhe e punëdhënësi) të cilat vendosin përfundimisht për pranimin ose jo të propozimit të zyrës së pajtimit. Pra sipas procedurës së parashikuar në Kodin e Punës dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, pavarësisht se organizata e punëmarrësve nënshkruese e kontratës kolektive, mund të mos jetë organizata anëtare e zyrës së pajtimit, në fund të procesit të pajtimit do të jetë pikërisht ajo që do të vendosë bashkë me punëdhënësin/organizatën e punëdhënësve për mënyrën e zgjidhjes së konfliktit kolektiv, duke garantuar në këtë mënyrë mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve të cilët ajo përfaqëson.

Përfundime:

1. Kodi i Punës ka të shprehur në përmbajtjen e tij parimet dhe normat e vendosura nga Kushtetutën e R. Sh, Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për “Të drejtën e organizimit”, apo “Për liritë sindikale”, të ratifikuara nga RSH, Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar, të cilat janë parime dhe norma mbizotëruese ndaj rregullimeve apo përcaktimeve të legjislacionit shqiptar të punës.

2. Organizatat e punëmarrësve luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e nënshkrimit të kontratës kolektive, si dhe gjatë zbatimit të saj. Ato gjatë këtyre proceseve përfaqësojnë interesat e punëmarrësve, për të garantuar një punë në kushte të denja për ta, në përputhje me të drejtat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Organizatat e punëmarrësve duhet të rrisin forcën e përfaqësimit dhe të reagimit të punëmarrësve në fazën e lindjes së marrëdhënies juridike kolektive të punës. Sa më e përfaqësuar të jetë një organizatë punëmarrësish aq më i fortë është pushteti i saj në fazën e negociimit të kontratës kolektive dhe në garantimin në të, të drejtave që burojnë për punëmarrësit nga legjislacioni i punës.

4. Organizatat e punëmarrësve kanë një rol të rëndësishëm jo vetëm në parashikimin në kontratat kolektive, të të drejtave të punëmarrësve, por edhe në drejtim të garantimit, nga anëtarët e

saj, të detyrimeve që ato marrin përsipër në këtë marrëdhënie kolektive të punës.

5. Organizatat e punëmarrësve të cilat kanë personalitet juridik, kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e grevës për zgjidhjen e kërkesave të tyre ekonomike dhe shoqërore. Pra këto organizata e ushtrojnë këtë të drejtë në emër të punëmarrësit dhe për zgjidhjen e kërkesave ekonomike dhe shoqërore të tyre.

6. Greva e solidaritet në përkufizimin që ka sot në Kodin e Punës, kufizon lirinë sindikale të organizatave të punëmarrësve, karakterin solidar të kësaj lëvizje. Pa solidaritetin e punëmarrësve për të garantuar të drejtat e tyre në marrëdhënien e punës, nuk mund të ketë sindikalizëm. Mbi sa më sipër, vlerësoj së duhet të ketë një riformulim të konceptit të grevës solidare, me qëllim që të mos kemi kufizim të lirisë sindikale, për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.

7. Organizatat e punëmarrësve janë aktore të rëndësishëm të procedurave të zgjidhjes së konflikteve kolektive të marrëdhënieve të punës, dhe veçanërisht të atyre të zhvilluara në zyrat e pajtimit.

BIBLIOGRAFIA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);

Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për të drejtën e organizimit”;

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për liritë sindikale”;

Karta Sociale Evropiane e Rishikuar;

Elizabeta IMERAJ (Ma)²⁴⁴

**BASHKËPUNIMI I PROKURORIT ME ORGANIZATAT
JOFITIMPRURËSE, PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE
TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE
NJERËZORE.**

Rastet e dëmshpërblimit.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një ndër prioritet më të mëdha për shoqërinë në përgjithësi dhe për organin e ushtrimit të ndjekjes penale, në veçanti.

Organi i akuzës drejton hetimin dhe kryen të gjitha veprimet që i çmon të nevojshme në funksion të zgjidhjes së çështjes, duke realizuar kështu ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese.

Në realizimin e detyrave të tij, prokurori bëhet “bashkudhëtar” me një sërë institucionesh të tjera, duke përfshirë dhe OJF-të. Praktika e viteve të fundit ka nxjerrë në pah, një bashkëpunim të frytshëm me OJF-të, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në trajtimin e rasteve të ndryshme. Bashkëpunimi i ngushtë me OJF-të, na krijon lehtësira në kuadër të zbatimit me përpikëri të ligjit, i cili parashikon një trajtim të posaçëm për viktimën e trafikimit.

Bashkëpunimi me OJF-të ka ardhur gjithnjë e në rritje duke u reflektuar në rezultatet e punës dhe një ndikim të mbarë në ecurinë e procesit. Nëpërmjet bashkëpunimit, arrijmë tu sigurojmë viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore trajtimin ekonomik kur

²⁴⁴ Prokurore në Prokurorinë për Krime të Rënda, Tiranë, Doktorante, UT

ato kanë nevojë dhe trajtimin psikologjik që është i nevojshëm në çdo moment.

Në praktikën e përditshme, vepra penale, subjekti i saj dhe viktimat duhen trajtuar si pjesë e të njëjtit problem, të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe jo si çështje të ndara, siç mundet të jetë trajtuar në kohë të ndryshme.

Kjo bëhet në funksion të luftës me efikasitet kundër kriminalitetit dhe realizimit të interesit parësor, “mbrojtjes së shoqërisë në përgjithësi”.

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë ecurinë e tyre, që nga momenti i parë i ndodhjes së veprës penale e në vazhdimësi. Gjatë gjithë kësaj ecurie, ne vëmë re se viktimat e trafikimit përballen, ose më saktë kalojnë në disa faza që e bëjnë pozitën e tyre vulnerabël.

Ajo çfarë ne, duhet të mbajmë parasysh dhe ajo çfarë tejçon frymën e legjislacionit në fuqi, në përjashtë dhe me legjislacionin ndërkombëtar, ka të bëjë me një trajtim dinjitoz të personave që janë dëmtuar nga vepra penale.

Në varësi të fazave, në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit në aspektin procedural, një moment i rëndësishëm për tu trajtuar është tërësia e parashikimeve ligjore, të cilat sigurojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Me konceptin “viktimitë krimi”, kuptojmë personat, të cilët individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike ose mendore, tronditje psikike, humbje ekonomike, ose përkeqësim të të drejtave të tyre themelore, me anë të veprimeve apo mosveprimeve të subjekteve të krimit.

Në kuadrin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe në referencë të mënyrave të kryerjes së këtyre veprave, viktimat e trafikimit do të quhen personat që janë vënë në pozita të tilla që lidhen me shfrytëzimin për prostitucion, realizimin e formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin për punë, shfrytëzimin për shërbime të detyruara, vënien në skllavëri, forma të tjera të shfrytëzimit, si edhe vënien në përdorim apo transplantim të organeve.

Në kuadrin e një procesi penal, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore.

Procedimet penale fillojnë në dy mënyra, nëpërmjet kallëzimit të bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga personi i dëmtuar ose viktima e trafikimit, dhe me anë të kallëzimit të bërë nga të tjerë. Në rastin e parë, kallëzimi i bërë nga viktima e trafikimit përfaqëson një të drejtë që ka viktima, e cila është e drejta për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale.

Në disa raste praktike, viktimat e trafikimit hyjnë në kontakt me OJF të ndryshme operuese duke marrë aty së pari, dijeninë në lidhje me këtë të drejtë të tyre për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale. OJF-të, në shumicën e rasteve kanë persona të specializuar, të cilët iu sigurojnë viktimave këshillime juridike dhe mbështetje psikologjike.

Ka ndodhur, që depozitimi i kallëzimit në prokurori është bërë pas marrjes së këshillimeve përkatëse nga stafi i OJF-ve.

Me fillimin e procedimit, vijnë fazat e tjera, që konsistojnë në dhënien e deklarimeve të viktimës para organit procedues fillimisht dhe vazhdojnë me marrjen pjesë në proces, me paraqitjen e kërkesës për prova.

I dëmtuari gjatë fazës së procedimit ka të drejtë të marrë dijeni për veprimet e kryera.

Në çdo moment, duhet të mbajmë parasysh trajtimin me dinjitet dhe profesionalizëm të viktimës së krimit.

Një ndër të drejtat, për realizimin e së cilës kemi pasur bashkëpunim me OJF-të, është e drejta që ka viktima për kompensim, ose shpërblyeri i dëmit.

Subjekti i kryerjes së veprës penale ka gjithmonë një qëllim të caktuar në rastin e veprave që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, realizimin e përfitimit monetar, si dhe realizimin e çdo lloj forme tjetër të përfitimit.

Legjislacioni procedural parashikon si koncept, termin “i dëmtuar nga vepra penale”, ku përveç kategorive të tjera, bëjnë pjesë dhe viktimat e trafikimit.

Në parashikimet e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, gjejmë të sanksionuara të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale.

I dëmtuari nga vepra penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. Këtë të drejtë, ai/ajo mund ta realizojë duke bërë të mundur paraqitjen e kërkesave në organin procedues, duke kërkuar marrjen e provave.

Në rast mospranimi të kërkesave të bëra para organit procedues, ai/ajo ka të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Të drejtat që i takojnë të dëmtuarit, shtrihen dhe tek trashëgimtarët e tij, dhe në mungesë të zotësisë juridike të të dëmtuarit, kjo e drejtë i takon dhe përfaqësuesit të tij ligjor.

Një tjetër element, që konsiderohet si e drejtë e të dëmtuarit nga vepra penale është dhe padia civile në procesin penal, e parashikuar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas parashikimeve të këtij neni, personi që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose kundër të paditurit civil, duke kërkuar kthim pasurie, dhe shpërblim dëmi.

Viktimat e trafikimit përveç dëmeve të tjera pësojnë dhe ato që ne i quajmë dëme ekonomike.

Në lidhje me këtë pikë ne do të ndalemi në një trajtim më të hollësishëm për vetë karakterin e çështjes dhe interesin që ajo paraqet. Të gjitha format me anë të të cilave realizohet trafikimi i qenieve njerëzore bëjnë që viktimat e trafikimit, për aq kohë sa ndodhen në varësinë e subjekteve të krimit janë të kufizuara në gëzimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu dhe ato ekonomike.

Një problem mjaft i rëndësishëm, duke e parë çështjen në këtë këndvështrim është dhe përcaktimi në mënyrë të drejtë i dëmit që u është shkaktuar këtyre viktimave.

Lind e nevojshme të përcaktohet dhe të përllogaritet jo vetëm dëmi, shpërblimi i tij por dhe mënyra e realizimit të këtij shpërblimi.

Në praktikën e përditshme gjyqësore, megjithëse kemi raste të shumta të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, mungojnë rastet në të cilat padia civile në procesin penal të jetë shqyrtuar dhe të ketë marrë një zgjidhje përfundimtare,

referuar në praktikën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Arsyet e një rezultati të tillë janë nga më të ndryshmet ndër të cilat, zhvillimi i gjykimit të çështjes penale në formën e gjykimit të shkurtuar (neni 403 e vijues i Kodit të Procedurës Penale).

Në disa raste, subjekti ose autori që ka kryer veprën penale kërkon aplikimin e gjykimit të shkurtuar. Ndërkohë që organi i akuzës, nisur nga parashikimet ligjore që lidhen me, zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, dhe për ekonomi gjyqësore, pranon zhvillimin e procesit me gjykim të shkurtuar.

Problemi i hasur lidhet me fatin që do ndjekë padia civile, e paraqitur nga i dëmtuari në procesin penal.

Nga pikëpamja juridike, zgjidhja mund të realizohet në dy mënyra, të pranohet shqyrtimi i padisë civile, në procesin penal qoftë edhe me gjykim të shkurtuar, ose të veçohet padia civile e cila më pas mund të ngrihet në gjykatën civile, kompetente.

Jo vetëm aplikimi i gjykimit të shkurtuar çon në veçimin e padisë civile në procesin penal. Kjo mund të ndodhë dhe në rastet kur çështja penale shqyrtohet me gjykim të zakonshëm.

Më të komplikuar paraqiten rastet në të cilat ka më shumë se një të pandehur në proces, ndërkohë që padia civile ka lidhje vetëm me njërin prej tyre. Edhe në këtë rast vendoset veçimi i padisë civile, e cila më pas zgjidhet në një proces civil.

Një moment problematik, lidhet dhe me "durimin" që paraqet i dëmtuari.

Kjo nënkupton, zgjatjen në kohë të realizimit të të drejtave të tij.

Ndarja apo veçimi i padisë civile bën që i dëmtuari nga vepra penale të përballlet me dy procese gjyqësore, procesin penal për provueshmërinë e fajësisë së të pandehurit dhe procesin civil që lidhet me realizimin e të drejtave të kërkuara prej tij. Në rastin e procesit civil, gjykata për ti dhënë zgjidhje padisë civile është e detyruar të presë vendimin e fajësisë në lidhje me veprën penale të kryer nga subjekti. Përballja me seanca të shumta gjyqësore ndikon jo mirë në gjendjen psikologjike të viktimës, e cila shpesh

manifeston lodhje. Kemi një rast të vetëm ku bashkëpunimi me OJF-të ka bërë të mundur që e dëmtuara D. S, ka arritur të përfitojë me padi civile shpërblimin e dëmit nga autori i veprës penale.

Fakti penal nga i cili është dëmtuar D.S, lidhet me trafikimin jashtë shtetit të të dëmtuarës, e cila në kohën e kryerjes së veprës së trafikimit ka qenë e mitur, duke bërë që vepra e kryer nga subjekti të kualifikohet sipas parashikimeve ligjore të nenit 128/b të Kodit Penal.

Shtetasja D. S, nën ndikimin e dhunës fizike dhe psikologjike, mashtrimit për martesë, krijimit të një jete më të mirë, për disa vite me radhë ka qenë, siç quhet “punëtore seksi”, duke punuar për llogari të të pandehurit A. A.

Në përfundim të hetimit paraprak, në bashkëpunim me përfaqësuesit ligjorë të Qendrës për Nisma Ligjore qytetare, e dëmtuara paraqiti një padi civile, në të cilën kërkonte shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale.

Padia civile u paraqit nga e dëmtuara që në fazën e hetimeve paraprake dhe me vendim, prokurori pranoi futjen e saj në fashikull.

Padia civile u paraqit nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, Tiranë së bashku me kërkesën për gjykim dhe aktet, në lidhje me procedimin penal në ngarkim të të pandehurit A. A, i akuzuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 128/b të Kodit Penal.

I pandehuri kërkoi aplikimin e gjykimit të shkurtuar, si formë e zhvillimit të gjykimit në lidhje me këtë çështje, kërkesë kjo e pranuar nga Gjykata. Meqenëse padia civile e paraqitur, nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet e dosjes, gjykata vendosi veçimin e padisë civile, e cila më pas u shqyrtua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si gjyq civil.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në vendimin e saj e deklaroi fajtor të pandehurin, vendim ky që u përdor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për padinë civile, të cilën e kishte marrë në shqyrtim, duke vendosur në favor të së dëmtuarës.

Ky është prezantimi më konkret i përballjes së të dëmtuarës, me dy procese gjyqësore, procesin penal dhe procesin civil. Secili nga proceset në kuadër të respektimit të procedurave përkatëse kanë të nevojshme një kohe të caktuar, kohë e cila, nuk ishte aspak e lehtë, për tu kaluar me 'durim', nga e dëmtuara. Përfaqësuesit e OJF-së siguruan përfaqësimin në mungesë të të dëmtuarës, në proces duke ndikuar ndjeshëm në mbarëvajtjen e saj.

Një tjetër problem lind dhe pas daljes së vendimit të Gjykatës, që ka pranuar padinë civile dhe lidhet konkretisht me ekzekutimin e këtij vendimi.

Vështirësia në ekzekutim e ka zanafillën tek faktorë të tillë që konsistojnë në qenien e izoluar të subjektit të veprës penale.

Duke qenë i izoluar, subjekti i kryerjes së veprës penale, nuk siguron të ardhura, dhe nuk kryen asnjë lloj aktiviteti.

Në shumë raste, autorët bëjnë tjetërsimin e pasurisë së vënë nga vepra penale, ku e tjetërsojnë atë për efekt fshehjeje apo dhe efekte të tjera.

Ndodh rëndom, që regjistrimi i pasurive të tyre bëhet në emër të personave të tjerë.

Në të shumtën e rasteve autorët e veprave penale e regjistrojnë pasurinë e tyre në emër të personave të tjerë, që në kuadër të informalitetit i cili ka karakterizuar shoqërinë shqiptare deri në ditët e sotme, është e vështirë të kemi një rezultat pozitiv.

Ka mjaft raste në të cilat autorët e veprave penale, si rezultat i mënyrës së jetesës së tyre, humbasin pasuritë e fituara nga vepra penale.

Paraqitëm një sërë faktorësh, të cilët e vështirësojnë apo e bëjnë të pamundur realizmin e të drejtave ekonomike të viktimave të trafikimit nëpërmjet shpërblimit të dëmit.

Viktima mund të kërkojë sigurimin e padisë civile, e drejtë kjo e parashikuar në nenin 63 të Kodit të Procedurës Penale.

Ky nen parashikon të drejtën që ka personi për të kërkuar sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit, me sigurim padie deri në momentin e përfundimit të çështjes penale.

Kjo është një e drejtë tjetër, që parashikimet tona procedurale i atribuojnë të dëmtuarit nga vepra penale.

Për efekt ilustrimi do të ndalemi në trajtimin e një rasti tjetër praktik, në të cilin do të prezantojmë vështirësitë me të cilat haset viktima e trafikimit të qenieve njerëzore, si rezultat i procedurave të ndjekura gjatë hetimeve paraprake.

E dëmtuara K. F ka depozituar kallëzim për veprën penale të kryer nga i pandehuri A.G, vepër kjo e kualifikuar sipas nenit 114/b të Kodit Penal.

Si rezultat i jetesës së përbashkët për disa vite me radhë, e dëmtuara dhe i pandehuri kanë një fëmijë të mitur.

Me vendim gjykate para fillimit të procesit penal, e dëmtuara K. F ka arritur të njohë atësinë e fëmijës, dhe të përftojë çdo muaj për të, një pension mujor në formën e detyrimit për ushqim. Forma me të cilën i pandehuri e detyroi për disa vite me radhë të dëmtuarën të ushtronte prostitucion dhe të ardhurat të shkonin ne favor te tij, lidhej me premtimin që ai i bënte asaj, se ata të dy, ishin një çift normal dhe në momentin më të parë që do të siguronin një shumë të mjaftueshme të ardhurash për një jetë luksoze, ajo do të shkëputej nga prostitucioni. Më vonë, me ardhjen në jetë të fëmijës së tyre, e dëmtuara u detyrua të ushtrojë prostitucion, si një kusht i kërkuar nga i pandehuri që ky i fundit të njihte atësinë e fëmijës së lindur.

Vetëm duke ushtruar prostitucion dhe duke siguruar shuma të mëdha të hollash, e dëmtuara ka arritur të marrë atësinë e fëmijës nga i pandehuri pasi, i mituri kishte mbushur moshën tre vjeç.

Problemi me të cilin u përball e dëmtuara pas depozitimit të kallëzimit lidhej me faktorë ekonomikë, pasi si rezultat i kryerjes së dënimit nga i pandehuri A. Ç, të dëmtuarës iu ndërpre pensioni mujor, si detyrim ushqimor për fëmijën e saj të mitur.

Ndërkohë viktima u përball edhe me probleme psikologjike sepse fëmija i mitur që ajo kishte me të pandehurin ruante marrëdhënie familjare me familjarët e të pandehurit, të cilët filluan të ndikojnë në psikologjinë e fëmijës së mitur.

Në këtë mënyrë e dëmtuara, ndodhej pa mjete monetare për të jetuar dhe nën trysninë psikike të familjarëve të saj.

Kjo ndikoi negativisht në psikologjinë e viktimës, duke e bërë atë të luhatej në pozicionin e mbajtur prej saj, si dëshmitare në procesin penal.

Dhe në këtë rast, në sajë të një bashkëpunimi të frytshëm me OJF-të u krijua mundësia e dhënies së ndihmës ekonomike për të dëmtuarën, dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike përmes këshillimit me punonjës social.

Kjo mbështetje ndikoi pozitivisht në psikologjinë e viktimës, duke bërë që ajo të ishte këmbëngulëse për ecurinë e procesit penal.

Raste të tilla, apo të tjera që karakterizohen nga vështirësi hasen shpesh, dhe kanë ndikimin e tyre në ecurinë e procesit penal.

Normalisht që, synimi ynë parësor është dënimi i autorit të veprës penale, dhe si rezultat i problematikës së përmendur më sipër, ky synim në disa raste mbetet i vetmi.

Megjithatë qoftë dhe për realizimin e këtij synimi ne duhet të vlerësojmë, domosdoshmërinë e mbrojtjes së viktimës nga momenti i kryerjes së aktit kriminal deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale.

Çdo person i dëmtuar nga vepra penale ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme.

Si persona për t'u ofruar mbrojtje konsiderohen të gjithë ata persona që njëherësh konsiderohen si viktima sipas akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kanë nevojë për një mbrojtje të menjëhershme.

Një problem më vete në rastin e mbrojtjes së viktimave është marrja e masave me qëllim parandalimin e ri viktimizimit të tyre apo të ashtuquajturit viktimizim sekondar.

Ata që kanë mbijetuar nga vepra penale, përballë një trajtimi jo të denjë, përballë mungesës së mbrojtjes, dhe përballë një trajtimi jo të drejtë nga organet e drejtësisë si organi procedues apo gjykata, mund të përballen edhe me një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë.

Fazat në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit gjatë procesit penal përfshijnë momente të vështira, me të cilat përballet viktimat, momente që lidhen me nevojat e saj dhe përballet me autorin e veprës penale. Për evitimin e situatave të tilla, duhet treguar kujdes dhe profesionalizëm.

Fryma e bashkëpunimit me OJQ-të ka qenë vërtet e suksesshme në adresimin e këtyre situatave. Kur flasim për sukses, e nisim që nga momenti i parë që lidhet me akomodimin e viktimës, (vendosjen në qendra), trajtimin psikologjik të saj, (vendosjen e kontakteve me psikologë dhe punonjës socialë në mënyrë të vazhdueshme), krijimin e një situatë drejt një jetese normale, (shoqërimin e akomodimit në qendra me programe trajtues specifike, që përfshijnë shkollim, punësim, etj), si dhe ndjekjen e procedurave ligjore për përfaqësimin e padisë civile.

Duke i vendosur viktimat e trafikimit në kushte të tilla trajtimi, të cilat sigurohen në bashkëpunim me qendrat e ndryshme si OJF-të, kemi mundësinë e informimit të viktimës në vazhdimësi për procesin penal.

Trajtimi i viktimës së krimit, mbrojtja juridike e saj është një nga problemet e mëdha të sistemit të drejtësisë penale dhe një ndër synimet tona kryesore.

Të drejtat e viktimave të krimit, parashikuar në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare konsiderohen pjesë e pandarë e të drejtave të njeriut.

Studimet dhe praktikat e ndryshme tregojnë përpjekjet dhe luftën efikase kundër kriminalitetit.

Përveç gjykimit dhe dënimit të autorit të veprës penale është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje juridike.

Sigurimi mbrojtjes së nevojshme juridike për viktimat duhet të shoqërohet edhe me vëmendje ndaj nevojave specifike dhe pozitës delikate e vulnerabel të viktimës, si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të.

Gjithashtu, duhet të mbajmë parasysh se humbjet e viktimës

janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Bashkëpunimi praktik, me të gjithë organizmat institucionalë apo jo, është shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm.

Vetëm në sajë të këtij bashkëpunimi, do të arrijmë të trajtojmë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në përputhje me standardet përkatëse.

Në këtë kuadër, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi i organit të prokurorisë me përfaqësues të OJF-ve që punojnë në këtë fushë, në mënyrë që kontakti të jetë i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm.

Nga ana tjetër, ajo çfarë është më e rëndësishme dhe e rekomandueshme është rregullimi i bazës ligjore në drejtim të realizimit me efektivitet të shpërblimit të dëmit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

BIBLIOGRAFIA

- Raport “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore”, QNL, shih: www.qag-al.org.

- Kodi Penal 1995, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet përkatëse.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7905, datë 21.03.1995, me ndryshimet përkatëse.

Emira SHKURTI, (LL.M., M.A.S)

ÇËSHTJE TË KONTRAKTIMIT TË OJF-VE NGA ANA E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Hyrje

Shqipëria vjen nga një e kaluar ku shteti karakterizohej nga një centralizim i theksuar. Shërbimet sociale mbuloheshin tërësisht nga institucionet dhe entet shtetërore. Sektori i organizatave shoqërore ishte i dominuar nga subjektet e krijuara nga vetë shteti. Ndryshimet demokratike dhe garantimi i lirisë së organizimit, krijuan kushtin themelor për lindjen dhe funksionimin e organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse. Nga ana tjetër, kjo periudhë ndryshimesh është karakterizuar edhe nga një zbutje e rolit të shtetit dhe një tendencë e përgjithshme decentralizimi. Kjo frymë decentralizimi duket se ka ndikuar edhe politikatat e shërbimeve sociale. Kështu, gjithnjë e më tepër janë organet e pushtetit vendor, ato që mendohet se duhet të kryejnë rolin e ofruesit të shërbimeve, teksa Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ruan rol mbikëqyrës, që të garantojë cilësinë e këtyre shërbimeve.

Pavarësisht nga kjo tendencë decentralizimi, (kryesisht në raportin pushtet qendror-pushtet vendor) ende vazhdon të ruhet koncepti se organet shtetërore duhet të vazhdojnë të mbajnë rolin e tyre si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale ndaj qytetarëve, në përputhje me votëbesimin që ata kanë marrë prej tyre. Mirëpo në këta 20 vite tranzicioni, natyra e problemeve sociale me të cilat ndeshet shoqëria shqiptare ka pësuar ndryshime

rrënjësore. Dukuri më parë të panjohura ose të patrajtuara, si për shembull, trafikimi i njerëzve, dhuna në familje, migracioni, urbanizimi, papunësia, përdorimi i drogës kanë bërë që popullata të ketë nevoja të reja, të ndryshme për shërbime sociale. Ratifikimi i një sërë konventash ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e ka vënë vendin tonë përpara detyrimeve të reja, përfshi këtu edhe ofrimin e shërbimeve të reja sociale.

Roli i OJF-ve në ofrimin e shërbimeve sociale në Shqipëri gjatë tranzicionit

Në kushtet e një klime më të favorshme për funksionimin e OJF-ve dhe pranisë së donatorëve të ndryshëm, të cilët ofronin ndihmën e tyre teknike dhe financiare për Shqipërinë gjatë viteve të tranzicionit, disa organizata shqiptare filluan të mbushnin këtë boshllëk dhe këto nevoja të reja të popullatës për shërbime sociale, të tilla si strehëza për të mbijetuarat e dhunës në familje, shërbime rehabilitimi për viktimat e trafikimit, shërbime për personat me aftësi të kufizuara, linja telefonike këshillimi për gratë dhe fëmijët e abuzuar apo që kanë probleme të ndryshme, këshillime dhe përfaqësim ligjor pa pagesë, kurse trajnimi dhe formimi profesional në sektorë që nuk ofroheshin nga entet shtetërore, etj. Me fleksibilitetin që i karakterizon dhe afërsinë me qytetarët, OJF-të qenë të afta të mbulonin këtë boshllëk brenda një kohe të shkurtër. Shërbime të tilla ose nuk ofrohen ende nga institucionet shtetërore ose kanë marrë një kohë shumë të gjatë derisa kanë filluar të ofrohen nga shteti. Shumë nga këto organizata, të konsoliduara për shkak të mbështetjes financiare të donatorëve, trajnimit nga ana e tyre dhe ekspozimit ndaj eksperiencave më të mira botërore, si dhe për shkak të një përvoje tashmë të grumbulluar prej pothuaj 20 vjetësh shërbime pranë qytetarit, përbëjnë një aset të konsiderueshëm për vendin që mund të vazhdojë të përdoret, fuqizohet dhe përmirësohet në dobi të qytetarëve.

Sigurisht edhe tranzicioni për Shqipërinë nuk do të ishte i

pafund. Si rezultat i kombinimit të nismës së lirë të qytetarëve, përpjekjeve të qeverive për reforma dhe ndihmës së konsiderueshme nga organizatat ndërkombëtare apo përmes marrëveshjeve bilaterale, Shqipëria po përparon drejt integritit të saj në Bashkimin Evropian dhe në familjen e vendeve të zhvilluara. Mirëpo kjo, megjithë aspektet e veta pozitive, po shoqërohet me një tërheqje graduale të donatorëve të huaj nga vendi, dora-dorës që Shqipëria aftësohet për të ecur vetë drejt zhvillimit. Kjo tërheqje dhe rrjedhimisht pakësim i burimeve financiare është ndjerë jashtëzakonisht nga sektori i organizatave jofitimprurëse, të cilat deri dje ishin të varura nga këto donacione të huaja për të ushtruar veprimtarinë e tyre, në shërbim të publikut.

Në këtë udhëkryq zhvillimesh, një pyetje që del vetiu është: Kush duhet të sigurojë këto tipologji shërbimesh sociale? Në kushtet kur qytetarët vazhdojnë ende të kenë nevojë për këto shërbime, shuarja e tyre është jashtë diskutimit. Pra, cili sektor është në pozita më të përshtatshme për të vazhduar ofrimin e këtyre shërbimeve? Nga njëra anë, sektori shtetëror ka përgjegjësinë ndaj qytetarëve për të siguruar shërbime të përshtatshme dhe të nevojshme për ta. Ka gjithashtu mundësitë financiare (në rritje), të krijuara përmes kontributit të qytetarëve/taksapaguesve. Nga ana tjetër kemi një sektor organizatash që, siç u përmend më lart, disponojnë kapacitete njerëzore të motivuara dhe të përgatitura prej vitesh në ofrimin e këtyre shërbimeve. Një përgjigje që rrjedh po aq vetiu sa dhe pyetja që u shtrua më lart është se çelësi gjendet pikërisht te një lloj kombinimi i këtyre dy sektorëve, ku përgjegjësia dhe kapacitetet e tyre të bëhen bashkë, për të vazhduar për të ofruar shërbime cilësore për qytetarin.

Modele bashkëpunimi të shtetit dhe OJF-ve në ofrimin e shërbimeve sociale

Ky lloj kombinimi i dy sektorëve në ofrimin e shërbimeve sociale merr diku termin prokurim publik i shërbimeve sociale, diku partneritet privat-publik, diku thjesht *outsourcing*. Filloi të zbatohet

në shkallë të gjerë në vendet e Evropës perëndimore dhe Amerikës veriore në vitet 80-90. Partneri më i rëndësishëm i shteteve në ofrimin e shërbimeve sociale janë organizatat jofitimprurëse, edhe pse subjektet fitimprurëse nuk përjashtohen nga mundësia për një bashkëpunim të tillë. Nga statistikat botërore duket se fondet që vijnë nga financat publike përbëjnë 40% deri 70% të të ardhurave të OJF-ve në Evropë, 31% në Shtetet e Bashkuara, 45% në Japoni dhe 70-80% në Hong Kong²⁴⁵.

E njëjta pririje, pra për të kontraktuar OJF-të me fonde publike për të ofruar shërbime sociale, po vihet re gjithnjë e më shumë edhe në vende të tjera që kanë një të kaluar të ngjashme me Shqipërinë, si për shembull Estonia, Hungaria, Sllovakia, Republika Çeke, etj. Megjithatë, duhet thënë se kjo pririje shoqërohet edhe me ankth nga ana e punonjësve shtetërorë, duke e parë me dyshim faktin që NGO-të po «rrëmbejnë» rolin e shtetit. Kryesisht përdorimi i fondeve publike vihet re në formën e subvencioneve (si dhe kontributeve të pjesshme në natyrë), granteve dhe prokurimeve. Dy format e fundit janë më tepër të lidhura me shërbime specifike për publikun dhe karakterizohen nga një procedurë konkurruese.

Embrione të bashkëpunimit mes shtetit dhe OJF-ve në Shqipëri dhe dritare ligjore

Shqipëria ka bërë përparime në njohjen e organizatave jofitimprurëse si partnere të dobishme në të mirë të publikut. Disa nga zhvillimet më të spikatura të viteve të fundit lidhen kryesisht me fushën e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, gjë që flet edhe për forcën propaganduese dhe lobuese të lëvizjes feministe, si një pjesë tepër e rëndësishme e shoqërisë civile. Kështu, ligji nr. 9970, dt. 24.7. 2008 «Për barazinë gjinore në shoqëri» (neni 11) krijon një organ këshillimor për qeverinë, Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, ku detyrimisht tre nga të 14 anëtarët e tij duhet të jenë përfaqësues të shoqërisë civile. Në bazë të po këtij ligji, autoriteti

²⁴⁵ Asian Development Bank (2009), *Final report on government procurement of public services: People's Republic of China*, prepared by Jia Xijin and Su Ming

kryesor përgjegjës, aktualisht Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e ka për detyrë të bashkëpunojë dhe t'u ofrojë mbështetje organizatave jofitimprurëse, aktive në fushën e barazisë gjinore²⁴⁶. I njëjti detyrim vendoset edhe për organet e qeverisjes vendore kur përcaktohet: “Organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, në territorin që mbulojnë.”²⁴⁷ Ky bashkëpunim dhe mbështetje që kërkohet nga ana e organeve publike, hap rrugën për modele të ndryshme bashkëpunimi me OJF-të, duke përfshirë këtu edhe kontraktimin e tyre dhe financimin e shërbimeve që ato mund të ofrojnë me fonde publike.

Po ashtu një rol i ngjashëm parashikohet për Ministrinë e Punës edhe në bazë të ligjit nr. 9669, dt 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Këtu mundësia ligjore dhe detyrimi për kontributin edhe me mjete financiare është akoma dhe më i dukshëm. P.sh.: neni 6 përcakton si detyrime për këtë autoritet financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes si edhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi, krahas licensimit të OJF-ve që ofrojnë shërbime për personat e prekur nga dhuna në familje dhe ngritjes së qendrave të shërbimeve për ta. Detyrimi për të instaluar dhe ngritur shërbime për viktimat, fëmijët dhe dhunuesin bie edhe mbi organet e qeverisjes vendore.

Ndonëse këto dritare ligjore kanë hapur një rrugëz për bashkëpunimin edhe në terma financiare mes organeve shtetërore dhe OJF-ve, si rezultat i mungesës së normimit të prokurimeve apo

²⁴⁶ Neni 13, par. 2, pika c

²⁴⁷ Neni 14, par. 2

financimit të shërbimeve sociale nga OJF-të, mund të thuhet se që nga miratimi i këtyre ligjeve, asnjë OJF nuk është financuar nga Ministria e Punës për ofrimin e shërbimeve në fushën e dhunës në familje apo të barazisë gjinore. Ndërkaq shohim një lloj fleksibiliteti dhe embrionet e një bashkëpunimi të tillë mes organeve të qeverisjes vendore dhe OJF-ve. Kështu, në kuadrin e Fondit të Mirëbesimit kundër Dhunës ndaj Gruas, Rrjeti i OJF-ve kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit ka mbështetur dhe nxitur bashkinë e Pogradecit të kontrakttojë shërbimin e linjës së këshillimit për viktimat e dhunës në familje nga një OJF që vepron në atë zonë, ndërsa bashkinë e Vlorës të mbulojë një pjesë të shpenzimeve të strehëzës “Vatra”, e cila krahas shërbimeve të strehimit dhe rehabilitimit për viktimat e trafikimit, ka nisur të mirëpresë edhe të mbijetuara të dhunës në familje. Në mënyrë të ngjashme, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, bashkia e Durrësit dhe ajo e Korçës kanë kontraktuar OJF lokale për të ofruar shërbime të ndryshme për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre. Këto bashki, kanë bërë thirrje të hapura dhe procedura konkurrimi, por gjithmonë është dashur të çaj në rrugën në kushtet e mungesës së rregullimeve ligjore të përshtatshme. Kështu, këto bashki kanë mundur t’i ligjërojnë këto procese dhe rrjedhimisht të lëshojnë kontratat dhe transferojnë fondet, pasi kanë marrë miratimin e këshillave të tyre bashkiake, gjë që në një farë mënyre e lë çështjen në varësi të formimit të vullnetit dhe arritjes së një konsensusi nga ana e këshillave. Nga ana tjetër, bashkia e Shkodrës, me gjithë dëshirën e madhe për të bashkëpunuar me OJF-të e specializuara në zonën e tyre, ka ngurruar të nisë procese të tilla prokurimi a kontraktimi, pa patur në dispozicion një bazë të detajuar ligjore.

Rekomandime

Megjithë inkurajimin që dëshirojmë t’u japim këtyre nismave, mbështetur edhe nga praktika botërore, është shumë më mirë, qoftë për të krijuar uniformitet nëpër njësitë e ndryshme të qeverisjes vendore apo qendrore, qoftë për të krijuar transparencë më të

madhe dhe siguri ligjore, qoftë për të përcaktuar kritere specifike (të përshtatshme edhe për OJF-të krahas bizneseve private) për përzgjedhjen e subjekteve dhe për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kontratës në vazhdimësi deri në realizimin e plotë të detyrimeve, që legjislacioni për prokurimet publike të pësojë ndryshimet e nevojshme për të rregulluar prokurimin e shërbimeve sociale edhe nga OJF-të ose ekskluzivisht nga OJF-të. Në ndryshim nga prokurimi i mallrave apo shërbimeve të tjera, për shërbimet sociale rekomandohet që kriteret e përzgjedhjes, monitorimi i cilësisë dhe vendimet për modifikime eventuale të kontratës të mos bëhen ekskluzivisht nga autoriteti kontraktor, as edhe thjesht nga një bord që përmbledh përfaqësues të kontraktuesit dhe autoritetit kontraktor, por mundësisht edhe përfaqësues të përfituesve të këtyre shërbimeve, me qëllim që shërbimi të shkojë tek qytetari apo grupi i synuar, në formën që iu përshtatet më mirë nevojave të tyre.

Nga praktika e vendeve të tjera me interes ka qenë edhe modeli sipas të cilit ofrimi i shërbimeve publike iu është nënkontraktuar pikërisht organizatave të vetë përfituesve, fjala vjen kur një grup të mbijetuarash të dhunës në familje janë organizuar në shoqata dhe kanë marrë përsipër që me fonde publike të ofrojnë shërbime për të tjerë të dëmtuar nga dhuna në familje që kanë nevojë të thyejnë ciklin e dhunës dhe të marrin mbështetje për t'u recuperuar dhe fuqizuar.

Nga ana tjetër, edhe përsa i përket bashkëpunimit në tërësi të shtetit me organizatat e shoqërisë civile, Shqipëria mund të dojë të mësojë nga shembulli i një morie vendesh, të cilët formulojnë strategji dhe plane veprimi periodike për fuqizimin e OJF-ve, ndërtojnë këshilla të përbashkët me pjesëmarrje të OJF-ve dhe shtetit dhe përmes tyre nxisin ndryshime të nevojshme legjislative, institucionale dhe të praktikave, me qëllim që të krijojnë një klimë sa më të favorshme për fuqizimin e shoqërisë civile si dhe të partneritetit me organet publike.

Pa dyshim bashkëpunimi shtet-OJF po vijon të forcohet. Krijimi i një fondi të veçantë për mbështetjen e OJF-ve dhe një zyre të

ngarkuar me administrimin e tij, parashikimi në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje (2011-2015) i planeve për të nënkontraktuar OJF-të për ofrimin e shërbimeve në këtë fushë, janë të gjitha sinjale pozitive. Është me rëndësi që mbi këto themele të ndërtohet dhe konsolidohet një bashkëpunim i vazhdueshëm, i mirërregulluar edhe me legjislacionin përkatës.

LITERATURA

Bullain, Nilda dhe Toftisova, Radost. "A comparative analysis of European policies and practices of NGO-government cooperation." *The International Journal of Not-for-Profit Law* volumi 7, nr. 4 (shtator 2005), http://www.icnl.org/knowledge/ijnl/vol7iss4/art_1.htm.

Auriol, Emanuelle dhe Picard, Pierre M. "Government outsourcing: Public contracting with private monopoly." *Vox* (24 nentor 2009), <http://www.voxeu.org/index.php?q=node/4248>

Halvorsen, Rune. "The role of NGOs in the New Social Europe." (ese NTNU, 5 shkurt 2004)

Asian Development Bank, "Final report on government procurement of public services. People's Republic of China", prepared by Jia Xijin dhe Su Ming (qershor 2009)

Nordtveit, Bjorn Harald. "Use of public-private partnerships to deliver social services: advantages and drawbacks" (tetor 2005), portal.unesco.org/education/es/files/43500/.../Nordtveit_B_1.doc

Semini, Mariana. "Analiza e mundësive dhe kushteve ligjore të kontraktimit të OJF-ve me institucionet publike, për ofrimin e shërbimeve me natyrë publike." (artikull i pabotuar ende, vënë në dispozicion me dashamirësi nga autorja)

"Chapter 6. To market, to market: outsourcing the public service." http://epress.anu.edu.au/anzsog/frank_fearless/

mobile_devices/ch06.html

Bulgarian Centre for Not-For-Profit Law. Përshkrime dhe raporte nga vende të ndryshme të rajonit <http://blacksea.bcnl.org/en>

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar)

Av. Aurela BOZO (Ma)²⁴⁸
Erviola STOJA (Ma)²⁴⁹

**KONVENTA CEDAW DHE PROTOKOLLI FAKULTATIV
 I KËSAJ KONVENTE-MJETE TË FUQISHME LOBIMI
 PËR OJF-TË, ME QËLLIM GARANTIMIN E TË
 DREJTAVE TË GRAVE.
 (referuar praktikës së QNL-së dhe ojf-ve të tjera)**

Dhuna me bazë gjinore dhe adresimi i efekteve të saj përbën një nga drejtimitet e axhendës së shtetit shqiptar dhe aktorëve të ndryshëm të shoqërisë shqiptare.

Pas vitit 1990 janë bërë përpjekje serioze për përjasjen e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare. Shteti shqiptar, midis të tjerave, është angazhuar me nënshkrimin dhe ratifikimin e disa traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër diskriminimit shoqëror dhe mbrojtjen nga forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore si dhuna në familje, trafikimi etj²⁵⁰. *Ato perceptohen si rreziqe që cenojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të individit në përgjithësi, veçanërisht të grave dhe vajzave.*

²⁴⁸ Është avokate pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Doktorante, UT

²⁴⁹ Është Prokurore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë.

²⁵⁰ Republika e Shqipërisë është palë në konventat e hartuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, si :

“ Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, e ratifikuar me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe hyrë në fuqi, më 11 maj 1994; me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

Është me interes kuptimi i koncepteve të dhunës me bazë gjinore referuar marrëdhënies së pabarabartë të fuqisë midis burrave dhe grave. Këto akte ndërkombëtare njohin se dhuna kundër grave përbën një manifestim të marrëdhënieve të pabarabarta të fuqisë, historikisht midis burrave dhe grave, i cili ka çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe në ndalimin e zhvillimit të plotë të grave.

Në përputhje me këto akte ndërkombëtare, "dhuna me bazë gjinore kundër grave" do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje sepse ajo është grua ose që sjell efekte tek gratë në mënyrë disproporcionale.

Në këtë set konventash të ratifikuara, Konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" dhe Protokollin i saj Opsional përbëjnë një mjet për të garantuar të drejtat e grave, tek i cili do të ndalem në mënyrë të veçantë.

"Protokollet opsionale janë traktate të veçanta, të cilat plotësojnë traktatin kryesor në dy mënyra: duke krijuar të drejta të reja

-
- " Konventa "Kundër torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës dhe ndëshkimit", hyrë në fuqi në 11 maj 1994.
 - " Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollin shtesë të saj (nr. 1,2,4,6,5,11,7,12), është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi në 2 tetor 1996.
 - " Konventa evropiane "Për parandalimin e torturës dhe të trajtimeve çnjerëzore apo poshtëruëse", e nënshkruar në 2 tetor 1996 dhe hyrë në fuqi në 1 shkurt 1997.
 - " Konventa ndërkombëtare "Për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore", aderuar në 4 tetor 1991.
 - " Konventa ndërkombëtare "Për të drejtat civile dhe politike", aderuar në 4 tetor 1991 etj.
 - " Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
 - " Protokoll kundër trafikimit të emigrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.
 - " Protokollin "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve", që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, etj.

substantive ose duke zhvilluar mekanizma ose procedura për të adresuar dhunimin e të drejtave.Në rastin e Konventës CEDAW, Protokollin Opsional nuk krijon të drejta substantive por krijon procedura për adresimin dhe kompensimin e dhunimit të të drejtave të përcaktuara në Konventë”²⁵¹.

Protokollin Fakultativ i Konventës CEDAW krijon dy procedura: **Procedura e komunikimit** e cila lejon që komunikime të paraqiten nga individë ose në emër të individëve ose grupeve të individëve nën juridiksionin e Shtetit Palë. (me pëlqimin e individëve, përveç rasteve kur mund të justifikohet veprimi pa pëlqim-neni 2 i Protokollit Fakultativ të Konventës) Individët ose grupet e individëve pretendojnë se janë viktime të dhunimit të garancive dhe të drejtave të sanksionuara nga Konventa CEDAW, të shkelura nga Shteti Palë.

Procedura e hetimit: Procedura e hetimit lejon vetë Komitetin të fillojë kërkime në situatat e dhunimeve të rënda ose sistematike të të drejtave të grave në një juridiksion të veçantë, pa marrë së pari një ankesë. Edhe në këtë rast OJF-të luajnë një rol të rëndësishëm.

Sa janë përdorur këto procedura në vendin tonë? Çfarë roli kanë luajtur organizatat jofitimprurëse?

Por nëse i referohemi zbatimit të Konventës CEDAW rezulton se nuk ka asnjë ankesë drejtuar Komitetit CEDAW, paraqitur nga një individ, grup individësh ose organizatë në emër të tyre nga Shqipëria.

Traktatet dhe mekanizmat ndërkombëtarë janë të vlefshëm vetëm nëse zbatohen siç duhet²⁵². Roli i organizatave jofitimprurëse në zbatimin e këtyre akteve ndërkombëtare është i një rëndësie të veçantë.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në kuadrin e ngritjes së

²⁵¹ IWRAW ASIA PACIFIC OCCASIONAL PAPERS SERIES no. 13, “Protokollin Opsional I Konventës CEDAW si një mekanizëm për zbatimin e të drejtave të grave: një analizë e vendimeve 6-10 të Komitetit CEDAW sipas procedurës së komunikimit të Protokollit Opsional të Konventës CEDAW.

²⁵² Amnesty International Publications, “Its in our hands; Stop violence against women”, 2004, iv

kapaciteteve ka kryer në vazhdimësi trajnime për organizatat jofitimprurëse mbi rolin që ato mund të luajnë duke përdorur instrumentet kushtetues e ligjor në nivel ndërkombëtar e kombëtar. Përbën një sfidë për stafin e avokateve të kësaj qendre identifikimi i rasteve potenciale për tu paraqitur në Komitetin CEDAW.

Organizata Jofitimprurëse mund të luajnë rol përmes: Paraqitjes së ankesave në emër të individëve apo grupeve të individëve në juridiksionin e shtetit shqiptar, të cilët ngrenë pretendimin e shkeljes së të drejtave të parashikuara në Konventën CEDAW;

Kështu në komunikimin e *"ahide Goekce vs. Austria*, autorë të komunikimit ishin dy organizata që punojnë në Austri për mbrojtjen dhe mbështetjen e grave, viktime të dhunës me bazë gjinore. Qendra e Ndërhyrjes në Vjenë kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe Shoqata për aksesin e grave në sistemin e drejtësisë.

Së dyti, një organizatë jofitimprurëse mund të luajë rol përmes kontributit në përgatitjen e raportit shtetëror mbi zbatimin e Konventës CEDAW, përgatitjes së raporteve alternative, përgatitjes së raporteve hije dhe e ftuar nga Komiteti CEDAW;

RAPORTI SHTETËROR I CEDAW

Brenda vitit pas hyrjes në fuqi të konventës dhe më pas të paktën çdo katër vjet dhe sa herë kërkohet nga Komiteti CEDAW, shtetet palë paraqesin një raport mbi masat me karakter legjislativ, gjyqësor, administrativ dhe masa të tjera në zbatim të Konventës, progresin e bërë dhe vështirësitë e hasura.

Në përgatitjen e këtij raporti mund të kontribuojnë edhe organizatat jofitimprurëse. Kështu në përgatitjen e raportit të tretë kombëtar periodik të shtetit shqiptar mbi zbatimin e Konventës CEDAW²⁵³ kanë kontribuar disa organizata jofitimprurëse si Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, grupi shqiptar për të drejtat e njeriut (GSHDNJ), Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare" (NDGSH), forumi i pavarur i gruas shqiptare (FPGSH), Qendra shqiptare për

²⁵³ <http://www.mpcs.gov.al>

popullsinë dhe zhvillim (QSHPZH). Nëpërmjet një Urdhri të veçantë të Kryeministrit, Ministria e Punëve të Jashtme është ngarkuar me detyrën e hartimit të Raportit Kombëtar Periodik, duke e realizuar përgatitjen e këtij raporti, në bashkëpunim me institucionet qeveritare, Avokatin e Popullit dhe OJF-të.

RAPORTI ALTERNATIV

Kur një OJF e shkruan raportin e saj, kur raporti qeveritar nuk është përgatitur (p.sh sepse qeveria nuk e ka shkruar atë ose e shkruan me vonesë) ky quhet Raport Alternativ.

Raporti i parë është përgatitur nga dy shoqata në lidhje me 6 nene të Konventës CEDAW dhe raporti i dytë Alternativ është përgatitur nga Koalicioni për Përgatitjen e Raporteve Alternative në Shqipëri, me iniciativën e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve.

Raportet alternative marrin një rëndësi të veçantë për disa arsye:

Së pari: Raportet Alternative japin një pamje më të plotë për Komitetin CEDAW, të situatës faktike dhe ligjore në zbatim të Konventës CEDAW, duke ndihmuar Komitetin të vlerësojë informacionin e marrë nga raportet e Shteteve Palë.

Së dyti përmes raporteve alternative, Organizatat Jofitimprurëse sjellin para Komitetit CEDAW zërin dhe shqetësimet e grave përmes të dhënave; informacionit mbi situatën reale të grave të cilën ato e prekin çdo ditë në veprimtarinë e tyre; progresin e kryer dhe impaktin e tij mbi gratë;

Shadow Report ose raportet hije.

Organizatat jofitimprurëse kanë krijuar eksperiencën e tyre në përgatitjen e raporteve hije. Raporti hije, "Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri" u përgatit dhe u paraqit në 2010 para Komitetit CEDAW nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Rrjeti kundër Dhunës me bazë gjinore dhe Trafikimit²⁵⁴ dhe Rrjeti

²⁵⁴ Në këtë rrjet bëjnë pjesë Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Shoqata Refleksione, Linja e Këshillimit për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe Strehëza për gra dhe vajza të dhunuara.

shqiptar i fuqizimit të grave.

Neni 22 i Konventës CEDAW, parashikon se: Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara për të paraqitur raporte lidhur me zbatimin e Konventës në ato fusha që përfshihen në kuadrin e veprimtarisë së tyre.

3. përdorimit të rekomandimeve të Komitetit CEDAW si mjet lobimi

Rekomandimet e Komitetit CEDAW

Rekomandimet e Komitetit CEDAW për Shqipërinë pasi mori në konsideratë raportin periodik të parë dhe të dytë të kombinuar të Shqipërisë në takimet e 594, 595 dhe 605, në 16 dhe 24 Janar 2003 kanë përbërë një platformë pune për OJF-të.

Kështu, në janar të vitit 2003, Komiteti shprehu shqetësim rreth shkallëzimit të dhunës kundër grave, duke përfshirë edhe dhunën në familje dhe mungesës së një ligji të veçantë për mbrojtjen prej saj.

Komiteti CEDAW shpreh gjithashtu shqetësim se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nuk bën dallim mes akteve të kryera nga persona të tjerë dhe akteve të kryera nga një anëtar i familjes dhe se asnjë akt specifik ligjor nuk ishte miratuar për të luftuar dhunën në familje.

Viti 2006, me Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 shënoi përmbyshjen e rekomandimit mbi nevojën e një ligji të veçantë për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ligji *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* ishte rezultat i një nisme qytetare, dhe u propozua në Kuvend nga 20 mijë zgjedhës, të cilët mbështetën projektligjin e hartuar nga aleanca e disa organizatave joqeveritare.

Kështu, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (CAO), në partneritet me 9 organizata të tjera, Qendra për Aleancën Gjinore për Zhvillim”, Qendra Për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza të Dhunuara, Shoqata *Në Dobi të Gruas Shqiptare*, Shoqata *Refleksione*, Klinika ligjore e të miturve, Strehëza për gra dhe vajza

të dhunuara përgatitën dhe prezantuan në Kuvend projektligjin “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Komiteti CEDAW i bëri thirrje palës shtetërore në janar të vitit 2003 të sigurojë se ligji shqiptar ofron procedura të duhura, të hapura, dhe të përballeshme dhe mjete ligjore për dhunimin e të drejtave të grave. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” forcoi pushtetin gjyqësor përmes sanksionimit të hollësishëm të masave mbrojtëse kundër dhunës në familje. Parashikohen si masa mbrojtëse të marra nga gjykata: urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat e mbrojtjes.

Organizata që punojnë për adresimin e dhunës me bazë gjinore si QNL, Forumi i Gruas Elbasan, “Vatra” Vlorë, Gruaja për Gruan Shkodër, Të drejtat e Njeriut në Demokraci Tiranë, Refleksione, Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, Qendra për këshillimin e grave dhe vajzave të dhunuara, Shoqata Në dobi të Gruas Shqiptare, etj punojnë për një zbatim efektiv të këtij ligji në bashkëpunim me aktorë të tjerë përgjegjës.

Rezultatet e raporteve monitoruese mbi zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dëshmojnë se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë mbrojtur me mjetet ligjore që ky ligj ofron²⁵⁵. Referuar këtyre raporteve rezulton se “Vetëm gjatë periudhës një-vjeçare Qershor 2009-Qershor 2010, pranë Gjykatës së Shkallës së I-rë Tiranë, janë paraqitur 406 kërkesa për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ndërkohë, një vit më parë (Maj 2008-Maj 2009), u paraqitën 448 kërkesa të tilla dhe dy vjet më parë 18 kërkesa”.

Disa nga rekomandimet e 2010 të Komitetit CEDAW për Shqipërinë ishin:

- Gëzimi nga gratë i të drejtave të parashikuara në Konventë, bazia formale dhe de facto.
- Rekomandohet ndërjegjësimi në lidhje me përdorimin e mjeteve ligjore kundër diskriminimit bazuar në seks dhe gjini, në

²⁵⁵ Shih: www.qag-al.org

mënyrë që të rritet kapaciteti i grave për të përdorur mekanizmat ekzistues të ankimit dhe të kërkohet kompensim për diskriminimin.

- Fuqizimi i masave të veçanta dhe masave të përkohëshme të veçanta.

- Komiteti i bën thirrje Shtetit Shqiptar të ndryshojë pa vonesë Kodin Penal, të parashikojë dhunën në familje si një vepër penale të veçantë;

- Rekomandohet që të sigurohet që punonjësit publikë, veçanërisht punonjësit e ekzekutimit të ligjit, anëtarët e gjyqësorit, punonjësit e shërbimit shëndetësor dhe punonjësit socialë të jenë të sensibilizuar për të gjitha format e dhunës kundër grave.

Organizatave jofitimprurëse po punojnë për përmbushjen e këtyre rekomandimeve. Janë hedhur hapa pozitivë në lidhje me përdorimin e mjeteve ligjore kundër diskriminimit gjinor, është rritur ndërgjegjësimi i punonjësve publikë për të gjitha format e dhunës kundër grave dhe çështja e ndryshimeve në Kodin Penal me qëllim parashikimin e dhunës në familje si një vepër penale e veçantë është në axhendën e organizatave jofitimprurëse, që punojnë për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Në lidhje me trafikimin dhe shfrytëzimin e prostitucionit, Komiteti ripërsërit shqetësimin që viktimat e trafikimit dhe prostitutat vazhdojnë të nënshtrohen dënimit penal.

Komitete CEDAW, në interpretim të nenit 6 të konventës CEDAW, pas raportimit periodik të fundit që shteti shqiptar paraqiti në OKB, i rekomandoi qartazi shtetit shqiptar, që Kodi Penal të ndryshohet me qëllim që viktimat të mos i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimit penal. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 113 parashikon se “Ushtrimi i prostitucionit përbën një vepër penale që ndëshkohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Çfarë është prostitucioni, çfarë do të thotë të ushtrosh prostitucion? A duhet të ndëshkohet prostitucioni?

Dispozita na thotë vetëm që është vepër penale.

Prostitucioni është kryesisht një përgjigje ndaj mungesës së alternativave ekonomike. Nuk është e habitshme që gratë e bëjnë

këtë për para²⁵⁶. Siç edhe Simone de Beauvoir thotë: “Është naive të vrasësh mendjen se për çfarë motivesh një grua prostituon.....E vërteta është se në një botë ku varfëria dhe papunësia ekziston, do të ketë njerëz që do të bëjnë çdo profesion që është i hapur... Shpesh pyetet: pse një grua e zgjedh atë? Pyetja që do të ishte më mirë të bëhej është: pse nuk duhet ta zgjedh atë?²⁵⁷

Vajzat dhe gratë që ushtrojnë prostitucion nuk janë të lira brenda unit të tyre, ato nuk ekzistojnë të izoluara nga konteksti i tyre social. Ato nuk e ushtrojnë këtë autonomi, nuk e bëjnë zgjedhjen e tyre të shkëputura nga ky kontekst social. Të mos e shohësh këtë varësi nga konteksti social është dritëshkurtësi.

Pas këtyre pyetjeve qëndron debati midis atyre që e konceptojnë prostitucionin si një e drejtë për ta zgjedhur atë, si një ushtrim autonomie dhe atyre që besojnë se prostitucioni e vendos klasën e grave në varësi, e nënshton atë.

Sa e mundshme është zgjedhja e një vajze apo gruaje që prostituon, sa autentik është pëlqimi i dhënë prej saj në një shoqëri të caktuar?

A ka pëlqim në një rast të tillë? Thënia “po” nga vajzat dhe gratë nuk garanton mungesë detyrimi apo shtrëngimi . Kështu, kur dikush jep pëlqimin, ajo i jep të dyja përgjigjet dhe krijon kuptimin e termit në një kohë të caktuar, në një kontekst të caktuar. Eksperienca e shkuar e një gruaje, imazhi i saj i socializuar, frikërat dhe pritshmëritë e saj në lidhje me seksualitetin- të gjitha këto janë në lojë kur ajo thotë po, jo ose qëndron e heshtur.²⁵⁸

Le ti referohemi një shembulli konkret. E pandehura B.Q, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të prostitucionit, ka deklaruar

²⁵⁶ D.Kelly Weiseberg, “Applications of feminist legal theory to women’s lives. Sex, violence, work and reproduction”, Jody Freeman, “The feminist debate over prostitution reform”, 1993.

²⁵⁷ Simone de Beauvoir, *The Second Sex* 524-525 (H.M.Parshely ed. & trans, Bantam Books, 1952)

²⁵⁸ D.Kelly Weiseberg, “Applications of feminist legal theory to women’s lives. Sex, violence, work and reproduction”, Jody Freeman, “The feminist debate over prostitution reform”, 1993.

se ajo ka ardhur nga një qytet verior, dhe është larguar nga familja për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Prindërit e saj ishin divorcuar dhe kushtet ekonomike e familjare e kanë detyruar të ushtrojë prostitucion. E pandehura në kohën e kryerjes së krimit ka qenë vetëm 17 vjeç e 11 muaj.

Më thoni ju çfarë po-je është kjo?

Zgjedhja e grave kur thonë “po” jo vetëm nuk është zgjedhje, por përforcon pushtetin e burrave dhe shpreh varësinë e grave, mungesën e pushtetit të tyre.

Kodi Penal i shmanget një definicioni për ushtrimin e prostitucionit, duke u fokusuar tek kriminalizimi i tij.

Politikat dhe legjislacioni i shtetit shqiptar përshkohen nga synimi i forcimit të grave. Por, në këtë rast kemi një kundërshti. Nuk mund të forcohen gratë duke i ndëshkuar ato për mungesën e forcës, pushtetit të tyre.

Kjo çështje është një çështje e barazisë gjinore dhe reflekton diskriminim të tërthortë. Ajo kërkon të shkatërrohen kushtet që e krijojnë prostitucionin dhe që i çojnë gratë drejt këtij tregu me dhimbje, ndonëse flitet shumë për kënaqësi.

Pse themi se jemi përballë një forme diskriminimi të tërthortë?

Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kriteve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njërës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë.²⁵⁹ Në rastet e diskriminimit të tërthortë gjinor, kriter përcaktues është efekti që një dispozitë, kriter apo praktikë ka mbi një grup të caktuar gjinor. Neni 113 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është një nen që ka efekt sidomos mbi gratë, ky nen në praktikën e zbatimit të tij ndëshkon gratë që janë në disavantazh ekonomik dhe social.

Nga statistikat rezulton, se në zbatim të kësaj dispozite penale, pothuajse të gjithë personat e dënuar kanë qenë gra dhe vajza të

²⁵⁹ Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, neni 6 “Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë”.

cilat kanë pranuar të hyjnë në marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit dhe ofertës së një burri, për shkak të vulnerabilitetit të tyre. Vulnerabiliteti i tyre, varfëria, papunësia, i fut gratë dhe vajzat në një risk të veçantë të dhunës e të abuzimit.²⁶⁰

Në rastin e nenit 113 të Kodit Penal, synohet mbrojtja e moralit dhe dinjitetit. Ndërsa objekt i kësaj figure janë marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit, me qëllim mbrojtjen e moralit dhe të dinjitetit të personit, duket qartë se nga ana objektive, element thelbësor për këtë figurë krimi është marrja e shpërblimit për ushtrimin e prostitucionit²⁶¹. Pra, subjekt i kësaj vepre penale është personi që ka marrë shpërblim si rezultat i kryerjes së marrëdhënieve seksuale. Kjo qasje është diskriminuese dhe nuk mbron të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Në këtë rast nuk mbahet parasysh se, veprimet kriminale me të cilat konsumohet kjo vepër penale, kryhen jo vetëm nga përfituesi i shpërblimit, por edhe nga personi që përfiton marrëdhënie seksuale, në mënyrë të paligjshme, si dhe nga persona të tretë që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme si rezultat i ushtrimit të prostitucionit. Si personi që ka përfituar marrëdhënie seksuale edhe ai/ajo që kryejnë marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit, kanë shkelur normat e moralit shoqëror dhe dinjitetin e personit. Nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë mbrojtja e normave morale të shoqërisë, atëherë dënimi për këtë vepër nuk mund të jetë diskriminues.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, bazuar në Konventën CEDAW e cila ka epërsi mbi ligjet e vendit²⁶² po punon për tu

²⁶⁰ Shih: Rekomandimin e Përgjithshëm nr.19, në zbatim të nenit 6, të Konventës kundër të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

²⁶¹ Shih: Ismet Elezi, "E drejta penale. Pjesa e Posaçme", Tiranë, 2009, fq.153-155.

²⁶² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 122, " 1.Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.....2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të....."

shpallur antikushtetues neni 113 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, përmes përfaqësimit ligjor të B. Q.

B. Q është përfituese dhe ka marrë në mënyrë të vazhdueshme këshillim ligjor dhe është përfaqësuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Ajo është akuzuar për kryerjen e veprës penale të prostitucionit, parashikuar nga neni 113 i K. Penal. Rasti i saj është një rast tipik i kriminalizimit të prostitucionit.

Me vendim të gjykatës së rrethit gjyqësor Tirane nr. 744, datë 6.5.2011, B. Q. është deklaruar fajtores dhe në bazë të nenit 59 të Kodit Penal është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një kohë prove prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, me kusht që e pandehura të mos kryejë veprën tjetër penale, gjatë kohës së provës. Është urdhëruar e pandehura që gjatë kohës së provës të marrë formimin profesional.

Në aktet ligjore të përgatitura për këtë rast, paraqitur Gjykatës së Apelit Tiranë, stafi i QNL-së është shprehur se neni 113 i Kodit Penal në bazë të të cilit B. Q është dënuar, shkel drejtpërsëdrejti parimin e barazisë gjinore dhe standardet e përcaktuara nga aktet ndërkombëtare, të cilat Shqipëria i ka ratifikuar.

QNL i është referuar edhe përvojave të shteteve të tjera në lidhje me këtë dispozitë²⁶³ si edhe qëndrimin të doktrinës shqiptare²⁶⁴, e cila në interpretimin e këtij neni shprehet për nevojën e heqjes së tij.

QNL ka kërkuar përpara gjykatës së Apelit Tiranë të zbatoje nenin 145/2 të Kushtetutës të pezulloje gjykimin dhe të dërgojë çështjen për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar që neni 113 i Kodit Penal të shpallet në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në të, parimit të barazisë gjinore në shoqëri.

Ky është një shembull i shkëlqyer i rolit aktiv që një organizatë

²⁶³ International approaches to decriminalizing or legalizing prostitution”, Tetor 2007, botuar n www.procon.org

²⁶⁴ Ismet Elezi, “E drejta penale. Pjesa e Posaçme”, Tiranë, 2009, fq.153-155

jofitimprurëse mund të luajë duke lobuar me rekomandimet e Komitetit CEDAW.

Natyrshëm dekriminalizimi i prostitucionit do të kërkojë punë lobuese edhe për masa të tjera si ndërgjegjësim, edukim dhe trajnim për çështje të barazisë, abuzimit seksual dhe seksualitetit në përgjithësi, lobim me qëllim rritjen e masës së pagës minimale, financim të bizneseve që drejtohen nga gratë dhe vajzat, politika punësimi dhe strehimi, etj. Pra dekriminalizimi i prostitucionit, mbetet një platformë edhe për organizata të tjera jofitimprurëse.

LITERATURA:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” dhe Protokollit i saj Opsional.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995;
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- IWRAW ASIA PACIFIC OCCASIONAL PAPERS SERIES no. 13, “Protokollit Opsional I Konventës CEDAW si një mekanizëm për zbatimin e të drejtave të grave: një analizë e vendimeve 6-10 të Komitetit CEDAW sipas procedurës së komunikimit të Protokollit Opsional të Konventës CEDAW.
- Amnesty International Publications, “Its in our hands; Stop violence against women”, 2004.
- D.Kelly Weiseberg, “Applications of feminist legal theory to women’s lives. Sex, violence, work and reproduction”, Jody Freeman, “The feminist debate over prostitution reform”, 1993.
- Simone de Beauvoir, The Second Sex 524-525 (H.M.Parshely ed. & trans, Bantam Books, 1952)
- Rekomandimi i Përgjithshëm nr.19, në zbatim të nenit 6, të Konventës kundër të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.
- Ismet Elezi, “E drejta penale. Pjesa e Posaçme”, Tiranë, 2009
- www.qag-al.org
- <http://www.mpcs.gov.al>

